

HETIMI DHE GJYKIMI NË MUNGESË, PRECEDENT PËR PRISHJEN E VENDIMIT. POZITA PROCEDURALE E MBROJTËSIT NË KËTË PROCES.

Neshet NGUCAJ

**Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale**

**Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoraturës në
Shkenca Penale, me profil Penal, për marrjen e gradës shkencore
“Doktor“.**

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Skënder KAÇUPI

Numri i fjalëve 61 974

Tiranë, Dhjetor 2016

DEKLARATA E AUTORESISË

Nën përgjegjësinë time personale, deklaroj se ky studim është punë origjinale dhe nuk përmban plagjaturë. Punimi është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe të referuara, të vendosura sipas një bibliografie të mirëpërcaktuar.

© *Neshet Ngucaj*

Vlorë, më 20.12.2016

Dedikim.

Ia kushtoj familjes sime. Gjithmonë nxitje dhe burim frymëzimi për studim e mbrojtje vlerash.

Falënderim.

Respekt dhe mirënjohje për Prof. Dr. Skënder Kacupi për profesionalizmin, mbështetjen, këshillat dhe materialet që më ka ofruar në përmirësimin e cilësisë së këtij punimi.

Falënderim të veçantë për gjithë stafin akademik të Universitetit Evropian të Tiranës, të cilët kanë treguar përkushtim dhe profesionalizëm në përmbushjen e programit të studimeve doktorale.

Mirënjohje familjes, e cila ka qenë gjithmonë nxitje dhe burim frymëzimi për studim e mbrojtje vlerash.

ABSTRACT

Në vendin tonë, para vitit 1995 hetimi dhe gjykimi në mungesë thuajse nuk aplikohet sepse në bazë të Kodit të Procedurës Penale të vitit 1979, mungesa e të pandehurit përbënte shkak për pezullimin e procedimit. Situata ndryshoi me hyrjen në fuqi të Kodit të Ri të Procedurës Penale në vitin 1995, i cili e konsideronte praninë e të pandehurit gjatë hetimit dhe gjykit jo si një detyrim por si një të drejtë.

Ky qëndrim u përforcua me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së vitit 1998, pra u la në vullnetin e lirë të të pandehurit nëse dëshironte të ishte i pranishëm gjatë hetimit dhe gjykit ose jo. Instituti i “hetimit dhe instituti i gjykit në mungesë” është shoqëruar përgjithësisht nga debate, fillimisht për kushtetueshmërinë e tij dhe më vonë për rregulla të vecanta në përbërje të tij. Pavarësisht nga koha që ka kaluar nga hyrja në fuqi e kodit, në praktikë vazhdon të ketë probleme në lidhje me aplikimin e institutit të “hetimit dhe gjykit në mungesë” dhe garancive që i shoqërojnë.

Legjislatori ka parashikuar një sërë garancish për të pandehurin i cili gjykohet në mungesë dhe organit procedues i lind detyrimi që të krijojë kushtet e nevojshme që këto garanci të gjykit të gjejnë zbatim edhe për hetimin në mungesë. Një ndër garancitë më të rëndësishme që pason gjykimin në mungesë është instituti i “rivendosjes në afat”. Rivendosja në afat e së drejtës së ankimit ndaj vendimit që është dhënë në mungesë të të pandehurit, i cili nuk ka marrë pjesë në gjykim sepse nuk ka pasur dijeni për të, nga mënyra se si është formuluar dhe zbatimi në praktikë është shumë problematike.

Pikërisht për arsyet e mësipërme vendosa të trajtoj këtë temë, për të evidentuar problemet që dalin nga praktika gjyqësore apo nga vetë ligji, duke shprehur që ky punim të shërbejë sado pak në sqarimin e këtyre problemeve.

Fjalët kyce: hetim në mungesë, gjykim në mungesë, rivendosje në afat, i pandehur, ankimim etj.

ABSTRACT

In our country before 1995, the investigation and trial in absentia almost did not apply because under the Code of Criminal Procedure of 1979 the lack of the defendant constituted grounds for suspension of the proceedings. The situation changed with the entry into force of the new Code of Criminal Procedure in 1995, which considered the presence of the accused during the investigation and trial, not as an obligation but as a right. This attitude was reinforced by the entry into force of the new Constitution in 1998, so was left to the free will of the defendant if he wanted to be present during the investigation and trial or not. The Institute of Investigation and the Institute of the trial in absentia is generally accompanied by debates, initially for its constitutionality and later for special rules on its composition. Despite the time, that has elapsed since the entry into force of the code, in practice there are still problems concerning the application of the institute of investigation, trial in absentia and guarantees accompanying them. The legislator has provided a series of guarantees for the accused/defendant, who is tried in absentia and for this, there is the obligation of the proceeding body to create the necessary conditions that these guarantees of the trial be applied also for investigation in absentia. One of the most important guarantees following the trial in absentia is the Institute for Functional Restoration. Restoring in Function the right of appeal / complaint against the decision that has been given in absentia of accused / defendant, who did not attend the trial because he did not know about it, the way it is formulated and the implementation in practice is very problematic. Precisely for the above reasons I decided to treat this theme to identify the problems arising from the judicial practice or by the law, hoping that this paper serve in clarifying of these issues.

Key words: *investigation in absentia, trial in absentia, restoration in function, defendant, complaint, appeal, etc.*

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Deklarata e Autorësisë.....	2
Dedikim.....	3
Falënderim.....	4
Abstrakt.....	5
Lista e shkurtimeve dhe e fjalorit.....	12
Struktura e punimit.....	7

KAPITULLI I - HYRJE

1.1 Qëllimi i punimit.....	13
1.2 Objekti i punimit.....	13
1.3 Rëndësia e punimit.....	13
1.4 Metodologjia	14
1.5 Pyetjet kërkimore.....	14
1.6 Hipoteza.....	15
1.7 Aspektet strukture të punimit.....	15

KAPITULLI II

HETIMI DHE GJYKIMI I TË PANDEHURIT NË MUNGESË, NËN VËSHTRIMIN HISTORIK

2.1 E drejta zakonore shqiptare (kanunet).....	19
2.2 Kodi i Procedurës Penale Otomane i zbatueshëm në Shqipëri.....	20
2.3 Statuti Themeltar i Republikës Shqiptare i vitit 1925	22
2.4 Kushtetuta e 1946 dhe Kodi i Procedurës Penale i 1953	22
2.5 Kushtetuta e 1976 dhe Kodi i Procedurës Penale i 1979.....	24
2.6 Kushtetuta e 1998 dhe K.Pr.Penale i 1995 me ndryshimet.....	24

KAPITULLI III

VËSHTRIM KRAHASUES

3.1	Itali.....	26
3.2	Kosovë.....	30
3.3	Francë.....	30
3.4	Portugali.....	32
3.5	Gjermani.....	32
3.6	USA	33
3.7	Angli.....	34
3.8	Çeki.....	34

KAPITULLI IV

HETIMI NË MUNGESË , TË DREJTAT PROCEDURIALE TË TË PANDEHURIT NË MUNGESË DHE MBROJTËSIT KRYESISHT

4.1	Hetimet paraprake.....	35
4.2	Garancitë procedurale të hetimit në mungesë.....	36
4.3	Efiçenca e mbrojtësit kryesisht gjatë hetimit në mungesë.....	38
4.4	Rastet e pezullimit gjatë hetimit në mungesë.....	39

KAPITULLI V

GJYKIMI I TË PANDEHURIT NË MUNGESË

5.1	Rastet e gjykimit në mungesë.....	42
5.2	Garancitë procedurale të gjykimit në mungesë.....	44
5.2.1	Heqia dorë vullnetarisht nga prania në gjykim.....	45
5.2.2	Deklarimi i mungesës së të pandehurit.....	46
5.2.3	Mosmarrja e njoftimit dhe pamundësia absolute për t’u paraqitur.....	47
5.2.3.1	Shkaqet e pamundësisë absolute të paraqitjes së të pandehurit, terminologjia.....	48

5.2.4 E drejta e të pandehurit për t’u përfaqësuar.....	49
5.2.5 Paraqitja në çdo kohë e të pandehurit.....	50
5.2.6 Përsëritja e shqyrtimit gjyqësor.....	50
5.2.7 Garanci të tjera.....	51

KAPITULLI VI

NJOFTIMET

6.1 Njoftimi i akteve të prokurorit të pandehurit.....	52
6.2 Njoftimi dhe pjesëmarrja e të pandehurit në gjykim, në shkallë të parë.....	53
6.2.1 Mosrespektimi i dispozitave për njoftimin e të pandehurit pasi sjell pavlefshmëri të akteve.....	55
6.2.1.1 Format e njoftimit.....	56
6.3 Njoftimi i të pandehurit dhe pjesëmarrja gjatë gjykimit në Apel.....	56
6.3.1 Dallimi midis “urdhërimit për thirrje” dhe “njoftimeve”.....	57
6.3.2 A do të përdoret si bazë ligjore neni 140 i K.Pr.Penale për njoftimin e të pandehurit me masë sigurimi personal “arrest në burg” në mungesë ?....	59
6.4 Njoftimi dhe pjesëmarrja e të pandehurit, në Gjykatën e Lartë.....	61

KAPITULLI VII

E DREJTA E ANKIMIT NDAJ VENDIMIT TË DHËNË NË MUNGESË

7.1 Neni 410/2 të Kodit i Procedurës Penale.....	64
7.1.1 Pse nuk i duhet njohur e drejta e ankimit mbrojtësit, pa prokurë të posaçme nga i pandehuri, ndaj vendimit të dhënë në mungesë.....	65
7.1.2 Pse i duhet njohur e drejta e ankimit, mbrojtësit pa prokurë të posaçme nga i pandehuri ndaj vendimit të dhënë në mungesë.....	68
7.1.2.1 Nje argument në favor të qëndrimit të Gjykatës Kushtetuese.....	70
7.2 Zbatimi në praktikë dhe pasojat e vendimit nr.15, datë 17.04.2003 të Gjykatës Kushtetuese.....	71

KAPITULLI VIII

RIVENDOSJA NË AFATIN E ANKIMIT

8.1 Rivendosja në afatin e ankimit, kur afati është humbur për shkak të rastit forcës madhore.....	73
8.2 Rivendosja në afatin e ankimit të vendimit, për të pandehurin e gjykuar në mungesë	75
8.2.1 Është e drejtë rivendosja në afat të ankimit ndaj vendimit për njohjen e një vendimi penal të huaj?.....	76
8.2.2 Kërkesat ligjore që kushtëzojnë rivendosjen në afat.....	78
8.2.2.1 A duhet që afatet të jenë të kthyeshëm?.....	79
8.2.2.2 Legjitimitimi i personave për të paraqitur kërkesën për rivendosje në afat.....	81
8.2.2.3 I pandehuri nuk duhet të ketë dijeni për vendimin e dënimit.....	84
8.2.2.4 Mosmarrja e dijenisë për vendimin të mos ketë ardhur për faj të të pandehurit.....	85
8.2.2.5 Mosezaurimi nga mbrojtësi i të drejtës së ankimit nga i pandehuri.....	86
8.2.2.5.1 A do t’i njihet e drejta të pandehurit të kërkojë rivendosje në afat, kur kanë bërë ankim bashkë të pandehurit e tjerë.....	88
8.2.2.6 Rivendosja në afat nuk lejohet më shumë se një herë për secilën palë dhe për secilën shkallë gjykimi.....	90
8.2.3 Afati i parashikuar nga ligji për paraqitjen e kërkesës së rivendosjes në afat.....	91
8.2.3.1 A është i mjaftueshëm afati dhjetë ditor për personin që pritet të ekstradohet..	91
8.2.3.2 Momenti i marrjes dijeni efektivisht për vendimin e dhënë ndaj të pandehurit	92
8.2.4 Gjykata kompetente për rivendosje në afat.....	94
8.2.4.1 Numri i gjyqtarëve për shqyrtimin e kërkesës.....	94

8.2.5	Ankimimi ndaj vendimit që lejon apo refuzon rivendosjen në afat.....	95
8.2.6	Sa efektiv është instituti i rivendosjes në afat?.....	96
8.2.7	Pasojat e rivendosjes në afat.....	98
8.2.7.1	Kur pranon kërkesën për rivendosje në afat Gjykata a mundet që të urdhërojë pezullimin e ekzekutimit të dënimit?.....	99
8.2.8	Raste praktike.....	101
8.2.8.1	Rast praktik.....	101
8.2.8.2	Rastpraktik.....	102
8.2.8.3	Rast praktik.....	105
8.2.8.4	Rast praktik.....	110
8.2.8.5	Rast praktik.....	111
8.2.8.6	Rast praktik.....	117
8.2.8.7	Rast praktik.....	121
8.2.8.8	Çështja Somogy kundër Italisë.....	127
8.2.8.9	Çështja Sejdovic kundër Italisë.....	129

KAPITULLI IX

POZITA PROCEDURALE E MBROJTËSIT TË TË PANDEHURIT GJATË GJYKIMIT NË MUNGESË

9.1	Pozita e mbrojtësit të të pandehurit në mungesë.....	135
9.2	Mbrojtësit e caktuar kryesisht nga organi procedues.....	136
9.3	Mbrojtësi i zgjedhur nga familjarët.....	138

KAPITULLI X

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

10.1	Konkluzione.....	139
10.2	Rekomandime.....	141
BIBLIOGRAFIA		148

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

BE - Bashkimi European

KPP- Kodi i Procedurës Penale

KPPI- Kodi i Procedurës Penale Italiane

KPPGJ- Kodi i Procedurës Penale Gjerman

KPPK- Kodi i Procedurës Penale të Kosoves

KPPRC- Kodi i Procedurës Penale të Republikës Ceke

GJEDNJ - Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut

GJSHP - Gjykata e Shkallës së Parë

GJA- Gjykata e Apelit

GJRGJ - Gjykata e Rrethit Gjyqësor

KBGJL - Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë

KPGJL- Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë

KEDNJ - Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut

KE - Komuniteti European

KPRSH –Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë

KRSH - Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

RSH - Republika e Shqipërisë

VUP - Vendim Unifikues Penal

VGJEDNJ- Vendime të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut

DUDNJ- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut

PNDGP- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile e Politike

KAPITULLI I

HYRJE

1.1 QËLLIMI I PUNIMIT

Qëllimi i këtij studimi është hulumtimi shkencor dhe krahasues në raport me disa shtete të rajonit mbi metodikën e hetimit dhe gjykimin në mungesë dhe roli i avokatit të caktuar kryesisht.

Në lidhje me institutin e hetimit dhe gjykimin në mungesë vende të ndryshme kanë pasur dhe kanë qëndrime të ndryshme; kjo varet edhe nga fakti se cilës familje ligjore i përket. Që në kohët më antike hetimi dhe gjykimi në mungesë ka sjellë mjaft probleme në të drejtën për t'u hetuar dhe gjykuar.

Po të marrim një shoqëri siç ishte ajo romake, ku vlera e fjalës ishte në besueshmërinë absolute dhe personi mund të aplikonte mekanizmat dhe garancitë që ofronte e drejta romake ndërsa mosaplikimi i tyre nënkuptonte pranimin e fajit, si rrjedhim pasoja e ardhur do të konsiderohej normale.

1.2 OBJEKTI I PUNIMIT

- Zhvillimin historik të institutit të hetimit në mungesë duke e parë në periudha të ndryshme të zhvillimit të së drejtës shqiptare duke përfshirë edhe kodin aktual me gjithë ndryshimet e tij në kohë.
- Nëpërmjet një vështrimi krahasues të institutit të hetimit në mungesë jam munduar të nxjerr në pah të përbashkëtat dhe dallimet që ka vendi ynë me vendet e tjera, si: Portugalia, Italia, Gjermania, Sh.B.A etj.
- Evidentimin e problemeve aktuale në këtë fushë.

1.3 RËNDËSIA E PUNIMIT

Të njihemi me:

- a) Procedurën e hetimit dhe gjykimin në mungesë në vendin tonë dhe në disa vende të rajonit.
- b) Rolin e avokatit të caktuar kryesisht në hetimin dhe gjykimin në mungesë të të pandehurit.

- c) Evidentimi i mangësive dhe avantazheve që krijohen nga kjo procedurë në krahasim me vendet e rajonit.
- d) Disa rekomandime për përmirësimin e këtij procesi;

Të identifikojmë problematikat aktuale lidhur me:

- Garancitë procedurale të gjyqimit në mungesë
- Rivendosjes në afatin e ankimit të vendimit, për të pandehurin e gjykuar në mungesë,
- Orientimin për zgjidhje të këtyre mangësive në kuadrin ligjor dhe institucional.

1.4 METODOLOGJIA E PUNIMIT

- Nëpërmjet një analize të mënyrës së hetimit dhe gjyqimit në mungesë, në lidhje me:
 - Rastet e hetimit dhe gjyqimit në mungesë, njoftimit dhe pjesëmarrjes së të pandehurit në gjykim ,
 - Të drejtës së ankimit ndaj vendimit të dhënë në mungesë.
 - Rivendosjes në afatin e ankimit.
 - Rigjykimi.
- Rekomandime për përmirësimin e bashkëpunimit.

1.5 PYETJET KERKIMORE

- a) A ka efikasitet procesi i hetimit dhe gjyqimit në mungesë në Shqipëri apo ekziston thjesht si një shtojcë legjislative e akteve juridike, dhe a luan rol avokati i caktuar kryesisht në çështje?
- b) Si funksionon procesi i hetimit dhe gjyqimit në mungesë në Shqipëri, krahasuar me vendet e tjera të rajonit të BE-së dhe SHBA-së?
- c) Cilat janë problematikat aktuale lidhur me hetimin dhe gjykimin në mungesë, mangësitë dhe pasojat ?
- d) Sa të qëndrueshëm janë vendimet e dhëna në mungesë të të pandehurit?
- e) A është domosdoshmëri rivendosja në afat për të pandehurin e hetuar dhe gjykuar në mungesë?
- f) Cilat janë zgjidhjet e mangësive në kuadrin ligjor dhe institucional?

1.6 HIPOTEZA

Përshtatja dhe adoptimi i legjislacionit tonë procedural me atë gjerman lidhur me hetimin dhe gjykimin në mungesë do të krijonte një standart më të garantuar lidhur me të drejtat procedurale të të pandehurit dhe do të zgjidhte kalvarin e rivendosjes në afat, do të shmangte investimin e dyfishtë të gjykatës, do të bënte vendimet e Gjykatave më të qëndrueshme.

1.7 ASPEKTET STRUKTURE TË PUNIMIT

Në kapitullin e parë të punimit trajtohet një informacion i përgjithshëm teorik mbi objektin e studimit, pyetjet kërkimore, metodologjinë, qëllimin, hipoteza dhe aspektet strukturore të punimit.

Në kapitullin e dytë të punimit trajtohet një zhvillim historik i institutit të hetimit dhe gjykimin në mungesë duke e parë në periudha të ndryshme të zhvillimit të së drejtës zakonore shqiptare, normat procedurale të pashkruara në Kanunin e Labërisë, Lekë Dukagjinit, të Skënderbeut dhe kanuneve të tjera. Kodi i Procedurës Penale Otomane dhe zbatimi i tij në Shqipëri; Statuti Themeltar i Republikës Shqiptare miratuar më 07/03/1925 (në fuqi deri më 1 shtator 1928); Kushtetuta e vitit 1946 dhe Kodi i Procedurës Penale i vitit 1953; Kushtetuta e vitit 1976 dhe Kodi i Procedurës Penale i vitit 1979; Kushtetuta e 1998 dhe K.Pr.Penale i vitit 1995 me ndryshimet. Bazë për trajtimin e këtij kapitulli është legjislacioni shqiptar ndër vite dhe e drejta zakonore. Në këtë kre kam bërë një përshkrim historik të lindjes së përgjegjësisë penale dhe gjykimin në mungesë, sigurimit të provave të mjaftueshme për të marrë një person në cilësinë e të pandehurit në mungesë.

Në kapitullin e tretë është vijuar me trajtimin e institutit të hetimit dhe gjykimin në mungesë nën vështirimin krahasues, duke nxjerrë në pah të përbashkëtat dhe dallimet që ka vendi ynë me vendet e tjera. Shtetet të cilat kam trajtuar janë:

Italia për shkak të ngjashmërive që ka me legjislacionin tonë; Franca për faktin se i bën një trajtim krejt të kundërt nga ne, po për të njëjtën arsye edhe Gjermania e Portugalia si vende që nuk e njohin hetimin dhe gjykimin në mungesë dhe problemet që i kanë lindur si rezultat i këtij fakti; vendet e Common-loë, USA dhe Anglia si vende që i bëjnë një trajtim ndryshe për shkak të traditës që kanë.

Në kapitullin e katërt kam bërë një analizë mbi:

- të drejtat procedurale gjatë hetimit të të pandehurit në mungesë si subjekt i të drejtave procedurale gjatë procesit hetimor;
- detyrat e organit të akuzës në rregullimin e kufijve të të drejtave procedurale të të arrestuarit, të ndaluarit, të akuzuarit në mungesë në këtë proces, dhe mbrojtësit të caktuar kryesisht (neni 49 K.Pr.Penale);
- marrjen dijeni për veprën dhe autorin nga organi i akuzës (neni 280 K.Pr.Penale);
- kërkimin e personit që nuk gjendet, (neni 247 K.Pr.Penale);
- deklarimin me vendim nga organi i akuzës për mosgjetjen e të pandehurit gjatë hetimit paraprak (neni 247 K.Pr.Penale);
- vështirësitë që dalin për respektimin konform nenit 6, të " Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut" për të pandehurin në mungesë si: e drejta e informimit për akuzën e ngritur kundër tij, t'i jepet koha e nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes, e drejta për të patur një mbrojtës, e drejta për të pyetur dëshmitarët, e drejta për të patur një përkthyes falas etj, - efienca e mbrojtësit kryesisht, gjatë hetimit.

Në kapitullin e pestë trajtohet gjykimi i të pandehurit në mungesë, i cili si institut i pranuar nga e drejta procedurale penale në vendin tonë është një zgjedhje midis interesit publik nga njëra anë për të ndëshkuar krimin e kryer nga individët, dhe interesit individual nga ana tjetër, që është e drejta e të pandehurit për të qenë i pranishëm për t'u dëgjuar dhe gjykuar. Nga ana e legjislatorit ky konflikt interesash është zgjidhur në favor të interesit publik duke pranuar institutin e hetimit dhe gjykimit në mungesë me Kodin e Procedurës Penale në 1995 dhe e saksionuar në Kushtetutën e vitit 1998. Si dhe përpjekjet që ka bërë legjislatori për të siguruar në një farë mënyre një standart të të drejtave në procesin penal, duke i garantuar të pandehurit një proces të rregullt ligjor.

Pra, synohet mbrojtja e interesave të shtetit dhe individëve që dëmtohen nga vepra penale, por pa cënuar të drejtat procedurale të personit që akuzohet për një vepër penale. Shqipëria është një vend akoma në tranzicion, me probleme të mëdha në regjistrimin e popullsisë dhe me faktimin lëvizje migruese e emigruese, faktorë që përbëjnë vështirësi objektive për organet proceduese në gjetjen e të pandehurve pavarësisht nga kërkimet që bëhen. Duket se gjykimi në mungesë i të pandehurit i përshtatet klimës aktuale shoqërore në Shqipëri, sepse e kundërta do të çonte në zvarritje pa fund të procedimeve penale dhe në një stanjacion të gjykimeve.

Kapitulli i gjashtë përmban problematikën që është hasur në praktikë në lidhje me institutin e njoftimeve, i cili përbën një nga garancitë që shoqëron hetimin dhe gjykimin në mungesë (neni 141/3 të K.Pr.Penale, njoftimi i bëhet mbrojtësit). Nëse nuk kemi njoftime efektive nuk mund të kemi as një proces të rregullt ligjor. Kreun do ta ndaj në tre pjesë ku secila do t'i korrespondojë një shkallë gjykimi. Problemet kryesisht do t'i evidentoj nga praktika, e cila nxjerr probleme për mënyrën se si realizohet njoftimi i të pandehurit në raste të ndryshme.

Të njohësh një person me procedimin e nisur ndaj tij, është një akt juridik që duhet të plotësojë disa kushte, qoftë nga ana formale dhe ajo substanciale, me qëllim që të garantojë të drejtat e të pandehurit. Kjo kërkon një dijeni të plotë të të pandehurit sipas dispozitave të parashikuara nga neni 141 i K.Pr.Penale. Mosrespektimi i dispozitave për njoftimin e të pandehurit sjell pavlefshmëri të akteve (neni 128/c i K.Pr.Penale).

Në kapitullin e shtatë është trajtuar ankimi si një prej çështjeve më të diskutuara në jurisprudencën shqiptare në lidhje me gjykimin në mungesë. Kam parashtuar diskutimet që janë bërë nga Gjykata Kushtetuese dhe nga Gjykata e Lartë në lidhje me të drejtën e mbrojtësit për të bërë ankim ndaj vendimit të dhënë në mungesë të të pandehurit, kur nuk është i pajisur me prokurë të posaçme nga ky i fundit. Gjithashtu do t'i bëjë një analizë pasojave që erdhën si rezultat i shfuqizimit të bërë nga Gjykata Kushtetuese nenit 410/2 të K.Pr.Penale. Analiza do të mbështetet kryesisht në praktikën e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë.

Në kapitullin e tetë në mënyrë të zgjeruar është bërë një analizë për institutin e rivendosjes në afat (neni 147/2 të K.Pr.Penale) duke u përpjekur të përfshijë të gjitha problemet që kanë dalë nga praktika, si dhe nga trajtimet teorike. Rastet se kur flitet për rivendosjen në afat të së drejtës për të bërë ankim ndaj vendimit të dhënë në mungesë, do të bëjë një analizë të hollësishme në lidhje me kushtet që duhet të vërtetohen që të pranohet kërkesa, - cila është Gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës, - afati brenda të cilit duhet të paraqitet kërkesa, - e drejta e ankimit ndaj vendimit që lejon apo refuzon rivendosjen në afat si dhe pasojat që sjell rivendosja në afat, - rikthimin në gjykim i të pandehurit, - sjellja e provave prej tij dhe për pasojë dhënia e një vendimi të ndryshëm nga i pari pra, investimi i dyfishtë financiar i Gjykatës.

Në kapitullin e nëntë është trajtuar pozita procedurale dhe efienca e një mbrojtësi kur i pandehuri është në mungesë, si një nga garancitë që lidhet detyrimisht me gjykimin në

mungesë. Fillimisht trajtoj pozitën procedurale në përgjithësi të mbrojtësit, të të pandehurit në mungesë dhe do të trajtoj:

- mbrojtësin e zgjedhur nga familjarët apo i caktuar kryesisht nga Gjykata në gjykim
- kur nuk ka mundësi financiare,
- caktimin e mbrojtësit kryesisht gjatë gjykimit në mungesën e të pandehurit shkak për prishjen e vendimeve.
- garancitë që shoqërojnë një gjykim në mungesë të të pandehurit, siç janë p.sh., e drejta e përfaqësimit nga mbrojtësi si një e drejtë procedurale dhe kushtetuese, të drejtën e paraqitjes në çdo kohë e të pandehurit,
- përsëritja e shqyrtimit gjyqësor, (neni 427/4 i K.Pr.Penale) kur rezulton se nuk është respektuar procedura sipas nenit 141 të K.Pr.P,
- mosmarrja dijeni dhe pamundësia për t'u paraqitur në gjykim e të pandehurit,
- identifikimi i shkaqeve,
- deklarimi i mungesës (neni 351 i K.Pr.P).

Gjithashtu në këtë kapitull kam trajtuar gjykimin në mungesë (neni 352 i K.Pr.P) si institut, duke trajtuar rastet doktrinale. Analizën do ta bëj duke u bazuar kryesisht në praktikën e Gjykatës së Lartë si edhe në literatura të ndryshme.

Në kapitullin e dhjetë kam dalë në konkluzione dhe rekomandime për përmirësimin e legjislacionit.

KAPITULLI II

HETIMI DHE GJYKIMI I TË PANDEHURIT NË MUNGESË, NËN VËSHTRIMIN HISTORIK

E drejta shqiptare është ndikuar nga e drejta e huaj dhe në përgjithësi nuk ka ndjekur një përvojë të sajën të zhvillimit. Kjo, për shkak të pushtimeve të vazhdueshme nën të cilat është gjendur vendi ynë, sipas periudhave të ndryshme, p.sh në periudhën e principatave ka pasur një ndikim të fortë e drejta *bizantine* dhe në periudhën e mesjetës ka patur ndikim nga e drejta *feudale*.

Po ashtu, një e drejtë tjetër që është zbatuar në disa zona të thella të Shqipërisë për shkak të terrenit të thyer malor dhe mungesës së aparatit shtetëror dhe nevojës për t'u vetëqeverisur, ka qënë e drejta zakonore ose e thënë ndryshe (kanunet). Kjo e drejtë, origjina e së cilës është shoqëria fisnore u rigjallërua dukshëm gjatë pushtimit osman¹.

Shqipëria, me pushtimin turk filloi të zbatonte të drejtën otomane, (ndryshe sheriati) dhe deri në shpalljen e pavarësisë legjislacioni procedural penal i zbatueshëm në Shqipëri ka qënë legjislacioni penal otoman, legjislacion i cili shërbeu si bazë në vitet që vijuan pas pavarësisë, por me ndryshime të herëpashershme që iu bënë nga qeveritë shqiptare të pas pavarësisë.

Pas Luftës së Dytë Botërore, në Shqipëri u miratua Kodi i Procedurës Penale me ligjin nr.1650 dt.30.03.1953 i cili shërbeu për afro një dekadë e gjysmë, deri në ndryshimin e Kushtetutës dhe bashkë me të u bë edhe ndryshimi disa ligjeve të tjera. Më 1980 hyri në fuqi Kodi i Ri, i cili vazhdoi të zbatohet edhe pas viteve 90-të me disa ndryshime deri në 21 mars të vitit 1995 kur u miratua ligji nr.7905, Kodi aktual i Procedurës Penale, i cili ka pësuar ndryshime vit pas viti, me gjithë ndryshimet e bëra në kohë.

Po a njihet në të drejtën zakonore dhe nëse njihet, si është trajtuar në periudha të ndryshme instituti i hetimit dhe gjyqimit në mungesë i të pandehurit në vendin tonë?

2.1. E drejta Zakonore Shqiptare (Kanunet).

Normat procedurale të parashikuara në Kanunin e Labërisë, janë thuajse të njëjta me normat e Kanunit të Lekë Dukagjinit, të Kanunit të Skënderbeut dhe kanuneve të tjerë si në përmbajtje dhe shpesh herë edhe në formë, gjë që dëshmon për karakterin dhe mentalitetin e ngjashëm shqiptar në të gjitha zonat në zbatimin e këtyre normave².

¹ "Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri", Pjesa e dytë, Luarasi, fq. 4

² Prof. Dr. Ismet Elezi "E drejta zakonore e Labërisë" fq. 199

Në të drejtën zakonore gjyqet zhvilloheshin nga pleqësia, që përbëhej nga persona të zgjedhur nga palët e interesuara dhe luanin më shumë rolin e një arbitrazhi, pra nuk mund të flitet për një administratë të nivelit të mirfilltë gjyqësor. Këto pleqësi krijoheshin për të gjykuar, jo si pjesë e administratës së gjyqësorit të shtetit osman, por pjesë e komunitetit (zonës ku banonin) dhe quheshin (Gjykata pleqsh) të cilat merrnin në shqyrtim çështjet konkrete rast pas rasti³.

Mosmarrëveshjet ndërmjet individëve merrreshin në shqyrtim nga kuvendi me ankimin e palëve pasi nuk kishin karakter publik. Të gjitha kanunet nuk shprehen për prezencën e të pandehurit për të qenë i pranishëm gjatë hetimit apo gjykimit që bëhej nga pleqtë, por njih rastet e ndërhyrjes së ndërmjetësve për të ndikuar mbi ta kur ndonjëra nga palët nuk donte që t'i nënshtrohej gjykimit të pleqve⁴. Për t'u patur në konsideratë si një veçori e rëndësishme e së drejtës zakonore është fakti se, përgjegjësia shpesh binte mbi të zotin e shtëpisë, çka do të thotë se nuk kishte rëndësi se kush e kryente veprën; pra prezenca e tij nuk ishte e rëndësishme, mjafton të përgjigjeshin në investim familjarët ose të afërmit e tij.

2..2 Kodi i Procedurës Penale Otomane, dhe zbatimi i tij në Shqipëri.

Legjislacioni procedural penal otoman, veprat penale i ndante në *kontravencione* (kundravajtje), *delikte* dhe *krime*. Duke patur parasysh këtë ndarje ishte e thjeshtë për të përcaktuar nëse personi mund të gjykohej në prezencë ose në mungesë të tij.

Sipas Kodit të Procedurës Penale otomane të vitit 1879, i cili kishte si model Kodin e Napoleonit të vitit 1808⁵, kundërvajtjet ishin për kompetencë të Gjykatave policore të thjeshta, si shkallë e fundit. Njoftimet për kundravajtjet bëheshin mbi kërkesën e funksionarit që ushtronte një detyrë publike ose të paditësit personal dhe i njoftoheshin të pandehurit me anë të një ftuesi gjyqësor. Palët kishin të drejtën që të paraqiteshin edhe me dëshirën e tyre pa qenë nevoja për fletëthirrje, por në qoftë se personat e thirrur rregullisht nuk paraqiteshin, atëherë procedohej me hetimin dhe gjykimin në mungesë. Në fund të aktit të njoftimit të cdo vendimi të dhënë në mungesë mund të deklaroheshin kundërshtimi i tij, ose brenda një afati tre ditor nga komunikimi vendimit, humbiste të drejtën e një gjykimi tjetër. Por edhe nëse kundërshtohej dhe apeluesi nuk paraqitej në seancën e parë të apelimit atëherë kundërshtimi do të konsiderohej nul.

³ Prof. Dr. Ismet Elezi "E drejta zakonore e Labërisë" fq. 197

⁴ "Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri", Pjesa e dytë, Luarasi, fq. 69

⁵ Halim Islami "Demokratizimi i Legjislacionit Penal" fq.12

Krimet dhe deliktet, të trajtuara në kapitullin e dytë të kodit “ *Padia në mungesë dhe çështjet kriminale*”, në lidhje me to lejohej hetimi dhe gjykimi në mungesë vetëm pasi bëheshin njoftimet përkatëse për çdo fazë procedimi dhe gjykimi (neni 371)⁶.

Deklarimi i mungesës së të pandehurit do të sillte pasoja të caktuara për të dhe konkretisht:

- Do të pezullohej nga ushtrimi i të drejtave si qytetar.
- Do t’i sekuestrohej pasuria e tij kudo që ishte, gjatë mungesës së tij.
- I mohohet çdo e drejtë për të kryer ndonjë veprim gjyqësor gjatë kohës që ishte në mungesë;
- Do të dekonspirohej nga çdo qytetar për të cilin ishte detyrim të tregonte se ku fshihej i pandehuri.

Ky vendim afishohej në portën e banesës së të pandehurit, në portën e Gjykatës, dhe në portën e Prefekturës. Gjithashtu, vendimi i vihej në dispozicion edhe organit që procedon me sekuestrimin e pasurisë së të pandehurit, e cila do të fillonte mbas 10 ditëve të njoftimit, dhe ndërkohë procedohet me gjykimin në mungesë. I pandehuri, i cili është deklaruar në mungesë përjashtohet nga e drejta e mbrojtjes, me përjashtim kur i pandehuri ishte jashtë territorit të shtetit dhe ishte në pamundësi absolute për t’u paraqitur. Në këto raste prindërve, të afërmeve si dhe miqve e dashamirësve të tij u njihej e drejta të paraqitnin dhe të arsyetonin shkaqet para gjykatës, e cila pasi shqyrtonte shkaqet dhe vlerësonte legjitimitetin e tyre vendoste pezullimin e sekuestros dhe të gjykitimit brenda afatit që ajo vlerësonte të arsyeshme duke gjykuar nga shkaqet penguese dhe largësinë ku ndodhej i pandehuri. Në qoftë se nuk kishte shkaqe të arsyeshme ose Gjykata i konsideronte jolegjitime, quhej se ishte konsumuar mundësia e prezencës dhe në këtë rast procedohej me gjykimin në mungesë të të pandehurit.

Në portën e banesës së fundit të të dënuarit, në portën e Prefekturës si dhe në portën e Gjykatës afishohej brenda tetë ditëve nga dita e shpalljes, një kopje, shkurtim i vendimit të dhënë në mungesë. Ky shkurtim vendimi brenda tetë ditëve duhej të botohej në gazetën e zonës pranë së cilës ka patur banesën e fundit i dënuari dhe i dërgohej autoritetit kompetent ku ndodhej pasuria e sekuestruar. Nga momenti i dhënies së vendimit, pasuritë

⁶ Në nenin 371” Nëse nuk kishte qënë e mundur që të kapej i pandehuri ose nuk paraqitej brenda dhjetë ditëve nga dita që ishte njoftuar në banesën e tij ose pasi ishte kapur por ishte larguar nga burgu, kryetari i Gjykatës ose në mungesë të tij anëtar i vjetër i Gjykatës nxirrte një urdhër në të cilin përcaktonte një afat të ri dhjetë ditë brenda të cilit i pandehuri duhej të paraqitej. Në te kundërt ai deklarohet “ rebel dhe kundraligjeve .”

e sekuestruara, deri në afatin e parashkrimit të dënimit prej 20 vjetësh do të qëndronin të ngrira, përveç një pjese që në rast nevojë mund t'i lihej familjes .

Prokurorit të Përgjithshëm dhe paditësit u njihej e drejta për të bërë rekurs në Gjykatën e Diktimit.

Kur i pandehuri paraqitej vetë ose kapej (arrestohej), para se të ishte parashkruar vendimi i dënimit i dhënë në mungesë të tij, të gjitha veprimet e kryera nga nxjerrja e urdhërit për deklarimin e mungesës, sipas nenit 371, e deri në atë moment do të konsideroheshin nul de jure. Edhe në qoftë se personi i hetuar dhe gjykuar në mungesë do të rezultonte i pafajshëm gjatë rigjykimit, ai do të dënohej administrativisht për pagimin e shpenzimeve që ishin bërë për gjykimin e tij në mungesë.

2.3. Statuti Themeltar i Republikës Shqiptare i vitit 1925

Për gjykimin në mungesë në disa raste janë shprehur Kushtetutat apo Statutet që kanë qenë në fuqi në vendin tonë. Statuti Themeltar i Republikës së Shqipërisë, i miratuar me 07/03/1925, i cili ka qenë në fuqi deri 1 shtator 1928, sipas këtij statuti, nenit 101 të tij: I akuzuari për një krim duhet që në momentin e marrjes nën akuzë të mbrohet nga një mbrojtës dhe nëse nuk e ka marrë vetë ia cakton Gjykata kryesisht. Pozita e të pandehurit të hetuar dhe gjykuar në mungesë nuk përmendet në statut.⁷

Kushtetuta e Mbretinisë Shqipëtare e miratuar më 01.12.1928, si dhe Statuti Themeltar miratuar ne 07.03.1925, nuk kanë parashikuar ndonjë trajtim të veçantë lidhur me hetimin dhe gjykimin në mungesë⁸.

2.4 Kushtetuta e vitit 1946 dhe Kodi i Procedurës Penale i vitit 1953.

Pas Luftës së Dytë Botërore u ndryshua rendi shoqëror në Shqipëri dhe u desh të miratohej Kushtetuta e vitit 1946⁹, e cila trajtonte në mënyrë eksplicite se askush nuk mund të gjykohej pa u dëgjuar, pa patur një mbrojtje efektive konform dispozitave ligjore lidhur me mbrojtjen, e cila konsiderohet një prioritet, vec kur mungesa e tij vërtetohet konform ligjit.

Kodi i Procedurës Penale doli rreth shtatë vjet më vonë. Nxjerrja e tij u bë e mundur vetëm me aprovimin nga Kuvendi Popullor i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 1650, dt. 30.03.1953 "Kodi i Procedurës Penale". Gjatë periudhës tremujore veprohej

⁷ Statuti Themeltar i Republikës së Shqipërisë, miratuar nga Asambleja Kushtetuese më 07.03.1925

⁸ Kushtetuta e Mbretinisë Shqipëtare, miratuar nga Asambleja Kushtetuese më 01.12.1928

⁹ Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë, miratuar me dekretin nr.24 të Presidiumit të Asamblesë Kushtetuese më dt. 15.03.1946.

nëpërmjet një urdhërese të bazuar në norma procedurale, deri më 1 qershor 1953 kur hyri në fuqi ligji nr.1650, dt. 30.03.1953, nëpërmjet të cilit u përcaktuan në mënyrë të plotë rregullat e procedimit penal.¹⁰

Sipas nenit 101 të këtij kodi procedure, hetimi i çështjes penale ndahet në gjurmime dhe veprime hetuesie. Gjurmimet (neni 104) bëheshin nëpërmjet organeve të gjurmimit të cilat ishin:

- a)- organet e policisë popullore dhe organet e tjera që barazohen me të.
- b)- organet e kontrollit, inspektoriatit financiar, tregtar-sanitar dhe të punës si dhe organet e tjera administrative për çështjet që janë në kompetencën e tyre.
- c)- komandat e njësive dhe reparteve ushtarake si dhe të ngarkuarit për hetimin e krimeve të kryera prej ushtarakëve.

Në çështjet për të cilat hetuesia nuk është e detyrueshme, organet e gjurmimit kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për hetimin e plotë të çështjes, duke ndjekur rregullat e parashikuara në nenin 105 të K.Pr.Penale.

Në nenin 233 të këtij kodi parashikohet se prezenca e të pandehurit në gjykim është e detyrueshme dhe vetëm tre janë rastet kur mund të gjykohej pa prezencën e të pandehurit:

- 1) *Kur nuk parashikohet heqje lirie për krimin e kryer;*
- 2) *Kur kërkohet nga vetë i pandehuri në seancë.*
- 3) *Kur nga hetimi del qartë se i pandehuri nuk ka shkaqe të parashikuara në ligj për mosparaqitjen e tij, por i shmanget gjykimit.*

Këtë çështje e ka trajtuar Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr.19, dt.30.03.1957, i cila ka dalë në konkluzionin se edhe kur i pandehuri ka dijeni nëse nuk është i pranishëm, Gjykata nuk mund të gjykojë në mungesë, pasi mosprezenca e tij nuk do të thotë se i shmanget gjykimit.

Para hyrjes në fuqi të K.Pr.Penale, gjykoheshin në mungesë edhe të pandehurit që nuk paraqiteshin apo lajmëronin Gjykatën për mungesën e tyre, dhe kur ishin njoftuar rregullisht sipas ligjit, kishin njoftim për ditën dhe orën e gjykimit kjo bënte që Gjykata të procedonte në mungesë të të pandehurit. Në këtë rast debati i provave bëhej në mungesë, si pasojë edhe vendimi, i cili i komunikohet të pandehurit¹¹.

¹⁰ Ligji nr.1650 dt.30/03/1953 g.z.nr.7/1953,ndryshuar me dekretin nr.1776dt.3/12/1953 ,g.z nr.17/1953dhe me ligjin nr.2805dt.4/12/1958.G.Z.nr.16/1958shpallur me dekretin nr.2869 dt.16/03/1959

¹¹Revista juridike "Drejtësia Popullore" viti 1957, nr.4, fq. 62.

Në të gjitha rastet e tjera kur i pandehuri nuk është i pranishëm, seanca gjyqësore duhet të shtyhet në një datë tjetër dhe me urdhër të Gjykatës i pandehuri duhet të sillet forcësiht nga oficerët e policisë gjyqësore para Gjykatës.

Me ndryshimin që iu bë Kodit të Procedurës të vitit 1953, me ligjin nr. 2805, dt. 04.12.1958, pikërisht nenit 233, lidhur me një gjykim në mungesë, do të bëhej edhe për kundërvajtjet penale për të cilat ligji nuk parashikonte burg, por me të drejtën e ankimit brenda pesë ditëve nga komunikimi.

Të gjitha gjykimet në mungesë të të pandehurit për rastet kur nuk parashikohej në ligj, ishin shkak për prishjen e vendimit të Shkallës së Parë nga Gjykata e Apelit.

2.5 Kushtetuta e vitit 1976 dhe Kodi i Procedurës Penale i vitit 1979.

Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë e vitit 1976¹² është pak a shumë në të njëjtën frymë me Kushtetutën e 46-ës në lidhje me hetimin dhe gjykimin në mungesë të të pandehurit, prezenca e të cilit është domosdoshmëri në gjykim, që do të thotë se prezenca në gjykim nuk ishte një e drejtë por një detyrim, e parashikuar kjo në të dyja Kodet e Procedurave Penale të vitit 1953 dhe vitit 1979.

Me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së re, me ligjin nr. 6069, dt. 25.12.1979 u miratua nga Kuvendi Popullor edhe Kodi i Procedurës Penale¹³, i cili pothuajse përjashton mundësinë e hetimit dhe gjykimin në mungesë. Sipas këtij kodi, mosdijenja dhe mosgjetja e të pandehurit përbënte shkak për pezullimin e hetimit dhe të gjykimin të çështjes. Neni 24 i Kodit të Procedurës Penale shprehet qartazi për prezencën e të pandehurit apo mungesën e tij pa shkaqe të parashikuara në ligj dhe sjellja tij para Gjykatës në mënyrë urdhëruese. Nga praktika e asaj periudhe mungojnë rastet e hetimit dhe gjykimin në mungesë të të pandehurit.¹⁴

2.6 Kushtetuta e 1998 dhe K.pr.Penale i 1995 me ndryshimet.

Kodi i Procedurës Penale i vitit 1995 e ndryshoi tërësisht pozitën e të pandehurit në gjykim. Sipas këtij Kodi dhe Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të vitit 1998, prania në gjykim e të pandehurit u cilësua si e drejtë dhe jo si detyrim i tij.

¹² Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, miratuar nga Kuvendi Popullor i Shqipërisë më dt. 28.12.1976.

¹³ Ky kod hyri në fuqi më 01.04.1980.

¹⁴ Ylvi Myrtja, "Gjykimi në mungesë", Trajtime Juridike, 2001

Ligji nr.7491 dt.29.04.1991 “ Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese ” nuk është shprehur për praninë e të pandehurit para Gjykatës dhe as për të drejtat e të pandehurit në gjykim. Projektligji i Kushtetutës së vitit 1994, në nenin 29 shprehet se “ *e drejta për t’u dëgjuar në gjykim nuk mund t’i mohohet askujt, para se ndaj tij të merrret një vendim*”. Ky projektligj nuk e kufizonte të drejtën për t’u dëgjuar , në ndryshim nga Kushtetuta e sotme dhe ajo e vitit 1998, e cila në nenin 33/2, e kufizon këtë të drejtë duke e përjashtuar personin që i fshihet drejtësisë nga e drejta për t’u dëgjuar. Gjykimi në mungesë, jo në të gjitha legjislacionet e mëparshme është lejuar, dhe do të ishte pikërisht Kushtetuta e vitit 1998 e cila lejoi që gjykimi në mungesë të aplikohet kaq gjerësisht.

KREU III

VËSHTRIM KRAHASUES

Që në kohët më antike hetimi dhe gjykimi në mungesë ka sjellë mjaft probleme në të drejtën për t'u hetuar dhe gjykuar. Në shoqërinë e Perandorisë Romake i pandehuri para se të dënohej, pra personit të akuzuar duhej t'i jepnin të drejtën për t'u mbrojtur ndaj akuzuesit, duke i krijuar mundësinë për t'u kundërpërgjigjur dhe mbrojtur në lidhje me veprën penale e cila i atribuohet¹⁵.

Çdo i akuzuar për një krim duhej t'i nënshtrohej procesit penal, në qoftë se ai brenda afatit prej tre ditësh nuk i bindej dhe nënshtrohej pushtetit dhe autoritetit të pretorëve ose fshihej. Kjo sjellje barazohej me një pohim dhe vërtetonte se ishte ai që e kishte kryer krimin dhe si rezultat i jepej edhe dënimi. E vetmja provë që lejohej të përdorej në Perandorinë Romake ishte fjala, pasi vërtetësia e saj konsiderohej absolute dhe ishte i vetmi mjet mbrojtës i të pandehurit ndaj akuzave që i drejtoheshin; mospërdorimi i saj nënkuptonte pranimin e fajit.

Në lidhje me institutin e hetimit dhe gjykimin në mungesë vende të ndryshme kanë pasur dhe kanë qëndrime të ndryshme. Kjo varet edhe nga fakti se cilës familje ligjore i përkasin. Në vendet e common-laë gjykimi në mungesë nuk parashikohet fare, kurse në sistemin civil-laë pranohet rallë në bazë të disa rregullave të forta, me përjashtim të Italisë e cila është shumë më tolerante se pjesa tjetër ndaj këtij instituti. E njëjta gjë verifikohet edhe në Shqipëri duke qenë se baza për hartimin e Kodit të Procedurës Penale ka qenë Kodi Italian. Por si trajtohet ky institut në vende të ndryshme të botës?

.1 ITALIA

Italia është i vetmi vend që në legjislacionin e tij pranon procedimin penal në mungesë për të gjitha veprat penale, pa përjashtim. Në disa vende evropiane ndodh e kundërta; gjykimi në mungesë zbatohet jo për të gjitha veprat penale, si psh. Anglia . Duke iu referuar legjislacionit gjerman, gjykimi në mungesë pothuajse nuk zbatohet. Në Itali prania e të pandehurit në gjykim dhe në debatin gjyqësor cilësohet si një e drejtë dhe jo si detyrim i tij. Lihet në zgjedhjen e të pandehurit nëse do të jetë i pranishëm ose jo në gjykim. Ndërsa në legjislacionet e disa vendeve të tjera prania e të pandehurit në gjykim është detyrim ligjor i tij.

¹⁵ Childers and Hinesley III "The illness exception: "The eleventh circuit and the right to be present at trial" in Merrcer Laë Revieë 1983

Legjislacioni italian shprehet se gjykimi në mungesë, nuk i jep në cdo rast të drejtë të pandehurit që të nisë një proces tjetër gjyqësor ku të kërkojë që të zbatohet e drejta e tij për t’u dëgjuar. Disa vende të tjera, në legjislacionin e tyre e kanë të parashikuar të drejtën e të pandehurit që të nisë një proces të ri gjyqësor nëse ai vendos të paraqitet në gjykim ose nëse arrestohet. Në të drejtën procedurale italiane parashikohet se nëse i pandehuri nuk është i pranishëm në gjykim, duhet të jetë patjetër prezent mbrojtësi i tij i cili mund të caktohet nga Gjykata ose të zgjidhet prej të pandehurit. Mbrojtësi duhet ta përfaqësojë të pandehurin gjatë gjithë procedimit dhe gjyqësorit. Po ashtu gjykimi në mungesë lejohet të zhvillohet kur provohet se i pandehuri e ka marrë njoftimin dhe se nuk ka shkaqe të përligjura që justifikojnë mungesën e tij në gjykim. Legjislacioni Italian për mbrojtjen e të drejtave të të pandehurit përmban edhe institutet e “ *rivendosjes në afat të gjyqësorit* ” dhe “ *rishikimit* ”.

Edhe pse sistemi procedural italian njihë garancitë procedurale të përmendura më sipër, shteti Italian është dënuar disa herë nga GJEDNJ, për mosrepektim të nenit 6 të Konventës lidhur me gjykimin në mungesë¹⁶. Legjislacioni italian parashikon gjykimin në mungesë, por paralelisht nuk ofron mbrojtje efektive pasi kur i dënuari paraqitet nëpërmjet kërkesës për rivendosje në afat të ankimit ai rigjykohe dhe merr pjesë në debatin gjyqësor, përfundim ky i arritur nga GJEDNJ. Me daljen e ligjit nr.67 dt.28/04/2014¹⁷ në paragrafin e parë të nenit 419 të K.Pr.Penale italian fjalët “***duke mos u paraqitur do të gjykohe në mungesë***” do të zëvendësohen me “***atëherë kur nuk paraqitet do të aplikohen dispozitat e neneve 420-bis, 420-ter, 420-quater e 420-quinquies***”. Pezullimi i procedimit (procesit) për mungesë të të pandehurit jashtë rasteve të parashikuara nga neni 420/bis e 420/ter dhe jashtë rasteve të pavlefshmërisë së njoftimeve, nëse i pandehuri nuk i është i pranishëm gjyqtari shtyn seancën me disponimin që njoftimi t’i komunikohet të pandehurit nga policia gjyqësore. Kur njoftimi sipas parashikimit të nenit 1, nuk rezulton i mundur dhe në rast se Gjykata nuk duhet të shprehet me vendim sipas nenit 129 të K.Pr.Penale gjyqtari disponon me ordinancë (*vendim të ndërmjetëm*) pezullimin e procedimit (*procesit*) ndaj të pandehurit në mungesë. Në këtë rast aplikohet neni 18/1 germa “b” (*vecimi i çështjes për këtë të pandehur nëse janë disa*). Neni 420-quinquies i K.Pr.Penale është zëvendësuar me këtë përmbajtje. (*Kërkimet e reja për të pandehurin dhe revokimi i pezullimit të procesit*).

¹⁶ Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, R.R. v Italisë, Zunic v Italisë, Sejdic v Italisë, Somogy v Italisë, Colozza v Italisë, Artico v Italisë, F.C.B v Italisë, Ivarazzo v Italisë dhe shumë vendime të tjera.

¹⁷ Ligji nr nr.67 dt.28/04/2014 ,pezullimi i procedimit per personat qe nuk gjenden.

a)Mbas një viti nga urdhri i Gjykatës, sipas nenit 420 quinquies paragrafi i dytë, gjyqtari disponon kërkimet e reja të të pandehurit për komunikimin e njoftimit. Në të njëjtën mënyrë procedon në skadimin e afatit njëvjetor, kur procesi nuk ka filluar rrjedhjen e tij.

b)Gjyqtari e revokon urdhrin e pezullimit të procesit, nëse kërkimet kanë përfundim pozitiv.

c)Nëse ndërkohë, i pandehuri ka zgjedhur një mbrojtës të besuar.

d)Kur ekziston prova e qartë që i pandehuri është në dijeni të procedimit të ndërmarrë ndaj tij.

Me urdhrin për revokim, gjyqtari cakton datën për seancën e re duke disponuar që njoftimi t’i komunikohet të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, si dhe organit të akuzës, etj. I pandehuri ka të gjitha të drejtat sipas nenit 438¹⁸ të K.Pr.Penale për të kërkuar (gjykimin e shkurtuar) dhe neni 444 të K.Pr.Penale, (*aplikimi i dënimit mbi kërkesën e palëve-patteggiamento*).

Në nenin 604 të K.Pr.Penale, mbas paragrafit 5 është shtuar paragrafi i mëposhtëm : 5-bis. Në rastet kur është proceduar në mungesë të të pandehurit nëse provohet se duhet të ishte proceduar sipas parashikimeve të nenit 420-ter ose sipas nenit 420-quater, Gjykata e Apelit deklaron pavlefshmërinë e vendimit dhe disponon kthimin e akteve Gjykatës së Shkallës së Parë. Gjykata e Apelit anullon gjithashtu vendimin dhe disponon kthimin e akteve Gjykatës së Shkallës së Parë, edhe kur i pandehuri provon që mungesa ka ardhur për shkak të mospasjes dijeni pa faj të celebrimit të procesit të Shkallës Së Parë, aplikohet neni 489/2 i K.Pr.Penale.

Në nenin 623/1 të K.Pr.Penale, gërma “b” është zëvendësuar nga e mëposhtmjja:

625-ter---Rescissione del giudicato- Ndërprerja e gjësë së gjykuar- ndoshta mund të përkthehet RIGJYKIMI.

- 1) I dënuari ose ai që është nën efektet e masës së sigurimit personal me vendim të formës së prerë, ndaj të cilit është proceduar në mungesë përgjatë gjithë

¹⁸ Ndryshimet ne nenin 420 quinquies—kerkimet e reja per te pandehurin dhe revokimi i urdherit te pezullimit te procesit mbas nje viti kur kerkimet kane patur pefundim pozitiv,,kur ka zgjedhur nje mbrojtes,kur i pandehuri eshte ne dijeni te plote.

Neni 489 ndryshimet ne lidhje me deklarimet e te pandehurit ne gjykimin e ri.kerkesat e te pandehurit sipas nenit 438 dhe 444 te K.Pr.Penale (gjykim i shkurtuar)dhe aplikimi i denimit mbi kerkesen e paleve-patteggiamento)

kohëzgjatjes së procesit, mund të kërkojë rigjykimin (ndërprerjen e gjësë së gjykuar), atëherë kur provon që mungesa ka qenë si rrjedhojë e mospasjes dijeni pa faj të celebrimit të procesit.

- 2) Kërkesa paraqitet me kusht papranueshmërine e saj, personalisht nga i interesuari ose nga avokati i zgjedhur i pajisur me prokurë të posacme, e autentifikuar në format e parashikuara nga neni 583/3, brenda tridhjetë ditëve nga momenti që vjen në dijeni të procedimit të ndërmarrë prej tij.
- 3) Nëse e pranon kërkesën, Gjykata e Lartë revokon vendimin dhe disponon transmetimin e akteve të Gjykatës së Shkallës së Parë, aplikohet neni 489/2.

Paragrafi 2 i nenit 175 i K.Pr.Penale, është zëvendësuar nga i mëposhtmi:

I pandehuri i dënuar me vendim (dekret) penal, dhe që nuk ka patur në mënyrë të menjëhershme dijeni efektive të vendimmarrjes, rivendoset me kërkesë të tij në afat për të paraqitur ankim (kundërshtim), përveç rastit kur në mënyrë të vullnetshme ka hequr dorë.

Paragrafit të parë të nenit 159 të K.Pr.Penale, mbas numrit 3 i shtohet i mëposhtmi:

3-bis. Pezullimi i procedimit penal sipas nenit 420-quater të K.Pr.Penale.

Mbas paragrafit të tretë të nenit 159 të K.Pr.Penale, është shtuar i mëposhtmi:

Në rast të pezullimit të procedimit (procesit) sipas nenit 420-quater të K.Pr.Penal, kohëzgjatja e pezullimit të parashkrimit të veprës nuk mund të kalojë afatet e parashikuara nga neni 161 i këtij kodi.

Sistemi ynë procedural penal është pothuajse i njëjtë me atë italian edhe Instituti i Gjyimit në mungesë të të pandehurit ka qenë i njëjtë me atë italian para daljes së ligjit të sipërcituar, çka e bën standartin tonë më pak të besueshëm për një gjykim të drejtë e të barabartë në përputhje me normat e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

.2 KOSOVA

Sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës¹⁹ në qoftë se i pandehuri nuk është i pranishëm dhe njëkohësisht nuk e justifikon sipas shkaqeve ligjore mosprezencën në proces, Gjykata urdhëron ndalimin e të pandehurit duke e shtyrë seancën gjyqësore.

¹⁹ Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës 01/01/2013.

Në rast se mungesa e të akuzuarit është e arsyetuar atëherë urdhri i Gjykatës revokohet, por në qoftë se provohet që mungesa është e qëllimshme ndërkohë që njoftimi është i rregullt atëherë Gjykata vendos për masën me paraburgim edhe pse sipas nenit 281 të K.Pr.P mund të ekzistojnë mungesa të shkaqeve për paraburgim, në këtë rast i pandehuri qëndron në kushtet e paraburgimit deri në të shpalljen e vendimit sipas nenit 340.²⁰

.3 FRANCA

Në sistemin procedural francez, parashikohet se gjykimi në mungesë zhvillohet në bazë të klasifikimit që legjislacioni u bën veprave penale duke i ndarë ato në delikte dhe krime. Deliktet (delits) janë vepra penale më pak të rënda, për të cilat është marrë në mungesë vendimi , ndërkohë që ekzekutimi i tij bëhet pas njoftimit të të dënuarit si dhe pas kalimit të afateve të ankimit, në të kundërt ankimi e bën vendimin e dhënë në mungesë të paekzekutueshëm dhe çështja rigjykohet. Në sistemin procedural francez është për t'u përmendur fakti që ekzistojnë paralelisht dy parime , nga të cilët njëri parashikon se nuk mund të dënohesh pa u dëgjuar nga Gjykata , bazuar kjo në të drejtën për tu mbrojtur, ndërkohë parimi tjetër parashikon se paraqitja në Gjykatë është detyrim ligjor i të pandehurit. Legjislacioni parashikon se veprat penale për të cilat masa e dënimit është me gjobë ose me burgim deri në 2 vjet e lejon të pandehurin të kërkojë gjykimin në mungesë. Kur Gjykata e lejon gjykimin në mungesë, i pandehuri duhet të përfaqësohet nga mbrojtësi i tij, por nëse Gjykata e vlerëson të domosdoshëm praninë e të pandehurit në gjykim urdhëron që ky i fundit të detyrohet të jetë i pranishëm. Në rastet kur sipas ekzaminimeve mjekësore i pandehuri ka probleme të rënda shëndetësore, dëshmia e tij mund të mos merrret para Gjykatës por në ambientin ku ai jeton, nga i autorizuari prej Gjykatës për efekt të zhvillimit të procesit gjyqësor brenda afateve ligjore.

Përsa i përket krimeve të rënda (crimes), lejohet gjykimi pranë Gjykatës së Asizit. Gjykata vlerëson në mungesë jo vetëm të akuzuarin që nuk është paraqitur në gjykim por edhe kur i akuzuari nuk paraqitet para Gjykatës edhe pse sipas njoftimit ka dijeni. I pandehuri sipas legjislacionit francez duhet të njoftohet 10 ditë para datës së caktuar të seancës gjyqësore nëpërmjet një njoftimi në adresën e tij. Nëse adresa nuk mund të gjendet njoftimi bëhet në zyrën e Prokurorit pranë Gjykatës së Asizit. Në rast se edhe pas njoftimeve të përmendura me sipër, ky i fundit nuk paraqitet ose largohet pasi është njoftuar, nga Presidenti i Gjykatës së Asizit ose nga Kryetari i Gjykatës, kur Presidenti

²⁰ Dr. Ejup Sahiti, "E drejta e procedurës penale", Universiteti i Prishtinës, 2005, fq. 203.

mungon, shpallet një urdhër me një afat prej 10 ditësh brenda të cilit i pandehuri duhet të paraqitet në të kundërt ky i fundit konsiderohet “*rebel ndaj ligjeve*”.

Shpallja e mungesës së të pandehurit shkakton sanksione ligjore ndaj tij, të cilat do të konsistojnë në sekuestrim të pasurisë, pezullim të të drejtave civile apo heqje të zotësisë për të bërë padi gjyqësore në mbrojtje të të drejtave të tij. Po ashtu lind detyrimi për gjithësecilin shtetas të tregojë se ku fshihet i pandehuri. Efekti thelbësor që sjell me vete shpallja e mungesës është gjykimi me anë të një procedure speciale të privuar nga garancitë që normalisht shoqërojnë një procedim para Gjykatës së Asizit.²¹

Gjykata e Asizit zhvillon një proces gjyqësor sipërfaqësor në mungesë të jurisë popullore dhe të dëshmitarëve duke bërë një gjykim në gjendjen që janë aktet. Të pandehurit në mungesë nuk i njihet e drejta për t’u përfaqësuar në gjykim²², ndërkohë që familjarëve të tij u jepet e drejta që të provojnë pamundësinë për të qenë prezent në gjykim. Edhe pse në dukje një procedurë e tillë e ndjekur nga Gjykata mund të lërë vend për diskutim, në fakt ky lloj gjykimi nuk ka aspak karakter kondradiktor. Shumica e gjykimeve në mungesë të të pandehurit përfundojnë duke e shpallur atë fajtor, por sipas ligjit Gjykata e Asizit nuk është e detyruar ta shpallë fajtor të pandehurin nëse aktet provojnë pafajësinë e tij. Një vendim pafajësie prodhon të njëjtat efekte si edhe një vendim pafajësie i dhënë pas një gjykimi kondradiktor.²³

Për ekzekutimin e vendimit në mungesë vendoset një afat, me qëllim paraqitjen vullnetarisht të të dënuarit ose për ndalimin e tij. Afati duhet të jetë brenda afatit të parashkrimit të dënimit të veprës penale (20 vjet), afat pas të cilit vendimi bëhet i paekzekutueshëm.²⁴

.4 PORTUGALIA

Portugalia në legjislacionin e saj, hetimin dhe gjykimin në mungesë përsa i perket dënimeve të buta deri në vitet 1987 e kishte të ngjashëm me legjislacionin francez. Pas

²¹ Jean-Claude Soyer, “Droit Penal et Procédure Pénale” 13^e édition, fq. 380.

²² Pikërisht për këtë arsye Franca u dënua nga GJEDNJ-ja në çështjen *Poitrol v Francës*.

²³ Jean-Claude Soyer, “Droit Penal et Procédure Pénale” 13^e édition, fq.381.

²⁴ Kode de Procedure Penal Français, 2008, www.lexadin.nl/html. Ky kod në fushën e gjyqimit në mungesë ka pësuar ndryshime me ligjin nr.204, dt.09.03.2004, i cili shfuqizoi nenet 627-21 deri 641 dhe futi kapitullin tetë me titull “Du Défaut en matière Criminelle”. Para këtij ndryshimi sistemi francez nuk parashikonte rishqyrtimin e dënimit të dhënë në mungesë nga ana e një juridiksioni më të lartë. Ndryshimet u bënë vetëm pasi Franca u dënua nga GJEDNJ-ja për shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së në çështjen *Einhorn v Francës* nr.71555/01, datë 13.02.2001.

vitit 1987 legjislacioni u ndryshua²⁵ dhe bashkë me të ndryshoi edhe procedura e hetimit dhe gjykitimit në mungesë duke e kufizuar tërësisht aplikimin e tij²⁶.

Gjykimi në mungesë lejohet vetëm kur i pandehuri është njoftuar në lidhje me hetimin dhe gjykimin e zhvilluar ndaj tij dhe pasi e ka aprovuar gjykimin në mungesë ose kur provon se nuk mund të paraqitet para Gjykatës për shkak të pamundësisë së rëndë. Sipas legjislacionit portugez gjykimi në mungesë sjell pasoja jashtëgjyqësore për të drejtat e të pandehurit duke ia kufizon këto të drejta, por ky gjykim pas deklarimit të mungesës pezullohet. Pavarësisht garancive ligjore për mbrojtjen e të drejtave të të pandehurit një sistem i tillë nuk është shumë efektiv, pasi është statik në procedurën e gjykitimit të të pandehurit. Legjislacioni portugez i jep rëndësi më të madhe mbrojtjes personale të të pandehurit por nuk ka parashikuar dëmet që mund t'i shkaktojë gjykimi në mungesë.

.5 GJERMANIA

Gjykimi në mungesë në Gjermani nuk lejohet.²⁷ Nëse i pandehuri nuk paraqitet në gjykim në fillim të procesit, pa shkak duhet të shoqërohet detyrimisht para Gjykatës²⁸ dhe gjithashtu nuk i lejohet të pandehurit që të largohet gjatë procesit gjyqësor për asnjë lloj arsyeje. Nëse i pandehuri nuk është i pranishëm në gjykim, me urdhër të Gjykatës gjykimi pezullohet, por mund të merrren prova ose të vendoset sigurimi i provave të cilat do përdoren në seancën e rradhës. Legjislacioni gjerman lejon aplikimin e gjykitimit në mungesë vetëm pasi është marrë dëshmia e të pandehurit në lidhje me akuzat drejtuar ndaj tij dhe Gjykata nuk e sheh më të domosdoshme prezencën e tij në gjykim. Rastet ku Gjykata mund të lejojë gjykimin në mungesë të të pandehurit janë :

- Për shkaqe të pabazuara në ligj i pandehuri largohet nga gjykimi ose nuk ka qenë i pranishëm në asnjë seancë gjyqësore;
- Kur shkaqet e pamundësisë së pranisë së të pandehurit në seancë janë shkaktuar me dashje prej tij.

²⁵Código de Processo Penal, aprovado pelo Decreto-Lei n.º 78/87, de 17 de Fevereiro, e alterado pelos Decretos-Leis n.os 387-E/87, de 29 de Dezembro, 212/89, de 30 de Junho, e 17/91, de 10 de Janeiro, pela Lei n.º 57/91, de 13 de Agosto, pelos Decretos-Leis n.os 423/91, de 30 de Outubro, 343/93, de 1 de Outubro, e 317/95, de 28 de Novembro, pelas Leis n.os 59/98, de 25 de Agosto, 3/99, de 13 de Janeiro, e 7/2000, de 27 de Maio, pelo Decreto-Lei n.º 320-C/2000, de 15 de Dezembro, pelas Leis n.os 30-E/2000, de 20 de Dezembro, e 52/2003, de 22 de Agosto, pelo Decreto-Lei n.º 324/2003, de 27 de Dezembro e pela Lei n.º 48/2007, de 29 de Agosto

²⁶ Kodi i Procedurës Penale të Portugalisë 17/02/1987.

²⁷ Kodi i Procedurës Penale të Republikës Federale të Gjermanisë datë 01/02/1877 me ndryshime në vitin 1949,1952,1968,1990.

²⁸ Shiko "German criminal proceedings" e Eissbrodt and Föftrum 1998.

- Kur i pandehuri e ka kërkuar vetë gjykimin në mungesë edhe pse është në dijeni se mund të dënohet deri në 6 muaj.
- Kur pas njoftimit i pandehuri përsëri nuk është i pranishëm në gjykim edhe duke ditur që mund të gjykohej në mungesë, nëse për veprën e kryer ndaj tij parashikohet një dënim i ndryshëm nga ai me burgim.
- Kur zhvillimi i rregullt i seancës pengohet nga sjellja e të pandehurit.
- Mund të lejohet gjykimi në mungesë i një të pandehuri, kur për të njëten vëpër janë duke u gjykuar disa të pandehur.

Të pandehurit që do të gjykohej në mungesë i caktohet menjëherë një mbrojtës. Në rast se i pandehuri paraqitet duhet të njoftohet për provat e vlefshme të mbledhura në mungesë të tij. Mundësia që procesi të zhvillohet në mungesë është prezent kur Gjykata arrin në përfundimin se mosparaqitja e të pandehurit përdoret si strategji procedurale me qëllim për të paralizuar vazhdimin e procesit. Çdo vendim i dhënë në mungesë është i ankumueshëm, me përjashtim të rastit kur i pandehuri nuk paraqitet në gjykim apo largohet nga seanca pa miratimin e Gjykatës.

.6 USA²⁹

E drejta për të qënë i pranishëm rrjedh nga e drejta për një proces të rregullt ligjor, "të dëgjohesh para se të gjykohesh"³⁰. Pas gjykimit të çështjes, "**Bill of Rights**", në 1791 të drejtën për t'u njoftuar e parashikoi si një detyrim ligjor për mbrojtjen e të drejtave të të pandehurit. Me kërkesë të të pandehurit mund të zhvillohet gjykimi në mungesë, pasi kërkesa e tij vlerësohet nga Gjykata. Prezenca në gjykim rrjedhimisht është një detyrim ligjor i të pandehurit pavarësisht të drejtës së tij për të qënë i pranishëm ose jo në seancë. Pra e drejta dhe detyrimi janë një e të pandara. Amendamenti 14 i Kushtetutës së SHBA thotë: ". . . Asnjë shtet nuk do të... privojë asnjë person nga e drejta e jetës, lirisë, apo pronës, pa një proces të rregullt ligjor. . ."

Praktikisht procesi i rregullt ligjor nënkupton njoftim dhe mundësi për t'u dëgjuar para se të ndërmerren veprime ndaj subjektit. Në çështje penale, shembuj të procesit të rregullt ligjor përfshijnë nevojën për një arsye të mundshme për të arrestuar dikë dhe se

²⁹ Avv. Davide Richetta, "In generale sulla contumacia, incontro di studio sulla legge 06/05 di conversione del D.L. 17/05 in materia di impugnazione delle sentence contumaciali e dei decreti di condanna", Torino 27.04.2005, www.camerrapenalevittorichiusano.it/index.

³⁰ Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (Sh.B.A) viti 1787.

mbrojtësi e prezumon të pafajshëm deri sa të provohet fajësia nga një trup gjykues ose një juri.

.7 ANGLIA(Unitet Kingdom)

Në legjislacionin anglez gjykimi në mungesë nuk është i parashikuar dhe nuk aplikohet, por në gjykimin e Gjykatave të Ulëta mund të aplikohet gjykimi në mungesë nëse vepra që është duke u gjykuar përmbush kriteret e parashikuara nga ligji³¹. Nëse i pandehuri nuk është i pranishëm në gjykim, Gjykata lëshon urdhrin e arrestit me qëllim që i pandehuri të sillet para Gjykatës, çka do të thotë se detyrimi për t'u paraqitur është e drejta për t'u dëgjuar, për të realizuar një gjykim të drejtë dhe jo të njëanshëm. Pra, me paraqitjen e të pandehurit para Gjykatës mbyllet rruga e stërzgatur e rivendosjes në afat dhe fillimi i një procesi nga fillimi, sic ndodh në vendin tonë.

.8 REPUBLIKA E CEKISË

Në legjislacionin Cek gjykimi në mungesë është i parashikuar në nenin 202³², i cili aplikohet pasi janë bërë të gjitha përpjekjet për të realizuar një njoftim jo formal, por në dijeni të plotë të të pandehurit. Gjikimi në mungesë të të pandehurit mund të zhvillohet kur Gjykata arrin në përfundimin se mosparaqitja e të pandehurit përdoret si strategji procedurale me qëllim për të paralizuar dhe zvarritur vazhdimin e procesit. Çdo vendim i dhënë në mungesë është i ankimumeshëm, me përjashtim të rastit kur i pandehuri nuk paraqitet në gjykim apo largohet nga seanca pa miratimin e Gjykatës. Në Republikën e Cekisë gjykimi në mungesë trajtohet pothuaj si në vendin tonë por hetimi bëhet më i plotë dhe i gjithanshëm.

³¹ Criminal laë akt 1826

²⁸ Neni 202 i K.Pr.penale ceke gjykimi ne mungese parashikohet pas nje dijenie te plote te te pandehurit

KREU IV

HETIMI NË MUNGESË, TË DREJTAT PROCEDURIALE TË TË PANDEHURIT NË MUNGESË DHE MBROJTËSIT KRYESISHT.

4.1 Hetimet paraprake.

Në hetimet paraprake që është faza e parë e procedimit penal, gjatë së cilës kryhen veprime të rëndësishme. Organet e Policisë Gjyqësore dhe Prokurori si subjekte të së drejtës penale kanë të drejtë të kryejnë kufizimin e lirisë duke kryer arrestimin kur kapen në flagrancë (neni 251 i K.Pr.Penale) ose ndalimin e çdo shtetasi për të cilin dyshohet se ka kryer një vepër penale, kur vërtetohet ekzistenca e kësaj veprë. Fillimi i ndjekjes penale nuk është i përgjithshëm, por specifik pasi ai i atribuohet një personi të caktuar për të cilin ka një dyshim të arsyeshëm të mbështetur në prova se është autor i krimit dhe fillon me marrjen e personit të pandehur dhe komunikimin e akuzës (sipas nenit 34 të K.Pr.Penale) dhe marrjen në pyetje dhe të gjitha veprimet hetimore si kontrolle, kqyrje, sekuestrime, ballafaqime duke qenë i pranishëm i pandehuri deri në përfundimin e hetimit, i cili konsiston në pushimin, pezullimin, ose kërkesën për gjykim dhe dërgimin e çështjes në gjykim (të parashikuara nga nenet 327, 328, 329, 330, 331 të K.Pr.Penale).

Në sistemin totalitar aplikohet sistemi inkuizitor ku hetimet paraprake i karakterizonte pabarazia e palëve pasi veprimet hetimore kryheshin në fshehtësi dhe prova formohet në këtë fazë të hetimit. Në vitin 1993 në mbështetje të K.Pr.Penale të Italisë të vitit 1989 i cili është i pari Kod në Evropën Perëndimore që bën përpjekje për zbatimin e sistemit akuzator, u miratuan dispozitat kushtetuese për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut me ligjin 7692 ,datë 31/03/1993 në zbatim të të cilave u bënë ndryshime në Kodin e Procedurës Penale me të cilat e përmirësuan nivelin e procedimit penal dhe krijuan kushte për demokratizimin e mëtejshëm të tij³³.

I bazuar në sistemin akuzator Kodi i ri ndryshon rrënjësisht mënyrën e zhvillimit të hetimit paraprak. Në këtë kod u përcaktuan qartë pozicionet e subjekteve të procedimit penal, duke iu përqasur sistemit akuzator si model i ideve anglosaksone ku garantohej parimi i prezumimit të pafajësisë, të barazisë së palëve, të vlerësimit të provës në debatin gjyqësor etj.

³³ Kodi i procedurës penale.

4.2 Garancitë procedurale të hetimit në mungesë.

Për të siguruar mbrojtjen e të drejtave procedurale dhe ruajtjes së të drejtave të ligjshme të një personi i cili dyshohet se ka kryer veprë penale, organi i akuzës i cakton konform nenit 6, të K.Pr.Penale nga lista e avokatëve të cilën e ka në dispozicion, një mbrojtës, në rastet kur personi nën hetim nuk ka mundësi financiare për të caktuar një mbrojtës vetë ose të afërmit e tij. Ky mbrojtës luan një rol të veçantë dhe të rëndësishëm në parandalimin e shkeljeve të ligjit nga organi procedues. Po sa është në gjendje mbrojtësi i caktuar nga organi i akuzës në procedimin penal për të realizuar një mbrojtje efektive në përputhje me procedurën, Kushtetutën dhe Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut? Kjo vlen për ta diskutuar.

Ekzistojnë tri raste në të cilat mund të caktohet mbrojtësi kryesisht gjatë hetimit:

a) Kur personi i dyshuar arrestohet në kryerje e sipër të veprës penale (neni 251 i K.Pr.Penale) dhe nuk do ose nuk mundet të marrë avokat mbrojtës.

b) Kur ndalohet me dyshimin se ka kryer veprë penale në një kohë të mëparshme (neni 253 i K.Pr.Penale), në kushtet e pamundësisë financiare të caktimit të vetë personit apo të të afërmeve të tij.

c) Kur personi i dyshuar për kryerjen e një veprë penale është në mungesë dhe nuk ka lënë përfaqësues të posaçëm për të mbrojtur të drejtat e tij procedurale në procesin penal në ngarkim të tij.

Në rastin e arrestimit ose ndalimit, personi nën hetim vihet në dijeni të caktimit të mbrojtësit dhe merrr kontakt me të , është prezent në të gjitha veprimet procedurale deri në përfundimin e hetimeve paraprake, ku mbrojtësi kryesisht dhe i pandehuri njihen me aktet si: pyetja e personit nën hetim sipas nenit 256 të K.Pr.Penale³⁴, vendimin për zgjatjen e afateve të hetimit nëse ka sipas nenit 324 të K.Pr.Penale,³⁵ vendimin për njoftimin e akuzës, marrjes si të pandehur të personit nën hetim sipas nenit 34³⁶ të K.Pr.Penale, procesverbalit të njohjes me aktet në përfundim të hetimit dhe kërkesën për gjykim.

Kur personi i dyshuar për një veprë penale është në mungesë, masa e sigurimit merrret në mungesën e të dyshuarit dhe mbrojtësit, me kërkesën e prokurorit sipas nenit 244 të K.Pr.Penale (kërkesë për caktimin e masave të sigurimit), duke i bashkuar të

³⁴ Neni 256 i K.Pr.Penale, pyetja e personit nën hetim.

³⁵ Neni 324 i k.pr.penale vendimi për zgjatjen e afateve.

³⁶ Neni 34 i k.pr.penale e drejta për tu njohur me aktet në përfundim të hetimit.

dhënat dhe aktet që tregojnë ekzistencën e kushteve dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit sipas Kreut I (masat e sigurimit personal).

Procedura për caktimin e mbrojtësit kryesisht sipas nenit 247/1 të K.Pr.Penale “ *kur personi ndaj të cilit është marrë masa nuk gjendet, of.pol.gjyq. mban proçesverbal në të cilën tregon kërkimet e bëra dhe ia dërgon atë Gjykatës që ka dhënë vendimin ”.*

Në paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se: “ *Kur Gjykata çmon se kërkimet janë bërë të plota deklaron ikjen e personit ”.*

Në paragrafin 3 të këtij neni thuhet se: “ *Me aktin që deklaron ikjen, Gjykata i cakton personit që ka ikur një mbrojtës dhe urdhëron që të depozitohet në sekretari kopja e vendimit me të cilin është caktuar masa e zbatuar ”.*

Procedura për nxjerrjen e urdhrit të mosgjetyes dhe caktimin e mbrojtësit kryesisht për njoftimin e akuzës parashikohet në nenin 141/1 ³⁷të K.Pr.Penale dhe sipas kësaj dispozite bëhen nga Prokurori dhe konkretisht:

“ *Në qoftë se kërkimi nuk jep rezultat pozitiv, atëherë nxirret urdhri i mosgjetyes, me të cilin pasi i caktohet një mbrojtës të pandehurit, urdhërohet që njoftimi t’i bëhet duke i dorëzuar një kopje mbrojtësit, duke u konsideruar i përfaqësuar prej tij ”.* Ky vendim i shtrin efektet deri në përfundimin e hetimeve ose me dhënien e vendimit nga Gjykata. Në sinkron të paragrafit të parë është dhe neni 141/3 i K.Pr.Penale i cili thekson :

“ *Njoftimi për të pandehurin e fshehur ose të arratisur bëhet nëpërmjet dorëzimit të kopjes së aktit, mbrojtësit dhe kur ai nuk ka mbrojtës, autoriteti procedues cakton një mbrojtës kryesisht, i cili përfaqëson të pandehurin ”.*

Pra, nga kjo dispozitë del qartë se veprimet për mosgjetyjen dhe kompetencën për vendimin si dhe caktimin e mbrojtësit kryesisht gjatë hetimeve paraprake në ndryshim nga sa përcakton neni 247 ³⁸ i K.Pr.Penale e ka prokurori. Kjo gjë tashmë është bërë praktikë e organit procedues.

4.3 Efiçenca e mbrojtësit kryesisht gjatë hetimit:

Në rastin e arrestit në flagrancë ose të ndalimit, roli i mbrojtësit të caktuar kryesisht nga organi i akuzës është detyrues nga fillimi i ndjekjes penale deri në përfundim të hetimit nëse e kërkon atë (neni 49 i K.Pr.Penale ³⁹) dhe teorikisht është efiçent, pasi i pandehuri ka mundësi të kontaktojë me mbrojtësin dhe të diskutojë me të. Në rastin kur i

³⁷ Proçedura për nxjerrjen e urdhrit të mosgjetyes sipas nenin 141/1 ³⁷të K.Pr.Penale sipas bëhen nga prokurori :

³⁸ Neni 247 ³⁸ i K.Pr.Penale caktimin e mbrojtësit kryesisht gjatë hetimeve paraprake e ka prokurori, e cila tashmë është bërë praktikë e organit procedues.

³⁹ Neni 49 i k.pr.Penale. Vendimi nr.13/2005 faqe 316 i Gjykates Kushtetuese.

pandehuri është në mungesë, çështja shtrohet ndryshe, pasi roli i avokatit kryesisht në këtë rast është pothuajse inekzistent dhe nga përvoja dhe praktika flitet për një mbrojtës i cili nuk e njeh klientin e tij dhe nuk ndien përgjegjësinë e duhur që përcakton neni 12 i Ligjit për Avokatinë, për të realizuar një mbrojtje eficiente në përmbushje të detyrës së tij.

Nga praktika hetimore dhe gjyqësore është vërtetuar se mbrojtësi kryesisht, i zgjedhur nga organi i akuzës nuk përzgjidhet sipas radhës nga lista e Dhomës së Avokatisë, gjë që është dhe një shqetësim i vazhdueshëm i Dhomave të Avokatisë në rrethe, por zgjidhen avokatë të patatueshëm, për të cilët është e mjaftueshme Liçenca e Avokatit dhe dashamirësia e organit procedues pa respektuar rregullat dhe Ligjin e Avokatisë duke krijuar një konkurrencë të pandershme. Madje këta të ashtuquajtur "avokatë", janë të paktë në numër por shumë të dëmshëm për interesat e klientëve " të tyre" të cilët nuk shqetësohen për të drejtat e tyre procedurale, por arrijnë deri sa firmosin akte procedurale që kanë të bëjnë me pyetjen e të pandehurit, njoftimin e akuzës, kërkesën për gjykim pa qënë prezent çka do të thotë se ky mbrojtës nuk mund të bëjë një mbrojtje eficiente, madje është një manipulator i procesit penal në bashkëpunim me organin e akuzës dhe në shumë raste për të mos thënë të gjitha rastet, me paraqitjen e të pandehurit dhe rivendosjes në afat sipas nenit 147/2 të K.Pr.Penale , vendimet e dala nga ky proces janë të cënueshëm.

Pra edhe pse është parashikuar nga neni 49/3 i K.Pr.Penale, kriteret për caktimin e mbrojtësit kryesisht të përmendura më lart, gjithmonë mbrojtësi kryesisht nuk mund të realizojë të drejtat që ligji i njeh mbrojtësit të autorizuar posaçërisht nga i pandehuri, të drejta që i jep neni 410/2⁴⁰ i K.Pr.Penale, ndryshuar në pikën 2 me ligjin nr.8813, dt.13.06.2002, ndryshuar me vendimin 15, dt.17.04.2003 të Gj.K.

Në këtë kontekst është shprehur Gjykata e Lartë në vendimin unifikues nr.354 /1999: " Në rastin e gjykimit në muungesë, sipas paragrafit të dytë të këtij neni (410/2), kur i pandehuri nuk e ushtron vetë të drejtën e ankimit, këtë të drejtë ligja ia njeh vetëm mbrojtësit të autorizuar posaçërisht për ushtrimin e saj ". Në vazhdim kjo Gjykatë shprehet: " Mbrojtja kryesisht, prezumon garantimin e një procedimi dhe gjykimi të drejtë, respektimin e të drejtave dhe lirive të të pandehurit në procesin penal, por kurrësi disponimin tërësor mbi të drejtat që atij i njeh ligji ".

⁴⁰ K.pr.penale,VUGJL386/2000fq.388.VUGJL30/1999 fq 389.VUGJL 354/1999,fq.390.VUGJL 371/2000 fq.391.

Pra, nga arsyetimi i Kolegjeve të Bashkuara del qartë se të drejtat e mbrojtësit, në mungesë të të pandehurit mbarojnë në përfundim të gjykimit në shkallën e parë, çka do të thotë se nuk mund ta mbrojë të gjykuar në mungesë në Shkallë të Dytë.

Sipas mendimit tim, duke iu referuar legjislacionit në fuqi mbrojtësi i caktuar kryesisht në mungesë të të pandehurit është një procedurë për statistikë për hetimin dhe gjykimin, por duke iu referuar praktikës gjyqësore në përfundim është joeficiente, pasi pas përfundimit të shkallëve të gjyqësorit fillon një proces i ri me prezencën e të pandehurit i cili sjell argumente të reja dhe për pasojë një vendim të ndryshëm nga i pari. Kjo gjë do të thotë një investim të organit të akuzës dhe Gjykatës, një kohë e harxhuar dëm, një kosto për shtetin.

Duke parë se roli i mbrojtësit kryesisht, në mungesë të të pandehurit është formal, në pamundësi për të realizuar një mbrojtje efektive në përputhje me nenin 33/1 të Kushtetutës së Shqipërisë **" Kushdo ka të drejtë të dëgjohet para se të gjykohet "** si dhe nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, **" E drejta për një proces të rregullt ligjor "**.

Do të ishte në të mirë të procesit dhe të gjitha palëve, që ligjvënësi të parashikonte pezullimin e hetimit dhe gjykimit në mungesë të të pandehurit duke zgjatur afatin e parashkrimit të ndjekjes penale.

4.4 Rastet e pezullimit të hetimit .

Legjislacioni ynë procedural ka pësuar disa ndryshime nga dalja e ligjit nr.7905, dt.21.3.1995 me gjithë ndryshimet e bëra me ligjin nr.7919, dt.19.04.1995, ligjin nr.7977, dt.26.07.1995, ligjin nr.8027, dt.15.11.1995, ligji nr.8180, dt.23.12.1996 (shfuqizuar me V.Gj.K. nr.55/1997), ligjin nr.8460, dt.21.11.1999, ligjin nr.8570, dt.20.01.2000, ligjin nr.8602 dt.10.04.2000, ligjin nr.8813 dt.13.06.2002, ligjin nr.9085 dt.19.06.2003, ligjin nr.9187 dt.12.02.2004, ligjin nr.9276 dt.16.09.2004, ligjin nr.9911 dt.05.05.2008, ligjin nr.10054 dt.29.12.2008, vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.5/2009, ligjin nr.145/2013 i përditësuar me praktikën gjyqësore, të Gjykatës Kushtetuese nr.3/2008, nr.14/2008, nr.5/2009, nr.30/2010, 26/2011, nr.16/2012, 31/2012 si dhe Vendimet Unifikuese të Gjykatës së Lartë, ligji nr.9110 dt.24.07.2003 "Për organizimin e Gjykatave për krime të Rënda" të cilat kanë shërbyer në përmirësimin e Kodit të Procedurës Penale, ku me gjithë ndryshimet e bëra në një periudhë relativisht të shkurtër në raport me ndryshimet prej 14 ligjesh dhe disa Vendime Unifikuese dhe Kushtetuese, është parë e arsyeshme njohja e

hetimit në mungesë edhe pse shkel disa standarte të të drejtave duke e krahasuar me Gjermaninë por edhe me Italinë mbas daljes së ligjit nr. 67, dt.28.04.2014 i titulluar **“Pezullimi i procedimit për persona që nuk gjenden”** legjislacioni ynë procedural parashikon pezullimin e hetimit në mungesë”, neni 326⁴¹ i K.Pr.Penale, vetëm në dy raste:

- Kur nuk njihet autori. Pra pasi kryhen të gjitha veprimet e nevojshme hetimore në përfundim të hetimit sipas nenit 327⁴², në përputhje me VUGJK nr.3/2002 dhe 4/2002, fq.376, Policia Gjyqësore i dërgon aktet prokurorit bashkë me një relacion shpjegues për faktin penal dhe provat, si dhe sugjerimet e veta, për mënyrën e përfundimit të hetimit për rastin kur nuk njihet autori jep mendimin për pezullimin e procedimit.
- Kur i pandehuri vuan nga një sëmundje e rëndë që ndalon hetimin e mëtejshëm, prokurori vendos pezullimin e hetimeve deri në zbulimin e autorit të kryerjes së veprës penale për rastin.

⁴¹ Pezullimi i hetimit neni 326 i K.Pr.Penale, kur nuk njihet autori i vepres ose kur i pandehuri vuan nga ndinje semundje e rende.

⁴² K.pr.penale neni 327
VUGJL nr.3/2002 dhe 4/2002fq.376

KREU V

GJYKIMI I TË PANDEHURIT NË MUNGESË

Gjykimi i të pandehurit në mungesë, i pranuar nga e drejta procedurale penale në vendin tonë, është një zgjedhje midis interesit publik nga njëra anë, për të ndëshkuar krimin e kryer nga individët dhe mbrojtjes së të drejtave procedurale të të pandehurit sic është e drejta për të qënë i pranishëm në gjykim, si garanci e interesit individual nga ana tjetër. Në kodin e Procedurës Penale të vitit 1995 dhe në Kushtetutën e vitit 1998 është parashikuar gjykimi në mungesë duke i dhënë përparësi interesit publik⁴³, por pa shkelur të drejtat themlore të të pandehurit për një proces të rregullt ligjor.

Pa mohuar të drejtat procedurale të personit që akuzohet për një veprë penale ligjvënësi është munduar njëkohësisht të garantojë mbrojtjen e interesit publik dhe të individëve që dëmtohen nga vepra penale.

Sipas autorit Y.Myrte, për ndëshkimin e menjëhershëm të veprës penale dhe kundër kriminalitetit në Kod është parashikuar procedimi në mungesë⁴⁴. Për të shmangur paralizimin e proceseve gjyqësore në një farë mase, duke patur parasysh pasojat që mund të vijnë nga zhdukja e provave, skadimi i afateve të hetimit ose një çekuilibrim dhe venitje të drejtësisë⁴⁵ duhet që ligjvënësi të parashikojë gjykimin në mungesë.

Sipas nenit 6 të KEDNJ, në lidhje me të drejtën për një proces të rregullt gjyqësor, ligjvënësi është i detyruar të parashikojë garanci për një mbrojtje efektive të të drejtave të të pandehurit në gjykim. Edhe pse e drejta për të qënë i pranishëm në gjykim nuk është e shprehur në permbajtjen e nenit 6, ajo i njeh të pandehurit të drejtën për pjesëmarrje në gjykim.

Gjithashtu neni 6 në nën paragrafet c), d) dhe e) të paragrafit 3 parashikon se i akuzuari ka të drejtë të mbrohet vetë ndaj akuzave, të kërkojë marrjen e dëshmive nga dëshmitarët si dhe t'i vihet në dispozicion një përkthyes falas, por mungesa e të pandehurit

⁴³ Shqipëria është një vënd akoma në tranzicion, me probleme të mëdha në regjistrimin e popullsisë dhe me faktimin lëvizje migruese e emigruese, faktorë që përbëjnë vështirsi objektive për organet proceduese në gjetjen e të pandehurve pavarësisht nga kërkimet që bëhen. Duket se gjykimi në mungesë i të pandehurit i pëshkallë klimën aktuale në shqipëri, sepse e kundërta do të çonte zvarritje pa fund të procedimeve penale dhe në një stancion të gjykimeve.

⁴⁴ Ylvi Myrtja, "Gjykimi në mungesë", Trajtme Juridike, 2001

⁴⁵ "Për një rend publik European", Vëllimi I, 2001, fq.648. Ky argument u përdor nga qeveria italiane për të justifikuar zbatimin e gjykimit në mungesë në çështjen Coloza v Italisë. "Sipas qeverisë e drejta për të marrë pjesë personalisht në gjykim nuk ka karakter absolut, (koncept që në pamje të parë jepet edhe nga Komisioni në raportin e tij) ajo duhet të harmonizohet nëpërmjet një "barazpeshe të arsyeshme" me interesin publik dhe interesat e rëndësishme të drejtësisë."

në gjykim e bën të pamundur aplikimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor⁴⁶. Në çështjen “*Sejdovic kundër Italisë*” GJEDNJ u shpreh se:

“Aplikimi i gjykimit në mungesë nuk i cënon të drejtat e parashikuara nga neni 6 i KEDNJ-së, nëse njoftimi është bërë i regullt, vetë i pandehuri ka kërkuar të gjykohej në mungesë ose pasi paraqitet, ndaj të pandehurit të zhvillohet një proces i ri gjyqësor.”

Sipas GJEDNJ shtetet anëtare jo detyrimisht duhet të parashikojnë që i pandehuri duhet të jetë i pranishëm në gjykim, pasi kjo do të ndalonte aplikimin e gjykimit në mungesë. Ndërkohë, ligjvënësi duhet të garantojë një mbrojtje efektive të të drejtave të të pandehurit në gjykimin në mungesë⁴⁷.

Në vendin tonë si në Kushtetutë ashtu edhe në Kodin e Procedurës Penale është parashikuar gjykimi në mungesë. Sipas Kushtetutës, neni 33 shprehet mbi të drejtën e të pandehurit për t’u dëgjuar nga Gjykata përpara se ndaj tij të merrret një vendim me përjashtim të personave që qëllimisht refuzojnë të jenë prezent në gjykim.

Rrjedhimisht gjykimi në mungesë kufizon të drejtën e të pandehurit për t’u dëgjuar, por pa mohuar të drejtat e të pandehurit të parashikuara në nenin 17⁴⁸ të Kushtetutës.

Në ndryshim nga legjislacioni gjerman, legjislacioni i vendit tonë, konkretisht neni 33 i Kushtetutës, i njeh të drejtën të pandehurit për të qenë i pranishëm në gjykim, por nuk e detyron atë, me përjashtim të rasteve kur vullnetarisht i pandehuri kërkon të mos jetë i pranishëm në gjykim ose kur qëllimisht i fshihet drejtësisë. Mungesa e pranisë në gjykim i shkakton të pandehurit humbjen e së drejtës për t’u dëgjuar, por nuk duhet t’i mohojë atij të drejtën e një procesi të regullt gjyqësor.

Në nenin 353 të K.Pr.Penale parashikohet se i pandehuri i gjykuar në mungesë mund të detyrohet të jetë prezent në Gjykatë vetëm nëse duhet të dëshmojë ose kur duhet të merrret një provë.

5.1 Rastet e gjykimit në mungesë.

Rastet kur Gjykata mund të gjykojë në mungesë të pandehurin parashikuar në nenin 352 të K.Pr.Penale, janë :

- Kur vetë i pandehuri me kërkesën e tij nuk merr pjesë në proces⁴⁹, duke zgjedhur që në gjykim të përfaqësohet nga mbrojtësi .

⁴⁶ “Për një rend publik Europian”, Vëllimi I, 2001y fq. 647

⁴⁷ Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, R.R. v Italisë, vendim nr. 42191/02, datë 09.06.2005, § 51.

⁴⁸ Neni 17 i Kushtetutës “1- kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e interesave të të tjerëve. Kufizimet duhet të jenë në përpjestim me gjendjen që e ka diktuar atë. 2- Këto kufizime nuk mund të cënojnë thelbin e lirive dhe të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut.”

- Nëse i pandehuri vendos të largohet nga procesi pasi është paraqitur, quhet prezent vetëm nëse përfaqësohet nga mbrojtësi.
- Gjykimi në mungesë mund të bëhet kur provohet se i pandehuri i fshihet gjykimin.

Pra sic kuptohet, në thelb i pandehuri mund të gjykohe në mungesë vetëm nëse ai pranon duke zgjedhur të mos jetë prezent në gjykim. Për këtë arsye njoftimi i të pandehurit për procedimin e filluar ndaj tij duhet të jetë bërë në formën e kërkuar nga ligji, dhe ky i fundit të zgjedh të jetë prezent ose jo në procesin gjyqësor.

Sipas vendimit nr.38, datë 08.04.2004, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë :

Edhe kur i pandehuri ka vendosur të mos jetë prezent në gjykim në Shkallë të Parë duke zgjedhur të përfaqësohet nga mbrojtësi, në gjykimin në Apel ligji i jep të drejtë që ai të heqë dorë nga gjykimi në mungesë dhe të jetë prezent në gjykim, pra gjykimi në mungesë pas revokimit të një gjykimi të tillë nga i pandehuri konsiderohet shkelje e së drejtës kushtetuese për zhvillimin e një procesi të regullt gjyqësor.

Gjykata nuk mund të vendosë për praninë e të pandehurit në gjykim; detyrimi i saj është ta njoftojë të pandehurin për ditën dhe orën e zhvillimit të gjykimin, pasi është e drejtë e të pandehurit të vendosë nëse duhet të marrë pjesë apo jo në gjykim.

Në rastin kur i pandehuri është i burgosur, Gjykata bën me dije të pandehurin dhe janë organet shtetërore që mbajnë të burgosurin të cilat janë të detyruara ta njoftojnë dhe t'i krijojnë të gjitha kushtet që i pandehuri të jetë prezent në senacën gjyqësore, pasi fakti që ai është i burgosur e bën të pamundur prezencën e tij në gjykim ndryshe nga rasti kur i pandehuri është në gjendje të lirë⁵⁰.

I pandehuri gjykohe në mungesë kur ⁵¹ :

- a) me dashje dhe paramendim i pandehuri i shmanget gjykimin.
- b) për shkaqe të pavarura prej tij, siç është mosmarrja e njoftimit apo pamundësisë së rëndë nuk mund të jetë prezent në gjykim.

Rastet kur i pandehuri heq dorë nga e drejta për të qenë i pranishëm në gjykim sipas Kodit të Procedurës Penale janë :

⁴⁹ Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë Vendim nr.602, datë 26.09.2007, "Rezulton se të pandehurit O. e M., të gjykuar me masë sigurimi "arrest në burg", për seancën e datës 21.12.2005 kanë njoftuar Gjykatën e apelit se nuk mund të marrin pjesë në gjykim për shkak të gjendjes jo të mirë shëndetësore, si dhe kanë kërkuar që gjykimi i çështjes të mos vazhdojë pa praninë e tyre. Nga ana e Gjykatës së Apelit Gjyrokaster, edhe pse nuk është dhënë pëlqimi i të pandehurve të arrestuar, si dhe nuk është bërë ndonjë verifikim që të provonte të kundërtën e pretendimit të tyre, është vendosur gjykimi i çështjes në mungesë të të pandehurve. Me këtë vendim nuk ka qene dakord mbrojtësi i caktuar nga të gjykuarit, i cili gjithashtu ka refuzuar të mbrojë interesat e tyre pa pasur më parë pëlqimin për këtë lloj përfaqësimi. Në kundërshtim me kërkesat e nenit 352 të K.Pr.Penale, Gjykata e Apelit Gjyrokaster ka vazhduar gjykimin e çështjes në mungesë të të pandehurve S.O. dhe V.M., si dhe ka vendosur që mbrojtjen e tyre ta realizojë avokat i caktuar kryesisht nga Gjykata e apelit."

⁵⁰ Stephanos STAVROS, "The guarantees for accused person under article 6 of The European Convention on Human Rights", fq.197.

⁵¹ Ylvi Myrtja, "Gjykimi në mungesë", Trajtime Juridike, 2001

a) i pandehuri pranon të gjykohet në mungesë, ose kur është i burgosur dhe nuk pranon të jetë prezent në gjykim (neni 352/1).

b) pas paraqitjes në Gjykatë i pandehuri vendos të mos jetë prezent, duke u larguar nga Gjykata (neni 352/2)

c) kur sipas provave i pandehuri i shmanget gjykimit (neni 352/4).

d) kur edhe pse është njoftuar, i pandehuri për shkaqe të pabazuara në ligj nuk është prezent në seancë (neni 351/1 i K.Pr.Penale⁵²).

Përvec rasteve kur i pandehuri me vullnetin e tij ka zgjedhur të mos jetë i pranishëm në gjykim, janë edhe rastet kur nuk mund të jetë prezent për arsye të pavarura prej tij. Këto raste janë :

a) kur i pandehuri nuk është njoftuar për procesin e nisur ndaj tij (nenet 351/2 dhe 427/4 i K.Pr.Penale).

b) kur edhe pasi është njoftuar për procesin e nisur ndaj tij nuk ka mundur të jetë prezent si pasojë e pamundësisë së rëndë fizike ose arsyeve të justifikuara në ligj (351/2 , 427/4 , përsëritja e shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën e Apelit).

c) kur me urdhër të kryetarit të seancës i pandehuri nxirret nga salla, për sjelljen e tij jo korrekte, e cila është bërë pengesë për zhvillimin e rregullt të seancës (neni 344/2 i K.Pr.Penale).

5.2 Garancitë procedurale të gjykimit në mungesë.

Sipas nenit 6 të KEDNJ , gjykimi në praninë e të pandehurit është më i thjeshtë dhe me më pak probleme në dallim nga gjykimi në mungesë. Kjo pasi mungesa e të pandehurit krijon vështirësi për të provuar përtej cdo dyshimi nëse i pandehuri e ka marrë ose jo njoftimin lidhur me procesin e zhvilluar ndaj tij, apo me dëshirë ka hequr dorë nga e drejta për të qënë prezent në gjykim.

Gjykimi në mungesë pothuajse nuk ka ndryshime nga gjykimi i zakonshëm. Megjithatë , një nga ndryshimet është pozita e të pandehurit, e cila është disfavorizuese në krahasim me pozitën e të pandehurit që është prezent. Kodi i Procedurës Penale përmban garanci të cilat sigurojnë të drejtën e të pandehurit për një proces të rregullt gjyqësor lidhur me gjykimin në mungesë. Shkelja e këtyre garancive shkakton prishjen e vendimeve gjyqësore ⁵³.

⁵² Neni 351/1 i K.Pr.Penale ka një gabim material në formulimin e tij, ai shprehet “ ... dhe nuk ka pasur shkaqe të ligjshme për t’u paraqitur...”, por nuk mund të mendohet se Gjykata deklaron mungesën e të pandehurit sepse ai “nuk ka patur shkaqe të ligjshme për t’u paraqitur” por sepse “nuk ka patur shkaqe të ligjshme për të mos u paraqitur”. Pra mungon pjezësa “mos” .

⁵³ Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, Vendim nr.410, datë 18.04.2007.

5.2.1 Heqja dorë vullnetarisht nga prania në gjykim.

I pandehuri mund të gjykohet në mungesë kur shprehimisht heq dorë nga e drejta për të qenë prezent në gjykim. Parashikuar nga neni 352 i K.Pr.Penale, gjykimi në mungesë i të pandehurit lejohet edhe kur i pandehuri refuzon të jetë prezent në gjykim, kur ikën nga seanca, ose kur i pandehuri i largohet policisë e cila e shoqëron si të paraburgosur dhe kur nuk është paraqitur gjatë hetimit dhe gjykimit. Kur gjykimi në mungesë është i vullnetshëm i pandehuri në seancë duhet të paraqesë kërkesë të shprehur para Gjykatës nga vetë ai. Nëpërmjet mbrojtësit të tij ose postës të paraqesë një akt noterial (prokurë të posacme ku shpreh vullnetin e tij)⁵⁴.

Në rastet kur i pandehuri refuzon, ikën nga seanca apo kur i largohet policisë me dhunë atëherë rrjedhimisht kjo do të konsiderohet si heqje dorë nga e drejta për të qenë prezent në gjykim. Akuza është e detyruar të provojë faktin se i pandehuri me dashje kërkon t'i fshihet drejtësisë.

Sipas nenit 351/1 i K.Pr.Penale gjykimi në mungesë aplikohet dhe kur i pandehuri nuk është prezent në gjykim për arsye të pabazuara në ligj, edhe pse është njoftuar për procesin e nisur ndaj tij. Prezumohet se i pandehuri ka hequr dorë nga e drejta për të qenë i pranishëm në gjykim kur edhe pse është njoftuar regullisht, pra ka marrë dijeni për procesin e nisur ndaj, ai është koshient për njoftimin që i është bërë dhe me dashje nuk merr pjesë në gjykim pa i justifikuar arsyet e mungesës së tij.

Sipas legjislacionit në vendin tonë të pandehurit i njihen të gjitha të drejtat, si e drejta për të marrë pjesë në gjykim ashtu edhe e drejta e njohjes së tij me akuzat. Këto të drejta nuk mohohen në asnjë pjesë të dispozitës procedurale, por nëpërmjet procedurave të njoftimit të parashikuara nga ligji konsiderohet sikur i pandehuri ka marrë dijeni, pra veprime të cilat të çojnë në prezumimin se mungesa është e vullnetshme⁵⁵.

Prezumimet dhe "*funksionet juridike*" për të qenë të sigurtë për një njoftim efektiv apo një dorëheqje të shprehur, sipas Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut nuk janë eficiente. Ndryshe ndodh në vende të tjera ku e drejta për t'u përballur me akuzat që i drejtohen të pandehurit kërkojnë domosdoshmërisht praninë e këtij të fundit në proces, me përjashtim të rasteve kur me vullnetin e tij të shprehur në formën e kërkuar nga ligji, vetë i

⁵⁴ Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda "Komentari i Procedurës Penale", botime "MORAVA", 2003, fq. 475.

⁵⁵ Një pjesë e juristëve vazhdojnë të mos jenë dakort me gjykimin në mungesë të të pandehurit, me argumentin se për sa kohë atij nuk i është komunikuar akuza nuk mund të marrë cilësinë e të pandehurit. (Fred Paskali, "Gjykimi në mungesë i të pandehurit", Tribuna Juridike, nr.30 2001, fq.20.)

pandehuri heq dorë nga kjo e drejtë, por heqja dorë nga e drejta për të qënë prezent në gjykim duhet patjetër të jetë e shprehur dhe jo të prezumohet.

Të pandehurit, të cilit nuk ka bërë deklarimet përkatëse në lidhje me ndryshimin e vendqëndrimit të tij i mohohet e drejta për t’u njohur dhe përballur me akuzat drejtuar ndaj tij. Nëse përmendim shtete të tjera anëtare të BE gjithashtu edhe vendimet e GJEDNJ ,të pandehurit të dënuar në mungesë i njihet e drejta për një proces të ri gjyqësor ku ai të ketë mundësi të njihet me aktet, të mbrohet dhe të kundërshtojë akuzat drejtuar ndaj tij , bazuar kjo në parimin “ *fresh determination of the merits of the charge* ”⁵⁶ sipas vendimeve të GJEDNJ.

5.2.2 Deklarimi i mungesës së të pandehurit.

Gjykata vendos të gjykojë në mungesë ⁵⁷, kur i pandehuri largohet vullnetarisht nga seanca gjyqësore , kur mundohet t’i fshihet drejtësisë , kur nuk paraqitet dhe nuk e justifikon mungesën sipas ligjit edhe pse ndaj tij janë kryer të gjitha procedurat e njoftimit⁵⁸, ose kur nuk arrihet të gjendet nga policia ⁵⁹ . Vetëm pasi janë kryer të gjitha procedurat e parashikuara nga ligji për njoftimin e të pandehurit në lidhje me akuzat që i drejtohen dhe procesin që ka nisur të zhvillohet ndaj tij , Gjykata mund të vendos për gjykimin në mungesë të të pandehurit.

Duhet theksuar se nuk ka rëndësi se këto njoftime janë bërë një herë gjatë hetimeve, ato duhet të përsëriten gjatë gjykimit nga e para dhe kjo vlen për çdo shkallë të procedimit. Si një element thelbësor të një procesi të rregullt ligjor njoftimi do të trajtohet me një kapitull më vete në këtë punim.

5.2.3 Mosmarrja e njoftimit dhe pamundësia absolute për t’u paraqitur .

Gjykata, bazuar në nenet 349 dhe 350/4 të K.Pr.P, kur i pandehuri nuk paraqitet në senacë, ka detyrimin ligjor të zhvillojë hetime në lidhje me shkaqet e mosprezencës së tij

⁵⁶ Parim i përmendur në disa vendime të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, si p.sh. vendimi Coloza v Italisë i dt. 12.02.1985 dhe vendim nr. 277, datë 23.11.1993, Poitrimol v Francës, “Kur ligji i brendshëm lejon zhvillimin e një procesi gjyqësor panvarsisht nga mungesa e personit të akuzuar për veprën penale, i cili mund të jetë në pozitën e Z.Coloza , ky person që në çastin që merrr dijeni për procesin, duhet të jetë në gjendje të përftoj, nga Gjykata që e ka dëgjuar atë një vendim të freskët mbi themelin e çështjes.”

⁵⁷ Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, Vendim nr.519, datë 08.10.2003 “Bazuar në procesverbalin gjyqësor, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vëren gjithashtu se, Gjykata e Apelit Durres gjykimin e tre të gjykuarve, megjithëse ata kanë qënë në mungesë, e ka kryer pa marrë më parë vendim për deklarimin e mungesës së tyre. Zhvillimi i gjykimit kur të pandehurit janë në mungesë, pa marrë vendim për deklarimin e mungesës së tyre, simbas nenit 351/1 të K.Pr.Penale, përbën shkelje ligji.”

⁵⁸ Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Vendim Unifikues nr. 354, datë 28.07.1999

⁵⁹ Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, Vendim nr.575, datë 20.07.2005, “ Nga aktet për njoftimin të ndodhura në dosje, në emër të të gjykuarit E.N. rezulton se për seancën e datës 09.05.2003, ai dhe familjarët e tij nuk janë njoftuar për datën dhe orën e gjykimit. Kjo për faktin se në fund të fletëthirjes është vënë shënimi “se nuk ka korrier fshati”. Gjykata e shkallës së parë Mirditë në kundërshtim me kërkesat e nenit 351, pika 1 të K.Pr.Penale në këtë seancë ka deklaruar mungesën e të gjykuarit dhe ka vazhduar gjykimin e çështjes deri në përfundim të saj, pa i bërë njoftim tjetër”

në gjykim , dhe në rast se arrihet në përfundimin se mungesa e të pandehurit ka ardhur si rezultat i mungesës së njoftimit, paregullsisë së njoftimit ose kur ka dyshime mbi rregullsinë e njoftimit, Gjykata vendos për shtyrjen e seancës gjyqësore duke kërkuar njëkohësisht përsëritjen e njoftimit. Gjykata ,edhe kur vërteton se i pandehuri mungon në gjykim jo për faj të tij por për shkaqe të justifikuara nga ligji bazuar në nenin 350/1 të K.Pr.P vendos shtyrjen e seancës ose pezullimin e gjykimit .

Gjykata ndjek të njëjtën procedurë edhe për mbrojtësin e të pandehurit kur ai mbrohet vetëm me një mbrojtës, ndërsa kur i pandehuri ka zgjedhur të mbrohet nga dy mbrojtës dhe njëri prej tyre nuk është prezent, i pandehuri mund ta zëvendësojë mbrojtësin që mungon ose të vazhdojë gjykimin pa të, pra vetëm me mbrojtësin që është i pranishëm në seancë me qëllim vijimin e procesit bazuar kjo në nenin 350/3 të K.Pr.P. Mungesa e mbrojtësit në proces do të quhet e justifikuar nëse ka ndodhur jo për faj të tij. Mungesa e tij justifikohet edhe kur vjen si rezultat i zhvillimit të grevës të avokatëve⁶⁰. Kur mbrojtësi është caktuar kryesisht nga Gjykata bazuar në nenin 348 dhe 49/5 të K.Pr.P, Kryetari i seancës cakton kryesisht një mbrojtës tjetër duke e shtyrë seancën gjyqësore, duke marrë parasysh kohën që i duhet mbrojtësit për t'u njohur me dosjen dhe përgatitjen e mbrojtjes.

Në rastet kur mungesa e të pandehurit në seancë ka ardhur si rezultat i mosmarrjes së njoftimit, ose kur i pandehuri ndodhet në kushtet e pamundësisë së rëndë për t'u paraqitur në seancë, bazuar në nenin 351/2 K.Pr.P vendimi i marrë nga Gjykata për mungesën e të pandehurit do të shpallet i pavlefshëm. Bazuar në nenet 349, 350/1 dhe 350/4 të K.Pr.P, nëse njoftimi nuk është bërë sipas procedurës së përcaktuar nga ligji, vendimi i Gjykatës i cili deklaron mungesën e të pandehurit do të quhet nul. Sipas nenit 143 të K.Pr.P, nëse njoftimi është i pavlefshëm, atëherë rrjedhimisht edhe vendimi që deklaron mungesën e të pandehurit është i pavlefshëm. Të njëjtat pasoja sjell edhe nëse njoftimi nuk është bërë sipas procedurës së përcaktuar në ligj vendimi përsëri është nul.

Nga praktika e deritanishme janë hasur vështirësi në lidhje me rrugën që duhet të ndjekë Gjykata kur i pandehuri është duke u gjykuar në një shtet tjetër ose kur i pandehuri ka marrë dënim nga një shtet tjetër për transferimin ose ekstradimin e tij. Gjykata në këto raste është e detyruar që deri në zhdukjen e pengesave të cilat nuk lejojnë prezencën e të pandehurit në gjykim të vendosë për pezullim të gjykimit.

⁶⁰ D.Siracusano, A. Galati, G. Tranchina, E. Zappalà, "Diritto Processuale Penale", volume secondo, Seconda Edizione, fq. 268.

Referuar nenit 352/1 të K.Pr.P, nëse kërkohet nga vetë i pandehuri të gjykohej pa prezencën e tij atëherë ai duhet të përfaqësohet nga mbrojtësi të cilin duhet ta autorizojë me prokurorë që ta mbrojë në gjykimin në mungesë.

5.2.3.1 Shkaqet e pamundësisë absolute të paraqitjes të të pandehurit.

Terminologjia.

Instituti i gjykimit në mungesë rregullohet nga norma të cilat nuk janë të shprehura vetëm në një seksion të veçantë, por ligjvënësi i ka përfshirë në disa prej pjesëve të kodit me një terminologji ku përcaktohen qartë rastet kur i pandehuri mund të gjykohej në mungesë. Sipas legjislacionit tonë procedural si shkaqe të pamundësisë absolute të paraqitjes së të pandehurit janë konsideruar:

- a) Pengesat e shkaktuara nga forcat madhore, pra pengesa të krijuara jo për faj të të pandehurit kjo sipas nenit 350/1 i K.Pr.P.
- b) Mungesë e justifikuar nga ligji sipas nenit 351/1 të K.Pr.P.
- c) Kur i pandehuri ndodhet në kushtet e pamundësisë së rëndë të cilat e bëjnë të pamundur prezencën e tij në Gjykatë, parashikuar kjo nga neni 351/2 i K.Pr.P.
- d) I pandehuri nuk është njoftuar ose kur është njoftuar por për shkaqe ligjore nuk ka mundur të jetë prezent në gjykim parashikuar në nenin 427/4 të K.Pr.P.

Referuar forcës madhore e cila është një koncept i qartë për t’u kuptuar pasi ka të bëjë me shkaqe natyrore, të shkaktuara jashtë vullnetit të të pandehurit, edhe shkaqet e tjera shpjegohen me të njëtin koncept si ai i forcës madhore, por janë të shprehura me terminologji të ndryshme.

Sipas neneve 486/1, 487/1, 487/4 dhe 603/4, të kodit të procedurës penale italiane⁶¹ ekuivalent me nenet e kodit të procedurës penale të vendit tonë të sipërcituara, mungesa e të pandehurit në gjykim si pasojë e shkaqeve të pavarura prej tij, parashikohet nëpërmjet tre termave; kur mungesa është shkaktuar nga forca madhore, kur mungesa është shkaktuar nga rasti faktor dhe për shkak të pengesave të tjera të ligjshme. Nëse do t’i referoheshim terminologjisë së përdorur do të arrinim në konkluzionin se ajo është e njëjtë në të gjitha pjesët e kodit.

Sa përmendëm më sipër dalim në përfundimin se me terminologji të ndryshme shpjegohet vetëm një koncept i cili është “ pengesë tjetër e ligjshme ”. Kjo e fundit ka një

⁶¹ Il Nuovo Codice di Procedura Penale e le Leggi Complementari, a cura di Piermaria CORSO. Quindicesima edizione, 2007. Casa Editrice La Tribuna.

kuptim më të gjerë se rasti i forcës madhore duke i krijuar Gjykatës më tepër hapësira veprimi.

5.2.4 E drejta e të pandehurit për t'u përfaqësuar.

Kur Gjykata vendos se shqyrtimi gjyqësor do të bëhet në mungesë të të pandehurit, këtij të fundit i njihet e drejta e përfaqësimit nga mbrojtësi i tij dhe nëse nuk ka mbrojtës të caktuar nga vetë i pandehuri, atëherë caktohet nga Gjykata një mbrojtës kryesisht⁶². Duke qenë se e drejta për të patur mbrojtës në gjykim është një elemnet themelor për zhvillimin e një procesi të rregullt gjyqësor, atëherë i pandehuri i cili nuk është prezent në gjykim, e ka automatikisht të drejtën për t'u përfaqësuar nga mbrojtësi, parashikuar kjo nga një sërë dispozitash si neni 351/1, 352, 344 të K.Pr. Penale. Referuar vendimit nr.124, datë 27.09.2001 të Gjykatës Kushtetuese lidhur me prezencën e të pandehurit në gjykim kur ai ka bërë kërkesë për të marrë pjesë dhe mosparaqitja e tij ka ardhur për shkak të pamundësisë së Gjykatës për ta sjellë në gjykim është bërë shkak për shtyrjen e gjykimit. Por me kërkesën e mbrojtësit konform nenit 50/1 mbi të drejtat që i njeh ligji, Gjykata është e detyruar të pranojë gjykimin pa prezencën e të pandehurit, duke e konsideruar në përputhje me ligjin marrëdhënien e mbrojtësit me klientin e tij. Nëse Gjykata do të shtynte gjykimin dhe i pandehuri do të asistonte në seancën e radhës atëherë ai mund të zhvleftësonte kërkesën e mbrojtjes konform nenit 50/3 të K.Pr.Penale.

Kur nga ana e Gjykatës bëhet deklarimi i mungesës së të pandehurit përgjegjësitë e mbrojtësit janë më të mëdha pasi ai në përfaqësimin e klientit i duhet të vendosë vetë pa konsultë duke ushtruar të gjitha të drejtat e njohura me ligj, që i njihen edhe të pandehurit duke e zëvendësuar atë me të gjitha tagrat. Për të realizuar një proces të rregullt, sipas nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe nenit 42 të Kushtetutës së Shqipërisë, është e domosdoshme pjesëmarrja në gjykim e avokatit të caktuar sipas nenit 48/3 të K.Pr.Penale ose sipas nenit 49 të K.P.Penale.⁶³

5.2.5 Paraqitja në çdo kohë e të pandehurit

Ligji procedural penal i njeh të drejtën të pandehurit i cili nuk ka marrë pjesë në seancat gjatë procesit dhe me vendim është deklaruar mungesa, deri sa nuk ka përfunduar shqyrtimi gjyqësor, në cdo kohë që ai e konsideron të arsyeshme, të marrë pjesë në gjykim dhe nga ky moment ka të drejtë të bëjë deklarime sipas nenit 358 të K.Pr.Penale,

⁶² Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda "Komentari i Procedurës Penale", botime "MORAVA", 2003, fq. 475.

⁶³ Gjykata Kushtetuese, vendim nr.15, datë 17.04.2003, mendimi i pakicës

por edhe të kërkojë kryerjen e veprimeve procedurale që mendon se janë në dobi të tij. Cdo kërkesë e bërë nga i pandehuri i deklaruar në mungesë por i rikthyer në gjykim, përfshirë edhe kërkesa për prova, Gjykata i merr në shqyrtim dhe vendos për pranimin e tyre kur vlerëson se mund të ndihmojnë hetimin e plotë dhe zgjidhjen e çështjes.

Edhe nëse Gjykata ka deklaruar me vendim mungesën e të pandehurit, me pjesëmarrjen e tij, Gjykata për të realizuar një proces konform nenit 6 të K.E.D.NJ në përputhje me nenin 351/3 i K.Pr.Penale e revokon vendimin e mungesës. Pjesëmarrja në gjykim nga i pandehuri i ofron atij mundësinë e kërkesave të humbura nga mosprezenca por edhe mundësinë të provojë vetë ose nëpërmjet delegimit avokatit të tij, duke mos përjashtuar veprimet e kryera nga Gjykata deri në këtë moment nëse nuk provon vetë i pandehuri shkaqet për mosparaqitjen e tij në gjykim të cilat do të bindin Gjykatën për marrjen e vendimit⁶⁴.

5.2.6 Përsërija e shqyrtimit gjyqësor.

Në gjykim në Gjykatën e Apelit vërtetohet nëpërmjet të pandehurit apo mbrojtësit të tij se mungesa e tij në gjykimin në Shkallë të Parë ka ardhur për shkak të mospasjes dijeni ose kur ai vërteton se shkak i mosparaqitjes në gjykim ka qënë e ligjshme Gjykata e Apelit konform nenit 427 duhet të përsëritë shqyrtimin gjyqësor.

Referuar praktikës së ndjekur nga Gjykata e Lartë mbi njoftimin e të pandehurit në mosrespektim të nenit 141 të K.Pr.Penale për të gjykuarin të cilit nuk i është bërë njoftim dhe nuk është bërë deklarimi i mungesës në shkelje të nenit 141/1/2 të K.Pr.Penale ka bërë që i gjykuari të bëjë kërkesë gjatë gjykimit në Gjykatën e Apelit për të përsëritur shqyrtimin gjyqësor duke arsyetuar shkaqet e mosnjoftimit. Gjykata e Apelit nuk e ka pranuar kërkesën e tij, e cila ka sjellë shkeljen e nenit 6 të KEDNJ, të drejtës për një proces të rregullt gjyqësor dhe ky vendim është i cënueshëm pasi ka rezultuar se i pandehuri ⁶⁵ nuk ka marrë dijeni apo për shkaqe ligjore nuk ka mundur të marrë pjesë në gjykimin që është zhvilluar ndaj tij në Shkallë të Parë, Gjykata e Lartë ka dalë në konkluzionin se nga Gjykata e Apelit është shkelur e drejta për një proces të rregullt gjyqësor dhe ndaj është e detyruar të përsëritë shqyrtimin gjyqësor (neni 427/4), me qëllim për t'i krijuar mundësinë të gjykuarit në mungesë që të sjellë argumente të reja që nuk ka mundur t'i paraqesë në gjykimin në Shkallë të Parë.

⁶⁴ Ylvi Myrtja, "Gjykimi në mungesë", Trajtime Juridike, 2001

⁶⁵ Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Vendim Unifikues nr. 2, datë 19.04.2001.

5.2.7 Garanci të tjera.

- Një prej garancive të tjera që i vjen në ndihmë të dënuarit në mungesë është njoftimi i të pandehurit (neni 386/2 i .K.Pr.P) i cili bëhet konform ligjit procedural penal (neni 140 dhe 141 të K.Pr.P). Për të balacuar institutin e gjykimit në mungesë, kur janë shkelur të drejtat procedurale në lidhje me njoftimin e të pandehurit, ligjvënësi ka parashikuar një mjet tjetër efektiv për të garantuar një proces të regullt ligjor; të gjykuarit në mungesë i cili është instituti i rigjykimit (neni 447 i K.Pr.P) . Referuar praktikave gjyqësore i dënuari në mungesë jo në të gjitha rastet ka pasur dijeni konform ligjit për vendimin e dënimit dhe kjo ka sjellë që i dënuari të mos realizojë të drejtën e tij për t’u ankuar kundër vendimit. Duke iu referuar rasteve të tilla ka dalë e nevojshme që në Kodin e Procedurës Penale ligjvënësi të parashikojë institutin e rivendosjes në afat, e cila është një garanci për rikuperimin e një të drejte të mohuar për të realizuar të drejtën e ankimit .
- Një garanci tjetër që i jepet nga ligjvënësi të dënuarit në mungesë është edhe instituti i rishikimit, parashikuar nga neni 449 të K.Pr.Penale sipas të cilit i pandehuri gjykohet sipas dispozitave të gjykimit në Shkallë të Parë brenda shkaqeve të parashtruara në kërkesën e rishikimit, shkaqe të cilat kanë dalë pas dhënies së vendimit. Rishikimi nuk është një mjet i zakonshëm gjykim, por sipas vendimit të Gjykatës së Lartë nr.6 /2002, “është një mjet i jashtëzakonshëm, madje i vetmi që parashikohet nga ligjvënësi në Kodin e Procedurës Penale për të ndrequr gabimet e mundshme gjyqësore në lidhje me vendimet e formës së prerë”, Si përfundim, është një mundësi për të pandehurin për një gjykim të ri në themel dhe nga ky gjykim mund të dalë një vendim krejtësisht i ndryshëm nga i pari.

KREU VI

NJOFTIMI

Subjektet e vecanta që marin pjesë në një procedim penal krijojnë me njëri-tjetrin raporte të cilat me term juridik quhet procedim penal. Që këto raporte të funksionojnë në mënyrën më të mirë të mundshme duhet që rregullat e komunikimit dhe njoftimet e akteve që i bëhen të pandehurit apo të tretëve, të dëmtuar apo përfitues nga procedimi penal, që kanë interes mbi çështjen duhet të jenë të mirëpërcaktuara⁶⁶.

6.1 Njoftimi i akteve të prokurorit gjatë hetimit.

Për njoftimin e akteve të pandehurit kur është i burgosur, kur është i lirë, kur nuk gjendet dhe kur ndodhet jashtë shtetit, janë rregulla të hollësishme që parashikohen në Kodin e Procedurës Penale.⁶⁷ Konkretisht, në bazë të nenit 134 të K.Pr.Penale, njoftimi i akteve të prokurorit gjatë hetimeve paraprake bëhet nga Policia Gjyqësore ose nëpërmjet shërbimit postar në format e parashikuara në ligj. Lajmërimet e bëra verbalisht nga prokurori zëvendësojnë njoftimet me një kusht, që ky fakt të shënohet në procesverbal.

Për të pandehurin i cili ndodhet në paraburgim, njoftimi i bëhet në vendin e burgimit. Për të pandehurin e lirë merrret adresa e banesës dhe e vendit të punës dhe njoftimi i bëhet duke i dorëzuar një kopjo të aktit. Në pamundësi të kësaj kjo kopjo i dorëzohet një personi që bashkëjeton me të, fqinjit ose një personi që punon me të. Kur banesa dhe puna nuk dihen bëhet në vendin ku ka qëndrim të përkohshëm, duke ia dorëzuar njërit prej personave të parashikuar në nenin 140/1 i K.Pr.Penale. Nuk mund t'i dorëzohet një të mituri nën 14 vjec. Kur është i pamundur njoftimi sipas paragrafit të parë dhe të dytë, procedohet me kërkimin e të pandehurit në vende të tjera, dhe nëse nuk është e mundur akti depozitohet në qendrën administrative të lagjes ku banon ose punon. Lajmërimi i depozitimit afishohet në portën e shtëpisë së të pandehurit ose vendit ku punon. Ftuesi e lajmëron atë për depozitimin me letër rekomande me lajmërim marrje. Efektet e njoftimit rrjedhin që nga marrja e rekomandesë⁶⁸(neni 140/4 i K.Pr.Penale).

Njoftimi që i bëhet të pandehurit për procedimin e nisur ndaj tij i shërben këtij të fundit për të shfrytëzuar të gjitha mundësitë procedurale të parashikuara nga neni 48, 49, 50

⁶⁶ Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda "Komentari i Procedurës Penale", fq.193.

⁶⁷ Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda "Komentari i Procedurës Penale", fq.194,195.

⁶⁸ K.Pr.Penale neni 140/4 faqe 60.

të K.Pr.P në lidhje me përfaqësimin, për t'u përballur me akuzën gjatë gjyqimit, duke i dhënë atij ose mbrojtësit të tij kohën e mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes .

Referuar nenit 141 për njoftimin e të pandehurit kur ai nuk gjendet, pasi njoftimi i tij nuk është bërë sipas rregullave të caktuara për njoftimin e të pandehurit të lirë, organi procedues urdhëron kërkimin e të pandehurit. Kur kërkimi nuk jep rezultat pozitiv nxirret vendimi i mosgjetyes. Pasi i caktohet një avokat kryesisht, i dorëzohet një kopjo akti mbrojtësit. I pagjeturi përfaqësohet nga mbrojtësi, vendimit të mosgjetyes i pushojnë efektet kur përfundojnë hetimet paraprake, në mbështetje të VGJK 31/1998 fq.329 dhe VUGJL 354/1999 fq.329.

6.2 Njoftimi dhe pjesëmarrja e të pandehurit në gjykim në Shkallë të Parë.

Si një detyrim për Gjykatën dhe një e drejtë, e cila është ndër elementet thelbësore për një proces të rregullt ligjor, i pandehuri njoftohet për gjykimin që zhvillohet ndaj tij në Gjykatën e Shkallës së Parë. Sipas neneve 348, 349 dhe 350/4 të K.Pr.Penale, Gjykata në fazën e veprimeve paraprake pasi verifikon prezencën e palëve, urdhëron përsëritjen e njoftimit, në rast se njoftimi është i dyshimtë, i vakët apo i pakomunikuar.

Njoftimi bëhet në vendin e burgimit duke i dorëzuar atij një kopje kur i pandehuri është i burgosur. Do të veprohet në të njëjtën mënyrë kur i pandehuri është duke vuajtur dënimin me burgim apo si i pandehur në një çështje tjetër.

Kur i pandehuri, nga i burgosur mund të jetë i lirë si rrjedhojë e ndryshimit të masës për efekt të ndryshimit të shkaqeve mbi masën e mëparshme, ai ka detyrimin ligjor të paraqitet para organit procedues dhe të deklarojë vendbanimin e tij të fundit. Kur nuk është realizuar njoftimi në adresën e deklaruar nga i pandehuri, bazuar në nenin 139/4 njoftimi i komunikohet mbrojtësit në adresën e tij. Por edhe pse sipas këtij neni paragrafi 4 përcakton se i liruari duhet të bëjë deklarin e banesës, ka mjaftuar me komunikimin e bërë mbrojtësit dhe nuk e ka trajtuar atë sipas nenit 140 të K.Pr.Penale i cili përcakton një sërë personash të cilët kanë marrëdhënie pune apo familjare me të pandehurin, apo duhet të njoftohet sipas nenit 141 duke e trajtuar me statusin e të pandehurit që nuk gjendet. (?) (kjo ngelet për të sqaruar në këtë kod).

Nëse do të shikojmë Kodin e Procedurës Italiane, përse i përket njoftimeve në nenet 161-164, lidhur me përmbajtjen e nenit 139 ekuivalent me to, duhet të zbatohen rregullat e parashikuara në nenin 157 të K.Pr.Penale italiane (neni 140 të Kodit tonë) duke mos e konsideruar sipas nenit 141 për të pandehurin që nuk gjendet.

Njoftimi që i dorëzohet mbrojtësit sipas nenit 141 të K.Pr.Penale, në kushtet e një mbrojtje të caktuar prej organit procedues i bërë mbas nxjerrjes së vendimit të mosgjjetjes është një njoftim i errët pasi vetë mbrojtësi nuk ka asnjë komunikim dhe asnjë lidhje me të pandehurin për të cilin ka dalë vendimi i mosgjjetjes, çka do të thotë se është një akt formal për procedurë por nuk zgjidh asgjë në lidhje me njoftimin e të pandehurit. Kjo procedurë prezumimi është trajtuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, dhe kjo e fundit ka penalizuar shtetin italian pasi sipas saj mosndodhja në banesë e të pandehurit nuk do të thotë se ky i fundit është në dijeni por ka hequr dorë nga paraqitja në gjykim. Sipas kësaj Gjykate heqja dorë duhet të jetë me një kuptim të qartë dhe jo me mëdyshje.

Në nenin 140 të K.Pr.Penale përcaktohen rregullat e njoftimit të të pandehurit të lirë, në të cilin përfshihen një sërë veprimesh procedurale duke njoftuar të pandehurin, familjarët, bashkëjetuesit, fqinjët në vendin e punës dhe nëse nuk realizohet nëpërmjet këtyre njoftimeve të pandehurit i bëhet njoftimi në banimin e përkohshëm të tij. Nëse edhe tek kjo e fundit i pandehuri si dhe personat e tjerë të sipërcituar nuk gjenden, organi procedues nuk duhet të ndalojë kërkimin në vende të tjera. Por nuk mjaftohet me kaq; kërkimi i organit procedues, pasi mbas ezaurimit të këtyre rugëve ligjore të njoftimit ky i fundit nëpërmjet lajmërimit apo rekomandesë bën njoftim në rajonin ku i pandehuri banon. Pra sipas nenit 140 të K.Pr.Penale, organit procedues i janë ngarkuar një sërë detyrash për të realizuar njoftimin me qëllim që në një formë apo një tjetër i pandehuri të marrë dijeni dhe pas përfundimit të këtij kërkimi merrret vendimi i mosgjjetjes së të pandehurit, vendim i cili ka fuqi të përkohshme deri në përfundimin e hetimeve paraprake apo deri në marrjen e një vendimi nga ana e Gjykatës⁶⁹.

Në fakt, mbrojtësi i caktuar kryesisht nga Gjykata ka shumë më pak mundësi për njoftimin e të pandehurit, pasi ai nuk ka asnjë komunikim, madje nuk e njeh të pandehurin, ndryshe nga organet që parashikon ligji të cilat kanë bërë kërkimet për gjetjen e të pandehurit. Pra me dhënien e vendimit nga Gjykata për mosgjjetjen e të pandehurit gjykimi do të vazhdojë pa prezencën e tij, që do të thotë se vendimi i prokurorit për mosgjjetje të të pandehurit e humbet fuqinë me përfundimin e hetimeve. Pas përfundimit të hetimit organi procedues çon çështjen në gjykatë dhe është detyrë e tij të nisë procedurën e njoftimit (sipas nenit 140 K.Pr.P) për të pandehurin. Pasi e ezauron njoftimin në zbatim të nenit 140, dhe nuk ka rezultat pozitiv atëherë Gjykata nëpërmjet Oficerëve të Policisë Gjyqësore urdhëron përsëri të bëhen kërkime për të pandehurin në vendet e parashikuara nga neni

⁶⁹ Neni 141/1 i Kodit të procedurës Penale.

140 K.Pr.Penale dhe merr vendim për mosgjethjen e tij në rast se i pandehuri nuk gjendet. Përsëritja e njoftimeve duhet të bëhet në çdo shkallë gjykimi, duke përfshirë Gjykatën e Apelit dhe atë të Lartë. Në shumë raste Gjykatat superiore janë mjaftuar me veprimet procedurale të Gjykatave më të ulëta duke u bërë shkak për prishjen e vendimeve. Sipas nenit 141/3 parashikuar nga Kodi i Procedurës Penale pranë avokatit të të pandehurit i zgjedhur apo kryesisht bëhet njoftimi i këtij të fundit në rast se ai i fshihet drejtësisë, por vlen nëse janë zbatuar rregullat e njoftimit sipas përcaktimeve ligjore në mënyrë eficiente dhe joformale.

Nuk janë parashikuar në K.Pr. Penale se si do të njoftohet i pandehuri që nuk është i burgosur, por ndodhet në një institucion tjetër, pra ka vakum ligjor në përcaktimin e mënyrës së njoftimit në rastet e sipërcituara.

6.2.1 Mosrespektimi i dispozitave për njoftimin e të pandehurit pasi sjell pavlefshmëri të akteve.

Është detyrim ligjor i Gjykatës të caktojë datën dhe orën e gjykimit konform neneve 132, 139, 140, 141, 142 të Kodit të Proçedures Penale⁷⁰, duke ia komunikuar më pas të pandehurit nëpërmjet njoftimit, por meqënëse marrja pjesë apo jo në gjykim është trajtuar si një e drejtë dhe jo detyrim është i pandehuri ai që vendos nëse do të jetë ose jo i pranishëm në gjykim. I pandehuri i burgosur me të drejtën ekskluzive që i njeh ligji, shpreh vullnetin me akt të shkruar para institucionit të burgimit nëse do të marrë pjesë apo do të autorizojë avokatin e tij në gjykim.

Në rast se nuk respektohen dispozitat për njoftimin e të pandehurit do sillte si pasojë pavlefshmërinë e akteve sipas dispozitave për pavlefshmërinë (neni 128/c).

Sipas Gjykatës së Lartë, Gjykatat duhet të bëjnë kujdes në vlerësimin dhe dallimin e pasojave që sjell pavlefshmëria e njoftimeve⁷¹ për një zhvillim të rregullt të procesit të gjykimit. Kështu edhe nëse njoftimet nuk janë realizuar në përputhje me ligjin procedural penal për pavlefshmërinë e njoftimeve, ato jo domosdoshmërisht do të sillnin

⁷⁰ Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, Vendim nr.47, datë 22.01.2003

⁷¹ Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, Vendim nr.411, datë 18.04.2007 "...edhe pse nga aktet e këtij procedimi penal rezulton se është e vërtetë që nuk janë respektuar kërkesat e dispozitave të sipërpërmendura të K.Pr.Penale për njoftimin e të pandehurit I., i cili u gjykua në gjendje të lirë, duke patur parasysh mënyrën se si u zgjidh nga Gjykata çështja penale në ngarkim të tij, mosnjoftimi i rregullt i tij për pjesëmarrjen në gjykim, nuk cenoi në thelb të drejtat e tij. Përkundrazi, realisht ai u shkarkua nga akuza e ngritur kundër tij nga prokuroria, duke u deklaruar i pafajshëm, fakt ky që tregon angazhimin maksimal, brenda kufijve të ligjit procedural penal, të Gjykatës që shqyrtoi çështjen, në dobi të tij. Pranimi i të kundërtës, sikurse ndodh në vendimin e Gjykatës së Apelit, do t'i dëmtonte seriozisht këto interesa."

pavlefshmërinë⁷² e gjykimit, kur gjykimi nuk ka ardhur si rezultat i shkeljes së të drejtave të të pandehurit për pjesëmarrjen në gjykim nga ai ose mbrojtësi i tij.

6.2.1.1 Format e njoftimit.

Mosrespektimi i formës së njoftimeve është një nga shkaqet që mund të çojnë në pavlefshmërinë. Nëse do t'i referoheshim Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, kjo Gjykatë në çështjen "Sejdoviç kundër shtetit Italian", penalizon këtë të fundit lidhur me formën e njoftimit, i cili përbën sipas saj një rëndësi të veçantë për t'i siguruar të pandehurit, konform nenit 6/3/a të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, këto të drejta. Sipas GJ.E.D.Nj-së që njoftimi të quhet i vlefshëm duhet të jetë konform ligjit procedural penal dhe i provuar me dokument shkresor. Nuk mund të pretendohet se i akuzuari ka hequr dorë nga pjesëmarrja në gjykim, kur nuk ka një njoftim të rregullt zyrtar ndaj tij, duke prezumuar dijeninë e tij. Megjithatë nuk përjashtohen edhe rastet⁷³ kur deklarimi i të pandehurit i marrë në rrugë jozyrtare, jo me njoftim zyrtar por me shkrim ku shprehet vullneti i tij se nuk do të marrë pjesë në gjykim, sikur të kishte një njoftim zyrtar.

6.3 Njoftimi i të pandehurit dhe pjesëmarrja gjatë gjykimit në Apel.

Një rol pozitiv për riparimin e gabimeve procedurale⁷⁴ të bëra nga Gjykata e Shkallës së Parë luajnë Gjykatat më të larta si ajo e Apelit, të cilat kanë ndihmuar për pasurimin e jurisprudencës, referuar burimeve të së drejtës si vendimeve unifikuese etj.

Ashtu sikurse në Gjykatën e shkallës së parë edhe Gjykata e Apelit duhet të vërë në dijeni të pandehurin mbi gjykimin që i atribuohet në këtë Gjykatë, për të dëgjuar pretendimet e tij lidhur me akuzat që i drejtohen pranë kësaj Gjykate.

Ky është detyrim ligjor i cili rrjedh nga dispozitat procedurale mbi njoftimet, si dhe dispozitat kushtetuese, e drejta për t'u dëgjuar dhe gjykuar (neni 33), K.E.D.NJ-së (neni 6).

Nëse do t'i referoheshim rasteve⁷⁵ praktike të gjykuara në Gjykatën e Apelit do të hasim raste në kundërshtim me ligjin procedural penal për njoftimin dhe thirrjen e të pandehurit në gjykim. Një nga rastet është kur Gjykata e Apelit ka mjaftuar me procedurën e gjykimit në Shkallë të Parë duke e marrë si të mirëqënë faktin që i pandehuri është

⁷² Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, Vendim nr.303, datë 11.05.2005 "...Megjithatë nuk mund të arrihet në të njëjtin konkluzion kur edhe pse nuk janë zbatuar me përpikmëri dispozitat procedurale për njoftimin e të pandehurit për gjykim, kur ai vetë ose mbrojtësi i tij marrin pjesë në gjykim. Në këtë rast, çmohet se nuk jemi para pavlefshmërisë së gjykimit, pasi edhe pse nuk është zbatuar si duhet ligji, pjesëmarrja e të pandehurit në gjykim është siguruar. Forma merr vlerë e lidhur me përmbajtjen. Kjo do të thotë që rregullat procedurale kanë si qëllim që nëpërmjet zbatimit të tyre, të garantohet një e drejtë që, kur kjo e drejtë garantohet edhe pa u zbatuar siç duhet forma, passjell shkelje për Gjykatën (e cila duhet t'i vihet në dukje nga Gjykata më e lartë), por jo pavlefshmërinë e veprimeve të kryera prej saj".

⁷³ Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Zunic v Italisë, vendim nr. 14405/05, datë 21.12.2006, § 59, Ivarazzo v Italisë vendim nr. 50489/99, datë 04.12.2001.

⁷⁴ OSCE, Maya Goldstein-Bolocan, "Analiza e procedimeve të çështjeve penale në Republikën e Shqipërisë", fq.21.

⁷⁵ Vendim Unifikues nr. 1, datë 15.02.2001

njoftuar⁷⁶ në këtë shkallë gjykimi. Një rast tjetër është kur Gjykata e Apelit ka gabuar duke u mjaftuar me njoftimin e avokatit duke prezumuar se edhe i pandehuri⁷⁷ ka dijeni. Rast tjetër është kur, edhe pse Gjykatës së Apelit i është bërë i ditur nga avokati mbrojtës i të pandehurit, detyrimi ligjor për thirrjen e këtij të fundit, ajo ka rrëzuar kërkesën në shkelje të hapur me dispozitat procedurale mbi njoftimet. Gjykata e Apelit ka gabuar edhe në rastin e njoftimit të të pandehurit në burg të ankimit të bërë nga prokurori kur i pandehuri është në gjendje të lirë⁷⁸, për shkak të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë.

Gjykata e Apelit e ka detyrim ligjor dhe Kushtetues thirrjen dhe pjesëmarrjen e të pandehurit në gjykim për t’u dëgjuar, pasi në ndryshim nga Gjykata e Lartë që është një Gjykatë ligji, Gjykata e Apelit mund të gjykojë kur është nevoja edhe si Gjykatë e Shkallës së Parë, dhe me kërkesën e palëve ose kryesisht riçel shqyrtimin gjyqësor dhe merrr provat që kërkohen ose i shikon ajo si të arsyeshme për gjykimin e drejtë të çështjes.

Edhe pse mbrojtësit i njihen të drejtat procedurale që i njihen dhe të pandehurit në shumë aspekte mbrojtësi duhet të pajiset me prokurë të posaçme nga i pandehuri për ta përfaqësuar atë denjësisht në gjykim. Nuk mund të barazohet pozita e mbrojtësit me të pandehurit për sa u përket të drejtave ngushtësisht personale vetëm të të pandehurit, siç është e drejta e të pandehurit për gjykimin e shkurtuar etj. Kjo edhe për faktin se është i pandehuri ai që përcakton të drejtën e përfaqësimit nga mbrojtësi apo zhvleftësimin të kërkesave të mbrojtësit në formën e shprehur para Gjykatës, deri në përjashtimin e avokatit nga mbrojtja, çka e bën atë përcaktues. Të njëjtën gjë parashikon dispozita e Kodit të Procedurës Penale (neni 426/1), në lidhje me thirrjen e të pandehurit dhe mbrojtësit.

Në shumë raste Gjykata e Apelit ka trajtuar në mënyrë të gabuar duke njehsuar urdhërimin për thirrje dhe njoftimin, duke i trajtuar këto dy koncepte si të njëjta por që në fakt nuk janë aspak të tilla.

6.3.1 Dallimi midis “ urdhrit për thirrje ” dhe “ njoftimeve ” .

A ka ndryshime midis “ urdhrit për thirrje ” dhe “ njoftimit ” të të pandehurit, sipas kërkesave të nenit 426/1 të Kodit të Procedurës Penale, por edhe sipas ligjit procedural penal ?

Në vendimin nr.1, datë 15.02.2001 të Kolegjeve të Bashkuara çmojnë se, efektivisht dhe potencialisht ekzistojnë ndryshime.

⁷⁶ Gjykata e Lartë, Vendim nr.412, datë 18.04.2007

⁷⁷ Gjykata e Lartë, Vendim nr.146, datë 16.03.2005

⁷⁸Vendimet nr. 9, datë 22.02.2001 dhe nr. 17, datë 09.03.2001, Gjykata Kushtetuese.

Së pari, referuar dispozitave të K.Pr.Penale, neni 112/1 e trajton “urdhrin” si një akt të Gjykatës i cili njoftohet sipas rregullave dhe në përputhje me ligjin procedural penal, dhe njëkohësisht trajton parashikimin mbi “njoftimet”.

Së dyti, “ urdhri ” në përmbajtjen e tij është një detyrë për Gjykatën e cila duhet të përcaktojë mënyrën dhe atë që do të realizojë këtë detyrë. Ndërsa “njoftimet” në përmbajtjen e tyre përcaktojnë formën shkresore se si do të bëhet njoftimi i të pandehurit, në lidhje me një vendim apo me një thirrje apo akt tjetër të parashikuar në ligj.

Sipas nenit 112/1 të K.Pr.Penale i cili e parashikon urdhrin si akt të nxjerë nga Gjykata që duhet ti vihet në dijeni të pandehurit nëpërmjet njoftimit, në zbatim të ligjit procedural penal.

Sipas Kolegjeve në lidhje me “urdhrin dhe njoftimin” kanë dalë në konkluzionin se shpesh herë Gjykatat e Apelit, nenin 426/1 të K.Pr.Penale nuk e kanë interpretuar drejt, pasi ato mjaftohen vetëm me nxjerrjen e urdhrit drejtuar organeve kompetente për zbatimin e tij, por pa marrë parasysh faktin nëse i pandehuri e ka marrë apo jo njoftimin e tij .

Në nenin 349⁷⁹ dhe 350⁸⁰ të K.Pr.Penale është përcaktuar në mënyrë të qartë bashkëveprimi i ndërsjelltë midis urdhrit të Gjykatës për thirjen e të pandehurit dhe bërjes së njoftimit të tij për t’u njohur me veprën që i ngarkohet dhe për të marrë pjesë në gjykim, kështu urdhri i Gjykatës bëhet më eficient dhe i zbatueshëm.

Në përfundim ligjvënësi nuk e ka përcaktuar qartë dallimin midis urdhrit të thirrjes dhe njoftimit të të pandehurit, dhe si pasojë sjell një keqinterpretim nga disa Gjykata në raste të vecanta. Në zbatim të nenit 139 dhe 140 të K.Pr.Penale Gjykatat e Apelit janë të detyruara që njoftimin e të pandehurit të lirë apo të arrestuar, ta kryejnë konform përmbajtjes së dispozitave të sipërcitura .

E njëjta procedurë duhet të ndiqet edhe për thirrjen dhe pjesëmarrjen e të pandehurit edhe për shqyrtim e ankesave kundër vendimeve të cilat caktojnë masat e sigurimit⁸¹.

6.3.2 A do përdoret si bazë ligjore neni 140 i K.Pr.Penale për njoftimin e të pandehurit me masë sigurimi personal “ arrest në burg ” në mungesë?

⁷⁹ Në nenin 349 të K.Pr.Penale parashikohet: “Gjykata urdhëron edhe kryesisht që të përsëritet thirrja për gjykim kur del që i pandehuri ose personi ndaj të cilit është bërë kërkesë për gjykim nga i dëmtuari akuzues nuk ka marrë njoftim ose njoftimi është i dyshimtë.

⁸⁰ Në nenin 350 të K.Pr.Penale, parashikohet: “Kur i pandehuri, qoftë edhe i paraburgosur, ose personi ndaj të cilit ka bërë kërkesë për gjykim i dëmtuari akuzues, nuk paraqitet në seancë...Gjykata edhe kryesisht shtyn ose pezullon shqyrtimin gjyqësor, cakton datën e seancës së re dhe urdhëron që të përsëritet thirrja... 4.Kur del që njoftimi nuk ka qenë i rregullt, Gjykata vendos shtyrjen e shqyrtimit gjyqësor dhe urdhëron përsëritjen e njoftimit...”.

⁸¹ Gjykata e Lartë, Vendim nr. 66, datë 16.06.2003.

Në vendimin⁸² nr.36 të vitit 2006, të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda në lidhje me njoftimin e të pandehurit nuk duhet vënë në zbatim neni 140 i K.Pr.Penale pasi , i pandehuri në këtë rast ndodhet në burg, rrjedhimisht ai është në të njëjtat kushte me të pandehurin e ikur parashikuar nga neni 247/4 të K.Pr.Penal.

Së dyti,veprimet procedurale për njoftimin e të pandehurit të kryera sipas nenit 140 i K.Pr.Penale përse i përket mosarritjes së njoftimit të të pandehurit barazohet me veprimet e organit të procedimit për ekzekutimin e një vendimi Gjykate për masën e dhënë në mungesë “arrest në burg” në një kohë që ikja është deklaruar.

E treta, masa e sigurisë “arrest në burg” është parashikuar si masë e qëndrueshme në kohe pasi është dhënë nga Gjykata me bindjen e plotë dhe prezumohet se mosparaqitja të pandehurit është dëshirë e tij.

Efekti i vendimit të ikjes së të pandehurit ka efekt edhe pas përfundimit të hetimeve si dhe pas dhënies të vendimit nga Gjykata, për arsye se prezumohet se i pandehuri është larguar me dashje me qëllim për t’ju fshehur ballafaqimit me akuzën. Koncept të kundërt ka vendimi i mosgjjetjes së të pandehurit, për arsye se mungesa e tij mund të ketë ardhur për shkaqe të pavarura prej tij, jashtë vullnetit të të pandehurit çka e shkarkon atë nga përgjegjësia e ikjes. Vendimi i mosgjjetjes ka efekte deri në përfundim të hetimit dhe rimerrret përsëri në gjykim nga Gjykata e Shkallës së Parë. E njëjta procedurë ndiqet edhe kur i pandehuri është pa masë sigurimi apo në gjendje të lirë, pasi nuk mund të provohet që i pandehuri i fshihet drejtësisë apo i shmanget njoftimit.

Së katërti: Gjykata e Lartë ka arsyetuar se përsëritja e kërkimeve të personit që nuk gjendet, në një kohë që urdhri i arrestit është në fuqi, është një humbje kohe dhe si pasojë sjell zgjatjen e afateve të gjykimit në kundërshtim me parimin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, kjo edhe për faktin se urdhri i arrestit ka në fuqi procedurat sipas nenit 140 i K.Pr.Penale. Sipas Gjykatës së Lartë , Gjykata e Apelit duhet mjaftohet me procedurën e stërzgjatur në Gjykatën e Shkallës së Parë.

Së pesti: Gjykata e Lartë është shprehur se nga njëra anë Gjykata e Apelit ka pranuar faktin se nuk ka dijeni i pandehuri për ankimin e bërë nga mbrojtësi, por njëkohësisht ka pranuar apelin e bërë nga mbrojtësi. Kjo është kontradiktore pasi mbrojtësi pa dijeninë e të pandehurit nuk mund të bëjë apel pa patur një prokurë të posaçme sipas nenit 410/2 të K.Pr.Penale, sipas të cilës mbrojtësi ka tagra të pakufizura që njehsohen me tagrat e të pandehurit.

⁸² Vendim i Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda nr. 36, datë 26.05.2006.

Si ka arsyetuar lidhur me këtë vendim të Gjykatës së Apelit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i cili e ka prishur vendimin me arsyetimin se⁸³:

Gjykata e Apelit në kundërshtim me dispozitat e nenit 426 të K.Pr.Penale në të gjitha seancat nuk ka njoftuar të gjykuarin duke i shkelur atij të drejtën për pjesëmarrje në gjykim, mohimin e së drejtës për të patur një mbrojtje efektive dhe së drejtës për një proces të rregullt ligjor, veprime këto që e bëjnë vendimin e Gjykatës së Apelit të cënueshëm, prandaj përfundimisht Gjykata e Lartë e ka vlerësuar këtë vendim si të padrejtë në zbatimin e rregullave procedurale, konkretisht si detyrim ligjor, Gjykata e Apelit para se të fillonte shqyrtimin gjyqësor duhet të njoftonte të pandehurin për kohën dhe vendin e procesit gjyqësor zhvilluar ndaj tij, në një kohë të mjaftueshme me qëllim që i pandehuri të realizojë të gjitha të drejtat që i njeh ligji procedural, përfshirë dhe të drejtën e mbrojtjes efektive.

“Kolegji penal sjell në vëmendje të Gjykatës që ka dhënë vendimin e ankimuar faktin se: subjekteve të procedimit pa përjashtuar edhe Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda nuk u njihet e drejta e vlerësimit të operativitetit apo jo, dhe aq më pak e drejta e oportunitetit të zbatimit të normave procedurale në përgjithësi dhe për më tepër të atyre që kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me krijimin e kushteve efektive për kufizimin e të drejtës së mbrojtjes të të akuzuarve në një proces penal ”.

Gjykata e Lartë del në konkluzion se Gjykata e Apelit ka gabuar në barazimin procedural dhe trajtimin e njëllajt të të pandehurit me masë sigurie “arrest me burg” në mungesë, me të pandehurin i cili nuk dihet pse ka ikur, nëse i fshihet drejtësisë apo nuk ka dijeni për procedimin apo gjykimin ndaj tij, pasi janë një sërë faktorësh që sjellin mosdijeninë me apo pa dëshirën e të pandehurit dhe prandaj dhe Gjykata e Lartë me të drejtë e ka konsideruar gabim vendimin e Apelit, lidhur me trajtimin e dy koncepteve që sipas doktrinë janë të ndryshme dhe duhen trajtuar si të tillë.

Është masa e sigurimit ajo që i jep statusin të ikurit konform nenit 247 të K.Pr.Penale që i jepet nga Gjykata dhe nuk kanë lidhje me procedimin dhe gjykimin, për këtë duhet të zbatohen me korrektësi procedurat e parashikuara në kreun II, “Njoftimet”. Në kushtet kur masa e sigurisë “arrest me burg” nuk i është komunikuar të pandehurit ai konsiderohet i lirë dhe në këto kushte duhen të zbatohen rregullat procedurale të parashikuara nga neni 140 të K.Pr.Penale (njoftimi i të pandehurit të lirë) dhe më pas sipas nenit 141 të K.Pr.Penale (njoftimi i të pandehurit kur nuk gjendet).

⁸³ Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr.61, datë 06.02.2008

6.4 Njoftimi dhe pjesëmarrja e të pandehurit në Gjykatën e Lartë.

Të drejtat procedurale dhe garancitë kushtetuese të gjykimit për të pandehurin janë detyruese në cdo shkallë gjykimi përfshirë edhe Gjykatën e Lartë. Edhe pse Gjykata e Lartë është një gjykatë ligji procedura për njoftimin do të jetë e njëjtë sipas kreut II të K.Pr.Penale, sipas specifikave të rasteve. Çdo neglizhencë në këtë drejtim do të konsiderohej si shkelje e të drejtave të parashikuara në ligjin procedural penal dhe atë kushtetues si dhe do të sillte një praktikë të gabuar pasi është kjo Gjykatë që unifikon praktikën. Të një rëndësie të veçantë në këtë gjykim janë parimi i barazisë dhe instituti i mbrojtjes, i cili sjell një proces sipas standarteve ndërkombëtare të shprehura nga neni 6 i KEDNJ-së. Për të patur një proces sipas këtyre standarteve kërkohet detyrimisht njoftimi i palëve, (i pandehuri) si subjektit të veprës penale të cilit i atribuohet vepra dhe mbrojtësit të tij, për datën, orën e gjykimit duke i komunikuar dhe një kopjo⁸⁴ të rekursit.

Për pasojë, në funksion të respektimit të këtyre parimeve një rol të veçantë luajnë edhe njoftimi i palës si dhe i avokatit mbrojtës të tij, si për kopjen e rekursit ashtu edhe për ditën e gjykimit.

Për të garantuar një proces penal të drejtë duhet që i pandehuri të marrë pjesë për t'u mbrojtur në gjykim ose të përfaqësohet nga mbrojtësi në rast se nuk është vetë në gjykim, në zbatim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të K.E.Dr.Nj-së. I detyrohet me ligj Gjykatës që të ndërmarrë masat ligjore për zhvillimin e një procesi të drejtë duke siguruar praninë e mbrojtësit në gjykim, si dhe t'i japë mbrojtësit kohën e mjaftueshme për një mbrojtje efektive në zbatim të parimit të barazisë së armëve⁸⁵. Pra mbrojtja, me një avokat që i njihet të pandehurit të mos jetë vetëm e parashikuar në ligj, por të pandehurit t'i krijohen gjithashtu edhe kushtet për ushtrimin në fakt të kësaj të drejte.

Gjykata Kushtetuese ka bërë shfuqizimin e disa vendimeve të Gjykatës së Lartë të cilat kanë gjykuar në mungesë të pandehurin, pasi nga verifikimet e bëra ka dalë që në lidhje me ditën e gjykimit i akuzuari nuk ka marrë dijeni⁸⁶. Gjithashtu edhe në rastin kur vërtetohet se të pandehurit apo mbrojtësit⁸⁷ të tij nuk i është bërë me dije në lidhje me

⁸⁴ Gjykata Kushtetuese, vendim nr.21, datë, 20.09.2005, " Gjykata Kushtetuese vlerëson se ky parim luan një rol të rëndësishëm në procesin penal, sepse në këtë rast, përballë personit të akuzuar për veprën penale, është shteti. Për këtë arsye shteti (në rastin në shqyrtim Gjykata e Lartë), duhet të ndërmarrë të gjitha masat ligjore që t'i sigurojë të akuzuarit mundësitë e njohjes dhe të deklarimit për ... vlerësimet ligjore të çështjes."

⁸⁵ Gjykata Kushtetuese, vendim nr.5, datë, 17.02.2003.

⁸⁶ Gjykata Kushtetuese, vendim nr.20, datë, 18.04.2000.

⁸⁷ Gjykata Kushtetuese, vendim nr.24, datë, 26.10.2005.

rekursin e bërë nga ana e prokurorit⁸⁸. Një tjetër rast është edhe kur nuk i dorëzohet kërkuesit kopja e rekursit të prokurorit, por i dorëzohet mbrojtësit të tij, i cili është autorizuar nëpërmjet një prokure të posaçme nga i akuzuari vetëm për shkallën e parë dhe të dytë të gjyqësorit, por jo për shkallë të tjera të gjyqësorit⁸⁹.

KREU VII

E DREJTA E ANKIMIT NDAJ VENDIMIT NË MUNGESË

Kontrolli mbi vendimin e Gjykatës realizohet nëpërmjet së drejtës së ankimit si një mjet procedural në dispozicion të palëve. Nëpërmjet ankimit bëhet ndreqja e gabimeve që mund të jenë bërë në gjykimin në shkallë të parë si dhe kontrolli i veprimeve procedurale në dhënien e vendimit nga Gjykata që ka dhënë vendimin⁹⁰.

Sipas të dhënave historike instituti i ankimit daton që në mesjetë, konkretisht në kohën e perandorisë, kohë në të cilën Gjykatat nisën të funksiononin si institucione shtetërore, perandori kishte të drejtë të ndreqte gabimet e bëra nga nëpunësit publikë që vareshin nga ai. Parimi i gjyimit në dy shakallë nisi të funksiononte pas Revolucionit Francez. Sipas këtij parimi vendimet dhe veprimet procedurale të gjyqtarit të Gjykatës më të ulët kontrolloheshin nga gjyqtari i Gjykatës së një shkalle më të lartë, me qëllim vendimet që jepeshin të ishin të drejta dhe të bazuara vetëm në ligj⁹¹.

E drejta e ankimit sipas nenit 43 të Kushtetutës është pjesë e të drejtave themelore të çdo njeriu ndaj të cilit është marrë një vendim. Kjo e drejtë nuk mund të kufizohet, me përjashtim të rasteve të përcaktuara në ligj. E drejta për ankim parashikohet edhe në akte të ndryshme ndërkombëtare të cilat janë bërë pjesë edhe të legjislacionit të vendit tonë. Konkretisht neni 13 i KEDNJ-së si dhe neni 8 i DUDNJ-së kanë në përmbajtjen e tyre të drejtën e rekursit dhe ankimit ndaj vendimeve gjyqësore⁹².

Në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile e Politike në nenin 2 të tij, është parashikuar detyrimi i shteteve për të garantuar nëpërmjet organeve gjyqësore administrative apo legjislative të drejtën e secilit për të bërë rekurs. Shteti gjithashtu ka

⁸⁸ Gjykata Kushtetuese, vendim nr.5, datë, 17.02.2003, "E drejta për të marrë pjesë në gjykim, presupozon jo vetëm pjesëmarrjen fizike të palës, por krijimin për të të mundësive që duke njohur pretendimet e palës tjetër, të jetë në gjendje të parashikojë prapësimet dhe pretendimet e saj. Kjo nuk është një kërkesë formale dhe pa rëndësi, por substanciale dhe e domosdoshme për mbrojtjen e të drejtave të palës, sepse vetëm në këtë mënyrë sigurohet roli i paanshëm i Gjykatës dhe i jepet asaj mundësia reale të shprehë me vendim opinionin për çështjen, pa cënuar rregullsinë e procesit"

⁸⁹ Gjykata Kushtetuese, vendim nr.21, datë, 20.09.2005

⁹⁰ D.Siracusano, A. Galati, G. Tranchina, E. Zappalà, "Diritto Processuale Penale", volume primo, Seconda Edizione, fq.409.

⁹¹ Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda "Komentari i Procedurës Penale", botime "MORAVA", 2003, fq. 525-527.

⁹² Deklarata universale e të drejtave të njeriut, neni 8 i saj shprehet "Çdo person ka të drejtën e një rekursi efektiv përpara juridiksioneve kombëtare kompetente, për veprimet që shkelin të drejtat themelore që i njihen atij nga kushtetuta ose nga ligji"

detyrimin që të krijojë të gjitha kushtet për zbatimin e kësaj të drejte. Edhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut në nenin 2 pika 1 të protokollit nr.7, parashikon të drejtën e rekursit dhe të gjitha mjetet për garantimin e kësaj të drejte⁹³.

Në Kodin e Procedurës Penale, instituti i ankimeve është parashikuar në titullin e tetë, konkretisht rregullat mbi ankimin janë të përcaktuara në kreun e parë të tij. Mjetet e ankimit të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale sipas nenit 407/3 janë tri, apeli, rekursi në Gjykatën e Lartë dhe kërkesa për rishikimin e vendimit. Përveç mjeteve të ankimit në kreun e tetë të kodit të Procedurës Penale janë përcaktuar edhe subjektet që kanë të drejtë të bëjnë ankim.

7.1 Neni 410/2 të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 410 i K.Pr.Penale rregullon të drejtat e të pandehurit për të bërë ankim. Procedura sipas së cilës zbatohet e drejta e ankimit kundër vendimit të dhënë në mungesë të të pandehurit është e shprehur në pikën dy të këtij neni. Sipas nenit 410/2 të K.Pr.Penale, mbrojtësi i të pandehurit duhet të jetë i autorizuar me prokurë të posaçme për të ankimuar vendimin e dhënë në mungesë.

Referuar nenit 410 të K.Pr.Penale për të cilin janë mbajtur qëndrime të ndryshme përsa i përket subjekteve që kanë të drejtën e ankimit kundër vendimit të dhënë në mungesë të të pandehurit, pasi ky në formulimin e tij nuk i shpreh qartë subjektet që kanë të drejtë të bëjnë ankim. Konkretisht, neni 410 nuk është shprehur qartë as mbi tagrat e mbrojtësit kur nuk ka autorizim nga i pandehuri, pra prokurë të posaçme që i jep të drejtë të ankimojë vendimin e dhënë në mungesë.

Qëndrime të ndryshme ka mbajtur Gjykata e Lartë, pasi në fillim e ka pranuar ankimin e bërë nga avokati i caktuar kryesisht nga Gjykata ose ankimin e bërë nga vetë familjarët, edhe pse nuk kishin autorizim të lëshuar nga i pandehuri të shprehur në formën e kërkuar nga ligji, duke e unifikuar praktikën lidhur me procedurën e ankimit.

Sipas Gjykatës së Lartë argumentohet përfaqësimi duke iu referuar nenit 64 të Kodit Civil, sipas të cilit mbrojtësit i jepen tagrat e përfaqësimit, por gjithmonë duke u bazuar në dipozitat procedurale të parashikuara nga neni 410/2 të K.Pr.Penale⁹⁴. Nëpërmjet përfaqësimit njehsohet e drejta e mbrojtësit me të pandehurin, duke i dhënë atij të gjitha të drejtat që gëzon vetë në mënyrë të shprehur me shkrim.

⁹³ Protokollin nr.7 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut në nenin 2 pika 1 parashikon "Çdo person i deklaruar fajtor për një vepër penale nga një gjykatë ka të drejtë të paraqesë për shqyrtim përpara një gjykate më të lartë deklarimin e fajësisë ose dënimit. Ushtrimi i kësaj të drejte, duke përfshirë shkaqet për të cilat ajo ushtrohet është i përcaktuar me ligj."

⁹⁴ Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Vendim Unifikues nr. 47, datë 28.01.1999.

Kjo praktikë, dalë nga Gjykata e Lartë nëpërmjet këtij vendimi, më vonë, prej Kolegjeve të Bashkuara u trajtua si jo e drejtë dhe se praktika gjyqësore duhej të ndryshohej me një tjetër vendim unifikues⁹⁵. Gjykata mbajti një qëndrim të ndryshëm nga i pari duke dalë në një tjetër përfundim me argumentin se ushtrimin e së drejtës së ankimit e ka ekskluzivisht i pandehuri; që kjo e drejtë t'i kalojë mbrojtësit duhet patjetër të bëhet konform nenit 64 të K.Civil dhe 410/2 të K.Pr.Penale, pra duhet të lëshohet me vullnet të shprehur para noterit dhe të përcaktohen qartë tagrat e mbrojtësit lidhur me ankimin.⁹⁶

Një qëndrim të kundërt ndaj atij të Gjykatës së Lartë, mban Gjykata Kushtetuese në vendimin nr.15/2003, sipas së cilës e drejta e ankimit nuk është një e drejtë ekskluzive e të pandehurit, atë mund ta ushtrojë edhe mbrojtësi ose familjarët edhe nëse nuk janë të autorizuar prej të pandehurit me akt të shkruar noteriel, e thënë ndryshe, prokurë të posaçme⁹⁷. Pasojë e këtyre dy qëndrimeve të ndryshme ishin konfliktet ndërinstitucionale që sollën disa vendime dhe ndryshime nga ligjvënësi në legjislacion për të unifikuar praktikën gjyqësore dhe shmangur interpretimet e ndryshme të Gjykatave.

7.1.1 Pse nuk duhet njohur e drejta e ankimit mbrojtësit, pa prokurë të posaçme nga i pandehuri, ndaj vendimit të dhënë në mungesë.

Së pari: kur i pandehuri i cili gjykohet në mungesë në shkallën e parë nuk ka autorizuar mbrojtës atëherë është detyrim ligjor procedural i Gjykatës t'i caktojë atij një mbrojtës kryesisht, i cili nga ai moment merr tagrat e të pandehurit që është duke u gjykuar në mungesë me qëllim për të realizuar një mbrojtje efektive.

Mbrojtësi ka të drejtë të bëjë të gjitha kërkesat paraprake të parashikuara nga neni 354, 356 të K.Pr.Penale duke përfshirë edhe konkluzionet përfundimtare të parashikuara nga neni 387 i K.Pr.Penale, deri në dhënien e vendimit nga Gjykata e Shkallës së Parë, ku përfundon edhe përfaqësimi i të pandehurit në mungesë prej tij. Mbrojtësi caktohet kryesisht nga Gjykata me qëllim garantimin e së drejtës së të pandehurit për një gjykim të drejtë, por mbrojtësi nuk mund të ushtrojë të drejtat e të pandehurit që ligji procedural ia njuh si ngushtësisht personale.

⁹⁵ Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Vendim nr. 354, datë 28.07.1999

⁹⁶ Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Vendim nr. 354, datë 28.07.1999, Kolegjet arsyetojnë se "... Neni 407 i K.Pr.Penale përcakton rastet dhe mjetet e ankimit. E drejta e ankimit sipas paragrafit të tretë, i takon vetëm atij që ligji ia njuh shprehimisht. Në harmoni me këtë vlerësohet edhe përcaktimi i nenit 50/1 të K.Pr.Penale, sipas të cilit mbrojtësi ka të drejtat që ligji i njuh të pandehurit, përveç atyre që i rezervohen atij personalisht. Ligji procedural njuh një sërë të drejtash ekskluzive për të pandehurin, si e drejta për të zgjedhur dhe për të pranuar mbrojtësin, pranimi ose jo i veprës që i atribuohet, e drejta për të dhënë shpjegime, edrejta për tu ankuar ndaj vendimeve të Gjykatës, etj. Sa më sipër gjen shprehje edhe në nenin 410/1 të K.Pr.Penale ku përcakton se kundër vendimit gjyqësor i pandehuri mund të bëjë ankim vetë ose nëpërmjet mbrojtësit të tij. Ndërsa, në rastin e gjykimit në mungesë, sipas paragrafit të dytë të këtij neni, kur i pandehuri nuk e ushtron vetë të drejtën e ankimit këtë të drejtë ligji ia njuh vetëm mbrojtësit të autorizuar posaçërisht për ushtrimin e saj...".

⁹⁷ Gjykata Kushtetuese, vendim nr.15, datë 17.04.2003.

Me përjashtim të rasteve kur i pandehuri nuk ka zotësi juridike për të vepruar dhe asistohet nga një kujdestar, ky i fundit mund të ushtrojë çdo të drejtë të të pandehurit pa asnjë kufizim sipas neni 410/1 i K.Pr.Penale⁹⁸.

Mbrojtësi përfaqëson dhe ushtron vetëm të drejtat e të pandehurit të gjykuar në mungesë jo të personave të tretë që mund të jenë në të njëjtin gjykim. Kur i pandehuri gjykohet në mungesë për shkak se i fshihet gjykimin ose është larguar me dashje të drejtat e tij ushtrohen nga avokati por nuk mund të themi se janë shprehje e vullnetit të të pandehurit pasi avokati është caktuar kryesisht nga Gjykata ose është zgjedhur nga familjarët dhe jo prej të pandehurit⁹⁹.

Në rastin konkret mbrojtësi ushtron mbrojtjen në funksion të të drejtave procedurale të të pandehurit për të pasur një mbrojtje pothuajse efektive brenda kufijve ligjorë, me të drejta të kufizuara për të garantuar minimumin e standartit për një proces të regullt gjyqësor.

Së dyti: me të drejtë neni 410/2 përcakton se nuk mund të legjitimohet ankimi i bërë nga avokati i caktuar kryesisht për faktin se i hiqet e drejta të pandehurit për të bërë ankim nëse ishte bërë njëherë nga avokati, i cili siç e sqaruam më lart nuk është vullneti i të pandehurit por i Gjykatës që e ka caktuar kryesisht në proces. Por edhe pse procedura nuk njeh mbrojtësin kryesisht për ankim kundër vendimit të dhënë në mungesë të pandehurit, këtij të fundit i njihet mekanizmi i rivendosjes në afat të ankimit, parashikuar nga neni 147/2 të K.Pr.Penale. Kjo kërkon që i pandehuri të vërtetojë se nuk ka marrë dijeni për gjykimin apo për vendimin e dhënë. Kur ai fiton të drejtën e rivendosjes në afat atij i njihet e drejta për të bërë ankim, nëpërmjet të cilit kundërshton vendimin e dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë sipas rastit në Gjykatën e Apelit.

Referuar procedurës sipas së cilës pjesëmarrja në gjykim është një e drejtë dhe jo detyrim, (pra ngelet një e drejtë fakultative që është në vlerësimin e të pandehurit dhe nuk trajtohet një e drejtë absolute), kufizimi i saj mund të jetë i pranueshëm deri në përfundim të gjykimin në Shkallë të Parë, por do të konsiderohej e patolerueshme dhe e pariparueshme kufizimi i kësaj të drejte në të gjitha shkallët e gjyqësorit edhe pse e njeh ligji procedural penal, dhe është trajtuar edhe nga Gjykata Kushtetuese.¹⁰⁰

Nëse vendimi i dhënë në mungesë të të pandehurit nga Gjykata e Shkallës së Parë nuk është ankimuar, i pandehuri në mungesë është në pozitë të favorshme krahasuar me

⁹⁸ Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Vendim nr. 354, datë 28.07.1999

⁹⁹ Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Vendim Unifikues nr. 371, datë 27.10.2000, shfuqizuar me vendimin nr.5, datë 07.02.2001 të Gjykatës Kushtetuese.

¹⁰⁰ Gjykata Kushtetuese, vendim nr.15, datë 17.04.2003, mendimi i pakicës.

vendimin që do të mund të ankimohej nga mbrojtësi i caktuar kryesisht dhe do të lihej në fuqi në të gjitha shkallët e gjyqësorit, e cila do të çonte në humbjen e së drejtës së ankimit nga i pandehuri kur ai të vihej në dijeni të vendimit të dhënë në mungesë të tij dhe nuk do të kishte asnjë mundësi për të realizuar një gjykim të ri ku mund të vërtetonte me argumenta mungesën e tij.¹⁰¹

Së treti: nga analiza e bërë dispozitave kushtetuese dhe procedurale lidhur me ankimin është qartësisht një e drejtë ngushtësisht personale në procesin penal, ku cilido subjekt i një veprë penale ka një sërë të drejtash kushtetuese si (neni 31) "*Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë:*

...ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij, të komunikojë lirisht dhe privatisht me të..."

Dispozita kushtetuese e sipërcituar është në pajtim të plotë me nenin 6/3 pika "c", të K. E.D.NJ-së, e cila njeh një sërë të drejtash ngushtësisht personale por edhe kryesisht që vijjnë në mbrojtjen e të drejtave procedurale, në rastin e një akuze në drejtim të tij.

Nje tjetër garanci procedurale vjen nga neni 6 i K.Pr.Penale, i cili garanton një mbrojtje kryesisht, brenda standarteve për të pandehurin i cili nuk ka fuqi financiare për të realizuar mbrojtjen.

Në dispozitat e kodit të procedurës penale përcaktohen mjetet e ankimit duke sqaruar me detaje se kur dhe kush ka të drejtë të bëjë ankim dhe sipas nenit 407/4, të K.Pr.Penale, kjo e drejtë është e drejtë ekskluzive e përcaktuar me ligj dhe nuk mund ta bëjë kushdo, përfshirë dhe të afërmit apo avokatin kur i pandehuri është në mungesë.

Kur i pandehuri është prezent në gjykim kjo e drejtë rregullohet sipas nenit 410, i cili ia njeh të pandehurit dhe mbrojtësit të zgjedhur prej tij. Ligji procedural i njeh të drejtën pa kufij kujdestarit kur subjekti i veprës penale është nën kujdestari të një personi tjetër. Ndryshe trajtohet e drejta e ankimit kundër një vendimi të dhënë në mungesë, për të cilën kërkohet një vullnet i shprehur i të pandehurit për mbrojtësin para një noteri publik ku të përcaktojë tagrat që i delegon atij.

Referuar dispozitave mbi të drejtën e apelit parashikuar nga neni 422 të K.Pr.Penale, tregon qartë se është një e drejtë që i takon subjekteve në proces dhe nuk mund të ketë karakter gjithpërfshirës por ekskluzivisht individual në frymën Kushtetuese.¹⁰²

¹⁰¹ Vendim Unifikues nr. 371, datë 27.10.2000.

¹⁰² Gjykata Kushtetuese, vendim nr.15, datë 17.04.2003, mendimi i pakicës

Në këtë frymë është parë e drejta e ankimit kundër vendimit të dhënë në mungesë, si një e drejtë e kufizuar për mbrojtjen dhe të afërmit e të akuzuarit dhe ligjvënësi ka parashikuar nëpërmjet dispozitave procedurale dhe kushtetuese që kjo e drejtë të ngelet e paezaurushme, përveç të pandehurit të gjykuar në mungesë e thënë ndryshe fisheku i fundit për t'u mbrojtur, dhe duhet të ushtrohet prej tij dhe do të quhej shkelje e të drejtave të përcaktuara me ligj nëse do të ndodhte ndryshe. Ushtrimi i kësaj të drejte realizohet me akt të shkruar sipas ligjit me qëllim që të jetë e provuar dhe e verifikueshme në çdo kohë.¹⁰³ Kjo tregon se për fatin e të pandehurit për të realizuar ankimimin e një vendimi të Shkallës së Parë kundër tij, si subjekt i dëmtuar nga vendimi i dhënë është ai që në vlerësimin e tij nëse janë cënuar të drejtat të shfrytëzojë ekzkluzivitetin që ka për të bërë ankim kundër vendimit të dhënë në mungesë të tij dhe askush tjetër qoftë dhe avokati nuk e gëzon këtë të drejtë.¹⁰⁴

Së katërti: pozita e të pandehurit lidhur me ankimin e një vendimi të dhënë në mungesë të tij nuk çenohet me moslejimin e mbrojtësit kyesisht, apo të zgjedhur nga familjaret, qoftë edhe me akt të shkruar kur deklarohet pavlefshmëria. Në momentin e marrjes dijeni, të pandehurit i lind e drejta për një proces të ri duke kontaktuar me avokatin e zgjedhur vetë. Më parë kjo mundësi ishte e kufizuar për mbrojtësin e caktuar kryesisht dhe të pandehurin, për përballjen me akuzat mundësinë e shfajësimit nëpërmjet provave.¹⁰⁵

7.1.2 Pse duhet njohur e drejta e ankimit mbrojtësit pa prokurë të posaçme nga i pandehuri, ndaj vendimit të dhënë në mungesë.

Së pari: mbrojtësi caktohet jo vetëm për të garantuar të drejtën e pjesëmarrjes në gjykim të të pandehurit por edhe për të mbrojtur në mënyrë efektive të gjitha të drejtat e tjera procedurale që ligji ia njeh atij, të drejta që janë esenciale për zhvillimin e një procesi të rregullt gjyqësor, konkretisht të drejtën e ankimit dhe mbrojtjes deri në shkallët më të larta të gjyqësorit. Ligjvënësi, për garantimin e së drejtës së ankimit ndaj vendimit të dhënë në mungesë të të pandehurit, e ka parashikuar konkretisht në nenin 410/2 të ligjit procedural penal, megjithatë fakti që mbrojtësi duhet të ketë autorizimin të shprehur me prokurë të posaçme nga i pandehuri që nuk është prezent në gjykim e kushtëzon mbrojtësin në ushtrimin dhe mbrojtjen e të drejtave procedurale të të pandehurit në lidhje me të drejtën e ankimit.

¹⁰³ Vendim Unifikues nr. 371, datë 27.10.2000

¹⁰⁴ Gjykata Kushtetuese, vendim nr.15, datë 17.04.2003, mendimi i pakicës.

¹⁰⁵ Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Vendim Unifikues nr. 371, datë 27.10.2000, shfuqizuar me vendimin nr.5, datë 07.02.2001 të Gjykatës Kushtetuese

Për mbrojtjen në mënyrë efektive të së drejtës kushtetuese për t'u mbrojtur me avokat, ligjvënësi duhet të sigurojë të gjitha mjetet dhe garancitë për zbatimin e saj. Ndalimi i mbrojtësit për ushtrimin e së drejtës së ankimit ndaj vendimit të dhënë në mungesë të të pandehurit sjell si pasojë pabarazi midis palëve. Të drejtës së mbrojtjes së të pandehurit dhe avokatit duhet t'i garantohen të gjitha kushtet për zbatimin e saj në fakt, në mënyrë që kjo e drejtë të mos ngelet vetëm në letër por si një e drejtë themelore kushtetuese që zbatohet rigorozisht me mjetet dhe nga organet që parashikon ligji. Nëse kjo nuk do të garantohej atëherë do të kishim shkelje të hapur të parimit të proporcionalitetit dhe atij të barazisë së palëve në proces, shoqëruar nga risku i dënimit pa u kufizuar nga parimi i kontradiktoritetit duke sjellë si rezultat një dënim të padrejtë¹⁰⁶. Pra që të mbrohen efektivisht të gjitha të drejtat procedurale të të pandehurit duhet që e drejta e ankimit t'i njihet edhe mbrojtësit të zgjedhur. Ligjvënësi nuk duhet të mjaftohet me garantimin e kësaj të drejte vetëm në Gjykatën e Shkallës së Parë.

Së dyti: të kufizosh të drejtën e ankimit vetëm me institutin e rivendosjes në afat, kur të drejtën e ankimit ligji procedural penal e njeh si një të drejtë që mund të ushtrohet nga avokati i caktuar nga familjarët, sjell si pasojë mohimin e së drejtës së mbrojtjes dhe shkeljen e parimeve Kushtetuese për një proces të regullt gjyqësor¹⁰⁷.

Së treti: nëse do t'i referoheshim arsyetimit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me të drejtën e ankimit ndaj vendimeve gjyqësore, e cila është shprehur së e drejta e ankimit në ndryshim nga e drejta e pranimit të autorësisë së veprës penale ose të drejtës për të mos dëshmuar, të cilat janë të drejta që i atribuohen vetëm të pandehurit, e drejta e ankimit është një e drejtë që mund të ushtrohet edhe nga mbrojtësi i të pandehurit, pasi mohimi i saj do të cënonte të drejtat që ligji prashikon për të pandehurin¹⁰⁸.

Si pasojë e rrëzimeve të vazhdueshme nga Gjykata Kushtetuese e vendimeve të dhëna nga Kolegjet e Bashkuara, legjislatori¹⁰⁹ e pa të domosdoshme ndërhyrjen e tij ndaj me ligjin nr.8813/2002 ai bëri ndryshime në disa dispozita të Kodit të Procedurës Penale, konkretisht termit "leshuar" i shtoi edhe termin i "pandehuri". Ky ndryshim ishte në favor të vendimeve të dhëna nga Kolegjet e Bashkuara por si pasojë e një kërkesë që Komiteti

¹⁰⁶ Gjykata Kushtetuese, vendim nr.15, datë 17.04.2003

¹⁰⁷ Gjykata Kushtetuese, vendim nr.17, datë 17.04.2000

¹⁰⁸ Po aty.

¹⁰⁹ Kolegjet e Bashkuara refuzuan të zbatonin vendimin nr.17, datë 17.04.2000 të Gjykatës Kushtetuese ndonëse ai ishte i detyrueshëm për to. Në vendimin nr.5, datë 07.02.2001 Gjykata Kushtetuese argumenton "Në parim, vendimet e dhëna nga Gjykata Kushtetuese kanë autoritetin absolut të gjësë së gjykuar dhe prodhojnë efekte "erga omnes"; pra, për të gjithë. Në rastin konkret, çështja që trajton të drejtën e avokatit për të bërë ankim, si përfaqësues i të gjykuarit në mungesë, i caktuar kryesisht ose nga familjarët e të pandehurit, është zgjidhur njëherë e përgjithmonë në mënyrë definitive dhe sipas parimit "res judicata" ajo nuk mund të rishikohet përsëri në të ardhmen. Pikërisht, zgjidhjen përfundimtare, kjo çështje e ka marrë tashmë me vendimin nr.17, datë 17.04.2000 të Gjykatës Kushtetuese."

Shqiptar i Helsinkit i drejtoi Gjykatës Kushtetuese, kjo e fundit e shpalli ndryshimin si antikushtetues¹¹⁰ duke e shfuqizuar atë. Sipas Gjykatës Kushtetuese paragrafi 2 i nenit 410 ishte lehtësisht i kuptueshëm dhe i zbatueshëm konform dispozitave të tjera ligjore dhe nuk ishte e nevojshme të bëheshin ndryshime. E kundërta do sillte shkeljen e të drejtave themelore kushtetuese dhe të së drejtës për një proces tërësisht ligjor, parashikuar nga nenet 31/ç, 42 të Kushtetutës, nenit 6 dhe 13 të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut, duke cënuar të drejtën e ankimit dhe mbrojtjes për të pandehurin si edhe do të binte në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës, pasi prezenca e të pandehurit e bën të pamundur lëshimin e një prokure të posacme përfaqësimi për mbrojtësin e tij në lidhje me të drejtën e ankimit.

Në bazë të arsyetimit të Gjykatës Kushtetuese mbi shfuqizimin e ndryshimit nga ligjvënësi të nenit 410/2, ndaj vendimit të dhënë në mungesë të të pandehurit, të drejtën e ankimit mund ta ushtrojë edhe mbrojtësi i zgjedhur nga familjarët e të pandehurit ose të caktuar kryesisht nga Gjykata.

Pavarësisht arsyetimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, ndeshen ende raste ku disa Gjykata nuk e pranojnë ankimin e bërë nga mbrojtësi i zgjedhur nga familjarët e të pandehurit ose të caktuar kryesisht nga Gjykata¹¹¹. Konkretisht në një vendim të Gjykatës së Tiranës ku kërkohej rivendosja në afat e ankimit, Gjykata e ka pranuar kërkesën e bërë, por nuk pranon apelin kundër vendimit të dhënë në mungesë të të pandehurit të bërë nga mbrojtësi i tij¹¹².

7.1.2.1 Një argument në favor të qëndrimit të Gjykatës Kushtetuese.

Referuar nenit 147/2 të Kodit të Procedurës Penale, në lidhje me të pandehurin që është gjykuar dhe dënuar në mungesë, nëpërmjet ankimit të bërë nga mbrojtësi i shuhet mundësia që të rivendoset në afat për të bërë ankim. Nëse do të kishim parasysh afatin e shkurtër brenda të cilit duhet të paraqitet ankimi, natyrshëm do të na lindë edhe dyshimi se mbrojtësi pavarësisht nga raportet e besimit midis mbrojtësit dhe të pandehurit, i pandehuri

¹¹⁰ Gjykata Kushtetuese në vendimin nr.15, datë 17.04.2003.

¹¹¹ Gjykata e Apelit Durrës, vendim nr.337, datë 09.11.2005.

¹¹² Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim nr. 425, datë 21.06.2007, "Ankimi ndaj vendimit Nr 180 date 12.03.2001 i cili është bere nga avokati H.K. (i caktuar kryesisht nga Gjykata), është bere ne kundërshtim me format e parashikuara nga ligji, pasi ai nuk ka qene i pajisur me asnje akt perfaqesimi nga i pandehuri apo familjaret e tij, ç'ka bie ndesh me nenin 407/4 te K.Pr.Penale ku citohet: **"E drejta e ankimit i takon vetem atij qe ligji ia nje shprehimisht"** dhe me nenin 410/2 te K.Pr.Penale ku thuhet: **"kunder vendimit te dhene ne mungese mbrojtësi mund te beje ankim vetem kur eshte i pajisur me nje akt perfaqesimi te leshuar ne format e parashikuara nga ligji"**."

i gjykuar në mungesë mund të mos jetë vënë në dijeni nga mbrojtësi në lidhje me ankimin¹¹³.

Për të ushtruar të drejtën që njeh instituti i rivendosjes në afat të ankimit, prezumohet se i pandehuri është vënë në dijeni në lidhje me ankimin nga mbrojtësi. Meqënëse mbrojtësi për të bërë ankim duhet të ketë prokurë të posaçme të lëshuar nga i pandehuri, edhe pse afati i ankimit është prekluziv autorizimi nga i pandehuri për të bërë apel nga mbrojtësi prezumohet se është dhënë. Duhet të kemi parasysh që e drejta për të rivendosur në afat ankimin edhe kur i pandehuri nuk ka komunikuar me mbrojtësin, kushtëzohet nga faktet të cilat duhen provuar para Gjykatës që ankimi ndaj vendimit të dhënë në mungesë të rivendoset në afat, por deri sa të provohet se pse nuk është bërë ankim në afat të pandehurit mund t'i kenë ardhur pasoja të rënda të pariparueshme siç është kalimi i afateve dhe humbja e së drejtës për të bërë ankim.

Si konkluzion nga sa u sipërcitua mund të themi se e drejta e avoaktit që me iniciativën e tij mund të ankimojë vendimin e dhënë në mungesë, garanton më shumë të drejtat procedurale të të pandehurit sesa i garanton e drejta për të kërkuar rivendosjen në afat të ankimit.

7.2 Zbatimi në praktikë dhe pasojat e vendimit nr.15, datë 17.04.2003 të Gjykatës Kushtetuese.

Përpara se Gjykata Kushtetuese të shfuqizonte ndryshimet e bëra në nenin 410/2 të K.Pr.Penale, disa Gjykata bazuar në këtë ligj nëpërmjet vendimeve të tyre e kishin rrëzuar ankimin e bërë nga mbrojtësi me arsyetimin se ai nuk ishte pajisur me prokurë të posaçme nga i pandehuri, edhe pse për këto vendime afatet e ankimit ishin shuar, si rezultat i shfuqizimit të tyre në praktikë sollën disa probleme, që kishin të bënin me:

Së pari: a do të fillonte një afat i ri për ankimin e këtyre vendimeve, që në momentin e hyrjes në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese ?

Pas ndryshimit të nenit 410/2 të K.Pr.Penale mbrojtësi i të pandehurit të gjykuar në mungesë nuk mund të bënte ankim, por njëkohësisht ky ndryshim nuk vepronte në afatet e ankimit. Meqë afatet vazhdojnë të ecin si pasojë e drejta për bërë ankim humbet pa u bërë ankim kundër vendimit të dhënë në mungesë, pasi mbrojtësi mund ta ankimojë vendimin brenda një afati të përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale, pra brenda 10 ditëve jashtë

¹¹³ D.Siracusano, A. Galati, G. Tranchina, E. Zappalà, "Diritto Processuale Penale", volume secondo, Seconda Edizione, fq. 417-420.

këtij afati, e dretja për të bërë ankim përfundon pasi është një afat prekluziv sipas Kodit të Procedurës Penale.

Së dyti: bazuar në nenin 147/1 të Kodit të Procedurës Penale, mbrojtësi vetëm pasi t'i drejtohet institutit të rivendosjes në afat ka të drejtën për të bërë ankim.

Nga ana e mbrojtësit afati për të bërë ankim nuk është respektuar si pasojë e rrethanave të pavarura prej tij, por për shkak të ndryshimeve të bëra nga legjislatori në nenin 410/2 të K.Pr.Penale, mbrojtësit iu hoq e drejta për të bërë ankim deri në autorizimin me prokurë të posaçme prej të pandehurit. Shfuqizimi që iu bë nenit 410/2 të K.Pr.Penale nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr.15.dt.17/04.2003 si nen në kundërshtim me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare, në lidhje me termin e shtuar " nga i pandehuri ", vendimi që shfuqizoi këtë ndryshim hyri në fuqi më dt.24.04.2003 , datë kjo e botimit në fletoren zyrtare. Mbas hyrjes në fuqi të vendimit të sipërcituar, mbrojtësit iu dha e drejta që në bazë të nenit 147/1 të K.Pr.P për të kërkuar rivendosjen në afat brenda 10 ditëve nga dita e heqjes së shkakut që pengonte rivendosjen në afat, pra mbrojtësi ishte i detyruar që fillimisht të kërkonte rivendosjen në afat pastaj dhe më pas mund të ankimonte vendimin e dhënë në mungesë¹¹⁴.

Së treti: bazuar në nenin 147/1 të K.Pr.Penale tek rasti fator apo tek forca madhore do të bëjë pjesë pengesa e sipërcituar?

Mbrojtësi u kufizua shprehimisht nga ligji për të ankimuar vendimin e dhënë në mungesë të të pandehurit , por Gjykata Kushtetuese e shpalli si antikushtetues këtë kufizim dhe si pasojë ai u shfuqizua. Në asnjërin prej rasteve përjashtimore të parashikuara në nenin 147/1 të K.Pr.P lidhur me trajtimin përkufizues të forcës madhore apo rastit fator, pengesa nuk është shjeguuar qartë.

Mbrojtësit, i cili e ka humbur afatin e ankimit jo për faj të tij, i ka ardhur në ndihmë Gjykata e Lartë me qëllim për të mos e penalizuar, ka interpretuar dispozitën akoma më gjerësisht duke i dhënë një përkufizim rastit praktik tek forca madhore¹¹⁵.

Së katërti: a do ta ruajë në vazhdimësi pozitën procedurale për të bërë ankim mbrojtësi i caktuar kryesisht nga Gjykata e Shkallës së Parë ?

Si e kemi theksuar më lart avokati i caktuar kryesisht nga Gjykata, kur e ka humbur të drejtën për të ankimuar vendimin për shkaqe të pavarura prej tij por që lejojnë dhe janë të justifikuara sipas nenit 147 të K.Pr.P (për të cilin mbrojtësi i zgjedhur dhe ai kryesisht

¹¹⁴ Kolegji Penal i Gjatës së Lartë, Vendim nr.663, datë 22.12.2004.

¹¹⁵ Po aty.

janë në të njëjta pozita dhe kanë të njëjtin vlerësim) për të kërkuar që të rivendoset në afatin e ankimit konform kësaj dispozite. E drejta për të rivendosur në afat nga mbrojtësi nëse do t'i referohemi mënyrës së formulimit të nenit 147/1, dalim në konkluzionin se e drejta e mbrojtësit është e pavarur nga e drejta e të pandehurit, por gjithmonë në interes të këtij të fundit.

KREU VIII

RIVENDOSJA NË AFATIN E ANKIMIT.

Vendimet dhe urdhrat e Gjykatës parashikuar sipas Kodit të Procedurës Penale janë të ankimueshme, por afati i ankimit është prekluziv dhe i përcaktuar në ligj, (neni 415 i k.pr.p.). Me mbarimin e kufijve të përcaktuara nga dispozita e sipërcituar i pandehuri e humbet të drejtën për të bërë ankim. Mosushtrimi i kësaj të drejte në afatin e përcaktuar nga neni 415 të K.Pr.Penale, nga i pandehuri ose mbrojtësi bën që të humbasë një e drejtë e përkoshme në shumicën e rasteve dhe ndoshta e përhershme në disa raste, sipas shkaqeve. Jo gjithmonë, humbja e afatit varet nga subjekti që e ka këtë të drejtë dhe për të rregulluar disi pozitën mbi ankimin është parashikuar në nenin 147 të K.Pr.Penale mundësia e rivendosjes në afat të së drejtës për të bërë ankim, duke i krijuar subjektit të veprës penale një mundësi të dytë me qëllim ushtrimin e së drejtës për t'u gjykuar në një shkallë tjetër më të lartë.

Rastet e rivendosjes në afat të përcaktuara në mënyrë taksative janë:

- Akuza, i akuzuari, të tretët në proces si dhe avokati i të akzuarit, në rast se provojnë se nuk e kanë pasur të mundur të ndjekin afatin e ankimit për shkaqe të pavarura prej tyre në bazë të nenit 147/1 të Kodit të Procedurës Penale, kanë të drejtë të kërkojnë rivendosjen në afat të ankimit.
- Bazuar në nenin 147/2 të Kodit të Procedurës penale i akuzuari ka të drejtë të kërkojë rivendosjen në afat për të bërë ankim nëse ai vërteton se nuk është vënë në dijeni për vendimin e dhënë në mungesë.

8.1 Rivendosja në afatin e ankimit, për shkak të një rasti fator apo forcës madhore.

Parashikuar në nenin 147/1 të K.Pr.Penale, afati i ankimit mund të vijë vetëm për shkaqe madhore siç janë ato të rastit fator me të cilin do të kuptojmë një ngjarje që nuk është parashikuar dhe nuk mund të parashikohet nga i pandehuri që nuk do të mund të ndryshonte gjatë periudhës kohore për përmbushjen e aktit në afatin e caktuar, apo të forcës madhore me të cilën kuptojmë energji rastësore, natyrore, njerëzore apo mbinjerëzore që i pandehuri nuk ka mundësi për ta ndaluar duke sjellë si pasojë prishjen e çdo veprimi të tij për të ndjekur afatet¹¹⁶ e aktit për ankim. Nëse nuk vërtetohet ekzistenca e një prej këtyre rasteve të sipërcituara nuk do të ketë rivendosje në afat të ankimit. Meqënëse të dy rastet e sipërcituara në thelb të tyre kanë kuptimin që kalimi i afateve të njoftimit ka ndodhur jo për faj të të pandehurit atëherë sipas një doktrine¹¹⁷ mendohet se kemi të bëjmë me të njëjtin koncept.

Të gjitha subjektet që legjitimohen në ngritjen e kërkesës për rivendosje në afat janë parashikuar nga neni 147/1 i Kodit të Procedurës Penale, të cilat janë pala akuzuese, i akuzuari, palët e treta si dhe avokati i zgjedhur nga i akuzuari apo i caktuar kryesisht nga Gjykata. E drejta e avokatit për bërë kërkesën e rivendosjes në afat ka të bëjë me aktet që janë në përgjegjësi të tij, aktet të cilat janë të të pandehurit si dhe aktet për të cilat ka përgjegjësi për t'i përgatitur vetëm i pandehuri që ai mbron. Rrjedhimisht, është detyrim për mbrojtësin të provojë arsyen pse ai nuk ka mundur të vërë në dijeni palën në lidhje me ankimin të cilit i ka kaluar afati dhe kërkon rivendosjen në afat, si dhe detyrim i tij të provojë arsyet se përse ai nuk ka mundur të respektojë afatet e ankimit, pasi sipas nenit 147/3 të Kodit të Procedurës Penale për secilën shkallë të procedimit nuk mund të bëhet rivendosja në afat më shumë se një herë. Ky kufizim qëndron për të pandehurin nga njëra anë dhe për mbrojtësin e tij nga ana tjetër, veçanërisht për secilin pasi të drejtën për të kërkuar rivendosjen në afat e gëzon secili, pa u kufizuar nga të drejtat e njëri- tjetrit.

Kërkesa për rivendosjen në afat parashikuar nga neni 147/3 duhet të paraqitet brenda dhjetë ditëve nga zhdukja e shkaqeve që përbënin pengesë, konkretisht rasti fator ose forca madhore, duke vërtetuar arsyet e humbjes së afatit të ankimit. Edhe pse sipas ligjit afati i ankimit është prekluziv, ligjvënësi ka parashikuar rezerva ligjore në lidhje me rastin kur provohet se humbja e afatit të ankimit, ka ardhur si pasojë e shkaqeve të pavarura nga vullneti i palëve siç është rasti fator ose forca madhore, duke parashikuar të drejtën e

¹¹⁶ D.Siracusano, A.Galati, G. Tranchina, E. Zappalà, "Diritto Processuale Penale", volume primo, Seconda Edizione, fq. 309.

¹¹⁷ Franco Cordero, "Procedura Penale", Terza Edizione, GIUFFRÈ 1995, fq.308.

rivendosjes në afat të ankimit. Por nuk është i qartë fakti nëse rasti fator apo forca madhore i përfshin të gjitha pamundësitë e palës për të respektuar afatet¹¹⁸ e ankimit. Referuar praktikës gjyqësore mendoj se ligjvënësi me konceptet rasti fator apo forcë madhore ka kufizuar Gjykatën në vlerësimin e provave për t'i dhënë ose jo të drejtën e rivendosjes në afat të subjektit i cili i vë në dispozicion për të provuar shkaqet e humbjes së të drejtës së ankimit.

Vetë përmbajtja e nenit na orienton drejt konkluzionit që Gjykata nuk mund të rivendosë në afat në rastet kur janë të ndryshme nga ai i rastit fator apo forcës madhore edhe pse humbja e afatit të ankimit është shkaktuar jo për faj të subjektit. Rrjedhimisht lind e nevojshme që ky nen të zgjerohet nga ana e legjislatorit pasi pa të drejtë kufizon të drejtën e subjekteve për të kërkuar rivendosjen në afat, në rastet e humbjes së afateve të ankimit për shkaqe të pavarura prej tyre.

8.2 Rivendosja në afatin e ankimit të vendimit, për të pandehurin e gjykuar në mungesë.

Referuar sistemit tonë dhe atij italian kur i akuzuari me vullnetin e tij të lirë nuk është paraqitur në gjykim, parashikojnë një qëndrim neutral të Gjykatave në lidhje me gjykimin në mungesë, duke i bërë këto sisteme të veçanta. Mosprezenca e të pandehurit në gjykim nuk konsiderohet rrethanë rënduese për faktin se legjislacioni procedural penal nuk parashikon asnjë lloj penalizimi, por ai gjithësesi parashikon disa masa dhe mjete mbrojtëse për të cilat prokurori ka detyrimin ligjor t'i zbatojë në lidhje me njoftimin, përpara se Gjykata të bëjë shpalljen e të pandehurit në mungesë.

Gjykimi në mungesë i të pandehurit në vendet e tjera nuk konsiderohet si i drejtë pasi ai bie ndesh me nenin 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut për arsye se është e vështirë të provohet nëse i pandehuri ka zgjedhur me vullnetin e tij të lirë të mos jetë prezent në gjykim apo mosprezenca e tij në gjykim ka ardhur si pasojë e mosbërjes së njoftimit konform ligjit procedural penal lidhur me akuzat e drejtura ndaj tij. Për këtë arsye disa shtete të tjera evropiane e kanë shmangur problemin e sipërcituar duke e kufizuar aplikimin e tij, ndërkohë që shteti gjerman gjykimin në mungesë pothuajse nuk e aplikon, përjashtuar disa raste të veçanta.

Ndryshe është parashikuar nga ligjvënësi në vendin tonë, sipas legjislacionit i pandehuri ka të drejtë të gjykohet në mungesë në të njëjtat kushte me gjykimin ndaj tij kur

¹¹⁸ Pasojat që solli vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.15, datë 17.04.2003.

ai është i pranishëm në proces. Në rastin kur ky i pandehur është në mungesë me vullnetin e tij të plotë ai ka të drejtën e përfaqësimit me një avokat të zgjedhur prej tij apo të caktuar kryesisht nga Gjykata. Nëse vërtetohet se mungesa e të pandehurit është shkaktuar për shkaqe të pavarura prej tij atëherë ai ka të drejtën e ankimit ndaj vendimit që është dhënë në mungesë të tij, nëpërmjet kërkesës për rivendosjen në afat që nga momenti kur atij i është bërë i ditur vendimi i marrë ndaj tij edhe pse kanë kaluar afatet e ankimit. Pra legjislacioni ynë e regullon problemin në lidhje me mungesën e të pandehurit në proces duke i dhënë atij të drejtën për rivendosjen në afat të ankimit, kështu që në rast se ai vetë vërteton para Gjykatës se vendimi i dhënë në mungesë nuk është i drejtë pasi mungesa e të pandehurit në proces ka ardhur si pasojë e shkaqeve të pavarura prej tij atij i jepet e drejta për rigjykim.

Nëpërmjet një mjeti që ligji ynë parashikon, garantohet realizimi i së drejtës së të pandehurit për të bërë ankim ndaj vendimit të dhënë në mungesë, parashikuar kjo e drejtë në nenin 351 të Kodit të Procedurës Penale. Gjithashtu neni 147/2 të K.Pr.Penale parashikon se i pandehuri ka të drejtë që pasi të provojë se nuk është njoftuar për vendimin e dhënë në mungesë të tij, bazuar në institutin e rivendosjes në afat të ankimit ai mund të ankimojë vendimin në Gjykatën e Apelit ose në Gjykatën e Lartë. I pandehuri ka të drejtë të kërkojë rivendosjen në afat të ankimit kur njoftimi¹¹⁹ nuk është bërë sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale.

Pas dhënies së vendimit të dënimit në mungesë të të pandehurit ai vendos me vullnetin e tij të lirë të paraqitet ose kur kapet nga policia, ka të drejtë të kërkojë që ankimi të rivendoset në afat. E kundërta ndodh nëse i pandehuri edhe pas marjes së njoftimit konform procedurave ligjore heq dorë përsëri për të marrë pjesë në gjykim; ai e humbet përfundimisht të drejtën e ankimit. E drejta e të pandehurit për të qënë i pranishëm në gjykim lihet në zgjedhjen e tij, kështu që në rast se ai nuk paraqitet në proces edhe pasi i është bërë i ditur procedimi i nisur ndaj tij, prezumohet se ai ka hequr dorë nga e drejta për të qënë i pranishëm në gjykim.

8.2.1 Është e drejtë rivendosja në afat të ankimit ndaj vendimit për njohjen e një vendimi penal të huaj ?

¹¹⁹ Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, vendim i Dhomës së Madhe, nr.56581/00 datë 01.03.2006, § 60.

Në vendimin unifikues nr.5, dt.10/10/2002 Gjykata e Lartë¹²⁰ ka arsyetuar se interpretimi i nenit 147/2 të K.Pr.Penale nuk është i drejtë, pasi dispozita vihet në përdorim në rastet kur i pandehuri provon se nuk është njoftuar në formën e kërkuar nga ligji dhe se nuk ka dijeni për vendimin e Gjykatës të dhënë në mungesë të tij, pra në rastin konkret e drejta e ankimit vendoset në afat për të bërë ankim ndaj vendimit në themel, vendim ky që është i ndryshëm nga vendimet e njohjes.

Gjykata e Lartë ka arsyetuar se kur i pandehuri është dënuar nga një gjykatë e huaj dhe kërkon nga autoritetet e huaja që dënimin ta vuajë në Shqipëri, nuk mund të jetë i pranishëm në gjykimin e konvertimit dhe të njohjes së vendimit penal të Gjykatës së huaj, për shkak të natyrës së gjykimit dhe rrethanave në të cilat është duke u zhvilluar ky gjykim. Për shkak të pamundësisë absolute i dënuari nga një Gjykatë e huaj, jo për faj të tij nuk mund të jetë i pranishëm në procesin e zhvilluar nga Gjykata shqiptare, pasi është duke vuajtur dënimin me burgim jashtë territorit të Shqipërisë. Megjithatë, ligjvënësi për garantimin e të drejtave të tij ligjore në mënyrë efektive, i ka krijuar mundësinë që në gjykimin e konvertimit dhe të njohjes së vendimit penal të Gjykatës së huaj nga Gjykata shqiptare të mbrohet nga një avokat i zgjedhur nga i dënuari duke i lëshuar një prokurë të posaçme. Kur avokati i zgjedhur nga i dënuari mungon për shkaqe të pajustificuara nga ligji ose kur i dënuari nuk ka zgjedhur asnjë avokat në fillim të gjykimit të konvertimit të vendimit të marrë nga Gjykata e huaj, Gjykata shqiptare e ka si detyrim ligjor ta zgjedhë ajo vetë mbrojtësin, duke e caktuar kryesisht. Nga palët kundër vendimit të konvertimit mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit¹²¹.

I dënuari që gjatë gjykimit nuk ka qënë prezent nuk ka të drejtë të kërkojë rivendosje në afat të ankimit nëse sipas nenit 147/2 të K.Pr.Penale nuk provon se nuk ka marrë dijeni për vendimin e dhënë në mungesë. Me qëllim mbrojtjen e të drejtave ligjore të të dënuarit, Kolegjet e Bashkuara me vendimin unifikues kanë arsyetuar se kur sipas të dënuarit vendimi i konvertuar nuk është i drejtë, pa aprovimin e tij autoritetet e huaja nuk mund ta ekzekutojnë vendimin duke e transferuar, pra duhet të presin deri sa i dënuari ta apelojë vendimin dhe vendimi të bëhet i ekzekutueshëm.

Për një të dënuar nga një vend i huaj është një zgjidhje jo efektive, (zgjidhja e dhënë nga Gjykata e Lartë duke caktuar një avokat kryesisht) pasi mundësitë e tij për të patur një avokat të zgjedhur ose të kontaktuar prej tij në vendin lindjes, janë të limituara pothuajse të pamundura dhe si pasojë mbrojtja bëhet thjesht formale. Zgjidhja do të ishte

¹²⁰ Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Vendim Unifikues nr. 5, datë 10.10.2002.

¹²¹ Po aty.

më efektive nëse do të konsiderohej forcë madhore fakti që i dënuari e vuan dënimin jo në vendin e lindjes por në një vend të huaj duke i dhënë mundësinë atij që nëpërmjet institutit të rivendosjes në afat sipas nenit 147/1 të K.Pr.Penale të kërkojë të drejtën e rivendosjes në afat të ankimit, si mundësi më e realizueshme nga ana e të dënuarit pas marrjes dijeni për vendimin e njohjes sesa ankimi. Faktikisht i pandehuri e ka pothuajse të pamundur të ankimojë vendimin e njohjes.

8.2.2 Kërkesat ligjore që kushtëzojnë rivendosjen në afat.

Sipas nenit 147/2 të Kodit të Procedurës Penale i pandehuri mund të rivendoset në afat nga ana e Gjykatës vetëm nëse plotësohen kushtet e sanksionuara sipas këtij neni. Ai e humbet të drejtën e rivendosjes në afat kur nuk plotëson qoftë edhe një kriter të vetëm të përcaktuar në dispozitë. Nëse do t'i referoheshim praktikës do të vinim re se ajo është e unifikuar rast pas rasti duke mos patur si bazë një kriter të përcaktuar qartë për pranimin ose jo të kërkesës për rivendoje në afat.

- Po t'u referohemi disa rasteve praktike Gjykata i ka shqyrtuar kryesisht me iniciativen e vet duke u përfshirë dhe marrë rol kryesor aktiv në hetimin gjyqësor dhe kur ka konstatuar moskomunikimin e vendimit të pandehurit kërkuar, pa qenë nevoja për prova të tjera e ka rivendosur në afat.¹²²
- Ka disa raste që Gjykata e Tiranës ka krijuar një bindje të cilën e ka kthyer në vendim, jashtë kushteve dhe kriterëve të parashikuara nga neni 147 i K.Pr.Penale, duke e trajtuar fshehjen si një rast faktor dhe të justifikuar për rivendosje thjeshtë për ti dhënë mundësinë të pandehurit për të bërë ankim¹²³, ose për rivendosje në afat ka shërbyer vetë gjykimi pa prezencën e tij apo komunikimi i vendimit i ka mjaftuar për pranimin e kërkesës për rivendosje në afatin e ankimit.¹²⁴
- Por edhe kur kërkesa e bërë ka qenë në përputhje me ligjin procedural penal (neni 147 i K.Pr.P) dhe Gjykata e ka refuzuar me arsyetime jo ligjore të cilat bien ndesh me Kodin e Procedurës Penale por edhe me të drejtat Kushtetuese dhe të Drejtat e Njeriut, duke arsyetuar se nga gjykimi në të dyja shkallët e gjyqësorit, gjykimi në mungesë të të pandehurit është bërë pasi është vërtetuar mungesa e tij duke iu shmangur me dashje gjykimit. Të dyja Gjykatat konform dispozitave të parashikuara në kapitullin II mbi njoftimet i kanë mundësuar të pandehurit dhe

¹²² Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendimet nr.347, datë 21.02.2006, nr.639, datë 18.04.2006, nr.759, datë 25.04.2007 etj.

¹²³ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim nr.447, datë 06.03.2007, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim nr.1519, datë 15.10.2007, "Përsa më sipër Gjykata krijon bindjen se kërkesa e të pandehurit E.M. i gjykuar në mungesë, duhet të pranohet për t'u dhënë mundësia, për t'u ankuar ndaj vendimit nr. 179 datë 24.03.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për arsye se sipas Gjykatës ai nuk ka pasur mundësi objektive për ta ankuar një vendim të tillë mbasi ai i është fshehur si hetimit ashtu edhe gjykimit."

¹²⁴ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim nr. 80, datë 17.02.2005 dhe vendim nr.1129, datë 18.05.2006.

familjarëve të tij njoftimin e vendimit dhe nuk ka pranuar kërkesën për rivendosje në afat.¹²⁵

Nëse do të shohim argumentimin që bën Gjykata në vendimin nr.687/2005, lidhur me të drejtën e bërjes së kërkesës për rivendosje në afat kundër një vendimi të dhënë në mungesë të të pandehurit, e cila është një e drejtë ekskluzive e të pandehurit i cili ngarkohet edhe me kërkesat e ligjit për ta provuar se mungesa e tij në gjykim është e justifikuar dhe kjo e drejtë vjen në përputhje dhe në zbatim të nenit 147/2 të K.Pr.Penale. Nga kjo e drejtë përjashtohen mbrojtësi i caktuar kryesisht si dhe familjarët nga dijenia e vendimit, kështu është trajtuar si një e drejtë personale e të pandehurit.¹²⁶

Të drejtën e rivendosjes në afat e kushtëzojnë disa kërkesa ligjore referuar nenit 147 të K.Pr.Penale dhe atë Italian para ndryshimeve i cili tregon qartazi lidhur me këtë.

8.2.2.1 A duhet që afatet të jenë të kthyeshëm.

Kusht për pranimin e kërkesës së rivendosjes në afat pranohet vetëm nëse afati që kërkohet të rivendoset duhet të jetë i kthyeshëm. Vetëm afatet të cilat kanë përfunduar¹²⁷ së vepruari për shkak se i pandehuri që duhej të vepronte nuk i ka respektuar afatet, mbasi fillimisht ky afat ka filluar së vepruari quhen afate të kthyeshme. Afati i ankimit parashikuar nga neni 415/2 të Kodit të Procedurës Penale është dhjetë ditë; përlogaritja e këtij afati fillon një ditë pas njoftimit apo shpalljes së vendimit.

Për vendimin e dhënë në mungesë të të pandehurit bazuar në nenin 386/2 të Kodit të Procedurës Penale kopja së bashku me lajmërimin për depozitimin e vendimit duhet patjetër t'i komunikohet të pandehurit. Llogaritja e afatit të ankimit nis pasi të pandehurit i komunikohet vendimi¹²⁸ i dhënë në mungesë të tij.

Pasi ka përfunduar gjykimi në mungesë të të pandehurit, vendimi i dhënë nga Gjykata duhet t'i komunikohet të pandehurit, sipas procedurave ligjore të përcaktuara nga nenet 140, 141 të Kodit të Procedurës Penale. Një kopje e vendimit së bashku me fletëlajmërimin sipas dispozitave ligjore që parashikohen, u jepet fqinjëve apo familjarëve të tij ose shpallet pranë vendbanimit si dhe në vendin e punës së të pandehurit. Kur i pandehuri përfaqësohet nga një mbrojtës komunikimi i vendimit bëhet në adresë të mbrojtësit të tij.

¹²⁵ Gjykata e Apelit Tiranë, vendim nr.687, datë 22.02.2005.

¹²⁶ Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, Vendim nr.225, datë 19.04.2006

¹²⁷ Franco Cordero, "Procedura Penale", Terza Edizione, GIUFFRÈ 1995, fq.310.

¹²⁸ "Commento al nuovo Codice di Procedura Penale", coordinato da Mario Chivaria, UTET, 1992, fq. 161.

Zbatimi i procedurave të përcaktuara në ligj për komunikimin e të pandehurit në lidhje me procesin gjyqësor të filluar ndaj tij apo të vendimit të dhënë në mungesë të tij, merrret si i mirëqenë fakti se i pandehuri ka marrë dijeni për çështjen në ngarkim të tij apo për vendimin e Gjykatës lidhur me të. I pandehuri konsiderohet se është njoftuar sipas të gjitha rregullave ligjore të parashikuara, në lidhje me vendimin e dhënë në mungesë të tij duke i filluar paralelisht edhe llogaritja e afateve ligjore për ankimin që nga dita kur i pandehuri ka marrë njoftimin për këtë vendim. Ne rastin kur i pandehuri është gjykuar në mungesë, vendimi i dhënë ndaj tij në mungesë merrr formë të prerë automatikisht në rast se kalojnë afatet e parashikuara për ankimin e tij, me përjashtim të rasteve që ligji¹²⁹ i parashikon si raste të rivendosjes në afat të ankimit.

Si veprohet kur i pandehuri për shkaqe të pavarura nga ai është gjykuar në mungesë dhe ndërkohë nuk i është komunikuar sipas rregullave ligjore njoftimi për dhënin e vendimit të dënimit në mungesë apo nuk i është bërë fare komunikimi i vendimit të dënimit të dhënë në mungesë të tij?

Afati për të bërë ankim në këtë rast, nuk mund të fillojë¹³⁰ fare, rrjedhimisht vendimi i gjykimit të të pandehurit nuk mund të marrë formën e prerë e për pasojë ky vendim është e pamundur të ekzekutohet.

Lidhur nga sa u tha lind pyetja se cilat duhet të jenë masat që duhet të marrë i pandehuri kur ndaj këtij të fundit është marrë një vendim Gjykatë në mungesë të tij por që nuk mund të marrë formë të prerë për arsyet që cituam më sipër? Nisur nga fakti në lidhje me rastin e sipërcituar që afati i të pandehurit për të bërë ankim fillon nga momenti që ky i fundit ka marrë dijeni lidhur me vendimin e dhënë në mungesë të tij, i pandehuri do të ankimojë vendimin direkt pa kërkuar rivendosje të afateve për ankim apo do të kërkojë si fillim rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit e më pas të ankimojë vendimin?

Në qoftë se i drejtohem parashikimeve të nenit 670 të K.Pr.P.Italiane i cili është përdorur si shembull për Kodin e Procedurës Penale të vendit tonë do të vërejmë se në rastet e shqyrtimit të kërkesave për ekzekutimin e vendimeve penale shihet se vendimi nuk është ekzekutuar pasi nuk i është komunikuar të pandehurit apo vendimi mungon, atëherë Gjykatësi vendos me vendim pezullimin e ekzekutimit të vendimit të sipërcituar bërjen e njoftimit sipas të gjitha procedurave e mjeteve ligjore të parashikuara në ligj. Që nga momenti i komunikimit të njoftimit do të fillojë afati dhjetë ditë i bërjes së ankimit.

¹²⁹ Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Vendim Unifikues nr. 354, datë 28.07.1999

¹³⁰ "Codice di Procedura Penale", commentato da Franco Cordero, Seconda Edizione, 1992, fq.202.

Kështu që dalim në përfundimin se të pandehurit të cilit nuk i është komunikuar vendimi i marrë ndaj tij nuk e ka detyrimin ligjor për të kërkuar rivendosjen në afat të së drejtës për ankim, por ai automatikisht ka të drejtën që në momentin që vihet në dijeni në lidhje me vendimin të bëjë ankim.

E drejta e rivendosjes në afat të së drejtës së ankimit nuk mund të kuptohet drejtpërdrejt në nenin 147/2 të Kodit të Procedurës Penale, por mund të nënkuptohet se ajo mund të bëhet vetëm në ato raste kur janë ndjekur të gjitha procedurat ligjore të parashikuara në nenin 386/2 të K.Pr.Penale, por të pandehurit, për shkaqe të pavarura prej tij nuk i është komunikuar vendimi i marrë në mungesë.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e ka trajtuar si një shkelje e të drejtave të të pandehurit kur penalizohet në realizimin e së drejtës së rivendosjes në afat të vendimit të dënimit të dhënë nga Gjykata në mungesë¹³¹, për moszbatim të rregullave procedurale apo gabimeve të bëra nga institucionet që kanë detyrë ligjore, sipas dispozitave të parashikuara nga neni 386/2 të K.Pr.Penale. Pra, në rastin kur nuk është bërë njoftimi sipas kësaj procedure arsyetimi logjik të çon se i pandehuri mund të bëjë ankim pa pasur nevojë për t'u rivendosur në afat, pasi vendimi duhet të konsiderohet si i paekzekutueshëm.

8.2.2.2 Legjitimitimi i personave për të paraqitur kërkesën për rivendosje në afat.

Para vitit 2002 Gjykatat mbanin qëndrime nga më të ndryshmet lidhur me rrethin e subjekteve të cilat kishin të drejtë për t'iu drejtuar Gjykatës me kërkesë, në zbatim të nenit 147/2 të K.Pr.Penale, për të rivendosur të drejtën e ankimit të vendimit të dhënë mungesë, qëndrime të cilat vunë në lëvizje Gjykatën e Lartë për të unifikuar qëndrimin që të bënte njësimin e praktikës nga të gjitha Gjykatat më të ulta me një vendim unifikues¹³², në kohën që Gjykata e Lartë dhe ajo Kushtetuese ndanin mendime të ndryshme për nenin 410/2 të K.Pr.Penale. Gjykata e Lartë e konsideronte si të drejtë eksplicite të të pandehurit të drejtën e ankimit dhe të drejtën e kërkesës për rivendosje në afat duke mbajtur një qëndrim të njëjtë për të dyja rastet. Qëndrim krejt të kundërt ka mbajtur Gjykata Kushtetuese mbi të drejtën e ankimit, por ka lënë të kuptohet se nuk është kundër qëndrimit të Gjykatës së Lartë mbi rrethin e subjekteve që kanë të drejtë të ushtrojnë të drejtën e bërjes së kërkesës para Gjykatës për rivendosje në afat konform nenit 147/2 të K.Pr.Penale.

¹³¹ GjEDNJ në çështjen *Goddi kundër Italisë* thekson se gjykimi në mungesë në asnjë rast nuk duhet të ketë karakter ndëshkues për të pandehurin.

¹³² Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Vendim nr.2, datë 14.10.2002

Sipas parashikimit që i bëhet nenit 147/2 të K.Pr.Penale, i jep të drejtën të pandehurit të bëjë kërkesë kur vendimi është dhënë në mungesë të tij, por mbas kësaj të drejte është një sanksion që parashikon kjo dispozitë që e vë në vështirësi të pandehurin . Kjo do të thotë se në shumë raste ngelet subjektive dhe ndoshta e pamundur për të vërtetuar çka kërkon paragrafi i dytë i nenit 147 të K.Pr.Penale. Por edhe çka kërkon paragrafi i tretë i kësaj dispozite duke gjykuar vendin e burgimit që mund të jetë në një shtet tjetër që është në pamundësi për t'u realizuar.

Pra, referuar paragrafëve të mësipërm rezulton se mbi subjektin rëndon barra e provës në dy drejtime:

- I pandehuri duhet të provojë mosdijeninë e vendimit.
- I pandehuri duhet të provojë se kur ka marrë efektivisht dijeni për vendimin.

Momenti marrjes dijeni ashtu sic thamë më lart ngelet të vërtetohet nga i pandehuri pasi vetëm atij mund t'i komunikohet, si një vendim i dhënë kundër tij dhe në mungesë të tij për t'u konsideruar i ekzekutueshëm dhe mbas vërtetimit nga ky i fundit për dijeninë mund të ankimohet në Gjykatën më të Lartë, në një kohë kur nga neni i mësipërm përdoret shprehja " kur provon ", duke iu referuar personalisht të pandehurit. Nga kjo rrjedh se vetë të pandehurit ligji përveç së drejtës të cilën mund t'ia delegojë avokatit, i ka vënë dhe detyrimin e të provuarit, e thënë ndryshe "*barra e provës*."

Në vendimin unifikues nr. 2, datë 14.10.2002, Gjykata e Lartë arsyeton: Rasti i këtij gjykimi është zbatuar e drejta e të pandehurit për t'iu drejtuar Gjykatës me kërkesë për rivendosje ashtu sikurse është i vetmi që mund të provonte mosmarrjen e dijenisë për vendimin e dhënë, ose ta delegonte të drejtën nëpërmjet një prokure të posaçme, akt të shkruar nga noteri për të qënë në koherencë dhe në përputhje me nenin 147/2 të K.Pr.Penale. Por meqënëse ligji procedural e kërkon nga i pandehuri të provuarin e mosdijenisë së vendimit atëherë askush tjetër nuk mund ta zëvendësojë më këtë akt të të provuarit, dhe nëse do të pranohet të kundërtën përveç kontradiktës me dispozitën do të dëmtonte interesat e vetë të pandehurit duke pranuar faktin se ishte në dijeni të një vendimi për të cilin vetë i pandehuri nuk dinte gjë. Nëse do të njihej e drejta e parashikuar nga dispozita ku i pandehuri mund t'ia delegojë avokatit apo familjarëve të drejtën për të bërë kërkesë për rivendosje të pandehurit do t'i humbiste e drejta e tij ekskluzive për ta bërë këtë kërkesë, pasi ia ndalonte paragrafi i tretë i nenit 147 të K.Pr.Penale një gjë të tillë, ku sipas kësaj dispozite " rivendosja në afat lejohet për çdo shkallë procedimi vetëm një herë, çka ia bën të pamundur të pandehurit kur ia ka deleguar atë avokatit apo familjarëve të tij".

Në dispozitën e rivendosjes në afat, të pandehurit të gjykuar në mungesë i është dhënë një mundësi e dytë pasi të marrë dijeni për vendimin e dhënë në ngarkim të tij të mund të paraqesë kërkesën për t'u rivendosur në afatin e ankimit të këtij vendimi ku nëpërmjet gjykimit të ballafaqohet me akuzën dhe të ngrejë pretendimet dhe kundërshtimet për aq sa i lejon ligji. Nëse kërkesa për rivendosje në afat do të bëhej në kundërshtim me nenin 147/2 të K.Pr.Penale, nga një subjekt i palegjitimuar siç është (mbrojtësi i caktuar nga familjarët) do të rrëzohej nga Gjykata, por duke i ruajtur të drejtën të pandehurit që vetë ose nëpërmjet një mbrojtësi të autorizuar me akt të shkruar nga një noter publik në një moment të dytë për të.¹³³

Është konsoliduar praktika gjyqësore nga një sërë vendimesh të Gjykatës së Lartë e cila ka konkluduar dhe arritur në një mendim unik i cili shërben për të gjitha shkallët e Gjyqësorit si një praktikë e pakontestueshme, duke e trajtuar unike dhe ngushtësisht personale të drejtën e të pandehurit e kërkesës për rivendosjen në afatin e ankimit të vendimit të dhënë në mungesë të tij duke kujtuar detyrimin ligjor të parashikuar nga nenet 438/4 dhe 440 të Kodit të Procedurës Penale. Gjykata e Lartë ka trajtuar përveç së drejtës që ka i pandehuri për të bërë kërkesën dhe të drejtën për t'ia deleguar atë vullnetarisht një avokati me akt noterial duke caktuar tagrat në përfaqësim.¹³⁴

Nëse do ta merrnim të mirëqenë të kundërtën e asaj çka sqaruam më lart, të konsiderohet hipotetakisht se mbrojtësi kryesisht apo ai i caktuar nga familjarët do të kishte të drejtë të bënte kërkesë për rivendosje në afat të ankimit etj...dhe për rrjedhojë të bëjë ankim kundër vendimit për të mbrojtur interesat e të pandehurit, prapë ekziston një ngërç i cili kërkon zgjidhje. Ky subjekt që pretendon të mbrojë interesat e të pandehurit proceduralisht a e ka statusin e mbrojtësit kryesisht në hetim dhe gjykim apo nga familjarët¹³⁵? Kodi i Procedurës Penale nuk njih asnjë prej rasteve të përmendura kështu që kjo hipotezë nuk mund të qëndrojë derisa është në kundërshtim me dispozitat procedurale të parashikuara në K.Pr.Penale.

Procedura njeh rastin e mbrojtësit të caktuar kryesisht nga organi procedues, Gjykata në fazën e hetimeve apo nga Gjykata gjatë procesit të gjykimit, por nuk mund të pranojë një procedurë ekstra e cila nuk njihet dhe nuk parashikohet nga dispozitat e K.Pr.Penale e cila do të njihte të drejta të panjohura dhe do të mohonte të drejta të njohura nga ligji procedural penal.

¹³³ Kolegji Penal I Gjykatës së Lartë, Vendim nr.424, datë 25.04.2007

¹³⁴ Kolegji Penal I Gjykatës së Lartë, Vendim nr.152, datë 29.03.2006

¹³⁵ Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Vendim nr.2, datë 14.10.2002

Mbrojtësi i të pandehurit nuk mund të bëjë ankim kundër vendimit të dhënë në mungesë të të pandehurit në qoftë se ai nuk disponon konform nenit 410/2 të Kodit të Procedurës Penale aktin noterial nëpërmjet të cilit ka fituar këtë të drejtë, në të njëjtat kushte është mbrojtësi edhe kur bën kërkesë për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit. Referuar nenit 147/1 të Kodit të Procedurës Penale, mbrojtësi mund të bëjë kërkesë për rivendosjen në afat për shkak të rastit faktor ose forcës madhore e cila nuk mund të kërkohej në bazë të nenit 147/2 të Kodit të Procedurës Penale, kur afatin ai e ka humbur për mosmarrjen dijeni të vendimit të dhënë në mungesë për të pandehurin që ai përfaqëson. Për sa i përket të drejtës së familjarëve për të zgjedhur një mbrojtës për të pandehurin konform nenit 48/3 të K.Pr.Penale ajo është e kufizuar vetëm për rastet kur i pandehuri ndodhet në kushtet e masës së sigurimit “arrest me burg”, si pasojë e arrestimit apo ndalimit të tij. Për të gjitha rastet e përmendura më sipër të pandehurit i lejohet të gjykohej në mungesë në rastet e parashikuara nga nenet 351/1, 352/1 të K.Pr.Penale, kur mosparaqitja e tij në gjykim është e vullnetshme dhe nuk ka shkak ligjor për të mos u gjykuar në mungesë. Referuar së drejtës së familjarëve për zgjedhjen e mbrojtësit konform nenit 48/3, nuk ka të bëjë me rastin e parashikuar në dispozitën ligjore të nenit 147/2, ku i pandehuri nuk duhet të ketë dijeni për vendimin e dënimit.

8.2.2.3 I pandehuri nuk duhet të ketë dijeni për vendimin e dënimit.

Barra e provës bie mbi të pandehurin kur ai është gjykuar në mungesë dhe kërkon të rivendoset në afat. Ligjvënësi ka parashikuar që i pandehuri ka detyrimin ligjor të provojë se mungesa e tij në procesin gjyqësor nuk ka qenë për faj të tij por ai nuk është vënë në dijeni në lidhje me gjykimin dhe vendimin e dënimit të dhënë në ngarkim të tij. Por kjo barrë rëndon pozitën e të pandehurit duke krijuar vështirësi ligjore. GJEDNJ e ka quajtur si “pengesë ligjore” duke i mohuar të pandehurit një proces të rregullt ligjor konform nenit 6 të Konventës¹³⁶ Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Konstatimet e shkeljeve të bëra prej Gjykatave lidhur me parimet e gjyimit në mungesë të të pandehurit të bëra nga GjEDNJ lidhur me raste konkrete si “Sejdovic kundër Italisë” ka penalizuar shtetin italian për mungesë të strukturës në sistemin procedural penal të njoftimeve, pasi ka gjetur një sërë shkeljesh të të drejtave të parashikuara në nenin 6 të KEDNJ-së duke e trajtuar rastin konkret në pamundësi të të dënuarit për rifillimin e gjyimit të procedimit

¹³⁶ Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, *Sejdovic v Italisë* Vendim nr. 56581/00, datë 10.11.2004

penal¹³⁷ konform së drejtës procedurale penale për t'u dëgjuar para se të merrret një vendim.

Nga analiza e bërë nenit 147/2 të K.Pr.Penale dalin dy pyetje në lidhje me marrjen dijeni: e para, a ka marrë dijeni për procedimin e nisur ndaj tij i pandehuri nga organi i akuzës? E dyta, a ka marrë dijeni i pandehuri për vendimin e dhënë ndaj tij ?

Kur i pandehuri vërteton se ka patur dijeni për procedimin e nisur në ngarkim të tij gjatë hetimit paraprak por nuk ka patur dijeni për vendimin e dhënë në mungesë të tij kjo për shkak të mosnjohimit nga ana e administratës së Gjykatës, dhe në këtë rast i pandehuri mund t'i drejtohet Gjykatës në lidhje me të drejtën e ankimit me kërkesë për rivendosje në afat të ankimit. Në rastin konkret, kur i pandehuri ka dijeni për procedimin por nuk ka dijeni për vendimin e dhënë ndaj tij në mungesë, ai mjafton të vërtetojë se nuk është njoftuar për vendimin e marrë ndaj tij, atëherë automatikisht Gjykata duhet të vendosë rivendosjen në afat të ankimit të të pandehurit pa marrë në konsideratë dhe pa e penalizuar atë për dijeninë mbi procedimin.

Ky konkluzion i cituar më sipër del konform nenit 147/2 të K.Pr.Penale i cili në brendësinë e tij nuk përfshin akte që vërtetojnë efikasitetin e dijenisë për procedimin e nisur ndaj të pandehurit. Sipas nenit 147/3 të K.Pr.Penale thuhet shprehimisht se e drejta për të bërë kërkesë për rivendosjen në afat është brenda dhjetë ditëve nga marrja dijeni për vendimin e dhënë në mungesë, çka do të thotë se dispozitat e mësipërme kur parashikojnë të drejtën e ankimit nuk kanë parasysh procedimin por vendimin nga ku fillon edhe afati i ankimit pas marrjes dijeni.

Pas ndryshimeve që iu bënë në vitin 2005 Kodi Italian i njeh të drejtën të pandehurit që në rast se vërteton se nuk ka marrë dijeni në lidhje me procedimin e nisur ndaj tij atëherë presumohet fakti se ai nuk ka marrë dijeni as për vendimin e dhënë në mungesë. Në këtë interpretim e drejta ka patur parasysh t'i garantojë të pandehurit një mundësi të dytë për të paraqitur kërkesë për rivendosjen në afat të ankimit me qëllim për t'u rigjykuar. Nëse do të kuptohej ndryshe ajo do të sillte rëndim të pozitës së të pandehurit në kuptimin e marrjes dijeni të procedimit dhe prezumimit të dijenisë së vendimit.

8.2.2.4 Mosmarrja e dijenisë për vendimin të mos ketë ardhur për faj të të pandehurit.

¹³⁷ Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, Dhoma e Madhe, vendim nr.56581/00 datë 01.03.2006 "Kemi të bëjmë me shkelje të nenit 6 (procesit të rregullt ligjor) të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut kur jepet një vendim dënimi në mungesë të të pandehurit, i cili nuk është njoftuar në mënyrë efektive për procedimin penal në ngarkim të tij dhe që nuk ka hequr dorë në mënyrë të shprehur nga e drejta e tij për të marrë pjesë në diskutim, për më tepër kur pas një dënimi të tillë nuk është parashikuar nga Kodi i Procedurës Penale një mekanizëm efektiv që synon ti sigurojë të dënuarit në mungesë një gjykim që të shprehet ex novo mbi bazueshmërinë e akuzave, pasi ta ketë dëgjuar në bazë të kërkesave të nenit 6 të KEDNJ."

Në nenin 147 të K.Pr.Penale nuk përmendet si kusht për t'u rivendosur në afat që mosmarrja e dijenisë të mos ketë ardhur për faj të të pandehurit. A do të jetë ky, sipas këtij neni, një nga rastet që penalizojnë të pandehurin për të paraqitur kërkesë? Kur kemi të bëjmë me faktin që i pandehuri me vullnetin e tij ka kryer veprime që tregojnë se është në dijeni të gjykimit, duke caktuar avokat në proces si dhe kur ai pretendon se nuk ka marrë dijeni për vendimin e dhënë ndaj tij por ka paraqitur rekurs¹³⁸, përbën shkak për të mos u rivendosur në afat.

Në praktikat gjyqësore është aplikuar kushti i sipërcituar sipas të cilit kërkohet që i dënuari të provojë se nuk i është shmangur gjykimit me dëshirën e tij dhe po ashtu dijenisë për vendimin e dhënë¹³⁹. Kur provohet se i pandehuri me vullnetin e tij të lirë iu është shmangur njoftimeve të bëra nga organi procedues nuk mund të rivendoset në afat. Një rast konkret lidhur me humbjen e së drejtës për të bërë ankim është edhe çështja "Medenica kundër Zvicrës" e gjykuar nga GjEDNj.

8.2.2.5 Mosezaurimi nga mbrojtësi i së drejtës së ankimit nga i pandehuri.

Për t'u rivendosur në afat kërkesa e të pandehurit duhet të mos jetë bërë më parë nga avokati i caktuar kryesisht apo i zgjedhur nga familjarët, e drejtë kjo që iu njoh mbrojtjes nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.15, datë 17.04.2003.

Në qoftë se mbrojtësit i njëhej e drejta e ankimit, atëherë, arsyetonte Gjykata e Lartë, me pa të drejtë i mohojë e drejta e ankimit të pandehurit. Sipas arsytimit të Gjykatës së Lartë e drejta e ankimit edhe pse ishte bërë nga subjekte të palegjitimuar, por me një të drejtë shumë personale, ekskluzive të tij, humbiste. Kjo ka ardhur si rezultat i problematikave që ka patur legjislacioni ynë i cili i është referuar Kodit Italian lidhur me të drejtën e mbrojtësit të paautorizuar me akt noterial për të bërë ankim, duke influencuar në legjislacionin e vendit tonë. Referuar nenit 571/3 të K.Pr.P. Italiane ekuivalent me nenin 410 të K.Pr.Penale të vendit tonë, pajisja me prokurë e mbrojtësit për të bërë ankim në mbrojtje të interesave të të pandehurit ishte obligim e tij. Këtë garanci e parashikonte neni 175 i K.Pr.P.Italiane duke i ardhur në ndihmë të pandehurit me marrjen dijeni të dënimit të rivendosjes në afat dhe të bënte ankim dhe se pa pëlqimin e tij askush nuk mund të operonte qoftë edhe për interes të tij, pasi ankim¹⁴⁰ për llogari të të pandehurit nuk mund të bënte çdokush nëse nuk do të autorizohet prej këtij të fundit me prokurë të posaçme.

¹³⁸ Gjykata e Apelit Tiranë, vendim nr.969, datë 24.12.2007

¹³⁹ Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, Vendim nr. 491, datë 21.03.2008

¹⁴⁰ "Digesto delle discipline penalistiche", volume VI GIURI-INFRE, "Contumacia nel diritto processuale penale", Aniello Nappi, UTET 1995, fq. 533.

Në Itali, të dyja Gjykatat, ajo e Kasacionit si dhe ajo Kushtetuese në ndryshim nga ato tonat dolën në të njëjtin konkluzion duke legjitimuar mbrojtësin e caktuar kryesisht apo të zgjedhur nga familjarët të bënte ankim ndaj vendimit të dhënë në mungesë qoftë ky mbrojtës i paautorizuar nga vetë i pandehuri me arsyetimin se nuk do të garantohej i pandehuri, se do të rivendosej në afat pas marrjes dijeni me shuarjen e afateve dhe do të kishte pasoja të pariparueshme për të. Ky qëndrim i Gjykatave superiore bëri që të ndryshonte legjislativi duke shfuqizuar paragrafin e dytë të nenit 571/3 të K.Pr.P.Italiane e për pasojë u ndryshua neni 175 ku do të pranohej kërkesa në qoftë se mbrojtësi nuk kishte bërë më parë ankim.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut duke parë se dispozita e parashikuar nga neni 175 i K.Pr.P. Italiane të drejtën ekskluzive të të pandehurit, zëvendësuar me të drejtën e ankimit të bërë nga mbrojtja pa patur një akt përfaqësimi nga ky i fundit e ka trajtuar si pexhorativ(përkeqësuese) për interesat e të pandehurit, në kundërshtim me parimet e një procesi të rregullt ligjor, duke mos e pranuar kërkesën, si të ezauruar nga mbrojtja edhe pse mosmarrja e njoftimit për vendimin e dhënë në mungesë nuk ishte për faj të të pandehurit, për këtë fakt kjo Gjykatë e ka penalizuar shtetin Italian.

Në institutin e rivendosjes në afat u bënë ndryshime të rëndësishme nga legjislatori Italian në vitin 2005 i detyruar nga penalizimi që iu bë nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, u ndryshua neni 175 duke u shfuqizuar kushti i vendosur që përjashtonte të pandehurin kur ankimi ishte bërë nga mbrojtësi duke i dhënë mundësinë të pandehurit të bënte kërkesën për rivendosjen në afat duke mos marrë në konsideratë ankimin e bërë nga avokati i paautorizuar prej tij.

Lidhur me ndryshimet në nenin 175/2, të pandehurit të gjykuar në mungesë i njihet e drejta e mohuar më parë, për t'u rivendosur në afat të ankimit edhe pse kjo e drejtë është ushtruar ose jo një herë nga mbrojtësi duke i dhënë atij mundësinë e përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor në dy Gjykatat superiore.

A është i duhur ndryshimi i bërë në nenin 175/2 të Kodit të Procedurës Italiane si kërkesë e ardhur nga sanksioni i GjEDNJ-së për këtë shtet dhe a zgjidh ky ndryshim problemin në thelb apo ai ndihmon në hapjen e problemeve të tjera? Si dhe, në favor të kujt është zgjidhja e problemit, në kushtet e dhënies së dy vendimeve ndoshta të ndryshëm nga njëri-tjetri? Por, problemi i të qenit të këtij vendimi në disfavor të ekonomisë gjyqësore¹⁴¹?

¹⁴¹Avv. Davide Richetta, "In generale sulla contumacia, incontro di studio sulla legge 06/05 di conversione del D.L. 17/05 in materia di impugnazione delle sentence contumaciali e dei decreti di condanna", Torino 27.04.2005, www.camerrapenalevittorichiusano.it/index.

Mendoj se ndryshimi i bërë në nenin 175/2 është në favor të të pandehurit për arsye se në një gjykim të ri i pandehuri nuk është më në pozitat e mëparshme në të cilin kishte humbur të gjitha të drejtat për të paraqitur prova dhe argumente, me qëllimin e kundërshtimit të akuzave të ngritura ndaj tij, por në një pozitë krejt ndryshe ku mund të ballafaqohet me akuzën dhe ka të drejtën të paraqesë prova të të gjitha formave që parashikon ligji. I ndodhur në këto kushte probabiliteti për të marrë një vendim në favor të tij ndryshe nga i pari i dhënë në mungesë është më i madh. E vetmja e metë që mendoj se ka sjellë ky ndryshim është ekonomia gjyqësore, duke çuar në një investim të dyfishtë të Gjykatës.

Referuar paragrafit 2 të nenit 147 të K.Pr.Penale të vendit tonë, e drejta e ankimit nga i pandehuri ose mbrojtësi i posaçëm trajtohen njësoj, mjafton që ankimi të mos jetë bërë më shumë se një herë nga çdonjëri prej subjekteve të përmendura më lart. Për të mos cënuar sigurinë juridike duhet që domosdoshmërisht të plotësohet ky kusht që të rivendoset në afat e drejta e ankimit të dënuarit.

Po t'i referohemi rasteve praktike të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në të shumtën e rasteve ato bien ndesh me procedurën e ndjekur në vendin tonë lidhur me rivendosjen në afat të vendimeve të dhëna në mungesë. Dhe në qoftë se do të kishim një rast ankimi drejtuar kësaj Gjykate nga ndonjë subjekt penal do të penalizoheshim prej saj. Për të mos lejuar që të ndodhë ndonjë penalizim i mundshëm duhet të bëhen ndryshime në legjislacion duke e përqasur atë me të drejtën ndërkombëtare që në rastin e një gjykimi është çështje primare. Një sërë shtetesh të Evropës si pasojë e penaliteteve të marra nga GJEDNJ e kanë përshtatur procedurën e gjykitimit në mungesë duke aplikuar pezullimin e procedimit dhe shmangur gjykimin në mungesë duke kërkuar prezencën e të pandehurit në gjykim sipas parimit që i pandehuri duhet të dëgjohet përpara se të gjykohet.

8.2.2.5.1 A do t'i njihet e drejta të pandehurit të kërkojë rivendosje në afat, kur kanë bërë ankim të bashkëpandehurit e tjerë.

Referuar dispozitës 425/1 të K.Pr.Penale lidhur me hapësirën dhe kufijtë e shqyrtimit të gjykitimit në Gjykatën e Apelit për sa u përket të bashkëpandehurve që kanë bërë ose jo ankim është një praktikë e paunifikuar nga Gjykata e Lartë dhe ka sjellë si pasojë që të ketë vendime të ndryshme, çka e bën të paqartë rishqyrtimin në këtë Gjykatë¹⁴² të së njëjtës çështje, përjashtuar rastet e parashikuara nga neni 34¹⁴³ i Kushtetutës.

¹⁴² Gjykata e Apelit Tiranë, vendim nr.891, datë 20.12.2005.

Referuar procedurës penale kreu VIII (Ankimet) nënkupton se nëse dikush nga të bashkëpandehurit ka bërë ankim dhe arsyet e ngritura nuk janë ngushtësisht personale, Gjykata e Apelit në zbatim të kësaj dispozite është e detyruar të shqyrtojë apelin e njërit në funksion të gjithë të bashkëpandehurve që nuk kanë bërë apel por prezumohet se kanë bërë.¹⁴⁴

Por referuar përmbajtjes së ligjit, në çdo rast të paraqitjes së ankimit nga një ose më shumë të pandehur, por jo të gjithë, Kolegji Penal ka dalë në konkluzion se Gjykatat e Apelit gjatë marrjes në shqyrtim të ankimeve të bëra nga të bashkëpandehurit duhet të analizojnë dhe vlerësojnë arsyet e ankimit dhe nëse këto arsye janë personale ose jo nuk mund të shqyrtojë pjesën e vendimit që ka të bëjë me të pandehurit që nuk kanë bërë ankim. Në të kundërt, nëse shkaqet e ankimit janë për të gjithë të pandehurit edhe pse nuk është bërë ankim nga disa të bashkëpandehur çështja duhet trajtuar si një e pandarë dhe konsekuencat janë njësoj për të gjithë të bashkëpandehurit.¹⁴⁵

Kjo do të shërbejë si praktikë për Gjykatat në lidhje me kërkesën e bërë nga i pandehuri për rivendosjen në afat të ankimit kur janë disa të bashkëpandehur, por dikush prej tyre është gjykuar në mungesë dhe kërkon të rivendoset në afat. Është shumë e rëndësishme të shikohen shkaqet që janë shqyrtuar më parë në Gjykatën e Apelit dhe nëse nëpërmjet këtyre shkaqeve del se edhe pse nuk është bërë ankim nga personi që ka kërkuar rivendosjen në afat, ankimi i bërë nga të pandehurit e tjerë ka patur motive të përbashkëta, nuk mund të pranohet kërkesa, dhe e kundërta duhet të ndodhë, të pranohet kërkesa kur kemi të bëjmë me një ankim me arsye dhe shkaqe individuale.

Shumë raste praktike në Gjykata të ndryshme kanë mjaftuar vetëm me kërkesën për të rivendosur në afat të dënuar pa bërë një analizë të gjykimeve të bëra nga të bashkëpandehurit¹⁴⁶.

Por një tjetër qëndrim është mbajtur nga Gjykata e Shkallës së Parë në gjykimin e kërkesës për rivendosjen në afat duke prezumuar qëndrimin e Gjykatës së Apelit në shqyrtimin e ankimit të bërë nga të bashkëpandehurit me të pandehurin që ka kërkuar rivendosjen në afat duke prezumuar verifikimin e njoftimit që i është bërë këtij të fundit i cili është gjykuar në mungesë në Shkallën e Parë. Ky detyrim parashikohet në dispozitat e neneve 426/1 dhe 414 i K.Pr.Penale për Gjykatën e Apelit dhe nuk mund të prezumohet

¹⁴³ Neni 34 i Kushtetutës parashikon " Askush nuk mund të dënohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale dhe as të gjykohet sërish, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjyqimi i çështjes nga një gjykatë më e lartë, sipas mënyrës së parashikuar me ligj."

¹⁴⁴ Neni 416/1 i K.Pr.Penale.

¹⁴⁵ Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, Vendim nr.650, datë 06.11.2002

¹⁴⁶ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim nr.311, datë 22.10.200,.

nga një Gjykatë më e ulët siç është ajo e Shkallës së Parë, e cila nuk ka kompetencë të verifikojë njoftimet e bëra nga Gjykata e Apelit nëse janë ose jo të vlefshme pasi dispozitat e cituara më sipër nuk e bëjnë këtë objekt verifikimi të kësaj Gjykate¹⁴⁷.

Kur çështja është gjykuar nga Gjykatat superiore siç është ajo e Apelit dhe Gjykata e Lartë, duhet marrë i mirëqenë njoftimi i të pandehurit në mungesë, fakt ky i cili nuk mund të analizohet nga Gjykata më e ulët pasi do të quhej kontroll jashtë kompetencave të saj.

Shkaku i kërkesës për rivendosjen në afat të ankimit kundër një vendimi të dhënë në mungesë është padijenja në njoftimin e vendimit të pandehurit në lidhje me gjykimin e bërë dhe jo mbi bazën e njoftimeve të bëra për gjykimin. Gjykata e Shkallës së Parë në rast shqyrtimi të kërkesës duhet të shqyrtojë vetëm mbi karakterin e shkaqeve të ankimit si shkaqe ngushtësisht personale apo që prekin edhe të bashkëpandehurit e tjerë të gjykuar dhe jo të merret me analizën, nëse njoftimet janë bërë ose jo në rregull gjatë gjykimit, fakt ky që ka të bëjë me akte themelore të gjykimit, detyrë e cila i përket Gjykatës që e ka gjykuar.

Edhe pse Kolegji Penal ka dhënë këtë zgjidhje duhet të plotësohet legjislacioni procedural penal duke përfshirë të gjitha aspektet dhe problematikat rast pas rasti në një dispozitë ligjore të tij, pasi shqyrtimi i kufijve të bashkëpandehurve duke përfshirë edhe të pandehurin e gjykuar në mungesë e penalizon në një farë mënyre pozitën e këtij të fundit. Konkretisht, për t'u rivendosur në afat dhe rigjykuar me arsyetimin se nuk kanë qenë shkaqe individuale ato të shqyrtimit në Gjykatën e Apelit të cilës mund t'i jepet kompetencë të gjykojë vetëm ankimuesin e vendimit dhe jo të bashkëpandehurit.

8.2.2.6 Rivendosja në afat lejohet vetëm një herë për çdo palë dhe shkallë procedimi.

Ashtu sikurse parashikohet në nenin 147/3 të K.Pr.Penale, sipas të cilit i pandehuri është gjykuar në mungesë dhe ka humbur afatin e ankimit kundër vendimit mund të bëjë kërkesë për rivendosjen në afat e cila lejohet vetëm një herë për çdo palë dhe për çdo shkallë procedimi, në të kundërt të pandehurit, kërkesa për rivendosje në afat e bërë për herë të dytë nuk do t'i pranohej¹⁴⁸.

Vendimi i dhënë në mungesë i cili është rivendosur në afatin e ankimit nuk mund të rivendoset për herë të dytë çka do të thotë se i pandehuri e ka humbur këtë të drejtë me vullnet të plotë, kjo edhe për faktin se dispozitat procedurale në mënyrë eksplicite kanë

¹⁴⁷ Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, Vendim nr. 20, datë 18.01.2006.

¹⁴⁸ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim nr. 349, datë 15.02.2007

përcaktuar kohën për të bërë ankim,(brenda dhjetë ditëve nga rivendosja në afat). Në rast se e drejta për t'u rivendosur në afat të ankimit sa herë që të kërkohej pa e shfrytëzuar ankimin atëherë do të cënohej siguria juridike dhe e drejta për të kërkuar rivendosjen në afat do të ishte qesharake.

8.2.3 Afati i parashikuar nga ligji për paraqitjen e kërkesës së rivendosjes në afat.

Afati i caktuar në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, konkretisht neni 147/3 K.Pr.Penale parashikon një afat dhjetë ditor duke llogaritur kohën që nga momenti i marrjes dijeni nga i pandehuri për vendimin e dhënë në mungesë në ngarkim të tij, për të bërë kërkesën e rivendosjes në afatin e ankimit. Ky afat prekluziv i caktuar nga ligjvënësi, është një afat i shkurtër po të mendosh se vendimi për të cilin do të bëhet ankim është dhënë në mungesë të të pandehurit, çka do të thotë se i pandehuri nuk ka informacion në lidhje me atë çka është thënë në këtë vendim dhe i duhet që brenda këtij afati të gjejë një mbrojtës të cilin nuk e ka, të tërheqë dosjen e përfunduar e depozituar pranë arkivit të Gjykatës si dhe të përgatitet për një mbrojtje efektive për t'u ballafaquar me akuzën.

Referuar Kodit të Procedurës Penale Italiane lidhur me rivendosjen në afat ashtu sikurse u citua dhe më sipër janë bërë një sërë ndryshimesh, një nga këto ndryshime është edhe afati i ankimit në të cilin parashikohej rivendosja në afat nga dhjetë ditë në tridhjetë ditë. Afat i mjaftueshëm ky, gjatë të cilit i pandehuri mund të rikuperojë penalizimet që i sillte afati dhjetë ditor.

8.2.3.1 A është i mjaftueshëm afati dhjetë ditor për personin që pritet të ekstradohet?

Afati dhjetë ditor ashtu sikurse u argumentua dhe më sipër nuk është i mjaftueshëm veçanërisht në qoftë se do të flitej për një të pandehur të dënuar në Shqipëri në mungesë të tij, për një vepër penale të kryer më parë dhe arrestimi për ekzekutimin e këtij vendimi është bërë në një shtet tjetër ku ai ndodhej për momentin dhe ndërkohë pret ekstradimin që brenda këtij afati dhjetë ditor do ta bënte të pamundur realizimin e së drejtës për të bërë kërkesë për rivendosjen në afatin e ankimit të vendimit, vetë i pandehuri apo nëpërmjet një përfaqësuesi të posaçëm.

Si një afat i pamjaftueshëm për një vendim të dhënë në mungesë të të pandehurit, i pamundur për një të pandehur që ekstradohet nga një shtet tjetër si dhe në kundërshtim me kërkesat e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut është cilësuar edhe nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, afati dhjetë ditor .

Sikurse cituam edhe në Kodin e Procedurës Italiane të pandryshuar afati dhjetë ditor ishte si për të pandehurin e lirë edhe për atë në burg brenda dhe jashtë vendit. Po ashtu afati dhjetë ditor ishte edhe për të pandehurin e arrestuar jashtë shtetit italian ashtu sikurse është i parashikuar sot në Kodin e Procedurës Penale të vendit tonë. Afati i ndryshuar në tridhjetë ditë përveç afatit të trefishuar bën edhe dallimin midis të dënuarit i cili ndodhet në burgjet e shtetit italian dhe atij të ndodhur në shtet tjetër dhe pret ekstradimin, nuk fillojnë në të njëjtën kohë. Konkretisht për të burgosurin brenda vendit afati për të bërë kërkesë për rivendosjen në afat të ankimit të vendimit në mungesë fillon nga marrja dijeni për vendimin, në rastin e të dënuarit të ekstraduar fillon nga paraqitja ose dorëzimi i të burgosurit në shtetin pritës. Që nga momenti që i pandehuri i ekstraduar paraqitet në vendin e ekzekutimit të vendimit afati tridhjetë ditor i jep mundësinë atij të bëjë të gjitha përgatitjet duke filluar që nga provat e deri te ballafaqimi me akuzën duke mos u gjendur kështu i papërgatitur për një mbrojtje efektive. Kjo procedurë e ndjekur nga shteti italian lidhur me afatin vlen për t'u ndjekur edhe nga ana e legjislatorit në vendin tonë për të bërë korrigjimet e nevojshme sipas standarteve të Strasburgut .

8.2.3.2 Momenti i marrjes dijeni efektivisht për vendimin e dhënë ndaj të pandehurit.

Për vendimin e dhënë në mungesë të të pandehurit i takon këtij të fundit barra e provës për të vërtetuar kohën kur ai është vënë në dijeni. Nëse do t'u referoheshim rasteve praktike do të vinim re se Gjykatat në jo pak raste e kanë patur të vështirë për të bërë vlerësimin e fakteve të cilat do të shërbenin si prova që do të vërtetonin kohën se kur i pandehuri ka marrë dijeni për vendimin e marrë ndaj tij. Gjykata të ndryshme kanë mbajtur qëndrime të ndryshme lidhur me dijeninë e të pandehurit për vendimin e dhënë në mungesë të tij. Në disa raste nga Gjykata¹⁴⁹ është marrë si provë për rivendosjen në afat, data e bërjes së aktit noterial të përfaqësimit dhe kjo është prezumuar edhe si datë në të cilën i pandehuri është vënë në dijeni në lidhje me vendimin e dhënë ndaj tij. Po ashtu të kundërtën e mendimit të sipërcituar ka patur një tjetër Gjykatë¹⁵⁰ e cila datën e aktit noterial të përfaqësimit bërë nga i pandehuri nuk e ka pranuar si datë në të cilën i pandehuri ka marrë dijeni për vendimin e dhënë në mungesë të tij, pasi është konsideruar

¹⁴⁹ Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, Vendim nr. 106, datë 24.01.2006, "Sipas prokurës së posaçme nr. 3945/ 285 dt. 17.11.2005, të lëshuar nga kërkuesi (i pandehuri) Sh.A., rezulton se ai ka marrë dijeni për vendimin në dt. 17.11.2005, dhe brenda afatit 10 ditor nga marrja dijeni e këtij vendimi, ka paraqitur në gjykatë kërkesën për rivendosje në afat të ankimit ndaj këtij vendimi konform nenit 147.2.3 të K.Pr.Penale"

¹⁵⁰ Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, Vendim nr. 931, datë 01.06.2006

se i pandehuri mund të ketë marrë dijeni më parë dhe kjo nuk përbën provë sipas dispozitave ligjore të parashikuara.

Nëse do t'i referoheshim jurisprudencës, ajo merrr si datë të vënies në dijeni të të pandehurit mbi vendimin e dënimit të dhënë në mungesë, datën në të cilën i pandehuri deklaron nëpërmjet firmës së tij se ka marrë në dorëzim vendimin, pra duke i kushtuar në këtë mënyrë më shumë vëmendje veprimeve formale të dorëzimit dhe marrjes në dorëzim të vendimit.

Nga sa u tha më sipër rezulton se midis marrjes dijeni nga vetë i pandehuri të vendimit të dhënë në mungesë dhe njoftimit nga Gjykata të vendimit ka diferenca të dukshme, siç është rasti kur vetë i pandehuri merrr dijeni për vendimin e ekstradimit apo rasti kur i pandehuri vihet në dijeni me urdhrin e lëshuar nga prokurori për ekzekutimin e vendimit të dënimit, raste këto në të cilat i pandehuri nëse do të ishte njoftuar nga Gjykata nuk do të kishte po të njëjtin efikasitet, kur një kopje të vendimit apo urdhrin e merrr vetë ai në dorëzim kundrejt firmës së tij.

8.2.4 Gjykata kompetente për rivendosjen në afat.

Nga interpretimi që i bëhet nenit 147/4 i K.Pr.Penale përmbajtja e tij në atë që parashikon është shumë e vakët dhe jo e plotë për faktin se ajo nuk lë mundësi për të kuptuar se çfarë nënkupton me frazën “...organi që procedon në kohën e paraqitjes së saj”.

Bazuar në nenin 147/4 të Kodit të Procedurës Penale, nëpërmjet një vendimi unifikues Gjykata e Lartë¹⁵¹ cilëson se në rastet kur të pandehurit i lind e drejta për të bërë kërkesë për rivendosjen në afat të ankimit ai duhet t'i drejtohet Gjykatës e cila ka dhënë vendimin që i pandehuri kërkon ta ankimohet, pra në më të shumtën e rasteve Gjykatës të Shkallës së Parë. Sipas Gjykatës së Lartë neni i sipërcituar nënkupton në mënyrë të qartë se vetëm Gjykatës së Shkallës së Parë i lind e drejta të marrë në shqyrtim kërkesat për rivendosjen në afat të ankimit, ku vendimi i cili vendos për të bërë rivendosjen në afat për ankim ankimohet së bashku me vendimin përfundimtar ndryshe nga vendimi i cili rrëzon kërkesën për rivendosjen në afat të ankimit që ankimohet në Gjykatën e Apelit, pasi Gjykatat supreme siç është Gjykata e Apelit edhe pse kjo mund ta ketë gjykuar çështjen në themel si dhe ajo e Lartë merren vetëm me ankimet dhe rekursin që bëhen kundër vendimeve.

Një mendim pakice arsyeton se për të marrë në shqyrtim kërkesën për rivendosjen në afat të ankimit ndaj vendimit gjyqësor e ka Gjykata e cila ka dhënë vendimin. Por kur

¹⁵¹ Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, Vendim nr.351, datë 31.05.2006

kërkohet rivendosja e së drejtës për të bërë apel ndaj një vendimi gjyqësor të Gjykatës së Shkallës së Parë, këtë kërkesë e merr në shqyrtim Gjykata e cila ka dhënë vendimin që kërkohet të apelohej, pra Gjykata e Shkallës së Parë. Ndërsa kur kërkohet rivendosja e së drejtës për të bërë rekurs ndaj vendimit të dhënë nga Gjykata e Apelit, është kjo gjykatë e që do të vendosë në lidhje me kërkesën.

Në Kodin e Procedurës Penale Italiane është parashikuar në mënyrë më të kuptueshme dhe më eksplicite se përgjegjësinë për të vendosur në lidhje me kërkesën¹⁵², e ka Gjykata e cila rast pas rasti shqyrton apelin ose rekursin. Kështu për sa i përket organit i cili do të ketë përgjegjësinë për të vendosur mbi kërkesat për rivendosjen në afat mendimet e shumicës apo pakicës në vendimin unifikuues janë të ndryshme nga ai që legjislatori Italian ka parashikuar. Pra legjislatori në vendin tonë ka marrë si model Kodin e Procedurës Penale Italiane lidhur me këtë pikë, mendimet e gjyqtarëve në vendimin Unifikues nuk janë në frymën e K.Pr.Penale Italiane(*i cili e ka të përcaktuar qartë se këto kërkesa janë kompetencë e Gjykatave respektive që gjykojnë apelin ose rekursin*) por ndajnë mendime të ndryshme edhe midis tyre.

Lidhur nga sa u tha më sipër, është Gjykata e Shkallës së Parë që ka kompetencën për të vendosur mbi kërkesën e rivendosjes në afat të ankimit kjo e zgjidhur nëpërmjet vendimit unifikuues i cili edhe me shumicë është në fuqi deri sa të ketë një unifikim unanim të mëvonshëm.

8.2.4.1 Numri i gjyqtarëve për shqyrtimin e kërkesës

Kodi i Procedurës nuk shprehet për numrin e anëtarëve që duhet për gjykimin e kërkesës për rivendosje në afat. Për sa kohë që nuk ka rregullim të posaçëm, atëherë sipas Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë¹⁵³, nëse çështja për të cilën i pandehuri ka bërë kërkesë për rivendosje në afat është gjykuar nga një trup gjykues i përbërë nga tre anëtarë sipas rregullit, mund të gjykohet nga një trup gjykues me një anëtar kërkesa për rivendosjen në afat të ankimit kundër vendimit të dhënë në mungesë të të pandehurit ? Një gjykim i tillë mund lejohej vetëm nëse do të ishte i shprehur në ligjin procedural penal, por ligji nuk e ka parashikuar pra edhe pas ndryshimit të nenit 13 të K.Pr.Penale nga ligji nr.8813/2002, zbatohet i njëjti arsyetim. Ligji procedural i ka përcaktuar qartë rastet kur

¹⁵² Neni 175/4 i K.Pr.Penale Italiane ka këtë formulim, "Për kërkesën vendos organi që procedon në kohën e paraqitjes së saj. Para bërjes së kërkesës për gjykim është kompetent gjyqtari për hetimet paraprake. Nëse është dhënë vendimi apo dekreti i dënimit vendos gjyqtari që do të ishte kompetent ankimin apo kundërshtimin." Ajo që bie në sy është fakti se në kodin tonë është përfshirë vetëm fjalia e parë e gjë që ka çuar në përplasje për interpretimin e pikës 4 të nenit 147.

¹⁵³ Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Vendim nr.2, datë 14.10.2002

gjykimi mund të bëhet nga një trup gjykues i përbërë nga një anëtar dhe në asnjë nga rastet nuk është shprehur për kërkesën në fjalë por parashikon në mënyrë taksative rastet kur çështjet gjykohen me një gjyqtar të vetëm dhe në këto raste nuk përfshihet rasti në fjalë.

8.2.5 Ankimimi ndaj vendimit që lejon apo refuzon rivendosjen në afat .

Rrugët e ankimit ndaj vendimit të rivendosjes në afat parashikohen nga Neni 147 i K.Pr.Penale në pikat 5 dhe 6 të tij. Në rastin kur kërkesa për rivendosje në afat nuk pranohet nga Gjykata e Shkallës së Parë që ka bërë shqyrtimin e kërkesës duke vendosur për rrëzimin e saj, kërkuesi ka të drejtën ta apelojë pranë Gjykatës së Apelit këtë vendim. Kështu duke ditur Gjykatën që ka dhënë vendimin kërkuesi e ka të lehtë për veprimet procedurale që duhet të ndjekë më tej në lidhje me vendimin.

Referuar praktikës së Gjykatës së Lartë ajo ka analizuar pikën 5 të nenit 147 të K.Pr.Penale lidhur me kompetencën që i jepet Gjykatës së Shkallës së Parë për gjykimin e kërkesës për rivendosjen në afat të ankimit të vendimit të dhënë në mungesë të të pandehurit. I njëjti Kolegj në të njëjtin vendim i ka bërë analizë pikës 6 të nenit 147 të K.Pr.Penale lidhur me hierarkinë e shkallëve të gjyqësorit për sa i përket ankimit kundër vendimit të apelit nga ana e prokurorit para Gjykatës së Lartë në rast rrëzimi të kërkesës si dhe ka analizuar të drejtën e prokurorit në rast se pranohet kërkesa në Gjykatën e Apelit për të bërë ankim në Gjykatën e Lartë. Pra sipas kësaj dispozite me pranimin e kërkesës për rivendosje në afat të vendimit të dhënë në mungesë të të pandehurit nuk parashikon ndaj këtij vendimi, por ai mund të bëhet në përfundim të gjyimit në Gjykatën e Apelit. Palët mund ta shfrytëzojnë këtë të drejtë në përfundim të këtij gjykimi, por nuk është e njëjta gjë kur kërkohet nga i pandehuri rivendosja në afat për të bërë rekurs, i gjykuar në mungesë në Gjykatën e Apelit.

Po në rastet kur është pranuar kërkesa për rivendosjen në afat për të bërë rekurs ndaj vendimit të dhënë nga Gjykata e Apelit në një kohë kur ka përfunduar gjykimi në Gjykatën e Lartë, si mund të ankimohet vendimi për rivendosjen në afat të rekursit? Praktika unifikuese e Gjykatës së Lartë ka pranuar kërkesën paraprake të prokurorit duke analizuar vendimin e rivendosjes në afat të së drejtës së të pandehurit për të bërë rekurs, praktikë kjo e kundërshtuar nga Gjykata Kushtetuese¹⁵⁴ e cila ka arsyetuar se me pranimin e kërkesës paraprake të prokurorit ka lejuar të shqyrtohet një dosje tjetër gjyqësore që nuk i përkiste rekursit, por i përkiste kërkesës për rivendosje në afat të ankimit, vendim i cili ishte i ekzekutueshem, çka do të thotë se nuk ishte ankimuar në Gjykatën e Lartë nga

¹⁵⁴ Vendimi nr.21, datë, 24.07.2006 i Gjykatës Kushtetuese.

organi i akuzës dhe del në konkluzionin se kërkesa e bërë nga prokurori nuk duhet të ishte shqyrtuar nga Gjykata e Lartë në këtë gjykim, por me ankim para se të shqyrtohej rekursi. Gjykata Kushtetuese në gjykimin e saj ka cënauar nenin 147/5 të K.Pr.Penale në arsyetimin se pala duhej të bënte ankim ndaj vendimit të dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë dhe e ka humbur atë, pra në një farë mënyre ajo ka zhvleftësuar dispozitën që e kufizon atë. Gjykata Kushtetuese ka të drejtë të shfuqizojë si antikushtetues nene të procedurës apo vendime të Gjykatës në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe jo të tërthortë, sic ka vepruar në këtë rast, duke mos i dhënë fuqi por duke e neglizhuar në mënyrë të heshtur. Ajo, duke mbajtur një qëndrim konkret për dispozitën, do të qartësonte dhe do t’u jepte zgjidhje problematikave analoge të ngjashme që do dalin në periudha të mëvonshme.

Përsa i përket vendimit të Gjykatës së Lartë¹⁵⁵ ka analizuar mbi të drejtën që i njeh dispozita, konkretisht neni 434 i K.Pr.Penale për të shqyrtuar kryesisht çështje të cilat i shikon të arsyeshme edhe pse nuk janë objekt i shqyrtimit për rastin konkret.

Sipas Nenit 147/5 i K.Pr.Penale kufizohet e drejta ankimit të drejtpërdrejtë kundër vendimit të rivendosjes në afat, për të garantuar të drejtat procedurale të të pandehurit pasi mungesa mund të ketë ardhur nga shkaqe të ndryshme që nuk vareshin nga vullneti i të pandehurit, Gjykata ka detyrim ligjor që të gjykojë objektivisht shkaqet e paraqitura në kërkesën për rivendosje në afat, por Gjykata e Lartë sipas nenit 147/5 të K.Pr.P i cili e ndal që pa gjykuar rekursin e rivendosur në afat nuk mund të gjykojë vendimin e rivendosjes në afat të rekursit. Në rastin konkret për të mos i shpëtuar një shqyrtimi në një shkallë më të lartë nga ajo e shkallës së parë Gjykata e Lartë ka pranuar kërkesën e prokurorit për të shqyrtuar rekursin kundër vendimit të rivendosjes në afat pasi ajo është shkalla më e lartë e gjykimit.

8.2.6 Sa efektiv është instituti i rivendosjes në afat ?

Gjykata e Strasburgut ashtu siç e kemi përmendur edhe më sipër në gjykimin e çështjes “Sejdovic kundër Italisë” arsyeton se kur i pandehuri është komunikuar konform të gjitha kërkesave procedurale lidhur me procesin penal e nisur ndaj tij dhe është vërtetuar se i pandehuri me vullnetin e tij të lirë ka refuzuar të përballlet me akuzën në gjykim, gjykimi në mungesë i bërë pa prezencën e të pandehurit nuk do të trajtohet se është proces i parregullt ligjor, por ai do të konsiderohet sipas kësaj gjykate si një proces

¹⁵⁵ Kolegji Penal I Gjykatës së Lartë, Vendim nr.532, datë 06.07.2005.

konform nenit 6 të KEDNJ, me kusht që me paraqitjen e të pandehurit t’i njihen të gjitha të drejtat e parashikuara në ligj për rigjykim.

Legjislatori me qëllim garantimin e të drejtave ligjore të të pandehurit ka parashikuar institutin e rivendosjes në afat të ankimit.

Por a sigurohet realisht në mënyrën më efektive të mundshme një gjykim i ri për të pandehurin nëpërmjet së drejtës për të kërkuar rivendosjen në afat të ankimit të vendimit të dhënë në mungesë të tij?

Duke pasur parasysh që, së pari vetë fakti i gjykimit në mungesë të të pandehurit deri në marrjen e një vendimi nga Gjykata, atij automatikisht i ka humbur e drejta nga një shkallë gjykimi, së dyti nëse i pandehuri paraqitet për të kërkuar rivendosjen në afat, atij nuk i garantohet në mënyrë kategorike e drejta për një proces të ri gjyqësor ku ai të ballafaqohet me akuzën edhe pse mungesa e tij në proces ka ardhur për shkaqe të pavarura nga vullneti i tij, sepse mundësitë janë që edhe mund të mos i pranohet kërkesa për rivendosjen në afat nga mënyra si funksionon ky institut.

Si përfundim nisur nga sa u citua me sipër si dhe duke ditur që Gjykata nuk siguron të quajturën “fresh determination of the charge”, por ajo njeh vetëm të drejtën e të pandehurit të gjykuar në mungesë për të bërë apel, themi se rivendosja në afat nuk ka një siguri edhe aq efektive.

Nëse do t’i referoheshim Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me atë që ajo mendon për garancitë që i siguron të pandehurit në mungesë rivendosja në afat të ankimit për një gjykim të ri si dhe sa është në përqasje me kërkesat e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut themi se ky institut nuk shkon edhe aq në konformitet me këto kërkesa si edhe nuk i garanton në mënyrë absolute¹⁵⁶ të pandehurit të gjykuar në mungesë të drejtën për një proces të ri gjyqësor ku ky i fundit të paraqesë gjithë pretendimet që ka në lidhje me akuzën që i drejtohet, pasi jo për faj të tij është gjykuar më parë në mungesë.

Gjithashtu nisur edhe nga sa u tha, i pandehuri mund ta humbasë fare të drejtën për të kërkuar rivendosjen në afat konform pikës 2/a,b,c të nenit 425 të Kodit të Procedurës Penale nëse vendimi i marrë në mungesë të tij apelohej nga të bashkëpandehurit e tjerë apo nga organi procedues në proces dhe pasi çështja të gjykohej në tërësi vendimi të ketë marrë formë të prerë, duke ezauruar kështu të gjitha shkallët e gjykimit edhe për të pandehurin në

¹⁵⁶ Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, R.R. v Italisë, vendim nr. 42191/02, datë 09.06.2005, § 57, Jones v Anglisë vendim nr. 30900/02, datë 30.09.2003.

mungesë¹⁵⁷ si ezaurimin e së drejtës së tij për të bërë kërkesë për rivendosje në afat të ankimit.

Gjykata e Strasburgut afatin brenda të cilit duhet të paraqitet kërkesa për rivendosje në afat e ka konsideruar si vështirësi që i krijohet të pandehurit për të realizuar me efektivitet të drejtën e tij për të bërë kërkesë për rivendosje në afat të ankimit të vendimit të dhënë në mungesë.

Gjithashtu edhe për sa i përket afatit brenda të cilit i pandehuri duhet të vërtetojë në lidhje me argumentimin e faktit që ai nuk është vënë në dijeni për vendimin e dhënë ndaj tij, pasi ka bërë kërkesën për rivendosjen në afat të ankimit të vendimit të dhënë në mungesë, Gjykata e Strasburgut mban po të njëjtin qëndrim.

Nëse për një vendim të dhënë në mungesë, sipas legjislacionit italian barra e provës i ngarkohet të pandehurit, me ndryshimet e bëra në këtë legjislacion në vitin 2005 barra e provës bie mbi Gjykatën e cila ka bërë njoftimin e të pandehurit. Pra bazuar në legjislacionin e ndryshuar Gjykata ka për detyrë të vërtetojë nëse janë ndjekur të gjitha procedurat ligjore për njoftimin e rregullt të të pandehurit në lidhje me vendimin pasi procesi nis me faktin se i pandehuri nuk ka marrë dijeni në lidhje me vendimin në mungesë edhe pse i pandehuri duhet të sjellë të gjitha provat që të vërtetojë kohën në të cilën ka marrë dijeni.

Por nëse do të vinim re rastet praktike të Gjykatës së Strasburgut do të na rezultonte fakti që përmbajtja dhe mënyra e funksionimit të rivendosjes në afat si insitut i së Drejtës Procedurale Penale nuk është konform asaj çfarë kërkon Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

8.2.7 Pasoja e rivendosjes në afat.

Efektet e rivendosjes në afat rregullohen nga neni 148 i K.Pr.Penale .

Sipas këtij neni, Gjykata e cila ka gjykuar kërkesën për rivendosjen në afat dhe e ka pranuar atë mund të përsëritë shqyrtimin gjyqësor me kërkesë të palës për aq sa ajo e shikon të arsyeshme dhe nëpërmjet vendimeve të ndërmjetme, vendos veprimet që do të ndërmerren në funksion të së drejtës së të pandehurit, si e drejtë ekskluzive e kësaj gjykate.

Vetë përmbajtja e nenit të sipërcituar, reflekton jo pak probleme. Në pikën e parë të tij, neni parashikon se Gjykata që ka vendosur rivendosjen në afat, urdhëron përsëritjen e

¹⁵⁷ Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Vendim nr.386, datë 29.07.1999

veprimeve. Përkrah qëndrimit të sipërcituar ku është Gjykata e Shkallës së Parë ajo që shqyrton dhe vendos pranimin ose jo të kërkesës për rivendosje në afat, në rastin e gjykimit në mungesë të të pandehurit mendojmë se ka mospërputhje kompetencash kur kjo gjykatë me vendimin e rivendosjes në afatin e ankimit, ku kemi të bëjmë me përsëritje të shqyrtimit gjyqësor apo veprime të cilat duheshin marrë nëse i pandehuri do të merrte pjesë në gjykim.

Pra, e thënë ndryshe janë veprime urdhëruese për Gjykatat superiore nga hierarkia, që do të shqyrtojnë ankimin e rivendosur në afat. Po t'i referohemi kodit italian ku dispozita ka kuptim të qartë lidhur me shqyrtimin e kërkesës për rivendosje e njehson me Gjykatën që do të shqyrtojë ankimin nëse pranohet dhe sipas kësaj dispozite kërkesa për rivendosje mund të bëhet në Gjykatën e Apelit dhe atë të Lartë. Kjo do të thotë se rivendosja afat do të vendoset ose jo nga këto Gjykata dhe kurrësi nga Gjykata e Shkallës së Parë, ndoshta kjo e parë në kuptim hierarkik të kompetencës dhe mendoj se është zgjidhur më mirë.

Por dhe pika e dytë e këtij neni është jo më shumë e qartë. Kështu, e paqartë është se cila Gjykatë do të quhet "kompetente për gjykimin në themel", ajo që ka kryer veprimet procedurale ku pala gëzonte të drejtën të merrte pjesë që është Gjykata e Shkallës së Parë apo Gjykata e Apelit që do të gjykojë ankimin e rivendosur në afat?

8.2.7.1 Kur pranon kërkesën për rivendosje në afat Gjykata a mundet që të urdhërojë pezullimin e ekzekutimit të dënimit?

Legjislatori ka parashikuar se edhe kur një vendim ka marrë formën e prerë për shkak të humbjes së afatit që është prekluziv sipas shkallës së gjykimit, brenda 10 ditëve duhet të bëhet ankim kundër vendimit të dhënë nga Gjykata. Me bërjen e kërkesës për rivendosjen në afat, i pandehuri, i cili në bazë të nenit 461/1 të Kodit të Procedurës Penale është arrestuar si pasojë e ekzekutimit të vendimit nuk mund të kërkojë edhe pezullimin e vendimit pasi legjislacioni nuk e ka parashikuar në asnjë dispozitë ligjore këtë të drejtë. Ndërsa Kodi Procedurës Penale Italiane në ndryshim nga Kodi ynë e parashikon këtë të drejtë për të pandehurin në nenin 175, pika 7 e tij. Sipas nenit të sipërcituar të K.Pr.Penale Italiane i cili i takon nenit 147 të K.Pr.Penale të vendit tonë, nëse kërkesa për rivendosjen në afat për ankim bërë nga i pandehuri i dënuar në mungesë i ndodhur në burg pranohet nga Gjykata atëherë po kjo Gjykatë njëkohësisht jep vendim për këtë të pandehur, të lirohet. Pra kodi ynë ka krijuar një boshllëk ligjor pasi parashikimin që ka bërë Procedura

Penale Italiane duke i krijuar një mjet sigurie të pandehurit në burg pas ekzekutimit të vendimit të dhënë në mungesë nga Gjykata nuk e ka bërë.

Në rast se kërkesa e të dënuarit për rivendosjen në afat të ankimit për vendimin e dhënë në mungesë pranohet, atëherë bazuar në nenin 417/1 të Kodit të Procedurës Penale kur çështja të jetë marrë në shqyrtim nga Gjykata e Apelit do të vendoset edhe për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit, por që nga koha kur është pranuar kërkesa për rivënie në afat të ankimit e ndërkohë afati ka filluar e deri në marrjen e çështjes në shqyrtim nga Gjykata e Apelit vendimi i ankimuar do të vazhdojë të jetë në fuqi. Pra ky nen i siguron pezullimin e ekzekutimit të vendimit të ankimuar të dënuarit më burg; nëse kërkesa për rivendosjen në afat të ankimit pranohet, ky pezullim do të qëndrojë në fuqi derisa Gjykata e Apelit të dalë me një vendim të saj.

Jam i mendimit për rastin e sipërcituar, që të pandehurit të dënuar me burg me vendim të dhënë në mungesë së bashku me të drejtën që i njihet nga ligji për të bërë kërkesë për rivendosjen në afat të ankimit ndaj vendimit t'i jepet edhe e drejta për të bërë kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit, kuptohet që kjo do të ndodhë nëse Gjykata e shih me pozitivitet dhe si të drejtë vendimin për pranimin e kërkesës për rivendosjen në afat. Nëse kjo do të realizohej atëherë do të mbyllej kështu një vakum ligjor në Kodin e Procedurës Penale si dhe të pandehurit në mungesë do t'i sigurohej edhe një garanci ligjore më tepër.

Nëse do t'i referoheshim praktikës ajo ka raste kur njëkohësisht me vendimin për kërkesën e rivendosjes në afat të ankimit të vendimit të dhënë në mungesë të japë vendim edhe për pezullimin e ekzekutimit të vendimit. Sipas një vendimi të Gjykatës së Apelit Tiranë thuhet se, së pari përderisa bazuar në nenin 462/1 të K.Pr.Penale të pandehurit i njihet e drejta për të bërë ankim atëherë nuk mund të pretendojmë për një vendim të formës së prerë, së dyti neni 417/1 të K.Pr.Penale prashikon se, deri në kohën kur Gjykata e Apelit të dali me një vendim, pezullimi i ekzekutimit të vendimit do të jetë në fuqi dhe së treti, konkretisht i pandehuri në këtë rast nuk ka marrë masën e sigurimit "arrest në burg" që të detyronte me vendim të formës së prerë qëndrimin e tij në burg, atëherë nëse pranohet rivendosja në afat e së drejtës për ankim të vendimit të Gjykatës të dhënë në mungesë, menjëherë do të shkaktohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burg.

Bazuar në ato që argumentuam më sipër, mund të themi se pasi të pandehurit i pranohet e drejta për t'u rivendosur në afatin e ankimit dhe ky afat fillon së vepruari atëherë bazuar edhe në nenin 462/1 të K.Pr.Penale vendimi e humbet fuqinë për t'u

ekzekutuar, rrjedhimisht pasi kërkesa për rivendosjen në afat është pranuar mund të vendoset për pezullimin e vendimit të dënimit me burg.

Kështu shihet e arsyeshme që nëse akuza vërtetohet se vendimi gjyqësor i dhënë në mungesë të të pandehurit, nuk i është bërë e ditur këtij të fundit ose nga organi përgjegjës për njoftimin e të pandehurit në mungesë për vendimin e marrë ndaj tij nuk është ndjekur procedura ligjore, atëherë akuzës t'i parashikohet në ligjin procedural penal e drejta për t'i kërkuar organit gjyqësor të nxjerrë urdhër për të bërë përsëri njoftimin e vendimit të pandehurit të cilit i është marrë vendimi .

8.2.8 RASTE PRAKTIKE.

8.2.8.1 Rast praktik.¹⁵⁸

Gjykata e Shkallës së Parë, Tiranë me vendim ka dënuar L.M në mungesë të tij i përfaqësuar nga mbrojtësi i caktuar kryesisht nga Gjykata, në masën e dënimit 12 vjet burg për veprën penale parashikuar nga neni 114/a paragrafi i parë, i dytë, i tretë në zbatim edhe të nenit 55 të Kodit Penal. Ky vendim i apeluar nga mbrojtësi i caktuar kryesisht është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit. Është rekursuar vendimi i dhënë nga Gjykata e Apelit nga i pandehuri dhe Gjykata e Lartë nuk e ka pranuar rekursin.

Edhe pse tre shkallët e gjykimit kanë përfunduar i pandehuri L.M i dënuar në mungesë ka bërë kërkesë për rivendosjen në afat të ankimit për vendimin e dënimit të dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, por kjo kërkesë nuk i është pranuar, me arsyetimin se ishte një kërkesë e pabazuar në ligj dhe në prova.

Pas ankimit të bërë nga i dënuari L.M për vendimin e dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë, Tiranë për rivendosjen në afat, në bazë të nenit 147/2 të K.Pr.Penale Gjykata e Apelit ka vendosur rivendosjen në afat të së drejtës së kërkuarit për të bërë ankim ndaj vendimit të dënimit të dhënë në mungesë të tij, pasi sipas kësaj Gjykate gjykimi i të pandehurit në Gjykatën e Shkallës së Parë dhe në atë të Apelit është zhvilluar në mungesë të tij për shkaqe të pavarura nga ky i fundit sepse nuk provohet që t'i jetë komunikuar njoftimi në lidhje me gjykimin dhe vendimin e bërë.

Duke u bazuar në nenin 420/1/b të K.Pr.Penale, organi akuzës me arsyetimin se njoftimi që i është bërë ankimesit të gjykuar më parë në mungesë i ka ndjekur të gjitha procedurat ligjore dhe meqënëse vendimi i dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë i ka

¹⁵⁸ Gjykata e Apelit Tiranë, vendim nr.969, datë 24.12.2007.

ezauruar të gjitha shkallët e gjyqësorit ai nuk mund të ankimohet, ka kërkuar nga Gjykata e Apelit të vendosë rrëzimin e ankimit .

Për të marrë në shqyrtim ankimin e bërë nga L.M sipas Gjykatës së Apelit ligjërisht nuk është e mundur të bëhet nga vetë kjo Gjykatë, pasi : së pari L.M. ka bërë ankim të vendimit të dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë, Tiranë edhe pse ky vendim është marrë njeherë në shqyrtim edhe nga Gjykata e Apelit, Tiranë për shkak të ankimit nga mbrojtësi i caktuar kryesisht. Gjithashtu L.M. ka bërë edhe rekurs në Gjykatën e Lartë, marrë në shqyrtim konform të gjitha procedurave ligjore që ligji parashikon. Së dyti duke qënë se çështja është gjykuar më parë nga Gjykata e Apelit e cila ka dalë me një vendim që nuk është prishur nga Gjykata e Lartë pasi kjo e fundit nuk e ka pranuar rekursin e bërë nga i dënuari.

Nga sa u citua më sipër konform nenit 8 të DUDNJ-së, nenit 2 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, nenit 13 të KEDNJ dhe Kushtetutës së vendit tonë, të gjykuarit në mungesë i është ezauruar e drejta për të bërë ankim ndaj vendimit të Gjykatës të dhënë në mungesë nga ankimi që ka bërë mbrojtësi i caktuar kryesisht.

Në zbatim të nenit 34 të Kushtetutës sonë¹⁵⁹ derisa nga Gjykata e Lartë nuk është vendosur për rigjykim të çështjes, Gjykata e Apelit nuk mund të marrë në shqyrtim këtë çështje edhe në rast se ankimi është bërë me kërkesë të të gjykuarit.

8.2.8.2 Rast praktik.¹⁶⁰

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr.11, datë 26.01.2001, ka vendosur në mungesë:

Deklarimin fajtor të të pandehurit A.I. për kryerjen e veprës penale të vrasjes me paramendim, vepër kjo e parashikuar si krim nga neni 78 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 20 (njetzet) vjet burgim.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr.05, datë 11.02.2008, ka vendosur:

Pranimin e kërkesës.

Rivendosjen në afat të kërkesës së kërkuarit A. I. për të ushtruar ankim ndaj vendimit penal nr.11, datë 26.01.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

¹⁵⁹ Neni 34 i Kushtetutës " Askush nuk mund të dënohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale dhe as të gjykohet sërish, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjyrimi i çështjes nga një gjykatë më e lartë, sipas mënyrës të parashikuar me ligj."

¹⁴⁶ Vendim i Kolegjit Penal i Gjykatës së Lartë Nr. 138/ 2008 ka vendosur:Prishjen e vendimit Nr.55, datë 26.03.2008, të Gjykatës së Apelit Gjyqësor dhe vendimit Nr.11, datë 26.01.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjyqësor Gjirokastrë. Dërgimin e akteve për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjyqësor Gjirokastrë, me tjetër trup gjykues.

Gjykata e Apelit Gjirokastër, me vendimin nr.55, datë 26.03.2008, ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr.11, datë 26.01.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjirokastër.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, ka paraqitur rekurs i gjykuari A .I. nëpërmjet avokatit të tij, i cili ka kërkuar prishjen e tij dhe kthimin e çështjes për rigjykim, duke parashtruar këto shkaqe:

Të dy vendimet janë marrë në zbatim të gabuar të ligjit dhe është haptazi të padrejtë, pasi nga Gjykata e Shkallës së Parë nuk është njoftuar fare i gjykuari A. I. për datën dhe orën e gjykimit, kjo sepse në dosje nuk ndodhet asnjë fletëthirrje qoftë dhe bosh që të jetë bërë për të gjykuarin dhe Gjykata ka vazhduar gjykimin në praninë e mbrojtësit të caktuar kryesisht që në hetimin paraprak.

Përveçse nuk është bërë asnjë lloj njoftimi me fletëthirrje Gjykata e rrethit nuk ka deklaruar me vendim mungesën e të gjykuarit Alban Islami duke u mjaftuar me vendimin e deklarimit të ikjes bërë gjatë hetimit paraprak, për më tepër që Gjykata përmend urdhrat e kërkit të datave 31.03.200, 04.04.2000 dhe 14.04.2000, që janë marrë nga organi i prokurorisë gjatë hetimit paraprak por që nuk kanë asnjë lidhje me gjykimin.

Edhe përsa i përket zgjidhjes së çështjes në themel Gjykatat kanë arritur në një konkluzion të gabuar të pambështetur në prova, për më tepër që gjykimi është zhvilluar pa praninë e të gjykuarit që ka qenë dhe personi që mund të jepte rrethana dhe fakte në lidhje me këtë vepër.

Gjykata e apelit, për shkak të mangësive të theksuara objektive dhe subjektive të gjykimit të zhvilluar në Gjykatën e Shkallës së Parë, duhet të përsëriste domosdoshmërisht shqyrtimin gjyqësor të çështjes, kërkesë e cila i është parashtruar nga avokati mbrojtës i zgjedhur tashmë nga i gjykuari Alban Islami, por kjo kërkesë nuk është pranuar nga Gjykata e Apelit Gjirokastër, duke shkelur kështu parimin e barazisë së armëve në një proces penal.

Gjykata e Apelit në vend që t'i tërhiqte vëmendjen Gjykatës së Shkallës së Parë, pasi kishte bazuar vendimin e saj në thëniet e dëshmitarit J.Z., në një kohë që nga procesverbali i gjykimit të zhvilluar në Gjykatën e Shkallës së Parë Gjirokastër nuk rezulton të jetë pyetur ky dëshmitar dhe as nuk t'i jenë nënshtruar shqyrtimit gjyqësor deklaramet e tij dhënë gjatë hetimit paraprak, duke pranuar kështu të mirëqenë konkluzionet faktike dhe ligjore të mbështetura në prova të mangëta të akuzës.

Nga organi i akuzës ashtu si dhe nga Gjykata nuk rezulton të ketë dalë në pah qëllimi i vrasjes së viktimës nga i pandehuri, për më tepër që pretendimi i mbrojtjes se në

vendngjarje kanë qenë dhe persona të tjerë që duhen thirrur si dëshmitarë okularë të ngjarjes, të cilët gjenden dhe në relacionin që oficeri i policisë gjyqësore ia dërgon prokurorit (shtetasi I. L.), por që çuditërisht Gjykata e apelit nuk iu përgjigj me vendim kësaj kërkesë.

Me vendimin Nr.11, datë 26.01.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyroskastër, i gjykuari u deklarua fajtor dhe u dënua me 20 vjet burgim në mungesë, për krimin për të cilin ishte akuzuar, vendim ky, i cili ka marrë formë të prerë pa u ankimuar.

Gjykata e Apelit edhe pse kishte detyrimin që pas verifikimit të shkeljeve të pretenduara e në respektim të përcaktimeve të nenit 428/ç të K.P.Penale, të prishte vendimin e ta kthente atë për rigjykim në Gjykatën e rrethit, ka vazhduar gjykimin e çështjes në themel, duke dhënë kështu një vendim të pavlefshëm.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ka konstatuar se për njoftimin e të gjykuarit duhet të ishin respektuar procedurat që parashikohen nga neni 141 i K.Pr.Penale, në të cilën bëhet fjalë për njoftimin e të pandehurit kur ai nuk gjendet. Këto procedura duhet të ishin respektuar nga Gjykata e rrethit. Mosrespektimi i këtyre detyrimeve që rrjedhin nga dispozitat procedurale nenit 141, 351, 352/4 të K.Pr.Penale, çmohet nga ky Kolegj se kanë sjellë për pasojë marrjen e një vendimi, i cili në kuptim të nenit 128/1-c të K.P.Penale, është absolutisht i pavlefshëm.

Në përfundim, ky Kolegj konkludon se pretendimet e të gjykuarit dhe mbrojtësit të tij janë të bazuara në ligj, pasi të dy vendimet, si ai Gjykatës së Apelit dhe ai i Rrethit Gjyqësor Gjyroskastër, janë absolutisht të pavlefshme, pasi kanë qenë pasojë e shkeljes të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, për t'u mbrojtur në mënyrë efektive të të gjykuarit të garantuar nga Kushtetuta, KEDNJ dhe ligji procedural penal.

Kolegji Penal e gjen të pambështetur në ligj pretendimin e përfaqësuesit të akuzës në seancën dëgjimore, se kërkesa e mbrojtësve dëmton rëndë parime të procesit të rregullt, të barabartë që lidhen me kohëzgjatjen e gjyimit, për shkak se një vrasje të ndodhur në vitin 1997 kërkohet të gjykohet me standarte e praktikë gjyqësore aktuale dhe në përfundim vendos:

Prishjen e vendimit Nr.55, datë 26.03.2008, të Gjykatës së Apelit Gjyroskastër dhe vendimit Nr.11, datë 26.01.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjyroskastër.

Dërgimin e akteve për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjyroskastër, me tjetër trup gjykues.

8.2.8.3 Rast praktik. ¹⁶¹

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me vendimin Nr.183 datë 16.07.2003, ka vendosur: Të deklarojë fajtor të pandehurin Y.Sh, për veprën penale të shfrytëzimit të prostitucionit në rrethana rënduese dhe në bazë të nenit 114/a, pika 1,4,5 dhe 50/c të K.Penal e dënon atë me 12 (dymbëdhjetë) vjet burgim. Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin Nr.71, datë 17.03.2004 ka vendosur: Lënien në fuqi të vendimit nr.183, datë 16.07.2003, të Gjykatës së Rrethit Fier.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Fier me vendimin Nr.196, datë 08.06.2009, ka vendosur: Refuzimin e kërkesës së kërkuarit Y.Sh, për t'u rivendosur në afat rekursi i tij kundër vendimit nr.71, datë 17.03.2004, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr.117, datë 10.06.2010 ka vendosur: Ndryshimin e vendimit nr. 196, datë 08.06.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe duke e gjykuar çështjen në fakt. Pranimin e kërkesës së kërkuarit Ymerr Shehaj duke e rivendosur në afat të rekursit kundër vendimit nr.71 datë 17.03.2004, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë ka paraqitur rekurs mbrojtësi i të gjykuarit, Y .Sh i cili kërkon prishjen e vendimit të mësipërm të Gjykatës së Apelit, duke parashtruar shkaqet.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë çmon se rekursi i të gjykuarit Y. Sh duhet të pranohet dhe vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë nr.71, datë 17.03.2004, si dhe vendimi nr.183, datë 16.07.2003, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier duhet të prishen për shkelje të ligjit procedural penal me pasojë pavlefshmërinë e të dy vendimeve.

Në bazë të akteve të fashikullit të gjykimit rezulton se shtetasi Y.Sh është gjykuar dhe dënuar në mungesë (*in absentia*) në të dy shkallët e gjykimit. Të drejtat e tij në procesin penal të zhvilluar në mungesë në kushtet kur nuk ka zgjedhur mbrojtës fillimisht gjatë fazës së hetimit dhe në një pjesë të shqyrtimit në gjykimin në Shkallë të Parë, janë garantuar nga një mbrojtës i caktuar kryesisht nga Gjykata. Më pas gjatë gjykimit në

¹⁶¹ Vendimi nr. 197/2012 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, konstaton shkelje procedurale dhe vendos: Prishjen e vendimit nr.71 datë 17.03.2004, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe të vendimit nr.183, datë 16.07.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e shkallës së parë me tjetër trup gjykues.

seancën e datës 25.03.2003 është paraqitur një mbrojtjes i zgjedhur nga familjarët sipas prokurës së lëshuar nga nëna e të gjykuarit.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë konstaton se nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë nuk janë respektuar rregullat për njoftimin e të pandehurit të parashikuar nga neni 140 i Kodit të Procedurës Penale.

Në bazë të akteve rezulton se pas dërgimit të akteve të fashikullit për gjykim, Gjykata kishte detyrimin ligjor në bazë të nenit 140 të K.Pr.Penale që të njoftonte si organin e akuzës ashtu edhe të gjykuarin për të marrë pjesë në procesin penal të zhvilluar kundër tij. Rezulton se në fazën e hetimit ashtu edhe të gjykimit Y. Sh, ka patur masë sigurimi "arrest në burg" në mungesë, vendosur me vendimin nr.275, datë 07.10.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, e cila nuk është ekzekutuar nga Policia Gjyqësore. Në këto kushte ky i gjykuar është hetuar dhe gjykuar në mungesë.

Në këto rrethana njoftimi i tij duhet të bëhej sipas rregullave procedurale për të pandehurin në gjendje të lirë sipas nenit 140¹⁶² të Kodit të Procedurës Penale.

Në rast të moszbatimit të procedurave ligjore për vlefshmërinë e njoftimit bazuar në nenin 143¹⁶³ të Kodit të Procedurës Penale atëherë i gjithë procesi penal do të konsiderohej si i pavlefshëm. Për sa u tha, mbi zbatimin e procedurave të njoftimit edhe Gjykata Kushtetuese në një vendim të sajën thotë, duke qënë se e drejta e të pandehurit për të marrë pjesë në gjykim si dhe e drejta e Gjykatës për të marrë një vendim në mungesë të të pandehurit, varen drejtpërdrejt nga fakti që njoftimi nga organet përkatëse të jetë bërë sa më i saktë dhe efektiv në zbatim të të gjithë procedurave ligjore për njoftimin e të pandehurit, fakte të cilat të provojnë mungesën e të pandehurit në gjykim sepse ai i fshihet drejtësisë. Për çështjen objekt gjykimi kundër Y.Sh, nga aktet e fashikullit të gjykimit rezulton se njoftimi është konsideruar i kryer në bazë të një fletëthirrjeje të firmosur nga një person i cili ka marrë përsipër njoftimin pa treguar lidhjen gjinore. Në sqarimin e dhënë nga ana e Gjykatës, por pa treguar burimin pretendohet se është firmosur nga tezja e të

¹⁶² i. Njoftimi i të pandehurit në gjendje të lirë bëhet duke i dorëzuar atij kopjen e aktit. Kur nuk mund t'i dorëzohet personalisht, njoftimi bëhet në banesën e tij ose në vendin e punës, duke ia dorëzuar aktin një personi që bashkëjeton me të ose një fqinji, ose një personi që punon me të.

ii. Kur vendet e treguara në paragrafin 1 nuk dihen, njoftimi bëhet në vendin ku i pandehuri ka banimin e përkohshëm ose vendin ku qëndron më shpesh, duke ia dorëzuar atë njërit prej personave të treguar në paragrafin 1.

iii. Kopja e njoftimit nuk mund t'i dorëzohet një të mituri nën 14 vjeç ose një personi me paafësi të dukshme intelektuale.

iv. Kur personat e treguar në paragrafin 1 mungojnë ose nuk janë të përshtatshëm, ose refuzojnë të marrin aktin atëherë procedohet me kërkimin e të pandehurit në vende të tjera. Në rast se edhe në këtë mënyrë nuk mund të bëhet njoftimi, akti depozitohet në qendrën administrative të lagjes ose të fshatit ku i pandehuri banon ose punon.

Lajmërimi i depozitimit afishohet në portën e shtëpisë së të pandehurit ose të vendit ku punon. Ftuesi gjyqësor e lajmëron atë për depozitimin me letër rekomande me lajmërim marrje. Efektet e njoftimit rrjedhin që nga marrja e rekomandesë.

¹⁶³ N.143 i K.Pr.Penale Pavlefshmëria e njoftimeve

Njoftimi është i pavlefshëm:

c) kur janë shkelur dispozitat e veçanta mbi personin të cilit duhet t'i dorëzohet kopja;

ç) kur nuk është bërë afishimi i njoftimit për të pandehurin në gjendje të lirë;

gjykuarit. Njoftimi është kryer në adresën ku banon i gjykuari. Duke e konsideruar të ezauruar njoftimin sipas nenit 140/1 të K.Pr.Penale Gjykata ka deklaruar mungesën dhe ka zhvilluar gjykimin në mungesë duke i caktuar avokat kryesisht për mbrojtjen e të drejtave të tij.

Kolegji Penal konstaton se vendimi i deklarimit të mungesës është marrë jo në përputhje me kërkesat që parashikon nga neni 140/1 i K.Pr.Penale mbasi fletëthirrja nuk është firmosur nga personi i njohur nga ligji i cili potencialisht ka mundësinë e komunikimit me të gjykuarin dhe vënies në dijeni të procesit që po zhvillohet kundër tij. Gabimisht Gjykata e Shkallës së Parë ka marrë si njoftim të kryer dorëzimin e fletëthirrjes një personi e cila nuk jeton me të gjykuarin në të njëjtën banesë pavarësisht lidhjes gjinore që ka.

Gjykata duhet të bëjë të gjitha verifikimet e nevojshme të ndjekjes rigoroze të procedurave të njoftimit në përmbushje të të gjitha kushteve për një proces gjyqësor konform ligjit dhe më pas të dalë në përfundimin se me vullnetin e tij të plotë i pandehuri me dëshirën e tij ka hequr dorë nga marrja pjesë në gjykim dhe duke vijuar me gjykimin në mungesë. Duke u bazuar në garancitë e forta procedurale të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, po në këtë kod është parashikuar edhe gjykimi “in absentia”. Në rast se nga verifikimet del që rregullat e procedurës së njoftimit nuk janë zbatuar konform ligjit si dhe nuk ka mundësi të shmangies së pasojës që vjen nga kjo parregullsi atëherë i gjithë procesi penal dhe vendimi i dhënë në mungesë bazuar në nenin 128/1 pika c, shpallen absolutisht të pavlefshëm dhe gjithashtu vendoset rigjykimi i çështjes. **“Prania e të akuzuarit në gjykim”**- si parim nën këndvështrimin e procesit ligjor sipas nenit 6/1 të KEDNJ-së, nënkupton praninë fizike të të akuzuarit. Në zbërthim të këtij parimi GJEDNJ në disa vendime (shih GJEDNJ 22 shtator 1994 Lala c/ Pays-Bas, 24.03.2005, Stoichkov c/Bulgarie) në të cilat është theksuar se: *“prania e të pandehurit ka rëndësi të madhe për procesin penal të rregullt ligjor dhe të drejtë, duke shtuar se detyrimi për t’i garantuar të akuzuarit të drejtën për të qenë i pranishëm...është një prej elementëve kryesorë të nenit 6 ”.*

Bazuar në rezolutën nr.(75), 11 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës *“Për kriteret e gjykimit në mungesë të të akuzuarit”*,¹⁶⁴ u janë rekomanduar shteteve anëtare që të mbajnë parasysh :

- (i) Në rast të mungesës së njoftimit në afatin e parashikuar nga ligji askujt nuk mund t’i mohohet e drejta për të marrë pjesë në procesin e nisur ndaj tij;

¹⁶⁴ Citim, në vendimin e Gjykatës Kushtetuese, nr. 26, datë 08.05.2012

- (ii) Pasi i pandehuri nuk merr pjesë në proces njoftimi që i bëhet atij duhet të ndiqet edhe nga masa të parashikuara në ligj;
- (iii) Në rast se pas njoftimit që i bëhet të pandehurit, Gjykata nga verifikimet që i bën procedurave dhe mjeteve të këtij njoftimi përpara se të fillojë me gjykimin, vërteton se nuk është paraqitur edhe pse janë ndjekur të gjitha rregullat ligjore për njoftimin dhe ndërkohë prezenca e tij në proces nuk mund të zëvendësohet apo nëse Gjykata është e mendimit se i pandehuri për shkaqe të pavarura prej tij nuk ka mundur të paraqitet atëherë vetë ajo duhet të marrë vendim për të shtyrë procesin gjyqësor në një datë të mëvonshme.
- (iv) i akuzuari nuk duhet të gjykohet në mungesë, nëse është e mundur të transferohen procedimet te një shtet tjetër ose të aplikohet për ekstradim;
- (v) kur i akuzuari gjykohet në mungesë, provat duhet të merrren në mënyrë të zakonshme dhe mbrojtja duhet të ketë të drejtë të ndërhyjë;
- (vi) Të pandehurit, brenda afateve të parashikuara nga ligjit për ankim duhet t'i vihet në dispozicion vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë, dhënë në mungesë të tij si dhe afati i akimit duhet të nisë që nga momenti i dorëzimit të vendimit realisht të pandehurit të dënuar në mungesë në rastin kur i pandehuri i dënuar në mungesë i fshihet drejtësisë me vullnet të plotë të tij;
- (vii) Të pandehurit të gjykuar në mungesë duhet t'i krijohet mundësia që ai të shfrytëzojë të gjitha të drejtat që i njihen çdo të gjykuari në prezencë për t'u ankuar ndaj vendimit të dhënë në një Gjykatë më të lartë.
- (viii) T'i jepet mundësia çdo të dënuari në mungesë të panjoftuar ose njoftimi është i pavlefshëm për te realizuar të drejtat procedurale dhe kushtetuese për t'u ballafaquar në një rigjykim të ri.
- (ix) Çdo person i njoftuar rregullisht sipas ligjit procedural penal për procedimin në ngarkim të tij por që arsyet e mosprezencës së tij në gjykim nuk kanë qënë të varura nga vullneti i tij dhe këtë e vërteton para Gjykatës duhet të rigjykohet.

Pra, siç rezulton nga përcaktimi i kriterëve të gjykimit në mungesë të të akuzuarit, ndër të tjera është parashikuar detyrimi i Gjykatës e cila në rastet kur nuk ka siguri nëse njoftimi është kryer për të gjykuarin pavarësisht se formalisht është kryer duhet të përsërisë njoftimin.

GJEDNJ-ja është shprehur gjithashtu se njoftimi i të pandehurit për një proces të filluar kundër tij duhet të bëhet dhe brenda kornizave të parashikuara nga dispozitat procedurale dhe kushtetuese me qëllim të ruhen standartet dhe të drejtat që ka i pandehuri në një proces penal. Gjykata nuk mund të pranojë një njoftim sa për statistikë por edhe kur njoftimi është jo i drejtëpërdrejtë ai duhet të shprehë qartë që i pandehuri ka hequr dorë me vullnet të plotë. Çdo të dënuari(*in absentia*), i rezervohet e drejta nëse vërtetohet se mosprezenca në gjykim nuk ka të bëjë me heqjen dorë të rigjykohe dhe të përballet me akuzat, të marrë prova, të provojë dhe të ketë një vendim tjetër për të (*Sejdovic kundër Italisë, 2000*). Siç është theksuar në vendimet nr.30, datë 17.06.2010; nr. 45, datë 10.10.2011, nr.26, datë 08.05.2012 të Gjykatës Kushtetuese, mjetet procedurale të ofruara nga legjislacioni i brendshëm dhe praktika duhet të tregojnë se ato kanë qenë efektive, kur një person i akuzuar penalisht nuk ka hequr dorë nga të drejtat e tij për t'u dëgjuar dhe mbrojtur personalisht dhe as nuk i është fshehur drejtësisë.

Në bazë të akteve të fashikullit të gjykimit rezulton se personi i cili ka marrë njoftimin nuk jeton me të gjykuarin por është me vendbanimi në një qytet tjetër, çka e bën objektivisht të pamundur dhe në kundërshtim me personat e autorizuar nga ligji për të kryer njoftimin. Ky konkluzion arrihet dhe nga mungesa e njoftimit për të gjykuarin gjatë gjykimit në shkallë të dytë në rastin kur në adresën e pretenduar nga shkalla e parë ku është gjetur personi i cili ka marrë përsipër njoftimin nuk rezulton të banojë ndonjë person i afërt i të gjykuarit. Për këtë shkak nga ana e Gjykatës së Apelit është proceduar me anë të shpalljes për të gjykuarin në kushtet kur njoftimi nuk mund të kryhej nëpërmjet dorëzimit të njoftimit tek personat e autorizuar në banesën e tij.

Moskryerja e njoftimit nëpërmjet personit të autorizuar sjell edhe pavlefshmërinë absolute të njoftimit e parashikuar si e tillë në nenin 143/1 ¹⁶⁵gërma "c" e K.Pr.Penale.

Në këtë nen shprehet se "1.Pavlefshmëria e njoftimit":c)kur janë shkelur dispozitat e veçanta mbi personin të cilit duhet t'i dorëzohet kopja;"

Kodi i Procedurës Penale ka përcaktuar si absolutisht të pavlefshëm çdo akt procedural i cili ka të bëjë me njoftimin e të pandehurit. Për pasojë i gjithë procesi penal dhe vendimi penal i dënimit për të gjykuarin Y.Sh është i pavlefshëm.

Kolegji Penal konstaton se në rastin e gjykimit të zhvilluar kundër Y.Sh nuk i plotëson standartet e një procesi të rregullt ligjor në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ-së. Si pasojë e shkeljes së rregullave në lidhje me njoftimin nuk është

¹⁶⁵ Procedura penale lidhur me pavlefshmërinë e njoftimit.

respektuar e drejta e të gjykuarit për t'u dëgjuar në procesin gjyqësor të zhvilluar kundër tij si dhe e drejta për t'u mbrojtur nga akuzat, ne rigjykimin e çështjes.

8.2.8.4 Rast praktik.¹⁶⁶

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr.03, datë 12.01.2000, ka vendosur:

- Deklarimin fajtor të të pandehurit D.V për veprën penale të vrasjes me dashje në bashkëpunim, parashikuar nga neni 76, 25 te Kodit Penal dhe dënimin e tij me 12 vjet burgim.
- Deklarimin fajtor të të pandehurit D.V për veprën penale të armëmbajtjes pa leje, të parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 (tre)vjet burgim.
- Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal e dënon përfundimisht të pandehurin D. V. me 12 vjet burgim.
- Deklarimin fajtor të të pandehurit E.K për veprën penale të vrasjes me dashje në bashkëpunim parashikuar nga nenet 76 e 25 të Kodit Penal e dënimin e tij me 12 vjet burgim.
- Deklarimin fajtor të të pandehurit E.K për veprën penale të armëmbajtjes pa leje parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal e dënimin e tij me 3 vjet burgim.
- Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal e dënon përfundimisht të pandehurin E.K me 12 vjet burgim.

Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 90, datë 11.03.2010 ka vendosur:

- Lënien në fuqi të vendimit nr.03, datë 12.01.2000, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

¹⁶⁶Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë,ne Vendimin nr. 23/2012 ka vendos: Prishjen e vendimit Nr. 90, datë 11.03.2010, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe vendimit nr.03, datë 12.01.2000, të Gjykatës së Shkallës së parë Berat dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë Berat, me tjetër trup gjykues.

Kundër vendimit nr. 90, datë 11.03.2010, të Gjykatës së Apelit Vlorë ka ushtruar rekurs, i gjykuari, E. K, i cili kërkon: Prishjen e vendimit të mësipërm dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat me arsyetimin e mbrojtjes se:

Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat është marrë si pasojë e një procesi jo të rregullt ligjor dhe është i pavlefshëm pasi nuk janë respektuar dispozitat që lidhen me thirrjen e të pandehurit, parashikuar nga nenet 140, 141 të Kodit të Procedurës Penale.

-Në dosje nuk gjendet asnjë akt ligjor që të ketë lidhje me njoftimin e pandehurit. - Gjykatat kanë marrë të mirëqenë faktin se hetimet paraprake janë zhvilluar në mungesë të të pandehurit, duke mos mbajtur në konsideratë nenin 141/2 të Kodit të Procedurës Penale, i cili përcakton se **"vendimi i mosgjetyes i pushon efektet kur përfundojnë hetimet paraprake"**. Kjo do të thotë se ka qenë detyrë e Gjykatës që të procedojë duke njoftuar të pandehurin sipas nenit 140 të Kodit të Procedurës Penale.

-Vetëm nëse kërkimi i bërë nga ana e Gjykatës nuk do të jepte rezultat, Gjykata mund të nxirrte vendimin e mosgjetyes dhe t'i caktonte një mbrojtës të pandehurve.

-Siç rezulton edhe nga përmbajtja e nenit 351 të Kodit të Procedurës Penale deklarimi i mungesës sipas këtij neni, siç ka vepruar Gjykata bëhet vetëm për të pandehurin e lirë ose të paraburgosur, që nuk paraqitet në seancë edhe pse është njoftuar. Njoftimi i të pandehurit është kusht për kryerjen e çdo veprimi tjetër të mëpasëm procedural ashtu siç parashikon edhe neni 349 i Kodit të Procedurës Penale.

-Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat është i pavlefshëm pasi nga kjo Gjykatë janë lejuar shkelje të dispozitave procedurale që kanë të bëjnë me njoftimin e të gjykuarit, kjo duke sjellë në mënyrë absolute pavlefshmërinë e vendimit nr.03, datë 12.01.2000, të Gjykatës së Shkallës së Parë Berat dhe vendimit nr. 90, datë 11.03.2010, të Gjykatës së Apelit Vlore, pasi janë rrjedhojë e interpretimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit procedural penal dhe për këtë shkak duhet **të prishen dhe kthehen për rigjykim.**

7.2.8.5 Rast praktik¹⁶⁷

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin Nr.945, datë 26.12.2002 ka vendosur:

¹⁶⁷ Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në Vendimin nr. (35/2013) ka vendos: Prishjen e vendimit Nr.185, datë 02.04.2003 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të vendimit Nr.945, datë 26.12.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vetëm për të gjykuarin Besnik Vukaj dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me tjetër trup gjykues.

Deklarimin fajtor të të pandehurit B.V për veprën penale të “Shfrytëzimit të prostitucionit në rrethana rënduese” dhe në bazë të nenit 114/a pika 5 dhe 6 të Kodit Penal e dënon të pandehurin me 13 (trembëdhjetë) vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit A.K për veprën penale të “Shfrytëzimit të prostitucionit në rrethana rënduese” dhe në bazë të nenit 114/a pika 6 të Kodit Penal e dënon të pandehurin me 12 (dymbëdhjetë) vjet burgim në mungesë.

Gjykata e Apelit Tiranë mbi ankimin e të pandehurit A.K, me vendimin Nr.185, datë 02.04.2003 ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit Nr.945, datë 26.12.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin Nr.630 akti, datë 06.05.2011, ka vendosur: Pranimin e kërkesës.

“Rivendosjen në afat të së drejtës së kërkuarit B.V për të bërë rekurs në Gjykatën e Lartë ndaj vendimit Nr.185 datë 02.04.2003 të Gjykatës së Apelit Tiranë.”

Kundër vendimit Nr.185, datë 02.04.2003 të Gjykatës së Apelit ka paraqitur në datën 26.05.2011 rekurs i gjykuarit B.V nëpërmjet avokatit, duke kërkuar prishjen e vendimit Nr.945, datë 26.12.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të vendimit Nr.185, datë 02.04.2003 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se, rekursi i të gjykuarit B.V duhet të pranohet dhe vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë Nr.185, datë 02.04.2003, si dhe vendimi Nr.45, datë 26.12.2010, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë duhet të prishen për shkelje të ligjit procedural penal, me pasojë pavlefshmërinë e të dy vendimeve.

Në bazë të akteve të fashikullit të gjykimit rezulton se, B.V është gjykuar dhe dënuar në mungesë (*in absentia*) në të dy shkallët e gjykimit. Të drejtat e tij në procesin penal të zhvilluar në mungesë, në kushtet kur nuk ka zgjedhur mbrojtës, fillimisht, gjatë fazës së hetimit dhe gjatë shqyrtimit në të dyja shkallët e gjykimit, janë garantuar nga një mbrojtës i caktuar kryesisht nga Gjykata.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë konstaton se, nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë nuk janë respektuar rregullat për njoftimin e të pandehurit, të parashikuar nga neni 140 i Kodit të Procedurës Penale.

Në bazë të akteve rezulton se, pas dërgimit të akteve të fashikullit për gjykim, Gjykata kishte detyrimin ligjor në bazë të nenit 140 të K.Pr.Penale, që të njoftonte si organin e akuzës ashtu edhe të gjykuarin për të marrë pjesë në procesin penal të zhvilluar kundër tij.

Rezulton se në fazën e hetimit ashtu edhe të gjykit B.V ka patur masë sigurimi “Arrest në burg” në mungesë, vendosur me vendimin Nr.1418 akti, datë 07.12.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila nuk është ekzekutuar nga Policia Gjyqësore. Në këto kushte ky i gjykuar është hetuar dhe gjykuar në mungesë.

Në këto rrethana, njoftimi i tij duhet të bëhet sipas rregullave procedurale për të pandehurin në gjendje të lirë, sipas nenit 140¹⁶⁸ të Kodit të Procedurës Penale.

Në referim të kësaj dispozite rezulton se, akti duhet t’i dorëzohet personalisht të pandehurit dhe nëse kjo nuk është e mundur, atëherë ajo i dorëzohet personave që bashkëjetojnë me të ose në vendin e punës. Në rast se njoftimi nuk mund të realizohet në këtë mënyrë, atëherë procedohet me kërkimin në vende të tjera nëpërmjet policisë gjyqësore. Në rast se edhe në këtë mënyrë nuk është bërë i mundur njoftimi, siç përcakton kjo dispozitë në paragrafin e katërt, në qendrën administrative, lagjes apo të fshatit ku i pandehuri banon ose punon. Vetëm pasi të jenë respektuar këto procedura Gjykata mund të procedojë me deklarimin e mungesës së të pandehurit, duke i caktuar një mbrojtës kryesisht.

Pavlefshmëria e njoftimit vjen si pasojë e moszbatimit të urdhërësave të parashikuara nga neni 143¹⁶⁹ i K. Pr. Penale. Nga kjo pavlefshmëri vjen, ndoshta në disa raste prishja e vendimit dhe një rigjykim të ri. Për mënyrën e njoftimit Gjykata Kushtetuese në vendimin Nr.30, datë 17.06.2010, arsyeton: *“Për mënyrën e njoftimit kodi i procedurës ka përcaktuar një rend i cili është duhet zbatuar sipas preferencave të ligjit dhe detyrueshme për orgamin procdues dhe procesin e filluar në ngarkim të dikujt. Organi i akuzës ka për detyrë të provojë se i pandehuri i shmanget me vullnet procedimit të nisur ndaj tij ashtu sikurse i pandehuri ka të drejtë për të marrë pjesë në gjykipër përballjen me drejtësinë. Kur njoftimet rezultojnë të qarta është e drejta e Gjykatës të vendosë për të gjykuar në mungesë të pandehurin. Në çështjen objekt gjykimi, kundër B.V, nga aktet e fashikullit të gjykit rezulton se, njoftimi nuk është kryer. Meqenëse është deklaruar ikja e të*

¹⁶⁸ 1. Njoftimi i të pandehurit në gjendje të lirë bëhet duke i dorëzuar atij kopjen e aktit. Kur nuk mund t’i dorëzohet personalisht, njoftimi bëhet në banesën e tij ose në vendin e punës, duke ia dorëzuar aktin një personi që bashkëjetojnë me të ose një fqinji, ose një personi që punon me të.

2. Kur vendet e treguara në paragrafin 1 nuk dihen, njoftimi bëhet në vendin ku i pandehuri ka banimin e përkohshëm ose vendin ku qëndron më shpesh, duke ia dorëzuar atë njërit prej personave të treguar në paragrafin 1.

3. Kopja e njoftimit nuk mund t’i dorëzohet një të mituri nën 14 vjeç ose një personi me paaftësi të dukshme intelektuale.

4. Kur personat e treguar në paragrafin 1 mungojnë ose nuk janë të përshtatshëm, ose refuzojnë të marrin aktin atëherë procedohet me kërkimin e të pandehurit në vende të tjera. Në rast se edhe në këtë mënyrë nuk mund të bëhet njoftimi, akti depozitohet në qendrën administrative të lagjes ose të fshatit ku i pandehuri banon ose punon.

Lajmërimi i depozitimit afishohet në portën e shtëpisë së të pandehurit ose të vendit ku punon. Ftuesi gjyqësor e lajmëron atë për depozitim me letër rekomande me lajmërim marrje. Efektet e njoftimit rrjedhin që nga marrja e rekomandesë.

¹⁶⁹ N.143 i K.Pr.Penale **Pavlefshmëria e njoftimeve**

Njoftimi është i pavlefshëm:

c) kur janë shkelur dispozitat e veçanta mbi personin të cilit duhet t’i dorëzohet kopja;

ç) kur nuk është bërë afishimi i njoftimit për të pandehurin në gjendje të lirë;

pandehurit gjatë hetimeve paraprake dhe është caktuar masa e sigurisë "Arrest në burg" në mungesë, Gjykata e ka konsideruar të ezauruar njoftimin dhe ka zhvilluar gjykimin në mungesë duke i caktuar avokat kryesisht, për mbrojtjen e të drejtave të tij (seanca e datës 20.06.2002)

Kolegji Penal konstaton se, vendimi i deklarimit të mungesës është marrë jo në përputhje me kërkesat që parashikon nga neni 140/1 i K.Pr.Penale pasi i gjykuari nuk rezulton të jetë njoftuar në mënyrë korrekte, siç parashikon Kodi i Procedurës Penale.

Njoftimi i të gjykuarit në lidhje me procesin që zhvillohej kundër tij mbetet i pakryer e për pasojë, Gjykata në kushtet kur ky njoftim nuk është kryer tek vetë i gjykuari apo persona të cilët jetojnë bashkërisht me të në të njëjtën banesë, duhet të kishte përsëritur njoftimin.

Mbi bazën e garancive të parashikuara në K.Pr.Penale është njohur dhe parashikuar gjykimi në mungesë. Nje nga kushtet bazë për të patur një gjykim konform procedurës dhe K.E.D.NJ për një proces të rregullt ligjor, i një rëndësie të veçantë është njoftimi i të pandehurit, sipas dispozitave mbi "Njoftimet". Që të arrihet në konkluzion nga Gjykata se i pandehuri i fshihet gjykimin apo me dashjet të tij, është larguar dhe ka hequr dorë vullnetarisht nga prania në gjykim duhet t'u qëndrojë rigorozisht dispozitave të parashikuara në K.Pr.Penale pa neglizhuar asgjë në hetim dhe gjykim. Neglizhimi i zbatimit të këtyre rregullave procedurale të njoftimit sjell pavlefshmërinë absolute të procesit penal duke përfshirë dhe vendimin përfundimtar sipas nenit 128/1 gërma "c" të K.Pr.Penale dhe pasoja është më kosto ekonomike për një rigjykim si dhe një vendim tjetër me pasojë tjetër.

"Prania e të akuzuarit në gjykim"- si parim nën këndvështrimin e procesit ligjor sipas nenit 6/1 të KEDNJ-së, nënkupton praninë fizike të të akuzuarit. Në zbërthim të këtij parimi GJEDNJ në disa vendime (shih GJEDNJ 22 shtator 1994 Lala c/ Pays-Bas, 24.03.2005, Stoichkov c/Bulgarie) në të cilat është theksuar se: *"prania e të pandehurit ka rëndësi të madhe për procesin penal të rregullt ligjor dhe të drejtë, duke shtuar se detyrimi për t'i garantuar të akuzuarit të drejtën për të qenë i pranishëm...është një prej elementëve kryesorë të nenit 6"*.

Bazuar në rezolutën Nr.(75), 11 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës *"Për kriteret e gjykimin në mungesë të të akuzuarit"*,¹⁷⁰ u janë rekomanduar shteteve anëtare që të mbajnë parasysh rregullat minimale:

¹⁷⁰ Citim, në vendimin e Gjykatës Kushtetuese, Nr. 26, datë 08.05.2012

- a) Gjykata nuk mund të gjykojë në mungesë pa patur një njoftim të firmosur rregullisht nga i pandehuri brenda afateve ligjore
- b) Fletëthirrja e bërë nga administrata e Gjykatës duhet të përcaktojë penalitetet në rast mosparaqitjeje para Gjykatës.
- c) Edhe në rastin kur njoftimi i bërë nga Gjykata është i rregullt dhe i pandehuri nuk është prezent datën dhe orën e gjyimit dhe nëse Gjykata cmon se prania e të pandehurit është e domosdoshme dhe ka dyshim se mosardhja ka shkaqe të tjera nga ato që varen nga i pandehuri duhet të shtyjë gjykimin për një datë tjetër.
- d) I akuzuari nuk duhet të gjykohet në mungesë, nëse është e mundur të transferohen procedimet te një shtet tjetër ose të aplikohet për ekstradim;
- e) Kur i akuzuari gjykohet në mungesë, provat duhet të merren në mënyrë të zakonshme dhe mbrojtja duhet të ketë të drejtë të ndërhyjë;
- f) Njoftimi i të pandehurit për vendimin e dhënë ndaj tij në mungesë të tij duhet bërë me korrektësi dhe përgjegjësi nga ftuesit e Gjykatave duke mbajtur shënim datën e komunikimit me qëllim që i pandehuri të realizojë të drejtën e ankimit brenda afateve ligjor, afat i cili nga data e marjes dijeni.
- (x) Të trajtohet proceduralisht sikur të ishte prezent në gjykim çdo i pandehur i gjykuar në mungesë duke i siguruar çdo mjet ligjor për të patur të drejtën për ankim.
- (xi) Çdo person i njoftuar rregullisht sipas ligjit procedural penal për procedimin në ngarkim të tij por arsyet e mosprezencës së tij në gjykim nuk kanë qenë të varura nga vullneti i tij dhe këtë e vërteton para Gjykatës duhet të rigjykohet.

Pra, siç rezulton nga përcaktimi i kriterëve të gjyimit në mungesë të të akzuarit, ndër të tjera është parashikuar detyrimi i Gjykatës, e cila në rastet kur nuk ka siguri nëse njoftimi është kryer për të gjykuarin pavarësisht se formalisht është kryer duhet të përsërisë njoftimin.

GJEDNJ-ja është shprehur gjithashtu se, njoftimi i të pandehurit për një proces të filluar kundër tij duhet të realizohet dhe brenda kornizave të parashikuara nga dispozitat procedurale dhe kushtetuese me qëllim të ruhen standartet dhe të drejtat që ka i pandehuri në një proces penal. Nuk mund që Gjykata të pranojë një njoftim për statistikë por edhe kur njoftimi është jo i drejtëpërdrejtë ai duhet të shprehë qartë që i pandehuri ka hequr dorë me vullnet të plotë. Çdo të dënuari(*in absentia*), i rezervohet e drejta nëse vërteton se

mosprezenca në gjykim nuk ka të bëjë me heqjen dorë të rigjykohet dhe të përballet me akuzat, të marrë prova, të provojë dhe të ketë një vendim tjetër për të (*Sejdovic kundër Italisë*, 2000).

Siç është theksuar në vendimet Nr.30, datë 17.06.2010; Nr. 45, datë 10.10.2011, Nr.26, datë 08.05.2012 të Gjykatës Kushtetuese, mjetet procedurale të ofruara nga legjislacioni i brendshëm dhe praktika duhet të tregojnë se ato kanë qenë efektive, kur një person i akuzuar penalisht nuk ka hequr dorë nga të drejtat e tij për t'u dëgjuar dhe mbrojtur personalisht dhe as nuk i është fshehur drejtësisë. Gjykata arsyeton se, në bazë të akteve të fashikullit të gjykimit rezulton se ka mungesë të njoftimit për të gjykuarin edhe gjatë gjykimit në shkallë të dytë, pasi në shkresën për njoftim të të pandehurit për seancën e datës 12.03.2, nuk ka firmosur asnjë person. Edhe shkresat për njoftim të të gjykuarit B.V drejtuar Burgut Nr.313, janë formale, pasi ky i gjykuar në atë kohë nuk ka qenë në burg.

Moskryerja e njoftimit nëpërmjet personit të autorizuar sjell edhe pavlefshmërinë absolute të njoftimit e parashikuar si e tillë në nenin 143/1 gërma "c" e K.Pr.Penale. Në këtë nen shprehet se "Në rast se shkelen rregullat ligjore që janë parashikuar në ligj kur bëhet njoftimi duke mos iu dorëzuar të pandehurit, një kopje e vendimit të dhënë në mungesë të tij, atëherë njoftimi do të konsiderohet nga Gjykata nul, pra që nuk sjell asnjë pasojë ligjore".

Kodi i Procedurës Penale ka përcaktuar si absolutisht të pavlefshëm çdo akt procedural, i cili ka të bëjë me njoftimin e të pandehurit. Për pasojë i gjithë procesi penal dhe vendimi penal i dënimit për të gjykuarin B.V është i pavlefshëm.

Kolegji Penal konstaton se, në rastin e gjykimit të zhvilluar kundër B.V nuk plotësohen standartet e një procesi të rregullt ligjor në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ-së. Si pasojë e shkeljes së rregullave në lidhje me njoftimin, nuk është respektuar e drejta e të gjykuarit për t'u dëgjuar në procesin gjyqësor të zhvilluar kundër tij si dhe e drejta për t'u mbrojtur nga akuzat. Gjykata e Apelit megjithëse ka konstatuar shkelje me pasojë zhvillimin e një procesi të parregullt, nuk e ka vlerësuar si të tillë megjithëse është evidente shkelja e procedurave të njoftimit për të pandehurin në gjendje të lirë duke lënë në fuqi një vendim të pavlefshëm dhe jo duke disponuar në bazë të nenit 428/1 gërma "ç" i K.Pr.Penale me rigjykimin e çështjes.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë konstaton shkelje procedurale në zhvillimin e procesit me pasojë pavlefshmëri të vendimit përfundimtar në vendimin e Gjykatës së Apelit dhe të

Gjykatës së Shkallës së Parë vetëm për të gjykuarin B.V. dhe për pasojë të dy vendimet duhet të prishen dhe çështja të rikthehet për rigjykim.

8.2.8.6 Rast Praktik¹⁷¹

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë me vendimin Nr.58, datë 29.07.1998, ka vendosur në **mungesë**:

Deklarimin fajtor të të pandehurit P.M për veprën penale të " Vrasjes" dhe në bazë të nenit 78 të K.Penal dënimin e tij me 25 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit P.M për veprën penale të "Mbajtjes pa leje të armëve luftarake" dhe në bazë të nenit 278/2 të K.Penal dënimin e tij me 2 vjet burgim. Në zbatim të nenit 55 të K.Penal dënimin përfundimisht të të pandehurit P.M me 25 vjet burgim.

Gjykata e Apelit Durrës me vendimin Nr.143, datë 06.11.1998, ka vendosur pas ankimit të bërë nga mbrojtësi i zgjedhur nga familjarët : Lënien në fuqi të vendimit Nr.58, datë 29.07.1998, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë me vendimin Nr.113, datë 02.12.2008, ka vendosur: Refuzimin e kërkesës së të dënuarit P.M për rivendosje në afat të rekursit të paraqitur kundër vendimit Nr.143, datë 06.11.1998, të Gjykatës së Apelit Durrës si të pabazuar në prova e në ligj.

Gjykata e Apelit Durrës me vendimin e saj Nr.36, datë 06.07.2009 ka vendosur: Lënien në fuqi të vendimi Nr.113, datë 02.12.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Gjykata e Lartë me vendimin Nr.510, datë 09.10.2009, ka vendosur: Mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi P.M ndaj vendimit Nr.36, datë 06.07.2009, të Gjykatës së Apelit Durrës.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin Nr.09, datë 08.02.2011, ka vendosur: "Rrëzimin e kërkesës së kërkuesit P.M me objekt rivendosje në afat të ankimit kundër vendimit Nr.58, datë 29.07.1998, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, si të pambështetur në ligj dhe në prova."

¹⁷¹ Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr.169/2012 ka vendos:

Ndryshimin e vendimit Nr.101, datë 05.10.2011, të Gjykatës së Apelit Durrës dhe të vendimit Nr.09, datë 08.02.2011, të Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë.

Pranimin e kërkesës së kërkuesit (të gjykuarit) P.M.

Rivendosjen në afat të ankimit kundër vendimit Nr.58, datë 29.07.1998 të Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë.

Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin Nr.1182 (101), datë 05.10.2011, ka vendosur: "Lënien në fuqi të vendimit Nr.09, datë 08.02.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë."

Kundër vendimit Nr. 110, datë 05.10.2011, të Gjykatës së Apelit Durrës, ka ushtruar rekurs kërkuar P.M nëpërmjet avokatit të tij, i cili kërkon ndryshimin e vendimit dhe pranimin e kërkesës për rivendosje në afat, duke parashtruar shkaqet:

Vendimi është marrë në vlerësim të gabuar të provave dhe në zbatim të gabuar të ligjit material dhe atij procedural.

Gjykimi, si në shkallë të parë, ashtu dhe në shkallë të dytë është bërë në mungesë të të pandehurit P.M.

Mbrojtja e caktuar kryesisht nga Gjykata në shkallë të dytë nuk ka bërë rekurs në Gjykatën e Lartë, ndonëse ka kundërshtuar provat dhe ka kërkuar ekzaminimin psikik të të pandehurit gjatë gjykimit në shkallë të dytë.

Kemi kërkuar nga kjo Gjykatë rivendosjen e së drejtës të ushtrimit të Rekursit kundër vendimit nr.130 akti, datë 06.11.1998, të Gjykatës së Apelit Durrës, por nuk është pranuar; ky qëndrim është mbajtur edhe nga Gjykatat më të larta.

-Në datën 29.01.2008, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë me procesverbal ka vënë në ekzekutim urdhrin e prokurorit për ekzekutimin e vendimit penal Nr.58, datë 29.07.1998, procesverbal i refuzuar të nënshkruhet nga i pandehuri. Avokati ka kërkuar me shkresë të datës 13.05.2008, në Gjykatën e Lartë informacion nëse kjo çështje është gjykuar në këtë gjykatë dhe ka marrë përgjigje me shkresën B-40, datë 13.06.2008, se kjo çështje nuk është e gjykuar në këtë gjykatë. Në këto kushte është paraqitur kërkesë për rivendosje në afat të rekursit, që mban datën 16.06.2008 pra brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 147 të K.Pr.Penale.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese Nr.30, datë 17.06.2010, ka përcaktuar se avokati i caktuar nga familjarët barazohet me të drejtat që gëzon edhe avokati i përcaktuar nga vetë i pandehuri, dhe kjo krijon mundësinë reale për realizimin e kërkesës për rivendosje në afat.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka karakter urdhërues për të gjitha Gjykatat në lidhje me të drejtën e rihapjes së procesit gjyqësor dhe jep përcaktime në lidhje me të drejtën e avokatit dhe familjarëve në gjykimin në mungesë, njoftimet për fillimin e procedimit penal për gjykimin në mungesë dhe për vënien në dijeni të të pandehurit për vendimin e Gjykatës dhënë në mungesë të tij.

I pandehuri duhet të japë pëlqimin e tij si për avokat të caktuar nga familjarët e tij, ashtu edhe për avokat të caktuar kryesisht (pika 23 i vendimit të Gj. Kushtetuese). Është detyrë e organeve shtetërore që në mënyrë rigoroze dhe konform ligjit procedural të njoftojë të pandehurin që nuk gjendet në lidhje me akuzën. Vetëm pasi të jetë realizuar ky njoftim, i pandehuri është i lirë të vendosë nëse do marrë pjesë në gjykim apo jo; dhe njëkohësisht të vendosë në lidhje me caktimin e mbrojtjes – ta caktojë vetë apo t’ia delegojë të afërmeve (pika 38 e vendimit të Gj. Kushtetuese).

Gjykata Kushtetuese në pikën 30 të vendimit, përcakton rëndësinë e vendimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për çështjen “Somoggy kundër Italisë”, duke përcaktuar standardet e gjykimit, në konsideratë të Nenit 46 të KEDNJ, të detyrueshme edhe për Shqipërinë si shtet nënshkrues i Konventës, duke bërë të mundur lejimin e shtetasve, që nuk kanë pasur dijeni për procesin penal në ngarkim të tyre, të kenë të drejtën për rihapjen e procesit gjyqësor, në përputhje me Nenin 147 të K.Pr.Penale, detyrim që lidhet me të gjitha organet gjyqësore, në çdo shkallë.

Për të drejtën e të pandehurit për të qenë prezent në procesin penal kundër tij dhe për të drejtën për të zgjedhur përfaqësuesin ligjor e ka trajtuar Gjykata Kushtetuese në pikën 44 të vendimit si një të drejtë vetjake që nuk mund të transferohet tek familjarët. Familjarët nuk mund të caktojnë një avokat pa pëlqimin e të pandehurit. Të pandehurit i janë caktuar tre avokatë, një nga familjarët dhe dy kryesisht, që të tre pa dijeninë e të pandehurit; për këto arsye legjitimohemi në kërkesën tonë për rivendosje në afat.

Arsyetimi ligjor i kolegjit penal ndaj vendimit të ankimuar:

- a) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë ka arritur në përfundimin, që kërkesa e të gjykuarit është e pabazuar në ligj.
- b) Gjykata e Rrethit Kavajë arsyeton se fakti që i dënuari ka zgjedhur një herë të bëjë rivendosje ndaj rekursit në Gjykatën e Lartë nuk e justifikon vonesën e tij për të bërë ankim brenda afatit në Gjykatën e Apelit...
- c) Gjykata e Apelit Durrës me vendimin Nr.1182 (101), datë 05.10.2011, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit, duke arsyetuar, sikurse Gjykata e Shkallës së Parë për krimet e rënda, mungesën e kushteve për rivendosjen e së drejtës së ankimit në afat dhe i referon Vendimit Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë Nr.01, datë 20.01.2011
Në lidhje me (rekursin).

- a) Shkaqet e parashtruara në rekurs nga i gjykuari P.M, pasi u analizuan nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, kanë rezultuar të bazuara në ligj (Neni 432 i Kodit të Procedurës Penale) dhe si të tilla, do të pranohen.
 - b) Vendimet e Gjykatës së Apelit Durrës dhe asaj të Shkallës së Parë Kavajë, janë rrjedhojë e zbatimit jo të drejtë të ligjit procedural, në lidhje me respektimin e kërkesave procedurale, që kanë të bëjnë me kriteret për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, si dhe ato të përcaktuara në dispozita të posaçme procedurale (neni 147 i Kodit të Procedurës Penale.)
 - c) Nga aktet e ndodhura në dosjen hetimore dhe gjyqësore rezulton se gjyqimi në shkallë të parë dhe të dytë është bërë në mungesë të të gjykuarit P.M.
 - d) Praktika gjyqësore deri para disa kohësh ka pranuar se avokati i caktuar nga familjaret gëzonte të gjitha të drejtat që gëzon edhe avokati i caktuar nga vetë i pandehuri. Në vështrim të kësaj praktike të gjykuarit i është rrëzuar kërkesa për rivendosje në afat të së drejtës për të paraqitur rekurs.
 - e) Dalja e vendimeve Nr. 30 datë 17.06.2010 dhe Nr.45, datë 10.10.2011, të Gjykatës Kushtetuese bën të mundur që të ndryshojë mënyra e caktimit të mbrojtësit dhe se është vetë i pandehuri ai që, pasi të njoftohet për akuzën ka të drejtë të caktojë mbrojtës, ose ai detyrimisht duhet të japë pëlqimin për mbrojtësit e caktuar nga të afërmit e tij apo të caktuar kryesisht nga Gjykatat.
 - f) Po kështu Gjykata përpara se t'i caktojë avokat kryesisht, duhet që në një mënyrë apo tjetër (kur i pandehuri nuk gjendet) të marrë pëlqimin real të tij (pika 23 e vendimit të Gjykatës Kushtetuese)
 - g) Gjykata Kushtetuese përcakton rëndësinë e vendimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për çështjen "Somoggy kundër Italisë", duke përcaktuar standardet e gjyqimit, në konsideratë të Nenit 46 të KEDNJ, të detyrueshme edhe për Shqipërinë si shtet nënshkrues i Konventës, duke bërë të mundur lejimin e shtetasve, që nuk kanë pasur dijeni për procesin penal në ngarkim të tyre, të kenë të drejtën për rihapjen e procesit gjyqësor, në përputhje me Nenin 147 të K.Pr.Penale, detyrim që lidhet me të gjitha organet gjyqësore, në çdo shkallë.
- Gj Të drejtën e të pandehurit për të qënë prezent në gjykim dhe të drejtën për të zgjedhur përfaqësuesin ligjor e ka trajtuar edhe Gj. Kushtetuese si një e drejtë vetjake që nuk mund të transferohet tek familjarët.

h) Familjarët nuk mund të caktojnë një avokat pa pëlqimin e të pandehurit. Të gjykuarit P.M i janë caktuar tre avokatë, një nga familjarët dhe dy kryesisht nga Gjykatat që të tre pa dijeninë e të pandehurit;

Arsyetimi i kolegjit penal për zgjidhjen e çështjes

- Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga çdo shkallë e sistemit të drejtësisë në Shqipëri dhe predominojnë edhe mbi vendimet unifikuuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (vendimi Nr.1 datë 20.01.2011 KBGJL)
- Mundësinë e rivendosjes në afat të së drejtës së ankimit, kundër një vendimi penal që ka marrë formë të prerë, sipas paragrafit 1 dhe 2 të nenit 147 të Kodit të Pr. Penale e kanë të gjitha palët që marrin pjesë në procedimin penal kur provojnë pamundësinë për shkaqe të ardhura jo për faj të tij po të forcës madhore si dhe rastit faktor sipas paragrafit të parë dhe sipas paragrafit të dytë të kësaj dispozite kur provon se nuk është vënë në dijeni të vendimit të dhënë në mungesë të tij.
- Ndodhur para të tilla rrethanave, vendimi për rrëzimin e kërkesës me objekt rivendosje në afat të së drejtës së ankimit, për të gjykuarin P.M, i marrë nga Gjykata e Shkallës së Parë Kavajë dhe, i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit , gjendet jo në përputhje me ligjin procedural penal dhe për këto arsye Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, bazuar në përcaktimet e nenit 441/1, shkronja "b", e Kodit të Procedurës Penale ka vendos:

Ndryshimin e vendimit Nr.101, datë 05.10.2011, të Gjykatës së Apelit Durrës dhe të vendimit Nr.09, datë 08.02.2011, të Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë.

Pranimin e kërkesës së kërkuarit (të gjykuarit) P. M.

Rivendosjen në afat të ankimit kundër vendimit Nr.58, datë 29.07.1998 të Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë.

8.2.8.7 Rast praktik.¹⁷²

Gjykata e Rrethit Gjyqësor B, me vendimin nr. 03, datë 12.01.2000, ka vendosur:

¹⁷² Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në Vendimin nr. 23/2012 vendosi: Prishjen e vendimit Nr. 90, datë 11.03.2010, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe vendimit nr.03, datë 12.01.2000, të Gjykatës së Shkallës së parë Berat dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë Berat, me tjetër trup gjykues.

Deklarimin fajtor të të pandehurit D.V për veprën penale të vrasjes me dashje në bashkëpunim, parashikuar nga neni 76, 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 12 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit D.V për veprën penale të armëmbajtjes pa leje, të parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 (tre) vjet burgim.

Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal e dënon përfundimisht të pandehurin D.V me 12 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit E.K për veprën penale të vrasjes me dashje në bashkëpunim parashikuar nga nenet 76 e 25 të Kodit Penal e dënimin e tij me 12 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit E.K për veprën penale të armëmbajtjes pa leje parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal e dënimin e tij me 3 vjet burgim.

Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal e dënon përfundimisht të pandehurin E.K me 12 vjet burgim.

Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 90, datë 11.03.2010 ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr. 03, datë 12.01.2000, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

Arsyetimi ligjor i kolegjit penal ndaj vendimit të ankimuar:

- a) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr. 03, datë 12.01.2000, ka deklaruar fajtorë dhe dënuar të pandehurit duke arsyetuar se mbrojtësit e caktuar kryesisht nuk mundën të kundërshtojnë provat e paraqitura nga organi i akuzës. Gjykata duke vlerësuar provat e shqyrtuara në harmoni me deklaratimet e deklaruesve, të cilët nuk u paraqitën në seancë gjyqësore konkludon se autorë të vrasjes së shtetas A.B, janë të pandehurit E.K dhe D.V.
- b) Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 90, datë 11.03.2010, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat duke arsyetuar se gjatë fazës së hetimeve paraprake është njoftuar vëllai i të pandehurit E.K dhe më pas organi i Prokurorisë bazuar në nenin 141/1 të Kodit të Procedurës Penale, ka nxjerrë vendim për mosgjethjen e tij. Gjithashtu pretendimet e mbrojtjes së të pandehurit në lidhje me caktimin e rolit të secilit pandehur në kryerjen e veprës penale, nuk janë të bazuara pasi të pandehurit kanë pasur të njëjtin rol në kryerjen e veprës penale.
- c) Kundër vendimit nr. 90, datë 11.03.2010, të Gjykatës së Apelit Vlorë ka ushtruar rekurs, i gjykuari, E.K, i cili kërkon:

Prishjen e vendimit të mësipërm dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat. Duke parashtruar këto shkaqe:

- a) Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat është marrë si pasojë e një procesi jo të rregullt ligjor dhe është i pavlefshëm pasi nuk janë respektuar dispozitat që lidhen me thirrjen e të pandehurit dhe si i tillë duhet të ishte prishur nga Gjykata e Apelit Vlorë.
- b) Rezulton se gjykimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor është zhvilluar në mungesë dhe nga ana e Gjykatës nuk janë respektuar kërkesat e neneve 140, 141 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me njoftimin e të pandehurit.
- c) I pandehuri nuk është thirrur në gjykim në asnjë nga format e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale. Në dosje nuk gjendet asnjë akt ligjor që të ketë lidhje me njoftimin e pandehurit.
- d) Rezulton se seanca e parë për gjykimin e kësaj çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat është zhvilluar në datën 15.01.1999, më pas janë zhvilluar 15 seanca të tjera, të cilat janë shtyrë pa asnjë arsye ligjore, ndërkohë nuk rezulton që t'i jetë bërë njoftim të pandehurit apo familjareve të tij. Avokatët që ka thirrur Gjykata gjatë seancave kanë qenë pikërisht ata që janë caktuar nga organi i akuzës gjatë hetimeve paraprake për efekt të komunikimit të akuzës ndaj të pandehurve në mungesë.
- e) Në seancën e datës 13.10.1999, pa administruar asnjë akt në lidhje me njoftimet, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka deklaruar formalisht mungesën e të pandehurve duke u caktuar secilit një mbrojtës kryesisht dhe ka lejuar vazhdimin e gjykimit. Duke vepruar në këtë mënyrë Gjykata nuk i ka siguruar dhe garantuar të pandehurit të drejtën për të marrë pjesë dhe për tu dëgjuar në gjykim, duke shkelur kështu edhe parimet kushtetuese.
- f) Gjykatat kanë marrë të mirëqenë faktin se hetimet paraprake janë zhvilluar në mungesë të të pandehurit, duke mos mbajtur në konsideratë nenin 141/2 të Kodit të Procedurës Penale, i cili përcakton se "vendimi i mosgjetjes i pushon efektet kur përfundojnë hetimet paraprake". Kjo do të thotë se ka qenë detyrë e Gjykatës që të procedojë duke njoftuar të pandehurin sipas nenit 140 të Kodit të Procedurës Penale.
- g) Vetëm nëse kërkimi i bërë nga ana e Gjykatës nuk do të jepte rezultat, Gjykata mund të nxirrte vendimin e mos gjetjes dhe ti caktonte një mbrojtës të pandehurve.

- h) Siç rezulton edhe nga përmbajtja e nenit 351 të Kodit të Procedurës Penale deklarimi i mungesës sipas këtij neni, siç ka vepruar Gjykata bëhet vetëm për të pandehurin e lire ose të paraburgosur, që nuk paraqitet në seancë edhe pse është njoftuar. Njoftimi i të pandehurit është kusht për kryerjen e çdo veprimi tjetër të mëpasëm procedural ashtu siç parashikon edhe neni 349 i Kodit të Procedurës Penale.
- i) Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat është i pavlefshëm pasi nga kjo gjykatë janë lejuar shkelje të dispozitave procedurale të parashikuara nga nenet 140 e 141 të Kodit të Procedurës Penale mbi njoftimin e të pandehurit, kjo duke sjelle në mënyrë absolute pavlefshmërinë e vendimit.
- j) Te gjitha këto probleme dhe të tjera që kanë të bëjnë me zbardhjen e të vërtetës, duhet të mbahen parasysh në rigjykim, i cili duke qenë se do të zhvillohet në prani të të pandehurve do të mundësojë dhënien e një vendimi të drejtë.

Arsyetimi i kolegjit penal për zgjidhjen e çështjes

- Duke pasur parasysh gjithë sa më sipër, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se pretendimi i mbrojtjes së të pandehurit se, "vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat është marrë si pasojë e një procesi jo të rregullt ligjor dhe është i pavlefshëm, pasi nuk janë respektuar dispozitat që lidhen me thirrjen e të pandehurit dhe si i tillë duhet të ishte prishur nga Gjykata e Apelit Vlorë", është i drejtë.
- Në bazë të akteve të fashikullit të gjyimit rezulton se shtetësi E.K është gjykuar dhe dënuar në mungesë (in absentia). Të drejtat e tij në procesin penal të zhvilluar në mungesë në kushtet kur nuk ka zgjedhur mbrojtës as ai vetë dhe as familjarët, janë garantuar nga një mbrojtës i caktuar kryesisht nga Gjykata.
- Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë konstaton se nga ana e Gjykatës së shkallës së parë Berat nuk janë respektuar rregullat për njoftimin e gjyimit për shkak të shkeljeve të rregullave procedurale të parashikuara nga nenet 140 e 141 të Kodit të Procedurës Penale që kanë të bëjnë me procedurat penale për njoftimin e të pandehurit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat pa kryer asnjë procedurë për njoftimin e të pandehurit për ditën dhe orën e gjyimit, pa u siguruar ligjërisht se ky njoftim është bërë, në seancën e datës 13.01.1999 ka deklaruar mungesën e të pandehurit E.K, duke i caktuar atij avokat kryesisht. Deklarimi i mungesës së të pandehurit

është bërë në kundërshtim flagrant me nenin 351të Kodit të Procedurës Penale. Në këto kushte ky vendim ka cënuar rëndë të drejtën e të pandehurit për një proces të rregullt ligjor.

- Edhe arsyetimi i Gjykatës së Apelit Vlorë se, gjatë fazës së hetimeve paraprake është njoftuar vëllai i të pandehurit E.K dhe më pas organi i Prokurorisë bazuar në nenin 141/1 të Kodit të Procedurës Penale, ka nxjerrë vendim për mos gjetjen e tij, është i pambështetur në ligjin procedural penal, duke cënuar rëndë nenin 141/2 të Kodit të Procedurës Penale, ku përcaktohet se vendimi i mos gjetjes i pushon efektet kur përfundojnë hetimet paraprake.

Në çështjen objekt shqyrtimi gjyqësor, njoftimi i të pandehurit E.K,duhet të bëhej sipas rregullave procedurale për të pandehurin në gjendje të lirë sipas nenit 140 të Kodit të Procedurës Penale¹⁷³. Sipas kësaj dispozite rezulton se akti duhet t'i dorëzohet personalisht të pandehurit dhe nëse kjo nuk është e mundur atëherë ajo i dorëzohet personave që bashkëjetojnë me të ose në vendin e punës. Në rast se njoftimi nuk mund të realizohet në këtë mënyrë atëherë procedohet me kërkimin në vende të tjera nëpërmjet policisë gjyqësore. Në rast se edhe në këtë mënyrë nuk është bërë i mundur njoftimi, siç përcakton kjo dispozitë në paragrafin e katërt,behet njoftimi me shpallje. Shpallja vendoset në rajon apo në fshatin ku banon ose punon i pandehuri. Vetëm mbasi të jenë respektuar këto procedura Gjykata mund të ,procedojë me deklarimin e mungesës të të pandehurit duke i caktuar një mbrojtës kryesisht.

Nese nuk respektohen procedurat e parashikuara nga dispozitat procedurale në mënyrën më të mirë të mundëshme dhe të qartë atëherë do të ndodheshim para një pavlefshmërie të njoftimit sipas nenit 143 të Kodit të Procedurës Penale.¹⁷⁴ dhe si rezultat do të kishim pavlefshmërinë e procesit penal.

¹⁷³. Njoftimi i të pandehurit në gjendje të lirë bëhet duke i dorëzuar atij kopjen e aktit. Kur nuk mund t'i dorëzohet personalisht, njoftimi bëhet në banesën e tij ose në vendin e punës, duke ia dorëzuar aktin një personi që bashkëjeton me të ose një fqinji, ose një personi që punon me të.

Kur vendet e treguara në paragrafin 1 nuk dihen, njoftimibëhet në vendin ku i pandehuri ka banimin e përkohshëm ose vendin ku qëndron më shpesh, duke ia dorëzuar atë njërit prej personave të treguar në paragrafin 1.

Kopja e njoftimit nuk mund t'i dorëzohet një të mituri nën 14vjeç ose një personi me paafësi të dukshme intelektuale.

4. Kur personat e treguar në paragrafin 1 mungojnë ose nuk janë të përshtatshëm, ose refuzojnë të marrin aktin atëherë procedohet me kërkimin e të pandehurit në vende të tjera. Në rast se edhe në këtë mënyrë nuk mund të bëhet njoftimi, akti depozitohet në qendrën administrative të lagjes ose të fshatit ku i pandehuri banon ose punon.

Lajmërimi i depozitimit afishohet në portën e shtëpisë së të pandehurit ose të vendit ku punon. Ftuesi gjyqësor e lajmëron atë për depozitimin me letër rekomande me lajmërim marrje. Efektet e njoftimit rrjedhin që nga marrja e rekomandesë.

¹⁷⁴N.143 i K.Pr.Penale Pavlefshmëria e njoftimeve

Njoftimi është i pavlefshëm:c) kur janë shkelur dispozitat e veçanta mbi personin të cilit duhet t'i dorëzohet kopja;c) kur nuk është bërë afishimi i njoftimit për të pandehurin në gjendje të lirë;

Nese do të respektohen rigorozisht mënyra e njoftimit sipas një rendi të caktuar për njoftimi e të pandehurit, sipas preferencës ligjore, citon midis të tjerash Gjykata Kushtetuese ne vendimin nr.30/2010 me qëllimin e vetëm realizimin e njoftimit. Nëse nga njëra ane është detyrimi i administratës së Gjykatës të realizojë njoftimin dhe nëpërmjet nënshkrimit të të pandehurit apo në format e tjera të parashikuara në dispozitat procedurale që nëpërmjet tyre të vërtetojë se i pandehuri me dëshirën e tij fshihet gjykimin, nga ana tjetër është e drejta e të pandehurit për të qënë prezent në gjykim. Lidhur me detyrimin e të parës dhe të drejtën e të dytit lind e drejta e Gjykatës për të zhvilluar një proces në mungesë.

Moskryerja e njoftimit nëpërmjet shpalljes sjell edhe pavlefshmërinë absolute të njoftimit e parashikuar si e tillë në nenin 143/1 gërma "ç" e K.Pr.Penale. Në këtë nen parashikohet se "1. Njoftimi është i pavlefshëm:ç) kur nuk është bërë afishimi i njoftimit për të pandehurin në gjendje të lirë..."

Kodi i Procedurës Penale ka përcaktuar si absolutisht të pavlefshëm çdo akt procedural i cili ka të bëjë me njoftimin e të pandehurit. Për pasojë i gjithë procesi penal dhe vendimi penal i dënimit për të pandehurin E.K është i pavlefshëm.

Kolegji Penal konstaton se në rastin e gjykimin të zhvilluar kundër E.K nuk i plotësohen standartet e një procesi të rregullt ligjor në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ-së. Si pasojë e shkeljes së rregullave në lidhje me njoftimin nuk është respektuar e drejta e të gjykuarit për t'u dëgjuar në procesin gjyqësor të zhvilluar kundër tij si dhe e drejta për t'u mbrojtur nga akuzat.

"Prania e të akuzuarit në gjykim" - si parim nën këndvështrimin e procesit ligjor sipas nenit 6/1 të KEDNJ-së, nënkupton praninë fizike të të akuzuarit. Në zbërthim të këtij parimi GJEDNJ në disa vendime (shih GJEDNJ 22 shtator 1994 Lala c/ Pays-Bas, 24.03.2005, Stoichkov c/Bulgarie) në të cilat është theksuar se: "prania e të pandehurit ka rëndësi të madhe për procesin penal të rregullt ligjor dhe të drejtë, - duke shtuar se - detyrimi për t'i garantuar të akuzuarit të drejtën për të qënë i pranishëm...është një prej elementëve kryesor të nenit 6".

Gjykata duhet të bëjë të gjitha verifikimet e nevojshme të ndjekjes rigoroze të procedurave të njoftimit në përmbushje të të gjitha kushteve për një proces gjyqësor konform ligjit dhe më pas të dali në përfundimin se me vullnetin e tij të plotë i pandehuri me dëshirën e tij ka hequr dorë nga marja pjesë në gjykim dhe duke vijuar me gjykimin në mungesë. Duke u bazuar në garancitë e forta procedurale të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, po

në këtë kod është parashikuar edhe gjykimi in absentia. Në rast se nga verifikimet del që rregullat e procedurës së njoftimit nuk janë zbatuar konform ligjit si dhe nuk ka mundësi të shmangies së pasojës që vjen nga kjo parregullsi atëherë i gjithë procesi penal dhe vendimi i dhnë në mungesë bazuar në nenin 128/1 pika c shpallen absolutisht të pavlefshëm dhe gjithashtu vendoset rigjykimi i çështjes.

Sa më sipër, të dy vendimet e Gjykatave janë marrë në kundërshtim me nenin 383/ç të Kodit të Procedurës Penale, të cilët nuk kanë analizuar dhe arsyetuar shkaqet e refuzimit të pretendimeve të mbrojtjes të të pandehurit E.K.

Duke ju referuar fakteve dhe provave procedurale Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka dalë në konkluzion se vendimi Nr. 90, datë 11.03.2010 i Gjykatës së Apelit Vlorë dhe vendimi nr.03 datë 12.01.2000, i Gjykatës së Shkallës së Parë Berat, janë rrjedhojë e interpretimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit procedural penal dhe për këtë shkak duhet të prishen.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 441/ç të Kodit të Procedurës Penale, Vendosi:

Prishjen e vendimit Nr. 90, datë 11.03.2010, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe vendimit nr.03, datë 12.01.2000, të Gjykatës së Shkallës së parë Berat kthimin për rigjykim të çështjes, me tjetër trup gjykues.

8.2.8.8 Çështja Somogy ndaj Italisë¹⁷⁵

Nga autoritetet e shtetit Italian nisi procedimi penal ndaj shtetasit hungarez i dyshuar me akuzën trafik armësh i cili sipas Gjykatës italiane u njoftua në adresën e tij në Hungari për seancën e gjykimit nëpërmjet letër thirje rekomande. Gjykata konform dispozitave procedurale i ka caktuar kryesisht një mbrojtës dhe në përfundim të gjykimit është dënuar me tetë vite burg, vendimi mori forcë të prerë dhe u vu në ekzekutim. Mbas kërkesës të shumta i dënuari u arrestua në Austri, u ekstradua për ekzekutimin e vendimit në shtetin ku kishte kryer veprën penale, Itali.

Me ekstradimin e tij në shtetin Italian i dënuari Hungarez konform dispozitave procedurale kërkoi rivendosjen në afat të ankimit, për mosdijeninë e procedimit të nisur ndaj tij pasi pretendonte se nuk ishte firma e tij ajo e kthyer nga shteti Hungarez në emrin e tij duke kërkuar të verifikohej nëpërmjet një akti ekspertimi i cili nuk u bë nga Gjykata. Pretendime i dënuari Somogy kishte edhe për njoftimin e bërë jo në adresën e saktë të banimit të tij në shtetin Hungarez.

¹⁷⁵ Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, Smogyi v Italisë, vendim nr. 67972/01, datë 12.05.2004

Edhe pse këto pretendime të të dënuarit ishin të mjaftueshme për të pranuar kërkesën për rivendosje në afat të ankimit, të gjitha shkallët e Gjykatave të shtetit Italian e rrëzuan atë me argumentin se janë të pabazuara pretendimet e tij dhe duke ju referuar një procedure formale të ligjit procedural penal Italian duke u mjaftuar me një firëm e cila nuk u provua se ishte e të dënuarit.

I ndodhur në këto kushte kur i dënuari e humbi të drejtën për tu rivendosur në afat dhe rigjykuar në shtetin Italian, në datën 5 Mars viti 2001, ju drejtua Gjykatës së Strasburgut, në referim të nenit 6 të KEDNJ, për një proces të rregullt ligjor i shkelur nga Gjykatat Italiane për këtë të dënuar në mungesë.

Në ballafaqimin para Gjykatës së Strasburgut pala Italiane ju referua njoftimit të firmosur duke e prezumuar të rregullt dhe e ka konsideruar që i pandehuri me vullnetin e tij nuk ka marrë pjesë në gjykim dhe duke qënë i njoftuar, me dashje jo vetëm që nuk është paraqitur vetë në proces por nuk ka marrë edhe mundimin për të zgjedhur një avokat për ta përfaqësuar atë.

Në ndryshim nga Gjykata Italiane e cila e prezumoi si të tij firmën e të dënuarit pa bërë aktin e ekspertimit, ajo e Strasburgut duke parë se firmat në emrin e të dënuarit kishin një ndryshim thelbësor në pamjen e parë e mori në konsideratë këtë fakt dhe e quajti të dënuarin si të panjoftuar nga ana e Gjykatës Italiane, fakt ky i cili shkaktoi mungesën në gjykim pa vullnetin e tij.

Gjykata Italiane e mbështet pretendimin e saj se i dënuari në mungesë ka qënë në dijeni të procedimit edhe në faktin tjetër që ai është vënë në dijeni edhe nëpërmjet një interviste të bërë nga një gazetar, por GJEDNJ citon se njoftimit si akt juridik i një rëndësie të lartë që garanton zbatimin e rregullt dhe efektiv të të drejtave të të pandehurit për procedimin penal të nisur ndaj tij, duhet ti kushtohet një vëmendje e veçantë dhe një vlerësim rigoroz, pasi një dijeni jo e mirëfilltë nuk do të mjaftonte për ta prezumuar mungesën e të pandehurit si të vullnetshme .

Në rastin praktik të sipërcituar nuk ka asnjë provë ku i dënuari me sjellje të tij të ketë shfaqur dëshirën për të mos marrë pjesë në gjykim, por ai është munduar të provojë se nuk është njoftuar për procesin gjyqësor të zhvilluar ndaj tij. Por Gjykata e Strasburgut vlerëson se nga të drejtat e garantuara në KEDNJ mund të hiqet dorë vetëm qartazi nga i akuzuari.

Gjykata e Strasburgut për herë të parë në gjykimet në mungesë, në rastin konkret edhe pse kishte dyshime në lidhje me disa evitime që ka bërë kërkuesi duke shfrytëzuar

disa gabime të autoriteteve Italiane, mori vendimin se, nga autoriteti i shtetit Italian ka shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së pasi nuk është zbatuar detyrimi ligjor i tyre për të bërë verifikimet e nevojshme për një njoftim rigoroz dhe efektiv .

Duke u nisur nga vendimi i dhënë nga Gjykata e Strasburgut mund të themi se, autoritetet ndërkombëtare bazuar në nenin 6 të KEDNJ shërbejnë si mjet procedural i cili siguron zbatimin e drejtë të KEDNJ-së, ashtu sikundër ndodhi në çështjen Somogy ndaj shtetit Italian duke shërbyer dhe si një rast praktik për t'u ndjekur.

Autoritetet e shteteve të ndryshme në rast se neglizhojnë në verifikimin që duhet t'i bëjnë njoftimit të të pandehurit nëse ky njoftim është bërë efektiv dhe konform ligjit duke siguruar kështu të drejtat dhe garancitë që parashikon edhe neni 6 i KEDNJ-së atëherë këto të drejta shkelen në mënyrë të tërthortë apo të drejtpërdrejtë nga vet autoritetet me apo mos veprimin e tyre.

8.2.8.9 Çështja e Sejdivic ndaj Italisë ¹⁷⁶

Në sistemin procedural Italian, një tjetër rast vërteton edhe një herë se ka difekte në strukturën¹⁷⁷ e këtij sistemi pasi përsëri edhe në ankimin e ngritur nga Sejdivic ndaj tij më datë 10.11.2004, u rezultua se ky sistem nuk kishte vepruar konform rregullave të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Ndaj shtetasit jugosllav, Ismet Sejdivic në shtator të vitit 1992, pasi u mor masa e sigurimit arrest në burg për veprën penale të kryer pranë një kampi nomadësh në kryeqytetin e shtetit Italian, me objekt "goditje me armë zjarri me pasoje vdekje", provuar kjo prej dëshmive të dëshmitarëve okularë të ndodhur në vendngjarje dhe i akuzuari nuk u arrit të ndalohej, kjo masë nuk u ekzekutua dhe i akuzuari ndërkohë u shpall në mungesë duke iu caktuar kështu një avokat kryesisht nga Gjykata, për të vijuar më pas me të gjitha procedurat e njoftimit në drejtim të këtij të fundit.

Ndaj të pandehurit pas gjykimit që iu bë në mungesë të tij u mor një vendim ku ai dënohej me 21(njëzetë e një) vite e 8(tetë) muaj burg, vendim i cili mori formën e prerë më datë 22.03.1997 pasi avokati i të pandehurit i caktuar kryesisht nga Gjykata nuk bëri ankim ndaj tij.

Ndërkohë që vendimi i sipërcituar u bë i ekzekutueshëm, atëherë nëpërmjet një urdhër arresti ndërkombëtar të lëshuar nga shteti Italian , i dënuari u kap në shtetin

¹⁷⁶ Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, vendim i datës 10.11.2004 dhe vendim i Dhomës së Madhe, nr.56581/00 datë 01.03.2006

¹⁷⁷ Ky konstatim i bërë nga GjEDNJ-ja në një farë mënyre prek edhe vendin tonë duke pasur parasysh që dispozitat tona që rregullojnë institutin e gjykimit në mungesë dhe garancitë që e shoqërojnë, janë pothuajse të ngashme me ato të Kodit të Procedurës Penale Italiane.

gjerman, por ekstradimi i tij nuk u lejua nga ky shtet pasi sipas tyre shteti italian në lidhje me mjetet për rivendosjen në afat të ankimit dhe rigjykimin e çështjes nuk i siguronte efektivisht të dënuarit të drejtën për të kërkuar rihapjen e procesit për të cilin akuzohet¹⁷⁸.

Me pretendimin se në gjykimin që i ishte bërë të dënuarit Sejdivic ishte shkelur neni 6 i KEDNJ-së sepse ndaj tij ishte marrë një vendim gjyqësor në mungesë duke iu shkelur kështu e drejta për të marrë pjesë në gjykim si dhe e drejta për t'u ballafaquar vetë me akuzat përpara Gjykatës Italiane atëherë i dënuari i është drejtuar Gjykatës së Strasburgut me kërkesë më datë 2/03/2000.

Qeveria Italiane iu drejtua nga ana e saj Gjykatës së Strasburgut me pretendimin se kërkuuesi nuk ka ezauruar si fillim mjetet e brendshme që i sigurohen, por kjo e fundit nuk e mori në konsideratë këtë kërkesë si dhe njëkohësisht me vendimin e datës 12.10.2004, konstatoi se Gjykata Italiane kishte shkelur nenin 6 të KEDNJ, për këtë vendim qeveria Italiane kërkoi shqyrtimin nga Dhoma e madhe të çështjes.

Sipas qeverisë Italiane kërkuuesi nëse do të vinte në zbatim nenin 175 të Kodit të Procedurës Italiane nen i cili parashikon të drejtën për të kërkuar rivendosjen në afat të ankimit ndaj vendimit të dhënë në mungesë të tij, atëherë ai në radhë hierarkike do të bënte njëherë ezaurimin e mjeteve të brendshme që i ofroreshin nga legjislacioni Italian dhe më pas do t'i lindte e drejta për t'iu drejtuar Gjykatës së Strasburgut.

Gjykata e të Drejtave të Njeriut të cilës i është drejtuar me kërkesë Sejdivic vë në dukje se rregulli për të ezauruar mjetet e brëndëshme kërkojnë mjete efektivemë të mëdha se shkelja e të drejtave për të cilën i është drejtuar kësaj gjykate i dënuari Sejdivic.

Dispozita e Kodit të Procedurës Italiane neni 175 i jep të drejtën e rivendosjes në afat të dënuarit pasi të ketë provuar mosdijeninë e njoftimit për procedimin e nisur ndaj tij, si dhe të provojë se nuk është vullneti i tij mosparaqitja në gjykim dhe largimi në një vënd tjetër si në rastin konkret ska qënë për shkak të këtij gjykimi i cili sdinte asgjë për të. Qeveria Italiane faktin e mosgjetyes së të dënuarit Sejdivic gjatë kërkimeve pas krimit e kanë konsideruar si largim të qëllimshëm për të mos u përballur me drejtësinë, duke e lidhur këtë pretendim me deshmitaret okulare në vëndngjarje. Sipas qeverisë Italiane nuk duhej të mërrej në konsiderate procedura e shkelur por duhej ti vihej rëndësi ngjarjes dhe largimit të të pandehurit pra prezumimit se ai me dashj është larguar për të mos u përballur me drejtësinë Italiane.

¹⁷⁸ Në prill të 2005 Italia bëri pjesë të së drejtës së saj të brëndshme vendimin kuadër të Këshillit të Europës (BE) nr.2002/584/GAI "Il mandato d'arresto Europeo", i cili në rast se i pandehuri ishte gjykuar "in absentia" dhe nuk kishte marrë dijeni për procedimin, e kufizonte transferimin me kusht që shteti kërkuës të garantonte se të pandehurit do ti sigurohet një gjykim i ri në praninë e tij.

Gjykata për të Drejtat e Njeriut argumentin dhe konkluzionin e Qeverisë Italiane nuk e pranoi por evidentoi moszbatimin e detyrimit ligjor që kishte ajo për të provuar dijeninë e të pandehurit për procedimin e filluar ndaj tij dhe që po gjykohej në mungesë, dhe smund të konsiderohej largim nga vendbanimi për në një vënd tjetër me qëllim për tju shmangur gjykimin u shpreh kjo gjykatë.

Arsyet e largimit nga vendbanimi mund të kenë qënë të ndryshme dhe s' duhet të spekullohet mbi këto dhe të merrret apriori dhe të barazohet largimi nga vendi me kryerësin e veprës. Për të qënë të qartë Gjykata në këtë gjykim i është referuar një rasti analog lidhur me kerkesat e njoftimit të një personi ndaj të cilit ka filluar një procedim penal i dyshuar për një vepër penale, të cilat sipas kësaj gjykate janë të një rëndësie të vëçantë si në forëm dhe në substancë, për të patur një dijeni të qartë në përputhje me normat procedurale në zbatim rigoros i të drejtave të pandehurit.¹⁷⁹

Në shqyrtim të procesit, u pranua fakti se kërkuesi nuk kishte asnjë mundësi për të provuar para Gjykatës Italiane se nuk kishte dijeni për vendimin e dhënë ndaj tij dhe doli në konkluzion se mosdijenja ishte për faj të organit procedues gjatë hetimit dhe e administratës së Gjykatës gjatë gjykimin dhe më pas për njoftimin e vendimit të dhënë në mungesë në ngarkim të tij.

Ishin disa arsye që bënin të pamundur mundësinë e të dënuarit për të kërkuar rivendosjen në afat sipas afateve që parashikonin dispozitat procedurale Italiane.

I pabesueshëm është pretendimi se njoftimi mund të bëhej në një afat si ai i parashikuar nga legjislacioni në atë kohë (dhjetë ditë), për të realizuar nga i dënuari.

Për vetë faktin se ai ndodhej në një shtet tjetër dhe sa mundësi kishte të komunikonte me një mbrojtës që ndodhej në shtetin Italian dhe të binte dakort për të marrë përsipër mbrojtëjen në një proces të cilin nuk kishte dijeni me parë për të realizuar të drejtat që i nje ligji në një afat të tillë i cili nuk do të mjaftonte kurrësi.

Vështirësi të mëdha do të sillnin gjuha si një mjet komunikimi në një shtet të huaj, gjendja ekonomike (në burg) për të kontaktuar dhe marrë përfaqësuesin ligjor (avokat) i cili nuk mund të marrë përsipër pa kontakt me klientin që kërkon një kohë si dhe kosto të cilat nuk mund t'i ketë një i burgosur i cili nuk kishte dijeni për asgjë.

Duke arsyetuar mbi vështirësitë që ishin prezent për të dënuarin Sejdivic Gjykata e shkarkoi nga detyrimi, që kishte për të ezauruar shkallët e gjyqësorit Italian.

¹⁷⁹ Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, vendimi T. kundër Italisë, i datës 12.10.1992. Në vendimin e Dhomës së Madhe nënvizohet se nuk mund të përjashtohet fakti që disa rrethana mund të jenë aq thelbësore sa mund të japin një informacion të pakundërshtueshëm për dijeninë nga ana e kërkuesit, se ndaj tij kishte nisur një procedim penal dhe se ai me nuk kishte marrë pjesë në gjykim me vullnetin e tij të lirë.

Për të mos patur një proces të rregullt ligjoë nuk konsiderohen vetëm pengesat që ekzistojnë për t'iu drejtuar kësaj gjykate. Nëse çdokush i proceduar dhe gjykuar në mungesë për të cilin nuk ka provë se i është larguar procedimit dhe gjykimit duke pranuar faktin e mosparaqitjes si një e drejtë procedurale në zbatim të vullnetit të tij por, shprehet Gjykata duhet t'i njihet e drejta e një rigjykimi në mënyrë të pakushtëzuar për t'u përballur me akuzat

Lidhur me dispozitën (neni 175) që i ofron mundësinë e kërkesës,(si një e drejtë,) të dënuarit për rivendosje në afatin e ankimit të vendimit të dhënë në mungesë,nderkohë që i vë një detyrim të madh aspak ekuivalente me të drejtën,për të provuar mosdijeninë e procedimit të filluar si dhe shmangien nga gjykimi me dashje,duke shpërfillur njoftimet. Sipas Gjykatës për të Drejtat e Njeriut kjo dispozitë e Kodit të Procedurës Italiane është në kundërshtim me nenin 6 të Konventës Europiane dhe si e tillë është e nevojshme për ristrukturimin e sistemit të brendshëm Italian dhe lidhur me këtë vendim dalim në konkluzion:

Pasojat që solli ky vendim ishin shume të rëndësishme jo vetëm në planin personal të të dënuarit Sejdivic por në pasojat që solli në fushën juridike si dhe në aspektin praktik për të ardhmen në ndryshimin e legjislacionit Italian përse i përket procedurës për gjykimin në mungesë.

Si pasojë e shkeljes së nenit 6 të Konventës Evropiane e të Drejtave të Njeriut për rastin konkret Gjykata penalizoi shtetin Italian duke detyruar atë të dëmshpërblejë të cënuarin nga ky proces z.Sejdivic, por hapi një faqe të re në lidhje me konceptin që kishte dhe shprehte dispozita por edhe praktika e ndjekur nga shteti Italian duke prezumuar në disfavor të të pandehurit dhe në favor të ligjit, për një koncept të ri të njoftimit sipas ligjit në favor të të pandehurit duke shmangur të gjitha pengesat ligjore që do të konsideroheshintë tilla përse i përket afateve dhe mundësise së të dënuarit për të patur një proces ku të dëgjohej dhe gjykohej.

Pikërisht kjo gjykatë bëri të mundur që penalteti kundër shtetit Italian dhe dëmshpërblimi i z.Sejdivic të shërbejë,duke kaluar edhe detyrimin e të provuarit në vavor të të dënuarit bëri që kushti i dispozitës (neni 175 i K.Pr.Penale I) të mos zbatohej ndaj të dënuarve në mungesë përderi sa me njoftim zyrtar të qartë të shprehet dëshira për tu gjykuar në mungesë.

KREU IX

POZITA PROCEDURALE E MBROJTËSIT GJATË GJYKIMIT NË MUNGESË

Në një procedim penal roli i mbrojtësit është një nga hallkat e domozdoshme të pazëvendësueshme rol i cili është në rritje dhe në përsosmëri dhe në koherencë me realitetin dhe rendin shoqëror që jetojmë sot. Në Shqipëri para Luftës së Dytë Botërore roli i mbrojtësit ka qënë pothuaj i tillë, por mbas Luftës së Dytë roli i tij u zhvleftësua dhe u quajt i padobishëm¹⁸⁰ për shkak të vendosjes së sistemit të diktaturës komuniste dhe më pas socialiste të tipit Sovjetiko- Kinez, rreth viteve 1967 deri në asimilim të plotë duke mohuar të drejtën e mbrojtësit si të panevojshëm nëpërmjet legjislacionit procedural penal të viteve 80, dhe u deshën rreth dy dekada për t'u rivendosur Instituti i Avokatise në vitet 1990¹⁸¹ me ardhjen e demokracisë.

Një garanci që e shoqëron detyrimisht në çdo shkallë të pandehurin është e drejta për t'u përfaqësuar nga mbrojtësi, me dhe pa prezencën e tij, dhe lidhur me këtë të drejtë është shprehur GJEDNJ në çështjen "*Lala kundër Hollandës* " Për të patur dhe zhvilluar një proces penal sipas nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut është e domosdoshme dhe e detyrueshme që i pandehurit të këtë një mbrojtëje efikase profesionale në përputhje me standartet europiane dhe nëse nuk e ka duhet ti sigurohet në të gjitha shkallët e gjyqësorit.

Kushtetuta me nenin 31/ç garanton të drejtën e të pandehurit për të pasur mbrojtës, sipas të cilit duke e konsideruar si një të drejtë, por e marrë kjo në kontekstin bashkëkohor në frymën e nenit 6/3 të Konventës Europiane e të Drejtave të Njeriut që është në unison me nenin e sipërcituar të Kushtetutës, përveç një e drejtë është një detyrë e Gjykatave sipas shkallëve t'i sigurojë të akuzuarit mbrojtje kryesisht nëpërmjet të cilit do të mund të ballafaqohet me akuzën, dhe do të shfrytëzojë gjithë të drejtën që i njej ligji procedural penal, Kushtetuta dhe Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut.

9.1 Pozita e mbrojtësit të të pandehurit në mungesë.

Për një proces të rregullt ligjor¹⁸² e drejta për t'u mbrojtur në një proces penal është pjesë themelore e së drejtës, e cila është në funksion dhe favor të të pandehurit për të qënë i barabartë përpara Gjykatës që sot luan rolin e arbitrit midis palëve dhe mbi

¹⁸⁰ Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda " Komentari i Procedurës Penale", fq. 131.

¹⁸¹ Fillimisht të drejtat e mbrojtësit në procesin penal u pranuan të cunguara duke mos u lejuar pjesëmarrja e tij gjatë fazës së hetimit, por më vonë situata u rregullua.

¹⁸² Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, Poitrimol v Francës, vendim nr. , datë 23.11.1993, § 34.

palët në marrjen e vendimit. Për ta patur këtë barazi në proces është e nevojshme që organit të akuzës që është i specializuar në fushën e drejtësisë dhe është në mbrojtje të ligjit duhet që për të mbrojtur të drejtat procedurale dhe interesat e palës së akuzuar të jetë një tjetër person i kualifikuar në drejtësi që është avokati dhe një debat midis palëve të kualifikuara përbën dhe të ashtuquajturen "*barazi armësh në proces*". Kjo vjen në përputhje me legjislacionin procedural të brendshëm, atë kushtetues dhe atë ndërkombëtar. Është për të theksuar se në procesin civil palët janë në të njëjtën pozitë procedurale pasi në shumicën e rasteve janë palë private dhe nuk kanë të bëjnë me aparatin shtetëror si në procesin penal si e theksuam më lart të pandehurit duhet të mbrohet nga akuzat e bëra nga një institucion shtetëror i centralizuar, nga përfaqësuesi i shtetit që është garant i ligjit, organi i akuzës dhe në këtë rast pozita e të pandehurit është shumë më e disfavorshme dhe kjo bëhet edhe më e vështirë për të pandehurin e gjykuar në mungesë.

Referuar parimit të barazisë së armëve i cili nënkupton që gjithsecilit që gjykohet duhet t'i krijohet mundësia nëpërmjet mjeteve që ofron dispozitat procedurale, kushtetuese dhe ato ndërkombëtare, për t'u dëgjuar dhe debatuar me akuzën, të japë prova dhe të bëjë pyetje dëshmitarëve në proces, me një fjalë të jetë aktiv në proces. Pa pjesëmarrjen dhe dëgjimin e të pandehurit apo mbrojtësit të autorizuar nuk duhet të legjitimohet procesi në mungesë të tij, në kuptim të barazisë së armëve që në procesin e gjyimit në mungesë nuk mund të konsiderohen të tilla. Në këtë proces i pandehuri është në disavantazh me palën e akuzës.¹⁸³

Ka shtete si Franca që nëpërmjet Gjykatave si ajo e Asizit e cila i mohon të drejtën e mbrojtësit të pandehurit i cili gjykohet në mungesë, e cila është konsideruar si shkelje e të drejtave të njeriut nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, dhe për këtë ka marrë masa duke e panalizuar. Ajo ka theksuar se çdo shtet në legjislacionin e tij të brendshëm mund të ketë ligje që mund të nxisin pjesëmarrjen në gjykim por ato nuk duhet të jenë të tilla sa të bien ndesh me konventën si është rasti i "*Krombach kundër Francës*".¹⁸⁴ Edhe pse thotë Gjykata "i pandehuri me vullnet të shprehur kërkon të mos marrë pjesë në gjykim, apo i fshihet ballafaqimit me ligjin para gjykaës", duhet detyrimisht të mbrohet në gjykim nga mbrojtësi i zgjedhur prej tij ose nëse nuk ka një të tillë ti caktohet kryesisht nga Gjykata dhe smund të privohet nga mbrojtëja.¹⁸⁵

¹⁸³ Gjykata Kushtetuese, vendim nr.5, datë, 17.02.2003.

¹⁸⁴ Ledi Bianku, "Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut", fq. 390-393.

¹⁸⁵ Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, Poitrimol v Francës Vendim nr. 277 , datë 23.11.1993, § 35.

Referuar nenit 50/1 të K.Pr.Penale i cili i njeh mbrojtësit të gjitha të drejtat që i njeh dhe të pandehurit, vec rasteve të vecanta që këto të drejta janë të rezervuara nga ligji vetëm për të pandehurin. Kur jemi para këtyre rasteve të cilat kërkojnë vetëm të pandehurin, duhet që mbrojtja të ushtroi të drejtën eskluzeve të të pandehurit nëpërmjet një autorizimi të posacëm sipas dispozitave procedurale¹⁸⁶.

Por si mund të konkludojmë nëse e drejta eskluzeve duhet të shprehet qartë tagra e dhënë apo duhet të merrret kuptimi nga lloji i aktit? ¹⁸⁷ Procedura Penale Italiane e ka trajtuar se mund të merrren në konsiderate të gjitha ato veprime dhe situata, si dhe akte që cmohet se çënohet apo zbehet e drejta e të pandehurit si dhe ato të parashikuara shprehimisht me ligj. Kjo ndodh para se të jetë marrë një vendim nga Gjykata lidhur me këtë veprim, edhe pse dispozita i njeh mbrojtësit të drejtat e të pandehurit, veprimet e kryera prej tij mund të zhvleftësohen nga i pandehuri me një deklaram para Gjykatës.

Në bazë të nenit 410/2 të K.Pr.Penale i gjykuari në mungesë mund të bëjë ankim kundër vendimit vetë ose nëpërmjet mbrojtësit të posacëm të caktuar prej tij dhe kurrësi nga avokati i caktuar kryesisht. Referuar paragrafit të parë të kësaj dispozite Gjykata e Lartë shprehet se avokati i caktuar kryesisht merr të gjitha tagrat e të pandehurit që gjykohet në mungesë si e drejta e bërjes së kërkesave dhe kundërshtimin e akuzës për të garantuar të drejtat e të pandehurit në procesin penal të nisur ngaj tij. Por këto të drejta e humbasin fuqinë në përfundim të gjykimit në shkallë të parë, çka do të thotë se nuk ka më tagra për të bërë apelin e vendimit të dhënë nga Gjykata pasi një ankim i tillë do të konsiderohej jashtë kompetencave të njohura me ligj dhe do të quhej nul. Ashtu sikurse avokati i caktuar kryesisht nga Gjykata në shkallë të parë nuk mund të bëjë kërkesë për rivendosje në afat të ankimit të vendimit të dhënë në mungesë, sipas nenit 147/2 të K.Pr.Penale, të cilën ligji procedural penal dhe praktika gjyqësore e ka trajtuar si të drejtë eskluzeve të të dënuarit në mungesë.

Lidhur me formën e aktit të përfaqësimit që duhet të ketë përfaqësuesi i të pandehurit të gjykuar në mungesë, për të realizuar të drejtën e kërkesës për rivendosje në afat të ankimit që i njihet të pandehurit edhe pse në dispozitë nuk është e përcaktuar, ajo duhet të bëhet me shkrim para noterit publik sipas mënyrës së bërjes së akteve noteriale referuar kodit civil dhe ligjit të posacëm mbi noterinë duke përcaktuar tagrat në mënyrë të

¹⁸⁶ Shëmbull, " gjykimi i shkurtuar mund të kërkohej vetëm nga i pandehuri ose nga përfaqësuesi i tij i posacëm, neni 403/1 i K.Pr.Penale.

¹⁸⁷ D.Siracusano, A. Galati, G. Tranchina, E. Zappalà, " Diritto Processuale Penale", volume primo, Seconda Edizione, fq.223

¹⁸² vendimi unifikues nr.354/1999 të Kolegjeve të Bashkuara.

shprehur për të mos lënë interpretime për Gjykatën, dhe për të qënë si provë në dosjen gjyqësore për një verifikim të mundshëm në të ardhmen.

9.2 Mbrojtësi i caktuar kryesisht

Përfaqësimi nga një mbrojtës të pandehurit është një element thelbësor dhe i pashmangëshëm në procesin penal për një proces të rregullt ligjor, i cili mund të sigurohet nëpërmjet vetë të pandehurit ose të afërmeve të tij, kur është i arresytuar ose i ndaluar dhe nëpërmjet organit procedues i ndihmuar nga dhoma e avokatisë me listën e avokatëve që operojnë në këtë dhomë.

Po si është trajtuar caktimi i avokatit kryesisht në procesin penal të ankimuar nga *Artiko kundër Italisë*¹⁸⁸ në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut e cila nuk mori parasysh pretendimin e shtetit Italian se caktimi i një avokati kryesisht kishte realizuar detyrimin ligjor dhe standartin e kërkuar nga Konventa, duke analizuar në detaje konceptin "**caktim**" të një avokati thjesht për statistik i cili nuk shfaq ndonjë interes që ta mbajë lidhur me klientin dhe mund të heq dorë në çdo kohë dhe konceptin "**ndihmë**" për të cilën merrret avokati mbrojtës, që sipas nenit 6/3 pika c e Konventës e konsideron ndihmën efektive dhe pa rezerva nga ana e mbrojtësit, madje një detyrim kundrejt një shpërblimi me marveshje, duke e konsideruar si një të drejtë praktike në funksion të tij dhe jo teorike për statistik në letra si ndodh rëndom. Kjo gjykatë ka dalë në konkluzion se vetëm formaliteti i caktimit të një mbrojtësi kryesisht nga lista në raport me efektin që duhet të ketë është i pa mjaftueshëm për të qënë efikas në mbrojtëjen e të drejtave të të pandehurit të gjykuar në mungesë.

Për të garantuar një mbrojtje eficiente të një cilësie të lartë nga një mbrojtës i caktuar kryesisht kërkon një sistem të organizuar mirë dhe me përvojë që në vendin tonë është pothuaj e pamundur për faktin se nuk ka mekanizma ligjor që të garantojnë dhe të vënë para përgjegjësisë mbrojtësin e caktuar kryesisht, pasi e para dhe kryesore është caktimi i një tarife qesharake për një mbrojtje kryesisht e cila varion në 5000 leke për të gjithë procesin, i cili mund të zgjasë disa seanca gjyqësore dhe është pa interes për një avokat cilësor. Kjo bën që organi i akuzës të marrë nga lista avokat të rinj pa përvojë por që organit të akuzës i intereson të përfundojë procesin pa gjykuar për të drejtën e në mbrojtje efektive të të pandehurit.¹⁸⁹

¹⁸⁸ Ledi Bianku, "Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut", fq. 380-382.

¹⁸⁹ "Codice di Procedura Penale", commentato da Franco Cordero, Seconda Edizione, fq.115

Avokati i caktuar kryesisht në procesin penal në vëndin tonë por edhe më gjerë ngelet formal kjo për faktin se avokatia është një shërbim privat dhe për të qënë të drejtë është klienti (ipandehuri) si i vetmi person që e vë në lëvizje eficiente dhe për sa kohë ai nuk është prezent risku është evident. Sidoqoft një mbrojtje e cfardoshme është më e mirë se pa mbrojtje si në rastin kur nuk caktohet mbrojtës kryesisht. Në këtë rast i pandehuri i gjykuar në mungesë është totalisht i pa përfaqësuar dhe për pasojë i pa dëgjuar në gjykim. Mospasja e mbrojtësit sjell pavlefshmërinë e procesit si një proces i zhvilluar pa kontradiktorialitet, dhe standartin minimum të "barazisë së armëve" në procesin penal midis organit të akuzës dhe të pandehurit apo mbrojtësit, duke humbur balancën e ndëshkimit të krimit dhe të pandehurit si interesi më i lart publik, si dhe plotësimi i kushteve të interesit të të pandehurit për të ruajtur dhe mos u shkelur të drejtat e percaktuara nga dispozitat procedurale si mision i mbrojtjes i cili mbaron në përfundim të gjykimit të asaj shkalle që është caktuar.¹⁹⁰

9.3 Mbrojtësi i zgjedhur prej familjarëve .

Të pandehurit të arrestuar apo të ndaluar përveç zgjedhjes së bërë nga vetë ai, ligjvënësi i ka parashikuar edhe një tjetër garanci për të zgjedhur një mbrojtës, kur ai ndodhet në dhomat e paraburgimit dhe nuk mund të komunikojë më avokatin ose nuk njih një të tillë. Këtë të drejtë e parashikon Neni 48/3 i K.Pr.Penale i cili u njih të drejtën familjarëve ose të afërmeve të caktojnë një mbrojtës për të mbrojtur interesat e të arrestuarit apo të ndaluarit të cilit i përfundon kjo e drejtë mbas deklaramit para Gjykatës të të pandehurit. Kjo dispozitë është në përputhje të plotë me nenin 96/3 të Kodit të Procedurës Italiane e cila ka shërbyer si orientues në lëgislatorin tonë procedural.

Referuar këtij kodi dalim në konkluzion se ishte e domosdoshëme dhënia e kësaj garancie e cila shërben në funksion të procesit dhe jo vetëm si garanci në favor të të arrestuarit, kjo lidhet me vështirësitë që ndodhet personi në momentin e parë të arrestit, dhe kjo është parë një zgjidhje.

Pra kjo dispozitë është e zbatueshme vetëm për rastin kur i arrestuari apo i ndaluari ndodhet në dhomat e paraburgimit në momentin e parë dhe nuk ka komunikim me avokatët dhe nuk është i zbatueshëm për një të pandehur që me dashje është larguar dhe nuk merr pjesë në gjykim.¹⁹¹ Pra vetë qëllimi i kësaj dispozite është të letësojë fillimin e hetimit

¹⁹⁰ Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Vendim Unifikues nr. 371, datë 27.10.2000, shfuqizuar me vendimin nr.5, datë 07.02.2001 të Gjykatës Kushtetuese.

¹⁹¹ Corte di Cassazione, 31.10.1990, De Vitis

duke mos i shkelur të drejtën të arrestuarit deri në miratimin e tij ose jo të mbrojtësit të caktuar nga familjarët. Por kjo nuk mund të ndodhë me të pandehurin e gjykuar në mungesë të cilit nuk i njihet e drejta e zgjedhjes së mbrojtësit nga familjarët.

Lidhur me këtë të drejtë edhe pse ka patur debat midis Gjykatës së Lartë dhe asaj Kushtetuese për të drejtën e ankimit të vendimit dhënë në mungesë të të pandehurit, nuk është parë e arsyeshme të diskutohej e drejta e familjarëve për të caktuar një mbrojtës në rast se i pandehuri ishte gjykuar në mungesë. Por edhe nga doktrina nuk është par si problem që kërkonte zgjidhje, por është parë si zgjidhje e momentit të arrestimit apo ndalimit. Ndoshta ngaqë roli i avokatit të caktuar nga familjarët është afërsisht i barabartë me atë të caktuar kryesisht dhe nuk është si roli i avokatit të zgjedh nga vetë i pandehuri, i cili ka të drejtë të bëjë kërkesa dhe ankim ndaj vendimit të dhënë në mungesë.

Të njëjtin mendim ka dhënë Gjykata Kushtetuese në vendimin nr.15/2003 lidhur me mbrojtësin e caktuar kryesisht në shkallë të parë parashikuar nga neni 49/1 i K.Pr.Penale si dhe për atë të caktuar nga familjarët neni 48/3 i K.Pr.Penale, ku asnjëri prej tyre nuk mund të ankimoj vendimin e dhënë në mungesë të të pandehurit, duke legjitimuar vetëm kujdestarin e të miturit sipas nenit 49/2 të K.Pr.Penale, për të bërë ankim kundër vendimit të dhënë në mungesë.¹⁹²

Lidhur me nenin 48 të K.Pr.Penale Gjykata Kushtetuese në vendimin nr.17/2000 e quan të rregullt zgjedhjen nga familjarët duke trajtuar si shkelje të të drejtave themelore vendimin e Kolegjeve të Bashkuara, pasi shprehet akti i përfaqsimi është bërë në përputhje me dispozitat procedurale.¹⁹³

➤ *Gjykata kushtetuese mban një qëndrim ndryshe nga dispozitat procedurale në vendimin nr.195/2004 lidhur mbi gjykimet e bëra në mungesë të të pandehurit duke u dhënë të drejtë mbrojtësit të caktuar kryesisht dhe atij të caktuar nga të afërmit në zbatim të neneve 48 dhe 49 të K.Pr.Penale të bëjnë ankim ose rekurs kundër vendimit të dhënë në mungesë si dhe shprehet për detyrimin ligjorë që ka Gjykata respektive të gjykojë çështjen në themel.*

➤ Të njëjtin qëndrim mban Gjykata Kushtetuese edhe në vendimin nr.15/2003 lidhur me të drejtën e mbrojtësit të caktuar kryesisht apo të zgjedhur nga familjarët, që në praktikën gjyqësore aplikohet vetëm caktimi i avokatit kryesisht

¹⁹² Gjykata Kushtetuese, vendim nr.15, datë 17.04.2003, mendimi i pakicës

¹⁹³ Gjykata Kushtetuese, vendim nr.17, datë, 17.04.2000.

dhe kjo më shumë për formalitet për të mos u prishur vendimi si një proces jo i rregullt ligjor por jo ai i zgjedhur nga familjarët.¹⁹⁴

Nëse do ti referoheshim Gjykatës Kushtetuese dalim në konkluzion se familjarëve të të pandehurit u njihet e drejta për të zgjedhur një mbrojtës për të mbrojtur interesat e tij edhe pse nuk është e saksionuar në dispozitat procedurale konkretisht në nenin 48/3 të K.Pr.Penal dhe që kërkon të vendoset si një rast i parashikuar.

¹⁹⁴ Gjykata Kushtetuese, vendim nr.15, datë 17.04.2003, mendimi i pakicës

KAPITULLI X

KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

10.1 Konkluzione

Në përfundim të këtij punimi po paraqes konkluzionet dhe rekomandimet në lidhje me konstatimet e vëna re në legjislacion gjatë punimit shkencor në lidhje me hetimin dhe gjykimin në mungesë të të pandehurit si dhe procedura e ndjekur gjatë praktikave gjyqësore.

1. Sipas rregullit të përgjithshëm hetimi dhe gjykimi duhen të zhvillohen në prezencë të të akuzuarit, por gjykimi në mungesë nuk është një gjykim i zakonshëm ndaj duhet konsideruar si i veçantë dhe i përjashtuar nga rregulli. Në shumë shtete hetimi dhe gjykimi në mungesë, në mënyrën se si është ndërtuar legjislacioni penal praktikohet në raste të veçanta, ndaj të akuzuarit aplikohen sanksione të cilat stimulojnë marrjen pjesë në gjykim të të pandehurit. Legjislacioni në vendin tonë ka parashikuar hetimin dhe gjykimin në mungesë të të pandehurit si një e drejtë dhe jo si një detyrim, çka bën që ai të mos penalizohet. Lidhur me garancitë në favor të të pandehurit të hetuar dhe gjykuar në mungesë mendoj se janë të pamjaftueshme dhe të paqarta lidhur me një sërë dispozitash të cilat i njohin të drejtat të pandehurit i cili është në një pozitë jo të favorshme në krahasim me të pandehurin e hetuar dhe gjykuar në prezencë.

Sipas dispozitës, e cila parashikon të drejtën e të pandehurit për të qënë i pranishëm ose jo, i lihet në dëshirën e të pandehurit, i cili me vullnet të shprehur në kërkesën për thirrje konfirmon dijeninë e procedimit penal ndaj tij apo të gjykit. Por sipas këtij legjislacioni detyrimi ligjor për të krijuar mundësi optimale të akuzuarit për t'u ballafaquar në gjykim me akuzën është e organit procedues. I pandehuri që ka vendosur të mos jetë prezent në gjykim, vendimin e refuzimit për pjesëmarrje në debatin gjyqësor duhet ta deklarojë para Gjykatës ose ta komunikojë në postë. Në rastet kur organi i akuzës pretendon se i pandehuri qëllimisht dhe me faj ka zgjedhur t'i fshihet gjykit ose është larguar nga gjykimi, duhet t'i provojë pretendimet dhe dyshimet e saj, por i akuzuari sipas dispozitës pavarësisht zgjedhjes së tij mund ta revokojë vendimin e tij deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor.

2. Pavarësisht mungesës së të pandehurit Gjykata ka detyrim ligjor të hetojë mbi shkaqet e mosprezencës dhe kur provohet se arsyet e mosprezencës nuk janë pasojë e dëshirës

së të pandehurit por të ardhura jashtë mundësive të tij, atëherë Gjykata përsërit njoftimin dhe shtyn seancën në një datë tjetër me qëllim për t'u bindur me rregullsinë e njoftimit. Edhe për mbrojtësin e të pandehurit ndiqet e njëjta procedurë. Kur gjykimi zhvillohet në mungesë të të pandehurit dhe del se ai ka qënë i panjoftuar dhe pjesëmarrja në gjykim ka qënë jashtë mundësive të tij, vendimi i Gjykatës që ka deklaruar mungesën e tij duhet të shpallet i pavlefshëm. Në të njëjtin status të pamundësisë absolute për të qënë prezent në gjykim do të konsiderohet i akuzuari që gjykohej në një shtet tjetër apo një i burgosur që i ka përfunduar gjykimi, por është duke e vuajtur atë dhe prej tij kërkohet prezenca në gjykim, pezullohet nga Gjykata me vendim të ndërmjetëm deri sa i pandehuri ose i dënuari të ekstradohet dhe ai të paraqitet në gjykim.

3. Në vendin tonë organi procedues që ka detyrimin ligjor për të bërë njoftimin e të akzuarit, zbatohet procedura në shumë raste në mënyrë formale dhe kjo mjafton për të prezumuar dijeninë e të pandehurit, duke *"realizuar"* procedurën e një gjykimi në mungesë, me mendimin subjektiv se janë zbatuar procedurat e njoftimit sipas ligjit procedural penal. Rastet kur mendohet se procedura e ndjekur për njoftimet është reale dhe joformale bën që të kalohet në një prezumim të dytë lidhur me mosparaqitjen e të pandehurit edhe pse ai nuk di gjë për njoftimin i cili është prezumuar i rregullt, duke e quajtur mosparaqitje të dëshiruar nga i pandehuri dhe me dashje nuk është paraqitur duke iu shkelur e drejta e njoftimit dhe e prezencës në gjykim. Për të shmangur formalitetet në lidhje me njoftimet të cilat deri tani kanë krijuar boshllëqe për t'i krijuar mundësi prezumimit që u krijojnë mundësi gjykimeve jo të zakonshme si është ai në mungesë, është shumë e domosdoshme të prefeksionohet sistemi i njoftimeve duke mos lënë hapësirë padrejtësive gjatë procesit të hetimit apo gjykimit.

4. Është detyrë e organit procedues t'i njoftojë të pandehurit të gjykuar në mungesë konform dispozitave procedurale vendimin e dhënë ndaj tij. Nëpërmjet këtij detyrimi që ka organi i akuzës dhe Gjykata, i lind e drejta të pandehurit të ushtrojë të drejtën procedurale të ankimit të vendimit si dhe i njihet e drejta për të riçelur shqyrtimin gjyqësor në Gjykatën e Apelit nëse provon se gjykimi në mungesë ka ardhur si shkak i mosdijenisë së tij, apo shkaqeve ligjore që nuk lejojnë gjykimin në mungesë si rasti fator apo shkaqe madhore të pavarura nga vullneti i tij.

5. E garantuar nga legjislacioni i brendshëm procedural penal dhe Kushtetuta, e drejta e ankimit është një e drejtë e mbrojtur edhe nga legjislacioni ndërkombëtar si i vetmi mjet i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për të ruajtur standartet e një shteti demokratik, për të

pasur një mundësi ballafaqimi me akuzat në një gjykim të ri, kur i pari është bërë në mungesë të të pandehurit. Referuar Gjykatës Kushtetuese dhe asaj të Kolegjeve të Bashkuara arrijmë në konkluzion se po t'i referohemi të parës veç të pandehurit të gjykuar në mungesë të drejtën e apelimit të vendimit e ka dhe mbrojtësi i tij, si i zgjedhuri kryesisht apo nga familjarët, e cila bie ndesh me nenin 410/2 të K.Pr.Penale si dhe me vendimin e Kolegjeve të bashkuara të cilët i janë referuar procedurës penale .

Sipas Gjykatës Kushtetuese i njihet e drejta e ankimit mbrojtësit të caktuar kryesisht apo nga familjarët, e cila i heq të pandehurit të drejtën e ankimit pasi sipas dispozitave procedurale nuk mund të bëhet dy herë ankim për të njëjtën çështje dhe si pasojë nuk i jepet e drejta për t'u rigjykuar në prezencë të tij duke u ballafaquar me akuzat e ngritura ndaj tij, atë që GJEDNJ-ja e quan "*fresh determination of the merits of the charge*".

Në kushtet kur Gjykata Kushtetuese ka dhënë një mendim gjatë shqyrtimit të çështjes në vendimin nr. 17/2000 lidhur me të drejtën e ankimit nga mbrojtësi i të pandehurit i caktuar kryesisht si dhe avokati i caktuar nga familjarët, është e rëndësishme që të bëhet ndërhyrje në Kodin e Procedurës Penale ku të sanksionohet në mënyrë eksplicite në funksion të së drejtës procedurale, kushtetuese në unison me mendimin kushtetues.

1. Personi ndaj të cilit ka filluar nga organi i akuzës një procedim penal duhet detyrimisht të njihet me këtë procedim, por që të njihet duhet njoftuar nëpërmjet formave të parashikuara nga dispozitat procedurale dhe Kushtetuese, si dhe nga neni 6 i konventës Europiane e të Drejtave të Njeriut. Një njoftim efikas sipas ligjit bën të mundur shmangjen e abuzimeve nga organi që ka për detyrë njoftimin lidhur me formalitetin e njoftimit dhe prezumimin. Në kushtet e një njoftimi efikas të të pandehurit, por edhe në funksion të privilegjit në favor të të pandehurit duke e konsideruar një të drejtë marrjen pjesë të të akuzuarit në proces dhe jo një detyrim ai mund të mos marrë pjesë duke e deklaruar vullnetin e tij

Mosnjoftimi sipas dispozitave të përmendura më lartë humbasin efikasitetin dhe çojnë në pavlefshmëri të njoftimit dhe për pasojë të të gjithë procesit të nisur ndaj tij.

Në zbatim të së drejtës së të pandehurit për një proces të rregullt ligjor si dhe duke ndjekur rregullat e gjyimit edhe në Gjykatën e Lartë do të respektohet e njëjta rrugë ligjore për sa i përket njoftimit të të pandehurit të gjykuar në mungesë.

2. Bazuar në rregullat e njoftimit në lidhje me të pandehurin e gjykuar në mungesë si dhe sipas të drejtës që i jep ligji, neni 426 i Kodit të Procedurës Penale "për nxjerrjen e urdhërit për thirrje", Gjykata e Apelit njofton këtë të pandehur në gjykimin në Apel duke

mos i mohuar këtij të fundit të drejtën procedurale dhe kushtetuese, neni 33/1 i Kushtetutës, të drejtën për t'u dëgjuar përpara se të gjykohet.

Gjithashtu edhe kur i pandehuri ka bërë ankim në Gjykatën e Apelit për masën e sigurimit që i është caktuar nga Gjykata e Shkallës së Parë, është përsëri përgjegjësia e kësaj gjykate për të bërë njoftimin e të pandehurit të dënuar në mungesë. Ndërkohë nuk mund të barazohet pozita e mbrojtësit me atë të të pandehurit për sa i përket procedurës së njoftimit në Apel.

Gjithashtu nga ana e Gjykatës së Apelit nuk mund të prezumohet njoftimi i të pandehurit nga fakti që është njoftuar më parë mbrojtësi i caktuar nga Gjykata kur është deklaruar në mungesë ky i pandehur, por kjo gjykatë ka përgjegjësinë ligjore të bëjë përsëri njoftimin edhe nëse i pandehuri në mungesë gjykohet në masën e sigurimit "arrest me burg".

Meqënëse vendimi i largimit të të pandehurit ka të bëjë me masën e sigurimit që merret ndaj tij, ndërsa vendimi i mosgjetyes së të pandehurit lidhet me procedimin e bërë ndaj tij, ky i fundit ka për qëllim që kërkimet për të pandehurin e proceduar në mungesë të mos ndalojnë, por të bëhen në çdo shkallë të gjyqësorit, pra këto dy vendime nuk kanë efekte të njëjta, kështu edhe vlerat që ato mbartin nuk janë të njëjta.

3. Sipas parashikimeve të bëra në nenin 147/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit të gjykuar në mungesë i jepet mundësia që pas kërkesës për t'u rivendosur në afat të ankimit ndaj vendimit të dhënë në mungesë të tij të rivendoset në afat për të bërë ankim vetëm kur ky i pandehur vërteton se për shkak të rastit faktor apo forcës madhore nuk ka mundur të jetë prezent në gjykim. Por ky nen është mjaft i cunguar sepse nuk janë vetëm këto dy rastet sipërcituara të cilat duhet ta lejojnë të pandehurin e gjykuar në mungesë të rivendoset në afat nga Gjykata për të bërë ankim, pasi mungesa e të pandehurit në gjykim mund të vijë edhe prej shumë rasteve të tjera jo për faj të tij dhe që janë të ndryshme nga forca madhore apo rasti faktor.

4. Për sa i përket institutit të rivendosjes në afat të ankimit për vendimin e dhënë në mungesë, shërben si garanci e gjykimit në mungesë të të pandehurit i cili, nëse provon se nuk është vënë në dijeni të vendimit të dhënë ndaj tij në mungesë, sipas neni 147/2 të K.Pr.Penale i lind e drejta për të kërkuar rivendosjen në afat të ankimit ndaj këtij vendimi, për tu rigjykuar tanimë nga një tjetër gjykatë fakti dhe në prani të tij për tu ballafaquar me akuzat që i drejtohen, por ky institut nuk është edhe aq rezultativ pasi ka disa probleme teorike dhe praktike që kanë nevojë për tu parë dhe ndërhyrë nga legjislatori.

- Nëse i pandehuri kërkon rivendosjen në afat të ankimit për vendimin e dhënë në mungesë me objekt njohjeje duke u bazuar në nenin 147/2, atëherë kjo nuk do të jetë e mundur për t'u realizuar pasi gjykimi i njohjes nuk është gjykim themeli, rrjedhimisht i pandehuri nuk ka se si të jetë prezent në këtë gjykim. Por bazuar në nenin 147/1 të pandehurit në kohën e transferimit i lind e drejta të kërkojë rivendosjen në afat për ankim apo të lëshojë një prokurë të posaçme avokatit të zgjedhur prej tij për të bërë ankim.
- Në rast se ndaj një të pandehuri në mungesë është zhvilluar një proces gjyqësor në ngarkim të tij si dhe është marrë edhe vendimi përfundimtar përsëri në mungesë, ndërkohë që më pas të pandehurit nuk i është njoftuar vendimi apo njoftimi që i është bërë ka qënë i pavlefshëm atëherë rrjedhimisht afati dhjetë ditë i ankimit nuk ka ekzistuar kështu, këtij të pandehuri në momentin që vihet në dijeni për këtë vendim i fillon edhe afati dhjetë ditë për të bërë direkt ankim ndaj vendimit të dhënë në mungesë, vendim i cili për arsye se nuk janë bërë njoftimet kanform nenit 386/2 të K.Pr.Penale apo këto njoftime kanë qënë të pavlefshme nuk mund të ekzekutohet, në këto kushte nuk lind nevoja e bërjes së kërkesës për rivendosje në afat. Të pandehurit i lind e drejta për t'u rivendosur në afat vetëm në rast se ky afat është i kthyeshëm, pra vetëm në rastin kur afati është shuar për arsye se organi përgjegjës për bërjen e njoftimit, nuk e ka bërë një veprim të tillë.
- Sipas nenit 147/2 të Kodit të Procedurës Penale e drejta për të kërkuar rivendosjen në afat është një e drejtë personale të cilën e gëzon vetëm i pandehuri i proceduar dhe dënuar në mungesë si dhe avokati i zgjedhur nga vetë i pandehuri, të cilin ky i fundit bazuar në nenin 147/1 të K.Pr.Penale, e autorizon atë me një prokurë të posaçme.
- Për të pandehurin e proceduar dhe dënuar në mungesë lind detyrimi ligjor që për tu rivendosur në afat të ankimit duhet të vërtetojë se ai nuk është vënë në dijeni në lidhje me vendimin e marrë ndaj tij në mungesë si dhe duhet të provojë kohën kur ai realisht është njohur me vendimin. Por Gjykata e Strasburgut këto detyrime ligjore për të pandehurin i quan si vështirësi ligjore që i ngarkohen të pandehurit pa të drejtë duke e bërë edhe më të pamundur rivendosjen në afat të ankimit, fakt për të cilin u penalizua edhe shteti Italian nga kjo gjykatë duke e kaluar detyrimin e të mos pasurit dijeni në lidhje me vendimin si detyrim për Gjykatën dhe jo për të pandehurin. Kështu bazuar në nenin 147/2/3 të K.Pr.Penale i pandehuri duhet të vërtetojë se ai nuk ka marrë dijeni në lidhje me vendimin e dhënë ndaj tij dhe jo të vërtetojë në lidhje me dijeninë për procedimin e nisur ndaj tij. Gjithashtu, i pandehuri, në rast se me dëshirën e tij nuk ka dashur të marrë dijeni për

vendimin e dhënë atëherë ai nuk mund ta përdorë këtë si fakt që nuk ka marrë dijeni për vendimin.

➤ Që të rivendoset në afat kërkesa e të pandehurit për vendosjen në afat të ankimit ndaj vendimit të dhënë në mungesë të tij, duhet që ky ankim të mos jetë bërë nga avokati i zgjedhur prej tij nëpërmjet aktit noterial të parashikuar në Kodin e Procedurës Penale neni 410/2, i cili i heq të drejtën të pandehurit për të kërkuar rivendosjen në afat dhe si pasojë edhe të drejtën e ankimit. Në rastet kur kemi më shumë se një të pandehur, dhe të pandehurit që kanë qënë prezent në gjykim kanë bërë ankim, Gjykata që caktohet për të gjykuar kërkesën duhet të shqyrtojë dhe analizojë shkaqet e ankimit të bërë nga bashkëtpandehurit. Nëse shkaqet e ankimit të bërë nga bashkëtpandehurit e tjere kanë të bëjnë edhe më të pandehurin e gjykuar në mungesë kërkesa për rivendosje në afat nuk pranohet në të kundërt do të pranohet të rivendoset me qëllim për ti krijuar mundësinë të pandehurit e gjykuar në mungesë për t'u dëgjuar dhe gjykuar.

➤ Afati për të bërë kërkesën për rivendosje në afat të ankimit të dhënë në mungesë të të pandehurit është dhjetë ditë nga marrja dijeni sipas procedurës së parashikuar nga ligji procedural penal. Referuar praktikave gjyqësore afati dhjetë ditë është i pamjaftueshëm që i pandehuri i gjykuar në mungesë të realizojë një mbrojtje efektive për një çështje të panjohur. Në të njëtin përfundim ka dalë edhe GJEDNJ pasi sipas saj janë një sërë veprimesh procedurale që duhet të ndiqen nga i pandehuri duke filluar nga komunikimi për të rënë dakort me një mbrojtës të cilit duhet t'i vendosë në dispozicion fashikullin e gjykimit i cili duhet të tërhiqet me kërkesë nga arkivi i Gjykatës, veprime që kërkojnë një kohë më të gjatë se dhjetë ditë, çka e bën pothuajse të pamundur realizimin e së drejtës për rivendosjen në afat të ankimit. Për këtë fakt shteti Italian ka ndryshuar procedurën duke e zgjatur afatin deri në 30 ditë. Afati dhjetë ditë është i pamundur të realizohet kur i pandehuri ndodhet i arrestuar në një shtet tjetër. Brenda këtij afati i pandehuri i arrestuar ose i burgosuri i ndodhur në një shtet tjetër duke pritur të ekstradohet, duhet të realizojë komunikimin me një avokat të vendit të tij. Lind pyetja sa e vështirë është për ta realizuar këtë dhe sa afat kërkon? Për të mos thënë afatin që i duhet për t'u njohur me dosjen dhe për të bërë kërkesë, patjetër i duhet një kohë më e gjatë se ajo e përcaktuar nga ligji procedural penal shqiptar, i cili i trajton njësoj si të pandehurin e gjykuar në mungesë në Shqipëri edhe atë që ndodhet jashtë shtetit. Pikërisht për këtë arsye kërkohet të ndërhyet në legjislacionin procedural duke e barazuar atë me afatin e kodit të procedurës Italiane, në të cilën është parashikuar një afat 30 ditë nga marrja dijeni për vendimin e dhënë në mungesë.

➤ Referuar vendimit unifikues të Gjykates së Lartë , Gjykata e Shkallës së Parë është Gjykata e cila shqyrton kërkesën e të pandehurit për rivendosje në afat dhe gjykon më të njëtin numër anëtarësh të trupit gjykues që është gjykuar çështja në themel, kjo referuar rregullave të përgjithshme. Të pandehurit i njihet e drejta e ankimit ndaj vendimit që ka rrëzuar kërkesën së bashku me vendimin përfundimtar sipas nenit 147/5 i K.Pr.P. Gjykata e Lartë ka detyrimin ligjor të shqyrtojë kërkesën e bërë nga i pandehuri i gjykuar në mungesë, për t'u rivendosur në afatIn e rekursit, para se të shqyrtojë rekursin.

➤ Rivendosja në afatin e ankimit të vendimit të dhënë në mungesë të të pandehurit nuk realizon një gjykim të ri nga fillimi pasi ai garanton nëse pranohet kërkesa për një gjykim në Gjykatën e Apelit dhe jo në shkallë të parë, çka do të thotë se të pandehurit i krijohet një pjesë e së drejtës dhe konkretisht gjykimi në apel humbet ato të drejta që nuk i ke ushtruar në shkallë të parë si p.sh.të drejtën e gjykimit të shkurtuar etj.,por i jep mundësinë të kundërsjojë me prova vendimin e shkallës së parë, kur ka humbur gjykimin në këtë shkallë dhe garancitë që siguron kjo shklallë. Edhe në rastin e rivendosjes në afat të rekursit të pandehurit i privohet e drejta për tu dëgjuar për fakti se në këtë gjykatë gjykohet zbatimi i ligjit nëse është zbatuar në mënyrë korrekte ose jo dhe nuk ka debat ku të dëgjohet i pandehuri.

➤ Legjislacioni i GJEDNJ-së për të gjitha shtetet që aderojnë në konventë është orientues për legjislacionin e brendshëm dhe i detyrueshëm përfshirë edhe Shqipërinë. Është në disfavorin tonë fakti që legjislacioni ynë procedural bie ndesh me atë European lidhur me gjykimin në mungesë si dhe afatet e rivendosjes në afatin e ankimit kundër vendimit të dhënë në mungesë të cila sjellin pasoja në një gjykim të mundshën nga GJEDNJ-ja e cila si ka bërë edhe me shtete si Italia mund të na penalizojë dhe për të mos arritur aty çdo shtet para se të kërkojë të bëhet pjesë e një konvente duhet të përshtat legjislacionin me atë të Unionit.

5. Për të patur një gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe të pacënueshëm duhet të respektohet e drejta e mbrojtësit të të pandehurit e gjykuar në mungesë si një hallkë kryesore dhe e pazëvendësueshme në një shtet të së drejtës. Zbatimi i rregullave procedurale të njoftimit të të pandehurit formalisht për justifikim ligjor nuk do të siguronte ligjshmëri për organin e akuzës apo për atë gjykatë që e ka marrë si të mirëqenë faktin e mosparaqitjes në gjykim si prezumim i vullnetit të të pandehurit për të mos u ballafaquar më drejtësinë.

10.2 Rekomandime për përmirësimin e disa dispozitave Procedurale.

1. Procedura që duhet të ndiqet në rastet e ndryshimit të masës së sigurimit nga "arrest në burg" në "gjendje të lirë" të të pandehurit nuk është e përcaktuar qartë se cilat dispozita do të përdoren për njoftimin e të pandehurit pasi sipas nenit 139/4 nuk e specifikon banesën e zgjedhur, të deklaruar apo do të kryhen sipas nenit 140 e 141 të K.Pr.Penale.
 2. Në Kodin e Procedurës Penale janë parashikuar rregulla për njoftimin e të burgosurit, të të pandehurit në gjendje të lirë, kur nuk gjendet, njoftimi i të pandehurit jashtë shtetit, por nuk është parashikuar njoftimi i të pandehurit që ndodhet i izoluar në një institucion si spitali, apo njoftimi i të pandehurit pa zotësi juridike, etj.
 3. Për të realizuar një të drejtë të humbur pa faj të të pandehurit ligjvënësi ka parashikuar se si mund të rivendoset në afatin e ankimit i pandehuri i gjykuar në mungesë sipas nenit 147/1 i K.Pr.Penale vetëm dy raste edhe pse provon se mungesa ka ardhur për arsye që nuk vareshin prej tij dhe lidhur me këtë duhet të mos limitohet mundësia e rivendosjes në afat për t'u ankuar e cila i jep mundësi të pandehurit por edhe zbatimit të ligjit kushtetues nenit 33 "*kushdo që gjykohet duhet të dëgjohet*" i cili vjen në përputhje me unionin ku kërkojmë të bëhemi pjesë..
 4. Edhe pika 2 e nenit 147 e cila kërkon që të provohet nga i pandehuri dijenia duhet të ndryshohet pasi bie ndesh me kërkesat dhe praktikën e GJEDNJ-së dhe është e domosdoshme të njëjsohet me legjislacionin e unionit, duke e kaluar detyrimin e të provuarit organit të akuzës dhe jo të pandehurit i cili është në vështirësi për ta provuar.
 5. Të ndryshohet afati i përcaktuar në nenin 147/3 i K.Pr.Penale si i pamundur që i pandehuri të realizojë të drejtën e kërkesës për rivendosjen në afatin e ankimit kundër vendimit të dhënë në mungesën e tij. Kjo bëhet më absurde kur mendon se i pandehuri është i ndaluar në një shtet tjetër dhe i duhet të komunikojë me mbrojtësin nëse ka një të tillë dhe sa janë mundësitë e komunikimit dhe ky i fundit duhet të informohet lidhur me akuzën dhe më tej të përgatit kërkesën për rivendosje në afat që është objektivisht e përcaktueshme kur kemi të bëjmë edhe me ekstradime.
- Një gjë të tillë ka bërë dhe shteti Italian i cili ndryshoi afatin dhjetë ditë në tridhjetë ditë, për të realizuar kërkesën e rivendosjes në afatin e ankimit ndaj vendimit të dhënë në mungesë të të pandehurit në vitin 2005 mbas penalizimit që iu bë nga Gjykata e Stasburgut, madje për personin që ekstradohej afati fillon në momentin kur pritët nga

autoritetet e shtetit pritës. Ky afat është i mjaftushëm që i pandehuri të realizojë të drejtën e rivendosjes dhe ankimit.

6. Neni 148/1 i K.Pr.Penale duhet të formulohet në funksion të vendimit unifikues nr. 2 / 2002 të Gjykatës së Lartë ku kompetente për gjykimin e kërkesës për rivendosje në afat është Gjykata e Shkallës së Parë dhe Gjykatat e tjera shqyrtojnë ankimet e bëra në rastet e rrëzimit të kërkesës. Po ashtu duhet të përcaktohet dhe numri i gjyqtarëve që do të gjykojnë kërkesën, pasi në rastin e pranimit të kërkesës nga Gjykata e Lartë është kompetencë e Gjykatës së Shkallës së Parë të shqyrtojë çështjen në themel dhe kjo duhet të zgjidhet për të mos lënë vend për interpretime.

7. Në Kodin e Procedurës Penale nuk është parashikuar zgjedhja e mbrojtësit nga familjarët kur i pandehuri është në mungesë, e cila do t'i siguronte një mbrojtje më efektive se mbrojtësi i caktuar kryesisht nga organi procedues apo Gjykata, si dhe të parashikohet e drejta e ankimit nga ana e mbrojtësit të caktuar nga familjarët për të pandehurin e gjykuar në mungesë.

8. Sipas meje një të drejtë të domosdoshme, të porealizur ende do të konsideroja të drejtën për të kërkuar pezullimin e ekzekutimit të vendimit më rastin kur kërkohet rivendosja në afat për të bërë ankim, e cila nuk është parashikuar në dispozitat procedurale duke krijuar një boshllëk në legjislacion që cënon të drejtat e të pandehurit të hetuar dhe gjykuar në mungesë.

Përfundimisht përshtatja dhe adoptimi i legjislacionit tonë me atë Gjerman do të krijonte një standart më të garantuar lidhur me të drejtat procedurale të të pandehurit dhe do të zgjidhte kalvarin e rivendosjes në afat.

BIBLIOGRAFIA

a) Burimet parësore:

Legjislacioni

a)-Shqipëtar

1. Ligji nr.8417 date 21/10/1998 *“Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”*.
2. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, ratifikuar me ligjin nr. 7692 dt. 31.03.1993.
3. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, ratifikuar me ligjin nr.7510, dt.08.08.1991.
4. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ratifikuar me ligjin nr.8137, dt. 31.07.1996.
5. Ligji nr.7905 date 21.03.1995 *“Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”*, botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare.
6. Ligji nr.8813, dt.13.06.2002 *“Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Penale”*.
7. Statuti Themeltar i Republikës së Shqipërisë, miratuar nga Asambleja Kushtetuese më 07.03.1925.
8. Kushtetuta e Mbretnisë Shqiptare, miratuar nga Asambleja Kushtetuese më 01.12.1928 .
9. Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë, miratuar me dekretin nr.24 të Presidiumit të Asamblesë Kushtetuese më dt. 15.03.1946.
10. Kushteuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, miratuar nga Kuvendi Popullor i Shqipërisë më dt. 28.12.1976.
11. Ligji nr.7491 dt.29.04.1991 *“Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese”*
12. Ligji nr. 1650, dt. 30.03.1953 *“Kodi i Procedurës Penale i Republikës Popullore të Shqipërisë”*.
13. Ligji nr. 6069, dt. 25.12.1979 *“Kodi i Procedurës Penale i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”*.
14. Ligji nr.2805, dt. 04.12.1958 *“Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Penale të Republikës Popullore të Shqipërisë ”*.
15. *“Kodi i Procedurës Penale Otomane i zbatueshëm për Shqipërinë, i vitit 1879.*
- 16.

b) I huaj:

17. Il Nuovo Codice di Procedura Penale e le Leggi Complementari, a cura di Piermaria CORSO. Quindicesima edizione, 2007. Casa Editrice La Tribuna.
18. Ligji nr.67dt.28.04.2014 ndryshimet në ”Kodin e Procedurës Penale Italiane”.
19. Kode de Procedure Penal Francais,2008 [ëëë.lexadin.nl.htm](http://www.lexadin.nl/htm).
20. Kode de Procedure Penal Francais, shpallur me ligjin nr.57/1426 datë 31/12/1957.
21. ”Ligji nr.204 datë 09/03.2004 “Kode de Procedura Penale Francais i ndryshuar.
22. Kodi i Procedurës Penale Italiane 1865, me ndryshimet 1913, 1930.
23. Kodi aktual i Procedurës Penale të Italisë 22/09.1988.
24. Ligji nr.67 dt. 8.04.2014, me ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale Italiane.
25. Kodi Procedurës Penale të Republikës Federale të Gjermanisë datë 01/02/1877 me ndryshime në vitin 1949,1952,1968,1990.
26. Kodi i Procedurës Penale të Republikës Çekisë (Ceske Republiky).
27. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës 01/01/2013.
28. Kodi i Procedurës Penale të Portugalisë 17/02/1987.
29. Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (Sh.B.A) viti 1787.
30. Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, 1950.
31. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, 1948.
32. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, 23 mars 1976.
33. Criminal laë akt 1826 Unitet Kingdom.(Angli)

b)-Burime Dytesore:

LITERATURË:

a) Shqiptare:

1. Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda “Komentar i Procedurës Penale”, botime “MORAVA”, 2003.
2. Ejup Selfo,”E Drejta e Procedurës Penale” Universiteti i Prishtinës 2005.
3. Halim Islami, “Demokratizimi i legjislacionit penal”, shtëpia botuese“LUARASI”, Tiranë 2000.

4. Ylvi Myrtja, "Gjykimi në mungesë", Trajtime Juridike, 2001.
5. Fredi Paskali, "Gjykimi në mungesë i të pandehurit", Tribuna Juridike, nr.30 2001.
6. Prof. Dr. Ismet Elezi, "E drejta zakonore e Labërisë", botime "TOENA", Tiranë 2002.
7. Xhemal Meçi, "Kanuni i Lekë Dukagjinit, në Variantin e Mirditës", shtëpia botuese "GEER", 2002.
8. Revista juridike "Drejtësia Popullore", nr.4, viti 1957.
9. Revista juridike "Drejtësia Popullore", nr.3, viti 1951.
10. OSCE, Mari-Ann Roos LL.M, "Analizë e sistemit të drejtësisë penale në Shqipëri, raport i programit për zhvillimin e një gjykimi të drejtë", shtëpia botuese "PEGI" 2006.
11. OSCE, Maya Goldstein-Bolocan, "Analiza e procedimeve të çështjeve penale në Republikën e Shqipërisë", Shtypi nga "albPAPER" 2007.
12. Dr. Ejup Sahiti, "E drejta e procedurës penale", Universiteti i Prishtinës, Prishtinë 2005.
13. "Historia e shtetit dhe e së drejtës", pjesa I, shtëpia botuese "LUARASI" 1997.
14. "Historia e shtetit dhe e së drejtës", pjesa II, shtëpia botuese "LUARASI" 1997.
15. Ledi Bianku, "Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut", shtëpia botuese "EDLORA" 2005.
16. "Për një rend publik European", vendime të zgjedhura të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, vëllimi I, Tiranë 2001.

b) E huaj:

17. Franco Cordero, "Procedura Penale ", Terca Edizione, GIUFFRE 1995.
18. "Codice di Procedura Penale", commentato da Franco Cordero, Seconda Edizione, UTET 1992.
19. "Commento al nuovo Codice di Procedura Penale", coordinato da Mario Chivaria, UTET, 1992.
20. "Digesto delle discipline penalistiche", volume III CONCU-DIN, "Contumacia nel diritto processuale penale", Aniello Nappi, UTET 1995.
21. "Digesto delle discipline penalistiche", volume VI GIURI-INFRE, "Contumacia nel diritto processuale penale", Aniello Nappi, UTET 1995.

22. D.Siracusano, A. Galati, G. Tranchina, E. Zappalà, “Diritto Processuale Penale”, volume primo, Seconda Edizione, GIUFRE editore 1996.
23. D.Siracusano, A. Galati, G. Tranchina, E. Zappalà, “Diritto Processuale Penale”, volume secondo, Seconda Edizione, GIUFRE editore 1996.
24. Stephanos STAVROS, “The guarantees for accused person under article 6 of The European Convention on Human Rights”, (an analysis of the application of the convention and a comparison with other instruments), MARTINUS NIJHOFF PUBLISHER 1996.
25. Gaston Stefani, Georges Levasseur, Bernard Bouloc, “Procédure Pénale”, 16^e édition, DALLOZ, 1996.
26. Jean-Claude Soyer, “Droit Penal et Procédure Pénale” 13^e édition, L.G.D.J, 1997.
27. Black’s Laë Dictionary, sixth edition, ËST publishing 1990.

JURISPRUDENCË:

a) Shqiptare:

VENDIME TË GJYKATËS KUSHTETUESE

1. Vendim nr.31, datë 14.07.1998
2. Vendim nr. 17, datë 17.04.2000
3. Vendim nr. 20, datë 18.04.2000
4. Vendim nr. 33, datë 24.05.2000
5. Vendim nr. 48, datë 28.07.2000
6. Vendim nr. 3, datë 29.01.2001
7. Vendim nr. 5, datë 07.02.2001
8. Vendim nr. 9, datë 22.02.2001
9. Vendim nr. 17, datë 09.03.2001
10. Vendim nr. 17, datë 04.04.2001
11. Vendim nr. 23, datë 23.04.2001
12. Vendim nr. 53, datë 27.06.2001
13. Vendim nr.124, datë 27.09.2001
14. Vendim nr. 5, datë 17.02.2003
15. Vendim nr. 15, datë 17.04.2003
16. Vendim nr. 21, datë 20.09.2005

17. Vendim nr. 24, datë 26.10.2005
18. Vendim nr. 21, datë 24.07.2006

VENDIME TË KOLEGJEVE TË BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

1. Vendim nr. 30, datë 28.01.1999 (unifikues)
2. Vendim nr. 47, datë 28.01.1999 (unifikues)
3. Vendim nr. 354, datë 28.07.1999
4. Vendim nr. 386, datë 29.07.1999 (unifikues)
5. Vendim nr. 371, datë 27.10.2000 (unifikues)
6. Vendim nr. 1, datë 15.02.2001 (unifikues)
7. Vendim nr. 2, datë 19.04.2001 (unifikues)
8. Vendim nr. 2, datë 14.10.2002 (unifikues)
9. Vendim nr. 5, datë 10.10.2002 (unifikues)

VENDIME TË KOLEGJIT PENAL TË GJYKATËS SË LARTË

1. Vendim nr.650, datë 06.11.2002
2. Vendim nr. 47, datë 22.01.2003
3. Vendim nr. 66, datë 16.06.2003
4. Vendim nr.387, datë 09.07.2003
5. Vendim nr. 519, datë 08.10.2003
6. Vendim nr. 38, datë 08.04.2004
7. Vendim nr.195, datë 21.04.2004
8. Vendim nr.663, datë 22.12.2004
9. Vendim nr.663, datë 22.12.2004
10. Vendim nr.146, datë 16.03.2005
11. Vendim nr.306, datë 11.05.2005
12. Vendim nr.303, datë 11.05.2005
13. Vendim nr.532, datë 06.07.2005
14. Vendim nr.575, datë 20.07.2005
15. Vendim nr.152, datë 29.03.2006
16. Vendim nr.225, datë 19.04.2006
17. Vendim nr.351, datë 31.05.2006

18. Vendim nr.410, datë 18.04.2007
19. Vendim nr.412, datë 18.04.2007
20. Vendim nr.424, datë 25.04.2007
21. Vendim nr. 61, datë 06.02.2008

VENDIME TË GJYKATË SË APELIT TIRANË

1. Vendim nr.891, datë 20.12.2005
2. Vendim nr.687, datë 22.02.2005.
3. Vendim nr.969, datë 24.12.2007
4. Vendim nr. 36, datë 26.05.2006

VENDIME TË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TIRANË

1. Vendim nr. 80, datë 17.02.2005
2. Vendim nr. 460, datë 24.02.2005
3. Vendim nr. 460, datë 09.06.2005
4. Vendim nr. 20, datë 18.01.2006
5. Vendim nr. 106, datë 24.01.2006
6. Vendim nr. 347, datë 21.02.2006
7. Vendim nr. 639, datë 18.04.2006
8. Vendim nr. 1129, datë 18.05.2006
9. Vendim nr. 931, datë 01.06.2006
10. Vendim nr. 1605, datë 26.09.2006
11. Vendim nr. 80, datë 26.02.2007
12. Vendim nr. 349, datë 15.02.2007
13. Vendim nr. 447, datë 06.03.2007
14. Vendim nr. 425, datë 21.06.2007
15. Vendim nr. 311, datë 22.10.2007
16. Vendim nr. 491, datë 21.03.2008

b) E huaj:

VENDIME TË GJYKATËS EUROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

- | | | |
|--|---|---------|
| 1. Vendim nr. 89 seria A , datë 12.02.1985 Colozza | v | Italisë |
| 2. Vendim nr. 208-B ser. A, datë 28.08.1991 F.C.B. | v | Italisë |
| 3. Vendim nr. 20491/92, datë 2001 Medenica | v | Zvicrës |
| 4. Vendim nr. 14405/05, datë 21.12.2006 Zunic | v | Italisë |
| 5. Vendim nr. 42191/02, datë 19.06.2005 R.R. | v | Italisë |
| 6. Vendim nr. 56581/00, datë 10.11.2004 Sejdivic | v | Italisë |
| 7. Vendim nr. 56581/00, datë 01.03.2006 Sejdivic | v | Italisë |
| (vendim i Dhomës së Madhe) | | |
| 8. Vendim nr. 67972/01, datë 12.05.2004 Smogyi | v | Italisë |
| 9. Vendim nr. 277 , datë 23.11.1993 Poitrimol | v | Francës |
| 10. Vendim nr. 6694/74, datë 13.05.1980 Artico | v | Italisë |
| 11. Vendim nr. 30900/02, datë 30.09.2003 Jones | v | Anglisë |
| 12. Vendim nr. 29731/96, datë 03.02.2001 Krombach | v | Francës |
| 13. Vendim nr. 71555/01, datë 2001 Einhorn | v | Francës |
| 14. Vendim nr. 50489/99, datë 04.12.2001 Ivarazzo | v | Italisë |

BURIME NGA INTERNETI

<http://www.Gjykatatirana.al.gov>
<http://www.Gjykataelarte.gov.al>
<http://www.gjk.gov.al>
<http://www.qpz.gov.al>
<http://www.ligje.org>
<http://www.camerrapenalevittorichiusano.it/index>
<http://www.lexadin.nl.htm>
<http://www.echr.com>
<http://www.osce.org/albania>
<http://www.altalex.com/idex.php>
<http://www.foroeuropeo.it>
<http://www.sioi.org>
<http://www.cortedicassazione.it>
<http://ëëë.overlex.com>